



# Rrënjët e besimit

Manuali i mësuesit

Pjesa 1

*Do ta njihni të vërtetën dhe e vërteta do t'ju  
bëjë të lirë (Gjoni 8:32).*



TruthSeekers





# TruthSeekers

## **Rrënjët e besimit**

### **Mësimet 1 - 33**

© 2011 Awana® Clubs International

1 East Bode Road, Streamwood, IL 60107-6658 U.S.A.  
internationalprogram@awana.org • (630) 213-2000

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Shtypur në SHBA. Asnjë material nga ky publikim nuk mund të riprodhohet apo të përkthehet pa leje të shkruar nga botuesi.


Awana dhe logoja Awana janë marka të regjistruara të Awana Clubs International. Tërë citimet e Shkrimit janë marrë nga Bibla, Diodati i Ri, përkthimi 1991-94. E drejta e autorit Albanian Bible Society. Përdorur me leje. Tërë të drejtat e rezervuara.



Mësimi kronologjik të Kartat Awana dhe “Ndihmat e mësimdhënies” në Manualin e Mësuesit Rrënjët e besimit të Kërkuesve të së Vërtetës Awana janë përshtatur nga Botimi i fëmijëve, Themelet e qëndrueshme: nga krijimi të Krishti (Librat 2 dhe 3).

Parimet e mësimdhënies që gjenden në seksionet “Udhëzimet për mësuesin” dhe “Si të përgatisësh mësimet” të Manuali i Mësuesit janë përshtatur nga Libri 1 i Botimit të fëmijëve, Themelet e qëndrueshme: Nga krijimi të Krishti.

Kur kërkohet për metodën më të qartë, më të thjeshtë e në të njëjtën kohë më të kuptueshme të mësimet të Fjalës së Perëndisë për t’i përgatitur njerëzit për ungjillin dhe për t’u mësuar rrugën e shpëtimit të Perëndisë, Trevor McIlwain-i e gjeti përgjigjen në Fjalën e Perëndisë. Botimi i fëmijëve, Themelet e qëndrueshme: nga krijimi të Krishti u përshtat nga seritë Ndërtimi në themelet e qëndrueshme shkruar nga Trevor McIlwain-i. Duke iu lutur Zotit për drejtim, skuadra e autorëve të këtyre librave zhvilloi parimet e mësimdhënies që hodhën themelet e qëndrueshme për besimin që shpëton duke mësuar një paraqitje të përgjithshme kronologjike të historisë së Biblës, duke filluar me Zanafillën dhe duke mbaruar me ngjitjen e Krishtit.



TruthSeekers

## Përmbajtje

### Seksioni 1

#### **Të kuptojmë mësimet e Kohës së Mësimit . . . .7**

Themelet e Ungjillit . . . . .9

Temat doktrinare . . . . .15

### Seksioni 2

#### **Si t'i përdorim këto mësimet . . . .19**

Udhëzime për mësuesin . . . . .21

Si të drejtojmë një fëmijë të Krishti . . . . .27

Si të përgatisësh mësimin . . . . .30


### Seksioni 3

#### **Ndihma të mësimit për mësuesin -**

**Mësimet 1-33 . . . . .35**

### Seksioni 4

**Mësimet për ata që kanë munguar . . . . .147**



# TruthSeekers

## **Rrënjët e besimit**

### **Manuali i Mësuesit**

## **Seksioni 1**

### **Të kuptojmë Mësimet**



TruthSeekers

## **Të kuptojmë Mësimet**

<b>Themelet e ungjillit</b> .....	9
<b>Temat doktrimore</b> .....	15
Personi dhe karakteri i Perëndisë .....	15
Perëndia komunikon me njeriun .....	15
Perëndia është kudo në çdo kohë; Ai di gjithçka .....	15
Perëndia është i plotfuqishëm .....	16
Perëndia është i shenjtë dhe i drejtë. Ai kërkon vdekjen si pagesë për mëkatin .....	17
Perëndia është i dashur, i mëshirshëm dhe plot hir .....	17
Perëndia është besnik; Ai bën gjithmonë atë që thotë; Ai nuk ndryshon asnjëherë .....	17
Njeriu .....	17
Satani .....	17
Jezu Krishti .....	18



# Themelet e ungjillit

Kartat Awana janë përshtatur nga mësimet kronologjike të mësimëve *Botimi i fëmijëve*, *Themelet e qëndrueshme*: nga krijimi te Krishti. Është e rëndësishme që ti, si mësues, të njohësh themelet (apo bazën) biblike mbi të cilat mbështeten mësimet tona Awana.

## **Perëndia ka caktuar Krishtin dhe ungjillin e Tij si bazën e vetme për besimin e mëkatarëve fajtorë.**

Perëndia ka caktuar Krishtin dhe ungjillin e Tij si bazën e vetme për besimin e mëkatarëve fajtorë.

*Sepse askush nuk mund të hedhë themel tjetër përveç atij që është hedhur, i cili është Jezu Krishti (1 Korintasve 3:11).*

*Tani, o vëllezër, po ju deklaroj ungjillin që ju kam shpallur dhe që ju e keni marrë dhe mbi të cilin ju qëndroni, dhe me anë të të cilit ju jeni shpëtuar, nëse do ta mbani fjalën që ju kanë predikuar, veç nëse besuat kot (1 Korintasve 15:1-2).*

Në ndërtimin e çdo ndërtese, pjesa e parë që përgatitet është themeli dhe jo çatia. Pa pasur një themel të mirë, ndërtesa do ta ketë të vështirë të qëndrojë ose mund të rrëzohet. Kjo është e vërtetë edhe për Fjalën e Perëndisë. Ai nuk filloi me ungjillin, por filloi të hidhte themelin e duhur për ungjillin. Nëse nuk vëmë një themel mbi të cilin të mbështesim mësimin e mesazhit të ungjillit, fëmijët e klubit tonë mund të bëjnë dëshmi të rreme apo boshe të besimit. Përndryshe, si të krishterë të rinj fëmijët e klubit mund të kenë dyshime apo pasiguri rreth asaj që besojnë. Kjo gjë mund të përbëjë një problem veçanërisht kur të përballen me vështirësi dhe të tjerët të vënë në dyshim besimin e tyre. Pa një themel të fortë e biblik rreth asaj që një person beson, është e lehtë, që për shkak të frikës apo presionit, ai të kthehet në besimet, zakonet dhe traditat e tyre të vjetra.

## **Vetëm Bibla është zbulimi i shkruar i Perëndisë për botën**

Vetëm Bibla është zbulimi i shkruar i Perëndisë për botën. Kjo është e vërteta themelore e krishterimit. Shumë fe të rreme po fitojnë ithtarë për shkak të shkrimtarëve liberalë dhe modernë, të cilët pohojnë se janë të krishterë, mësojnë se e vërteta nuk është e kufizuar te Shkrimet hebraike e të krishtera. Ata thonë se e vërteta gjendet edhe në shkrimet e feve të tjera të botës. Pohimet e njerëzve fisnorë animistë rreth së vërtetës janë mbështetur në folklore dhe zbulime nga frymërat. Përgjegjësia e mësuesit të krishterë është që me ndihmën e Frymës së Shenjtë dhe përmes mësimit të Shkrimit, të mëshojë në mënyrë të qartë, se zbulimi i së vërtetës së Perëndisë ndaj tërë njerëzve gjendet në Bibël. Prandaj nëse fiset dhe kombet e botës duhet të njohin të vërtetën dhe bekimet e Perëndisë, ata duhet të kërkojnë në Bibël, si zbulimi i vetëm hyjnor, i vërtetë dhe i plotë. Ky zbulim i Perëndisë filloi me Dhiatën e Vjetër dhe u plotësua me zbulimin e Dhiatës së Re në dhe përmes Mesisë së Izraelit, Jezusit të Nazaretit.

*Perëndia, mbasi u foli së lashti shumë herë dhe në shumë mënyra etërve me anë të profetëve, së fundi, këto ditë na ka folur me anë të Birit, të cilin e bëri trashëgimtar të të gjitha gjërave, me anë të të cilit e krijoi dhe gjithësinë (Hebrenjve 1:1-2).* Gjithçka që kemi nevojë të dimë për “jetën dhe perëndishmërinë” e gjejmë në Bibël.

Ka vetëm një themel të vërtetë për të kuptuar tërë jetën: këtu në tokë dhe tërë përjetësinë, dhe ky themel është Fjala e Tij.

## **Perëndia na ka treguar të ndërtojmë mbi themelin e Fjalës së Tij**

Perëndia është ndërtuesi i tërë gjërave. *Sepse çdo shtëpi ndërtohet prej dikujt, por ai që ka ndërtuar gjithçka është Perëndia* (Hebrenjve 3:4). Fjala e Tij na zbulon gjithçka që duhet të dimë dhe Ai ka zgjedhur ta bëjë këtë përmes një zbulimi të vetes në mënyrë progresive e historike. Zoti ynë Jezu Krisht, kur donte t'u hapte sytë dishepujve të Tij në rrugën për në Emaus, tha: *“O budallenj dhe zemërngathët për të besuar gjithçka që kanë thënë profetët! Por a nuk duhej që Krishti të vuajë gjëra të tilla që të hyjë kështu në lavdinë e tij?”. Dhe, duke zënë fill nga Moisiu dhe nga gjithë profetët, ai u shpjegoi atyre në të gjitha Shkrimet gjërat që i takonin atij”* (Luka 24:25-27). Duke filluar që nga Zanafilla, këto Shkrime rreth “Moisiut dhe gjithë profetëve” janë themelet e qëndrueshme të Perëndisë për ungjillin.

Pak nga pak, përmes rrëfimit të Tij të vërtetë historik, Perëndia na është zbuluar: sovraniteti i Tij, krijimi i Tij, nevoja e njeriut për një Shpëtimtar dhe sigurimi i Perëndisë për një Shpëtimtar në Jezu Krishtin, Zotin tonë.

Ashtu siç mësojmë rreth një personi duke parë atë që bën, po kështu mësojmë rreth Perëndisë duke mësuar atë që ka bërë Ai. Ai na ka zbuluar karakterin dhe atributet e Tij përmes ndodhive historike që Ai ka regjistruar për ne në Shkrim.

## **Këto mësimë hedhin një themel të qëndrueshëm të së vërtetës të Perëndisë**

Këto mësimë ndërtojnë një themel të së vërtetës nga Fjala e Perëndisë, duke theksuar në mënyrë të veçantë:

- Perëndinë - karakterin dhe atributet e Tij.
- Njeriun - marrëdhënien e tij me krijuesin, Perëndinë, dhe nevojën e tij për një Shpëtimtar.
- Jezu Krishtin - Perëndia Bir dhe Shpëtimtari i vetëm i të gjithë atyre që besojnë tek Ai.

## **Bibla është historia e Perëndisë**

Para së gjithash ne mësojmë se Bibla është Fjala e Perëndisë. Ajo nuk është një libër rreth Perëndisë, as një libër me histori rreth personazheve të Perëndisë. Bibla është historia e Perëndisë. Ai është autori, personazhi kryesor dhe Ai tek i Cili duhet të përqendrohemi ndërsa mësojmë.

Prandaj ne nuk do të mësojmë historinë e “Noeut dhe arkës”, por do të mësojmë historinë se si “Perëndia shpëtoi Noeun dhe të gjithë ata që ishin në arkë”.

Nga historia e Kainit dhe Abelit ne nuk do t'u mësojmë fëmijëve të “sillen mirë me vëllezërit dhe motrat e tyre”, por do t'u mësojmë atyre se Perëndia gjeti një mënyrë që njeriu t'i afrohej Atij përmes besimit. Abeli i besoi Perëndisë dhe solli një flijim prej gjaku. Perëndia e pranoi flijimin e Abelit, sepse Abeli shkoi te Perëndia me anë të besimit. Kaini u rebelua kundër Perëndisë dhe shkoi tek Ai sipas mënyrës së vet. Perëndia e refuzoi Kainin. Ne nuk do të mësojmë historinë e “Jozefit”. Ne do të mësojmë se si “Perëndia e mbështeti Jozefin dhe se si solli tërë Izraelin në Egjipt”. Duke mësuar në këtë mënyrë, ne do të theksojmë se Bibla është historia e Perëndisë, libri më i rëndësishëm nga Personi më i rëndësishëm që mund të njihni ndonjëherë! A është mënyra jonë tërheqëse e të treguarit të historive ajo që i tërheq fëmijët për të njohur Perëndinë? Jo, është fuqia e Fjalës së Perëndisë, mësuar në fuqinë e Frymës së Shenjtë.

## **Ne do të mësojmë temën e shpëtimit me anë të hirit**

Përgjatë Biblës hasen shumë tema. Këto mësimë theksojnë temën e shpëtimit me anë të hirit përmes besimit. Veprat e mira të besimtarit nuk trajtohen në këtë seri mësimesh. Vetëm Krishti është rruga jonë e shpëtimit. Ne nuk mund të bëjmë asgjë tjetër për të shpëtuar veten. Për këtë arsye, edhe në historitë e Dhiatës së Vjetër, ne nuk theksojmë veprat e besimtarëve, si të Davidit dhe Elisë, për shembull. Këto histori mund të mësohen më vonë, në kontekstin e jetëve të besimtarëve dhe veprave të prodhuara nga Fryma e Shenjtë.

## **Ne fillojmë te Zanafilla, me PERËNDINË e përjetshëm, Krijuesin**

Duke filluar me Zanafillën, fëmijët prezantohen menjëherë me Perëndinë si Krijuesi i plotfuqishëm. Mësimi i qartë nga Zanafilla është mënyra më e mirë për të zbuluar mësimet e rreme të evolucionit. Atje ku ka një projekt, ka një projektues dhe Projektuesi i çdo gjëje është Perëndia!

Engjëjt, madje edhe Satani dhe ndjekësit e tij rebelë, janë qenie të krijuara, por jo të plotfuqishëm apo të kudondodhur si Krijuesi ynë i madh. Njeriu është përgjegjës ndaj krijuesit të tij, Perëndisë.

Njohja e këtyre të vërtetave u jep fëmijëve të klubit tonë një themel të qëndrueshëm dhe siguri në një botë të mbushur me ligësi. Themeli i fortë i të vërtetës së Perëndisë është një strehë sigurie për fëmijët.

## **Fëmijët e klubit mësojnë për pasojat e tmerrshme të mëkatit**

Mëkati i njeriut dhe mallkimi që e pasoi atë u tregon fëmijëve të klubit arsyen e vuajtjes dhe dhimbjes në këtë botë.

Menjëherë ata janë në gjendje të shohin kontrastin midis botës së përsosur që krijoi Perëndia dhe botës së rënë që rezultoi nga zgjedhja e njeriut për të mëkatuar.

Ne nuk mund t'i mbrojmë ata nga shkatërrimi i mëkatit. Megjithatë, ne mund t'u tregojmë atyre pasojat e mëkatit, i cili është ndarja nga Perëndia.

## **Perëndia premtoi një Çlirimtar**

Ne u tregojmë fëmijëve të klubit se Perëndia, në mëshirën e Tij të madhe, bëri një premtim për të dërguar një Çlirimtar (Zanafilla 3:15), birin e një të virgjëre, për të shtypur fuqinë e Satanit. Kur Adami dhe Eva mëkatuan, Perëndia u përgjigj duke vrarë kafshët për t'i veshur ata, flijimi i parë për mëkatin. Edhe Abeli solli një flijim dhe Perëndia e pranoi, për shkak të besimit të tij. Menjëherë ne fillojmë të hedhim themelin për flijimin për mëkatin dhe shpëtimin me anë të besimit përmes hirit të Perëndisë.

Shumë fëmijë të klubit mund të mahniten kur të zbulojnë se mëkati është i trashëguar: ai u kalon tërë pasardhësve të Adamit. Askush nuk mund t'i shpëtojë kësaj trashëgimie vdekjeprurëse.

## **Perëndia i dha premtime Abrahamit**

Perëndia i premtoi Abrahamit se Ai do të bekonte tërë kombet përmes tij. Abrahami i besoi Perëndisë dhe Ai ia llogariti këtë si drejtësi. Çlirimtari i premtuar do të ishte pasardhësi i Abrahamit. Perëndia i dha të njëjtat premtime Isakut dhe pastaj Jakobit, të cilin Perëndia e quajti Izrael. Familja e Izraelit dhe pasardhësit e tij u bënë të njohur si izraelitë, populli jude.

## **Përmes kombit të Izraelit Perëndia i dha botës mesazhin e Tij**

Zoti e krijoi kombin e Izraelit për veten e Tij, në mënyrë që Ai të mund ta përdorte si dëshmi dhe mjet të Tij për bekimin e tërë njerëzimit (Isaia 43:1, 10-12, 21).

Premtimet e Zotit ndaj Abrahamit, atit të kombit të Izraelit, treguan se bekimet e Perëndisë përmes tij dhe farës së tij do të shtriheshin te... tërë familjet e tokës (Zanafilla 12:1-3). Ky premtim u përmbush përmes Krishtit, Farës së premtuar, por edhe përmes Shkrimeve, të cilat iu besuan Izraelit si zbulesa e vetme e shkruar e Perëndisë ndaj botës. Tërë kombet e tjera u lanë në padituri, pa Perëndinë dhe pa shpresë, derisa të ishin gati të pranonin të vërtetën dhe diturinë që iu dha përmes mjetit të zgjedhur të Perëndisë, Izraelit.

### **Perëndia dha Ligjin për t'i treguar njeriut natyrën e tij mëkatore**

Pas plagëve të mëdha dhe Pashkës, Perëndia i udhëhoqi izraelitët jashtë Egjiptit. Ai bëri një rrugë që ata të kalonin përmes detit dhe Ai i mbështeti ata në shkretëtirë, edhe pse ata shpesh u ankuan dhe dyshuan për Të.

Perëndia e çoi Izraelin në malin Sinai dhe i dha urdhërime. Këto urdhërime, Ligji i Perëndisë, erdhën si një marrëveshje, e cila varej nga njerëzit që duhej t'i bindeshin gjithmonë Perëndisë. Perëndia tha se Ai do t'i bekonte nëse do të bindeshin. Izraeli mendoi se mund t'i bindej Perëndisë, sepse ata nuk e kuptonin se sa mëkatarë ishin në të vërtetë.

Perëndia e dinte se izraelitët nuk do t'i bindeshin kurrë Atij në mënyrë të përsosur. Në të vërtetë Ligji i Tij e zbuloi mëkatën e tyre. Por Perëndia i donte akoma ata. Edhe pse nuk iu bindën Ligjit të Tij, Perëndia arriti që të jetonte midis tyre dhe të bënte shlyerjen për mëkatet e tyre. Vit pas viti njerëzit flijonin kafshë për të mbuluar mëkatet e tyre. Megjithatë, gjaku i kafshëve nuk mund të paguante kurrë plotësisht për mëkatet. Perëndia po i drejtonte nga Çlirimtari i premtuar. Megjithatë, ata duhej të prisnin me anë të besimit.

Ai i udhëhoqi përmes shkretëtirës për dyzet vjet dhe i solli të sigurt në Tokën e Premtuar.

### **Perëndia dërgoi profetë për të paralajmëruar Izraelin**

Perëndia dërgoi profetët për të paralajmëruar Izraelin të pendohej dhe t'i drejtonte për nga Çlirimtari i premtuar. Sapo populli u vendos në Tokën e Premtuar, Perëndia dërgoi profetët njëri pas tjetrit për t'i paralajmëruar njerëzit që të pendoheshin për mëkatet e tyre, të pranonin se ishin mëkatarë, të hiqnin dorë nga përpjekjet e tyre vetjake dhe të ktheheshin drejt Perëndisë së vërtetë, i Cili ishte i vetmi që mund t'i shpëtonte. Por në mënyrë të përsëritur njerëzit i kthyen shpinën Perëndisë dhe vazhduan të mëkatonin. Perëndia i dërgoi sërish profetët për t'i paralajmëruar dhe për t'u kujtuar se një ditë Perëndia do të dërgonte Çlirimtarin e premtuar.

Këto të vërteta të Dhiatës së Vjetër janë themeli për mësimin rreth Zotit Jezu Krisht.

### **Perëndia dërgoi Birin e Tij për të qenë Çlirimtari**

Duke mësuar këto histori të Dhiatës së Vjetër, sa më e qartë bëhet panorama kur shikojmë se foshnja i lindur në një grazhd nuk është biri i Jozefit, një mëkatar i gjenealogjisë së Adamit, por Ai është Jezusi, Biri i Perëndisë, i shenjtë dhe pa mëkat!

### **Jezusi është Perëndi**

Çfarë gëzimi që është t'u mësojmë fëmijëve se ky Jezus mund të qetësojë erërat dhe ujërat, sepse Ai është Perëndia, Ai që krijoi erën dhe ujin!

Sa e mrekullueshme të jesh në gjendje t'u thuash fëmijëve se Jezusi mund t'i sjellë shikimin një të verbri, sepse Jezu Krishti është Perëndia, Ai që bëri sytë e njeriut!

Sa e mrekullueshme t'u mësosh atyre se Jezu Krishti mund të flasë dhe ngjallë Llazarin prej së vdekurish, sepse Ai është Perëndia që krijoi gjithçka nga asgjë!

## **Jezu Krishti është Qengji i Perëndisë, i Cili vdiq për të marrë mëkatet tonë**

Jezu Krishti është Qengji i Perëndisë, flijimi, për të Cilin u profetizua që nga fillimi.

Ai është personi që heq përfundimisht mëkatet. Perëndia, Krijuesi ynë, Ai që na do si asnjë tjetër, është Ai që zuri vendin tonë në kryq.

Perëndia Atë u kënaq plotësisht me pagesën e Jezusit për mëkatet. Jezusi u ngrit prej varrit për t'u dhënë jetën e përhjetshme të gjithë atyre që besojnë tek Ai.

## **Dhiata e Vjetër është themeli për Dhiatën e Re**

A e shikon se sa shumë mund të fitohet duke mësuar në mënyrë të kujdesshme nga Dhiata e Vjetër?

Duke hedhur themelet e Dhiatës së Vjetër, historitë e Dhiatës së Re mund të mësohen në mënyrë të qartë, duke ndërtuar mbi atë themel të qëndrueshëm.

Nuk ka asgjë tjetër më të rëndësishme se sa hedhja e atyre themeleve të rëndësishme të së vërtetës së Biblës për fëmijët e klubit të cilëve u japim mësim. Pa një themel të qëndrueshëm për ungjillin, mesazhi mund të jetë i dobësuar apo i ngatërruar. Ndërsa fëmijët e klubit rriten, ata do ta marrin këtë ngatërresë me vete. Ata madje mund t'u transmetojnë një mesazh të gabuar të tjerëve.

## **Çfarë është ungjilli?**

*Po ju deklaroj ungjillin... me anë të të cilit ju jeni shpëtuar... se Krishti vdiq për mëkatet tona sipas Shkrimeve, se u varros dhe u ringjall të tretën ditë, sipas Shkrimeve (1 Korintasve 15:1-4).*

Ungjilli është një mesazh objektiv dhe historik. Jezu Krishti vdiq për mëkatet tona, u varros dhe u ngjall përsëri ditën e tretë. Kjo ndodhi me të vërtetë. Ky është ungjilli.

Kur besojmë te Jezu Krishti dhe te ungjilli i Tij, ne po vendosim besimin tek një person dhe tek ajo që Ai bëri për ne 2 000 vjet më parë.

Ungjilli nuk është një ndjenjë dhe nuk varet nga veprat, aftësitë tona apo emocionet tona. Jezu Krishti ka bërë gjithçka që ishte e domosdoshme për të na shpëtuar.

Ky është mesazhi që duhet t'u japim fëmijëve të klubit tonë.

## **Çfarë është shpëtimi?**

Shpëtimi është dhurata e hirit të Perëndisë. Fëmijët e klubit duhet të pajtohen me Perëndinë se ata janë mëkatarë, plotësisht të paafte për të shpëtuar veten. Ata kthehen te Perëndia duke besuar tërësisht dhe vetëm në veprën e kryer të Krishtit në kryq, si pagesë për mëkatet.

Atëherë Perëndia u jep atyre shpëtimin me anë të hirit të Tij.

Nëse fëmijët e klubit janë me të vërtetë të shpëtuar, ata do ta dinë se janë mëkatarë, të paafte të shpëtojnë veten. Ata do të dinë se Jezu Krishti vdiq në kryq si shlyerje e plotë për mëkatet e tyre dhe se Krishti u ngjall prej së vdekurish.

## **Disa fëmijë të klubit do të përgatiten nga Fryma e Shenjtë të marrin ungjillin para se të fillojë mësimi i ungjillit**

Në varësi të asaj që kanë mësuar fëmijët e klubit mund të jenë gati për shpëtimin në çdo çast gjatë kohës që po mëson. Lejoje Frymën e Shenjtë të veprojë në zemrat e tyre, duke e ditur se çdo fëmijë i klubit është i ndryshëm, secili ndryshon nga tjetri në të kuptuarit dhe secili mund të ketë marrë më shumë ose më pak mësim dhe informacion shtesë.

Ashtu siç është e gabuar t'ua imponosh ungjillin atyre që nuk janë përgatitur nga Perëndia, po ashtu është e gabuar t'ua ndalosh ungjillin atyre që janë mësuar nga Perëndia, të cilët

kanë frymë të thyer dhe që janë të etur për mëshirën dhe faljen e Shpëtimtarit.

Nëse shikon se fëmijët e klubit janë gati të besojnë te Krishti, apo janë të shpëtuar tashmë, mund të kalosh disa minuta me ata fëmijë mënjanë grupit (pa i vënë në siklet!) dhe të flasësh rreth asaj që kanë kuptuar për shpëtimin. Perëndia nuk është i kufizuar në mënyrën se si vepron.

### **Si të shpëtuarit, ashtu edhe të pashpëtuarit përfitojnë nga mësimi bazë**

Edhe pse shumë fëmijë të klubit që mëson mund të jenë tashmë të shpëtuar, ata do të përfitojnë ende nga mësimi bazë dhe kronologjik i Biblës.

Disa fëmijë të klubit mund të kenë bërë rrëfime besimi vetëm pas pak mësimëve. Këta fëmijë kanë ende nevojë për mësim bazë, në mënyrë që të njohin Perëndinë dhe të njihen me Fjalën e Tij.

### **Ne duhet të kemi kujdes që të mos ngatërrojmë veprat me hirin**

Ne duhet të kemi kujdes që të mos shtrembërojmë të kuptuarit e fëmijëve të klubit rreth ungjillit duke përdorur terma (fjalë), të cilat i shtyjnë të mendojnë rreth asaj që duhet TË BËJNË, sesa asaj që Perëndia ka BËRË për ta përmes Krishtit. Ne duhet të përdorim fjalë që do t'i çojnë drejt besimit në atë që është bërë PËR TA përmes Krishtit, sesa të drejtojmë vëmendjen e tyre se çfarë duhet bërë NË TA.

Fëmijët, ashtu si të rriturit, zbulojnë se të bërët e diçkaje është më e lehtë sesa thjesht besimi. Ne nuk duhet të ngatërrojmë kurrë ungjillin me veprat. Kur një person ka vendosur besimin e tij në atë që ka bërë Krishti për të në kryq, Fryma e Shenjtë jeton tek ai. Fryma e Shenjtë mëson besimtarët dhe i ndihmon ata të bëjnë vepra të mira që Perëndia i ka caktuar për ta.

### **Jo “metoda”, por fuqia e Perëndisë**

Kujto, fuqia nuk qëndron te metoda, por fuqia qëndron në Perëndinë dhe Fjalën e Tij. Këto mësimë janë vetëm një mjet. Asnjë “metodë” nuk mund të çojë një fëmijë të klubit te Krishti. Nëse një fëmijë shpëtohet përmes leximit të një fletushke, dëgjimit të një mësuesi apo një prindi që i shpjegon ungjillin, apo në ndonjë mënyrë tjetër, fuqia qëndron te Fjala e Perëndisë.

Perëndia vepron në mënyra misterioze dhe të mrekullueshme për të kërkuar dhe për të shpëtuar. Ne mund të shikojmë drejt Tij të habitur për atë që ka bërë.

Ndërsa mësojmë Fjalën e Perëndisë, ne qëndrojmë në premtimin e Tij:

*Ashtu si shiu dhe bora zbresin nga qielli dhe nuk kthehen prapa pa vaditur tokën, pa e bërë pjellore, pa bërë që të mbijë në mënyrë që ai që do të mbjellë të marrë farën dhe të sigurojë bukën për të ngrënë, kështu do të jetë fjala ime e dalë nga goja ime; ajo nuk do të më kthehet bosh mua, pa kryer atë që dëshiroj dhe pa realizuar plotësisht atë për të cilën e dërgova (Isaia 55:10-11).*

Për shpjegime të mëtejshme rreth themeleve të qëndrueshme të mësimdhënies për ungjillin, shiko Botimin për fëmijë, Themelet e qëndrueshme: nga krijimi te Krishti, nga Trevor McIlwain-i me Nancy Everson-in, New Tribes Mission, 1991.



# Temat doktrinare që paraqiten në këto mësim

Me anë të veprës së Frymës së Shenjtë, temat doktrinare (të vërtetat biblike) që paraqiten në këto mësim do të jenë:

1. Ndhima ndaj fëmijëve të klubit që të kuptojnë atributet (karakterin) e Perëndisë.
2. Të bërët të ditur fëmijëve të klubit se ata janë mëkatarë: të dënuar dhe të pashpresë para Perëndisë, Krijuesi dhe Gjykatësi i tyre i shenjtë dhe i drejtë.
3. Shfaqja e besimit dhe varësia e plotë në Zotin Jezu Krisht si Shpëtimtari i mrekullueshëm dhe i vetëmjaftueshëm. Ai është çlirimtari i premtuar.

Këto janë temat specifike doktrinare që do të theksohen:

## Personi dhe karakteri i Perëndisë

**Perëndia është më i madhi dhe më i fuqishmi se të gjithë; Ai është autoriteti më i lartë.**

Me fjalë të tjera, Perëndia është **më i larti** (më i larti në pozicion apo fuqi) dhe **Sovran** (duke pasur shkallën, fuqinë apo autoritetin më të lartë). Kjo e vërtetë është themelore (baza mbi të cilën qëndron diçka) në të gjitha doktrinat e tjera rreth Perëndisë dhe në çështjet frymërore.

Pozicioni i sovranitetit të Perëndisë shihet qartë në mbarë Biblën. Ai është autoriteti mbi tërë krijimin: njeriun, engjëjt dhe Satanin. Askush nuk mund të vërë në dyshim atë që bën Ai. Ai është Krijuesi i madh, Alfa (fillimi) dhe Omega (mbarimi), që bën çdo gjë sipas dëshirës së Tij.

Në një botë ku mësimet e rreme mësohen si fakte, **fëmijëve duhet t'u mësohet që Perëndia është sovran!** Kur kjo e vërtetë është e qartë, të vërtetat e tjera mund të fillohen të kuptohen.

Këto mësim tregojnë Perëndinë që ndërhyr në histori: gjithmonë fitimtar, gjithmonë fitues ndaj tërë atyre që luftojnë kundër Tij. Ai është Krijuesi i të gjithëve dhe autoriteti i përjetshëm mbi të gjithë. Ai qëndron sovran më i lartë dhe i lavdishëm si Perëndia Shumë i Lartë.

## Perëndia komunikon me njeriun

Bibla nuk është thjesht një regjistrim i asaj që Perëndia i ka thënë popullit në të shkuarën. Ajo është edhe mesazhi i Perëndisë për ne sot.

Këto mësim theksojnë (tregojnë rëndësinë e diçkaje) se Fjala e Perëndisë është e vërtetë. Është një histori e vërtetë dhe një mesazh i gjallë për çdo person në botë. Fëmijët duhet të dinë se Bibla është mesazhi i Perëndisë për ta në mënyrë personale.

## Perëndia është kudo në çdo kohë; Ai di gjithçka

Perëndia është i kudondodhur, që do të thotë se Perëndia është kudo në çdo kohë. Perëndia është i gjithëdijshtëm, që do të thotë se Perëndia di gjithçka.

Fëmijët e klubit tuaj mund të dëgjojnë mësim të rreme nga dikush, ndaj ne duhet të jemi shumë të kujdesshëm ndërsa mësojmë këto attribute të Perëndisë. Siç u përmendte mësimet, New Age (Brezi i Ri) edhe fe të tjera panteiste mësojnë se Perëndia është gjithçka dhe gjithçka është Perëndi. Sigurohu që të jesh i qartë se ka ndryshim midis Perëndisë Krijues dhe krijimit të Tij. Perëndia është kudo, por Ai nuk ndodhet në të gjitha gjërat; jo çdo gjë është Perëndi.

## **Perëndia është i fuqishëm**

Perëndia është i plotfuqishëm. Fëmijët kanë dëshirë të dëgjojnë për fuqinë e madhe të Perëndisë. Nëse mëson qartë Fjalën, nuk është problem që shumica e fëmijëve të besojnë te mrekullitë.

## **Perëndia është i shenjtë dhe i drejtë. Ai kërkon vdekjen si ndëshkim për mëkat**

Perëndia është standarti i vetëm i mirësisë. Çdo gjë, që nuk e arrin drejtësinë e përsosur të Perëndisë, është e papranueshme për Të. Gjithçka që nuk përputhet apo është në kundërshtim me Perëndinë është mëkat.

Nga të gjitha të vërtetat rreth Perëndisë, kjo mungon në pjesën më të madhe të mendësisë së sotme “fetare”. Shumë mesazhe nuk përmendin të vërtetën rreth shenjtërisë së Perëndisë, natyrën mëkatore të njeriut, ndëshkimin e vdekjes për mëkat dhe gjakun e Jezu Krishtit të derdhur për mëkatarët.

Edhe pse Perëndia është dashuri, mesazhi i Biblës nuk është: “Buzëqesh, Perëndia të do”; por është: *Shpirti që mëkaton ka për të vdekur* (Ezekieli 18:4).

Kur ky mesazh është i qartë, atëherë Gjoni 3:16 merr kuptimin e tij të vërtetë. Edhe fëmijët duhet të njohin të vërtetën, sepse edhe ata janë mëkatarë. Edhe pse në pamje të parë mund të duket mizore t’u mësosh fëmijëve realitetin e ndëshkimit për mëkat, ne e dimë se Perëndia nuk hoqi dorë së mësuari fëmijëve Fjalën e Tij.

Njerëzit në disa vende nuk kanë njohuri të vërtetë për flinë që derdh gjak, edhe pse një lloj i shtrembëruar i flijimit të kafshës praktikohet shpesh në shumë vende. Bibla flet shumë për flijimin zëvendësues, duke përfunduar në një flijim që mund të heqë mëkatet.

Për shumë njerëz ndëshkimi me vdekje për mëkat dhe fakti që ekziston një ferr i vërtetë nuk përbën shqetësim. Por Perëndia nuk e ka ndryshuar standardin e Tij të drejtë. Ai nuk do të lejojë kurrë që një njeri të shkojë tek Ai nëse nuk është paguar tërësisht kërkesa e plotë dhe e drejtë e Ligjit të Tij.

Edhe pse kërkesa e drejtë e Ligjit të Perëndisë mund të plotësohet vetëm përmes gjakut të Jezu Krishtit, Perëndia i pranoi mëkatarët që shkonin tek Ai me besim gjatë kohës para Kryqit, sepse vdekja e Krishtit ishte, edhe atëherë, një realitet i pranishëm për Perëndinë (Zbulesa 13:8). Megjithatë, gjatë kohës së Dhiatës së Vjetër, adhuresve duhej t’u kujtohej se pranimi i tyre nga Perëndia nuk do të thoshte se nuk kishte drejtësi.

Perëndia kërkonte vdekjen e mëkatarit. Gjaku i kafshëve mund të vepronte vetëm si një mbulesë e përkohshme për mëkat. Nuk mund të kishte përmbushje të plotë për atë që bënte ofertën më përpara kryqit. Njerëzit viheshin në dijeni për mëkat. Vdekja, paga e mëkatit, tregohej vazhdimisht nga vdekja e kafshëve të pafajshme, të cilat duhej të ishin pa të meta si një figurë e mosdashjes së Perëndisë për të pranuar diçka që ishte poshtë standardit të pagesës së përsosur për mëkat.

Shembulli i parë i regjistruar ku kemi flijimin e një kafshe është sakrifica e Abelit. Perëndia duhet t’i kishte thënë familjes së parë se çfarë kërkonte rreth flijimeve. Hera e parë kur Perëndia i dha lejen njeriut të vriste dhe hante kafshët ishte pas përmbajtjes. Abeli nuk do të kishte vendosur vetë që të vriste një prej krijesave të Perëndisë dhe t’ia kushtonte si flijim Atij nëse nuk do t’i ishte urdhëruar nga Perëndia. Abeli ushtroi besim. Besimi kërkon një zbulesë nga Perëndia si bazë për të. Njeriu nuk tregon besim kur përpigjet t’i pëlqejë Perëndisë sipas mënyrës së tij. Kaini u përpoq t’i afrohej Perëndisë sipas mënyrës së tij dhe u refuzua.

Prandaj, kërkesa e Perëndisë për flijimet e kafshëve do të mësohet shumë herë në këto mësim, sepse theksojnë shenjtërinë e Perëndisë dhe drejtësinë e Tij kërkon vdekjen e mëkatarit si pagesë për mëkat. Gjaku i kafshës nuk mund të jetë zëvendësimi për



vdekjen e mëkatarit, por ishte një kujtesë e vazhdueshme se asgjë tjetër përveç vdekjes nuk mund të përmbushte kërkesat e shenjta e të drejta të Perëndisë (Hebrenjve 10:1-12). Vdekja e Jezu Krishtit i përmbushi këto kërkesa.

Ndërsa mëson karakterin e Perëndisë dhe mëkatin e njeriut, fëmijët e klubit do të fillojnë të kuptojnë realitetin e vështirë të ndëshkimit të mëkatit. Mos resht së mësuari të vërtetën. Perëndia përdor të vërtetën për të ndryshuar zemrat.

### **Perëndia është i dashur, i mëshirshëm dhe plot hir**

Dashuria e Perëndisë është e pandryshueshme, e pastër dhe nuk varet nga mirësia apo denjësia e atyre që marrin këtë dashuri. Perëndia është dashuri (1 Gjonit 4:8). Këto mësimë tregojnë se dashuria e Perëndisë nuk është si dashuria e njeriut, e cila mendon për veten. Fëmijët duhet ta kuptojnë dashurinë e Perëndisë ashtu siç paraqitet në Fjalën e Tij, jo në mënyrë të pasinqertë, njerëzore dhe emocionale. Mëshira e Perëndisë shpjegohet në këto mësimë si gjetja e një rruge prej Tij që mëkatarët t'i shpëtojnë ndëshkimit që meritojnë. Hiri i Perëndisë përshkruhet si mirësia e Tij ndaj mëkatarëve që nuk e meritojnë.

### **Perëndia është besnik; Ai bën gjithmonë atë që thotë; Ai nuk ndryshon kurrë**

Disa studiues “fetarë” po rishkruajnë Biblën për të qenë në një vijë me atë që ata mendojnë se është e përshtatshme sot. Ne duhet të mësojmë në mënyrë të qartë se Perëndia nuk ndryshon; as Fjala e Tij. Këto mësimë theksojnë besnikërinë e Perëndisë. Perëndia i mban premtimet e Tij. Ky fakt duhet të përsëritet shpesh, sepse është i tillë, pavarësisht nga ajo që fëmijët dinë për veten dhe për të tjerët.

### **Njeriu**

**Njeriu është mëkatar. Ai ka nevojë për Perëndinë dhe nuk është në gjendje të shpëtojë veten.** Njeriu nuk mund t'i pëlqejë Perëndisë me diçka që mund të bëjë. Vetëm hiri i Perëndisë mund ta shpëtojë. Perëndia i ka dhënë njeriut **gjithçka** që zotëron: jetën e tij dhe çdo gjë që e mban jetën gjallë. Pamundësia e njeriut në jetën e tij të përditshme përdoret në Shkrim për të treguar pamundësinë e tij frymërore dhe nevojën që ka njeriu për sigurimin plot hir të Perëndisë për çlirim.

**Njeriu mund të shkojë te Perëndia vetëm sipas vullnetit dhe planit të Tij.** Duke qenë se Perëndia është i shenjtë dhe më i larti, vetëm Ai e përcakton mënyrën se si njeriu mund të shkojë tek Ai dhe se si mund të shpëtohet. Duhet të bëhet sipas mënyrës së Perëndisë, përmes Jezu Krishtit.

Sepse Biri i njeriut erdhi për të shpëtuar atë që qe humbur (Mateu 18:11)

Jezusi i tha: “Unë jam udha, e vërteta dhe jeta; askush nuk vjen tek Ati përveçse nëpërmjet meje (Gjoni 14:6)

**Njeriu duhet të ketë besim për t'i pëlqyer Perëndisë dhe për t'u shpëtuar.**

### **Satani**

**Satani lufton kundër Perëndisë dhe vullnetit të Tij. Satani është gënjeshtar dhe mashtgues. Ai urren njeriun.**

Satani (në fillim Luciferi) dhe engjëjt e tij u krijuan nga Perëndia dhe, për këtë arsye, varen

dhe i nënshtrohen autoritetit të Tij. Ata janë armiq të Perëndisë dhe njeriut.

Ata nuk mund të kënaqen kurrë. Satani përdor engjëjt e tij dhe njeriun mëkatar për të vendosur mbretërinë e tij dhe ata përpiqen për të shkatërruar mbretërinë e Perëndisë.

Megjithatë, Perëndia do të triumfojë gjithmonë ndaj çdo përpjekjeje të Satanit për të prishur planet e Perëndisë për të bekuar popullin e Tij dhe për t'i sjellë shpëtimin njerëzimit.

Edhe pse Satani dhe demonët e tij nuk përmenden shpesh në Dhiatën e Vjetër, është mirë t'u kujtojmë fëmijëve të klubit tonë për praninë e vazhdueshme dhe ndikimin e këtyre armiqve frymërorë në historinë e botës. Ne e dimë nga Dhiata e Re që Satani është “perëndia i këtij shekulli” (2 Korintasve 4:4), kështu që ne e dimë që ai është gjithmonë i pranishëm për të tunduar dhe për të drejtuar njerëzit në kundërshtimin e tyre ndaj Perëndisë dhe vullnetit të Tij.

Fëmijët duhet të mësojnë nga Fjala e Perëndisë që të dallojnë armikun dhe të njohin mënyrën se si vepron ai. Fëmijët sulmohen vazhdimisht nga i ligu. Mund të mahnitesh se sa shumë gjëra kanë parë e dëgjuar dhe se sa të lehtësuara ndihen kur e dinë burimin e të keqes, dhe KUR DINË SE PERËNDIA ËSHTË MË I FORTË SE TË GJITHË!

### **Jezu Krishti** (vetëm Dhiata e Re)

Jezu Krishti paraqitet si përmbushje e profecisë, tërësisht Perëndi e tërësisht njeri, Shpëtimtari i vetëm.

Ti dhe fëmijët e klubit që mëson mund ta shijoni studimin rreth Jezu Krishtit, Çlirimtarit të premtuar!

1. Jezu Krishti është Perëndi.
2. Jezu Krishti është njeri.
3. Jezu Krishti është i shenjtë dhe i drejtë.
4. Jezu Krishti është Shpëtimtari i vetëm.



# TruthSeekers

**Rrënjët e besimit**

**Manuali i mësuesit**

**Seksioni 2**

**Si t'i  
përdorim  
këto mësimet?**



TruthSeekers

## **Si t'i përdorim këto mësimet?**

<b>Udhëzues për mësuesin</b> .....	21
Çfarë është Manuali i Mësuesit? .....	21
Cila është e vërteta më e madhe? .....	21
Hiri, jo veprat! .....	21
Përshtatja e mësimet për grupe të ndryshme moshash .....	22
Njih fëmijët e klubit tënd .....	22
Perëndia ka përgjigjet për tërë nevojat reale të fëmijëve .....	22
Ai është një Perëndi personal të Cilin fëmijët mund ta njohin përmes besimit në Jezu Krishtin. ....	23
Ç'mund të themi për disiplinën? .....	23
Çfarë i duhet mësuesit për të dhënë këto mësimet? .....	24
Ji i përgatitur! Zbato planin mësimor .....	24
Kur duhet ta shpall ungjillin? .....	24
Bëji mësimet e tua interesante! .....	25
Ji i durueshëm. Mos i thuaj me nxitim këto të vërteta të rëndësishme biblike .....	25
Ka shumë informacion .....	26
Po fëmijët e rinj të klubit? .....	26
<b>Si të drejtojmë një fëmijë te Krishti?</b> .....	27
Paraqitja e ungjillit .....	27
A e kuptojnë fëmijët mesazhin e ungjillit? .....	27
Çfarë duhet të kuptojë një fëmijë për t'u shpëtuar? .....	28
Çfarë duhet të bëjë një fëmijë për t'u shpëtuar? .....	29
Ftesa ngatërruese .....	29
Një fëmijë duhet të dijë: .....	29
<b>Si t'i përgatitësh mësimet e tua?</b> .....	30
Qëllimet e mësimit .....	30
Figurat .....	30
Historia .....	30
"Le të shohim në Bibël" .....	31
Lojërat për mësimin e vargut përmendësh .....	31
"Le ta mendojmë" .....	32
"Mësime nga Fjala e Perëndisë" .....	32
"Përsëritje" .....	32
Pyetje e përgjigje .....	32
Mësimet e përsëritjes .....	33
Lojërat e përsëritjes .....	33



# Udhëzues për mësuesin

## Çfarë është Manuali i Mësuesit?

Mirë se erdhe te *Kërkuesit e së Vërtetës Awana*, një program klubi javor argëtues për fëmijë të moshave të ndryshme. *Manuali i Mësuesit* përmban udhëzime për të të ndihmuar që të mësosh *Kartat Awana* gjatë Kohës së Mësimi.

## Cila është e vërteta më e rëndësishme?

Shumë gjëra mund të vijnë ndërmend, por **një gjë** është më e rëndësishmja. Te Gjoni 17:3 Jezusi thotë: ***“Dhe kjo është jeta e përjetshme, të të njohin ty, të vetmin Perëndi të vërtetë, dhe Jezu Krishtin që ti ke dërguar”***.

Perëndia Shumë i Lartë dëshiron që të gjithë njerëzit në botë ta njohin Atë. Këto mësimë paraqesin historinë e Perëndisë: **gjënë e vetme që duhet** t’u mësojmë fëmijëve!

Fëmijët duhet të mësojnë të vërtetën e Perëndisë. Duhet që çdo e vërtetë t’u paraqitet si pjesë e një themeli të qëndrueshëm dhe biblik. Skica e mësimi ndjek një model të qartë e kronologjik. Kjo do t’i ndihmojë fëmijët e klubit tënd të shikojnë hedhjen e themelit dhe të kujtojnë atë që u është mësuar.

Qëllimi i këtyre mësimëve është:

**T’u paraqesë fëmijëve natyrën, karakterin e Perëndisë dhe planin e Tij të shpëtimit përmes Birit të Tij Jezusit, ashtu siç na i ka zbuluar këto të vërteta në mënyrë progresive përmes Fjalës së Tij, Biblës.**

## Hiri, jo veprat

Këto mësimë paraqesin shpëtimin me anë të hirit. Në këtë pikë nuk flitet fare për realizimin e veprave që Perëndia dëshiron që të bëhen te besimtari dhe përmes tij; kjo do të shpjegohet më vonë.

Shumë nga pjesët biblike u referohen shumë shembujve se si Perëndia i ka përdorur besimtarët të bëjnë veprat e Tij të mira, por ky kurs thekson vetëm ato tema që janë themelore për shpëtimin.

Mund të mos i gjesht disa nga historisë biblike të preferuara të fëmijëve në këto mësimë. Por do të shikosh se ato që janë përfshirë këtu do të japin një themel të qëndrueshëm për shpëtimin e siguruar nga Jezu Krishti në kryq. Më vonë historitë tuaja të preferuara do të kuptohen në kontekstin e hirit të Perëndisë.

Tërë fëmijët e klubit tënd që janë besimtarë do të përfitojnë duke parë edhe planin e shpëtimit të tyre të paraqitur në mënyrë të qartë: një shpëtim i varur në mëshirën dhe hirin e Perëndisë dhe jo në veprat e tyre të mira. Perëndia bën vepra jashtëzakonisht të mira përmes atyre të bijve të Tij që kuptojnë se shpëtimi dhe ecja e tyre e krishterë janë për shkak të hirit të Tij dhe jo të vetes së tyre.

**Perëndia është figura qendrore në çdo mësim.** Ti nuk do të mësosh “çfarë bëri Noeu”, por **çfarë bëri Perëndia** për të shpëtuar Noeun. Ki kujdes që të nxjerrësh në pah këtë gjë: Perëndia është autori. Në vend që të mësosh të jenë “realizues” dhe “bërës”, fëmijët do të mësojnë të njohin Krijuesin e tyre dhe Perëndinë shpëtimtar, i Cili është i vetmi që mund t’i shpëtojë. Pastaj Ai do të kryejë përmes tyre veprat e mira për të cilat i krijoi!

## **Përshtatja e mësimeve për grupmoshat e ndryshme**

Këto mësime janë shkruar në mënyrë të veçantë për fëmijët e moshës kur fillojnë të lexojnë. Megjithatë, edhe pse ata që nuk dinë të lexojnë nuk do t'i kuptojnë figurat me fjalë, atyre do t'u pëlqejnë figurat dhe do të mësojnë nga skeçet dhe mësime verbale.

Një mësues që i njeh nevojat e fëmijëve të tij mund t'i përdorë këto mësime për shumë grupmosha të ndryshme. Është e rëndësishme që **t'i përmbahesh skicës!** Shiko **"Qëllimet"** për çdo mësim për të qëndruar sipas planit mësimor. Vendos se si mund t'ua mësosh sa më mirë këto të vërteta biblike fëmijëve të klubit. Përdor fjalë dhe shembuj që janë të kuptueshëm për moshën e fëmijëve të cilëve po u jep mësim. Për t'u siguruar që fëmijët po e kuptojnë atë që po u mëson, bëju pyetje, në mënyrë që të dëgjosh prej tyre se çfarë po mësojnë. Mos përjashto asnjë nga të vërtetat biblike duke menduar se fëmijët e klubit nuk mund t'i kuptojnë akoma. Ndonjëherë fëmijët mund të kuptojnë më tepër nga sa mendojmë se munden.

### **Njih fëmijët e klubit tënd**

Jezusi i njihte fëmijët dhe kujdesej për ta. Kur mësonte Ai ishte në gjendje të fliste në mënyrë të tillë që njerëzit të kuptonin. Ai përdorte shembuj që ishin të qartë për njerëzit që e dëgjonin. Jezusi, mësuesi më i mirë, është shembulli ynë. Ashtu siç i njihte Ai njerëzit që mësonte, edhe ne duhet t'i njohim fëmijët e klubit tonë.

Është shumë e rëndësishme që të lejosh Zotin t'u tregojë dashuri fëmijëve të klubit përmes teje. Interesohu për secilin nga fëmijët. Lutu për ta; vizitoji nëpër shtëpitë e tyre. Mëso për familjet, miqtë, shkollën dhe gjërat që pëlqejnë të bëjnë. Mëso për nevojat e tyre. Nëse nuk ke shumë kohë që ta kalosh me fëmijët në mënyrë individuale, bëj atë që ke mundësi dhe sigurohu që ata të dinë se i do.

Disa fëmijë mund të jenë nga familje ku prindërit kanë mësime të rreme. Ki kujdes të dëgjosh atë që thotë çdo fëmijë. Mos prit të bien dakord me atë që po u mëson. Mos i dëno nëse paraqesin një doktrinë të rreme. Thjesht tregojua që ky pohim bie ndesh me Biblën. Kujtoju se Bibla është autoriteti përfundimtar për çdo të vërtetë. Inkurajoji që të respektojnë prindërit e tyre, por që të pranojnë autoritetin e Fjalës së Perëndisë. Fjala e Perëndisë do ta bëjë punën në zemrat e tyre!

Këtu në tokë mund të mos e shohësh kurrë atë që ka bërë Perëndia me Fjalën e Tij në jetët e fëmijëve të klubit që të ka dhënë për t'i mësuar. Por do të gëzohesh për tërë përjetësinë për secilin që ka dëgjuar të vërtetën dhe ka besuar!

### **Perëndia ka përgjigjet për tërë nevojat reale të fëmijëve**

Fëmijët sot përballen me probleme shumë të vështira dhe serioze. Ata kërkojnë përgjigje dhe ndihmë; dhe e kërkojnë në vendet e gabuara. Ne kemi mundësi t'i mësojmë ata të njohin se kush është Perëndia dhe se si është Ai, dhe t'u tregojmë hirin e Perëndisë. Ne kemi privilegjin për t'u treguar atyre se Ai e ka bërë të mundur që ata të kenë faljen e mëkateve dhe jetën e përjetshme përmes Birit të Tij Jezu Krishtit.

Perëndia nuk kishte si qëllim që fëmijët të mbartin shqetësimet dhe lëndimet që ndodhin zakonisht, kur familjarët zihen me njëri-tjetrin. Gjithashtu, nuk ka pasur si qëllim që fëmijët të shikojnë dhe dëgjojnë paudhësinë që tregohet shpesh në televizor apo në video të ndryshme. Disa fëmijë i shikojnë këto programe ditë pas dite. Për shumë fëmijë rreth botës

kjo është një pjesë reale e jetëve të tyre. Ata kanë nevojë për ndihmë. Ata kanë nevojë për përgjigje. Atyre u duhet e vërteta për të mësuar se cili është shkaku i të keqes që shohin përreth tyre.

### **Ai është një Perëndi personal, të Cilin fëmijët mund ta njohin përmes besimit në Jezu Krishtin**

Nevoja e tyre më e madhe është një marrëdhënie personale me Perëndinë përmes Birit të Tij dhe për të njohur që Ai, Perëndia Shumë i Lartë, është më i fortë se armiku! Shumica e fëmijëve dëgjojnë me lehtësim ndërsa mësojnë të vërtetën nga Fjala e Perëndisë. Ata lehtësohen kur dinë se Perëndia i njeh gjërat e vështira të jetës dhe ka siguruar një mënyrë që ne të mposhtim Satanin, mëkatin dhe vdekjen.

Këto mësimet e paraqesin të vërtetën në kontekstin e saj biblik. Ato theksojnë karakterin dhe atributet e Perëndisë, duke e paraqitur Perëndinë në veprim në jetët e njerëzve realë përgjatë historisë. Këto mësimet tregojnë se ky është Perëndia që është në veprim rreth nesh sot. Perëndia është që nga përjetësia i shenjtë, i plotfuqishëm, i drejtë dhe i dashur; Ai është një Perëndi personal, të Cilin fëmijët mund ta njohin përmes besimit në Jezu Krishtin.

### **Ç'mund të themi për disiplinën?**

Ne jetojmë në një shoqëri që lejon dhe shumë herë inkurajon mungesën e respektit. Këto qëndrime mund të vijnë në klub përmes fëmijëve të klubit. Grupet e mëdha apo të vogla të fëmijëve mund të kenë probleme me mungesën e respektit.

Çfarë duhet të bëjë një mësues kur ka në klubin e tij fëmijë që nuk e respektojnë? Kjo është arsyeja pse është e rëndësishme që t'i njohësh fëmijët e klubit tënd. Do të jesh në gjendje të marrësh në konsideratë idetë e mëposhtme: A tregon gjithmonë fëmija mungesë respekti apo thjesht po kopjon disa fëmijë të tjerë në klub? Nëse ai po kopjon të tjerët, një ndreqje e shpejtë për momentin dhe një diskutim i ëmbël me fëmijën pas takimit mund të ndreqë problemin. Sigurohu që fëmija të dijë që ti kujdesesh për të.

Nëse fëmija tregon gjithmonë mungesë respekti, mund të ketë probleme në shtëpi. Lutu për atë fëmijë. Nëse ndreqja ndaj tij për momentin dhe diskutimi me të pas takimit nuk shërben për gjë, atëherë mund të jetë e dobishme të flasësh me prindërit e tij.

Nëse flet me prindërit, ji gjithmonë miqësor dhe mos u çudit nëse nuk do t'u pëlqejë të dëgjojnë atë që do t'u thuash. Vazhdo të lutesh. Fjala që po mëson është e fuqishme. Perëndia është në gjendje t'u tregojë fëmijëve të klubit nevojat e tyre dhe të ndryshojë jetët e tyre. Mos u dorëzo. Disiplino sa herë që është e nevojshme.

Nxiti fëmijët të dëgjojnë dhe t'i përdorin Biblat e tyre. Drejtuesit e tjerë të klubit duhet të jenë të ulur me fëmijët ndërsa ti po jep mësimin për të ndaluar sjelljen e keqe kur ajo ndodh. Këta drejtues mund ta bëjnë këtë gjë duke e prekur lehtë në shpatull apo duke i folur me zë të ulët një fëmijë që po sillet keq. Nëse është e nevojshme, ata mund të ulen midis dy fëmijëve.

## **Çfarë i duhet mësuesit për të dhënë këto mësim?**

Bibla do të jetë teksti yt. Fjala e Perëndisë është autoriteti dhe burimi i këtyre mësimëve. Duke lexuar të vërtetat që mësohen nga Bibla, fëmijët e klubit do të mësojnë se Bibla është burimi i çdo të vërtete.

Ne rekomandojmë që të përdorësh grafikët dhe figurat. Këto figura janë bërë për të shoqëruar mësimet. Për ata që do ta zgjedhin këtë mundësi, ne do të rendisim listën se cila figurë do të përdoret me secilin mësim dhe ku duhet paraqitur ajo gjatë tij.

Historitë në *Kartat Awana* mund të përdoren me kukulla, ose mund të luhen si drama.

## **Ji i përgatitur! Zbato planin mësimor**

Çdo mësim mbështetet mbi themelin e hedhur në mësimet e mëparshme. Prandaj është shumë e rëndësishme që të gjitha mësimet të mësohen tërësisht. Mos kapërce asnjë prej mësimëve. Është e domosdoshme që ti, si mësues, të kuptosh se përse po përdor metodën e mësimit kronologjik. (Shiko Pjesën 1, Themelet e Ungjillit). Mënyra më e mirë për t'i dhënë këto mësim do të ishte të kishe një mësues apo një skuadër mësuesish që mësojnë gjatë tërë vitit.

Është e rëndësishme që mësuesit të fillojnë t'i përgatisin këto mësim disa javë para se të fillojë klubi Awana. Ata duhet t'i njohin disa nga mësimet e para. Në këtë mënyrë ata do ta dinë se si do të jenë mësimet para se të fillojnë të japin mësim. Ndërsa japin mësim, ata duhet të mendojnë që më përpara, në mënyrë që të jenë të sigurt se po ndjekin planin kronologjik mësimor.

Nëse jepni mësim si skuadër, sigurohu që të gjithë ta njihni të tërë materialin mësimor. Me mësuesit e tjerë mund t'i ndani këto gjëra si vijon: dhënien e “Mësimeve nga Fjala e Perëndisë”, ndihmën për paraqitjen e historisë, bërjen e dy grupeve të pyetjeve, ndihmën me figurat, mësimin e vargut përmendësh apo zëvendësimin e të tjerëve nëse ndonjë prej jush nuk është në gjendje të marrë pjesë në mësim. Mund të kesh disa drejtues të tjerë Awana për të të ndihmuar të mësosh vargun përmendësh. Nëse ke drejtues Awana që të ndihmojnë, mund t'u japësh atyre Ndihamat e Mësimit të Mësuesit për atë mësim kohë më parë, në mënyrë që të jenë të përgatitur.

## **Kur duhet ta paraqes ungjillin?**

**Paraqite ungjillin sa herë që shikon që një fëmijë e ka zemrën të përgatitur për të pranuar të vërtetën!**

Këto mësim janë ndërtuar për një paraqitje ngazëlluese të ungjillit, mbështetur me kujdes në themelet e të vërtetës së Dhiatës së Vjetër dhe Dhiatës së Re. Por kjo nuk është koha e vetme e duhur për të shpallur ungjillin. Fëmijët e klubit tënd mund të vijnë nga ambiente të ndryshme dhe mund të kenë pasur lloje dhe sasi të ndryshme mësimi. **Vetëm me anë të lutjes dhe varësisë nga Fryma e Shenjtë mund të dimë se kur është koha e përshtatshme për të paraqitur ungjillin. Disa fëmijë të klubit mund të jenë gati kohë më parë se të tjerët në grup.**

Perëndia na ka dhënë detyrën për të shpallur të vërtetën e Tij shpëtuese. Ne jemi përgjegjës për ta shpallur në mënyrë të qartë. Fryma e Shenjtë përdor Fjalën e Perëndisë për të përgatitur zemrat. Kur Perëndia përgatit zemrën, e vërteta do të zërë vend. Lindja e re është nga Perëndia, jo nga ne. Ajo që ka rëndësi është që fëmija të kuptojë se është mëkatar, tërësisht i paaftë për të shpëtuar veten. Ai duhet të besojë vetëm te Krishti, i Cili



vdiq në kryq për ta shpëtuar nga ndëshkimi i mëkatit, Satanit dhe vdekjes.

Si një rregull i zakonshëm, ndiq skicën dhe trajto çdo të vërtetë biblike. Paraqite ungjillin kur është kuptuar qartë se kush është Perëndia, se cila është gjendja e njeriut të rënë dhe nevoja e tij për një shpëtimtar. Mos e humb mundësinë e dhënë nga Perëndia për të shpallur të vërtetën në çdo kohë, në çdo vend apo me çdokënd. Shiko “Si të drejtosh një fëmijë te Krishti” në fund të kësaj pjese (“Udhëzime për mësuesin”).

### **Bëji mësimet interesante!**

Ne kemi për të treguar historinë më të mrekullueshme të botës. Ajo flet për Atë që është më i madhi dhe më i mrekullueshmi nga të gjithë. Asnjë prej mësimëve tona nuk duhet të jetë i mërzitshëm.

Bëju fëmijëve pyetje ndërsa jep mësim. Pjesëmarrja e tyre do të jetë një ndihmë e madhe për të mbajtur gjallë interesin e tyre.

Përdor shprehjen e fytyrës, duart dhe zërin për ta bërë mësimin interesant. Për shembull, kur mëson se si njerëzit mëkatarë përqeshnin Noeun kur po ndërtonte arkën, mund të bësh të njëjtat veprime që bëjnë fëmijët kur tallin të tjerët që janë të bindur dhe që zbatojnë rregullat. Kjo do t'i ndihmojë fëmijët të kuptojnë se çfarë po mundohesh t'u mësosh. Bëj gjithmonë përsëritje ndërsa jep mësim. Të pyeturit e fëmijëve ndërsa mëson është mënyra më e mirë për të ditur nëse po të kuptojnë.

Shumica prej tyre e njohin që më përpara materialin që po u mëson. Lutu, studio dhe mendo për atë që po studion. Besoi Perëndisë për të hapur mendjet dhe zemrat e studentëve të tu. Çfarë privilegji kemi për të mësuar Fjalën e Perëndisë!

### **Ji i durueshëm. Mos u ngut në këto të vërteta të rëndësishme biblike.**

Disa mësues, nga ngazëllimi për të qenë mësues të mirë, mbushin mësimet e tyre me shumë shembuj të panevojshëm. Disa shembuj interesantë duhet të shtohen për t'i bërë mësimet interesante dhe të qarta. Por shembujt nuk duhet të zënë pjesën më të madhe të kohës, në mënyrë që të vërtetat biblike të rëndësishme për këtë mësim të mos lihen jashtë apo të mos thuhën me nxitim.

Mos nxito kur jep mësim. Sigurohu që po mëson qartë atë që thotë Bibla. Mos u shqetëso që nuk mund të mësosh gjithçka përnjëherësh.

Qëllimet javore për çdo mësim janë dhënë për të ndihmuar mësimin e fëmijëve të vegjël pak nga pak, hap pas hapi, drejt qëllimeve afatgjata. Mos lejo që fëmijët e klubit të të dëgjojnë për tema apo hollësi të cilat nuk duhet t'i mësosh. Çdo mësim duhet t'i nxisë fëmijët një hap përpara në njohjen e historisë së plotë në Bibël rreth Çlirimtarit apo Shpëtimtarit dhe në njohjen e së vërtetës doktrinale.

## **Ka shumë informacion!**

Mund të mendosh se ka shumë informacion për të mësuar në 15 minuta. Disa mësimë do të kenë më tepër informacion për të mësuar se sa të tjerët. Është shumë e rëndësishme që të mësosh tërë informacionin që është ngjyrosur me gri në “Mësime nga Fjala e Perëndisë”. Sigurohu që t’i njohësh këto të vërteta mirë, në mënyrë që t’ua mësosh qartë fëmijëve. Megjithatë, duhet të jesh i përgatitur të mësosh tërë informacionin në faqet e Ndihmës së Mësimit të Mësuesit. Ndonjëherë do të ketë informacion të përfshirë në Ndihmën e Mësimit të Mësuesit që do të ngjallë më tepër interes te fëmijët më të rritur.

Në shumicën e mësimëve ka material të mjaftueshëm për të mësuar rreth së njëjtës temë edhe një herë tjetër, mbase në Shkollën e së Dielës.

## **Po fëmijët e rinj të klubit?**

Ne jemi gjithmonë të gëzuar kur shikojmë fëmijë të rinj që marrin pjesë në takimet tona. Por si e ndihmojmë atë fëmijë të ri të kuptojë mësimin e sotëm kur ai nuk ka dëgjuar tërë të vërtetat e mëparshme themelore?

Një mësues duhet të mendojë në lutje se çfarë mund të bëjë në varësi të plotë ndaj drejtimit të Frymës së Shenjtë. Disa gjëra të cilat mund të të ndihmojnë të dish se çfarë të bësh janë numri i fëmijëve në klasën tënde, tema e mësimit të ditës dhe se sa përsëritje duhet për t’i ndihmuar fëmijët e tjerë në grup. Ti zakonisht nuk e di se sa shumë e njeh Biblën fëmija i ri. Përsëritja e të vërtetave të rëndësishme biblike është shpesh e dobishme për këdo në grup. Nëse do mund t’i përfshish edhe fëmijët që të të ndihmojnë me përsëritjen, duke përdorur figura me ngjyra. Koha e përsëritjes do të varet nga sasia e kohës që ke në dispozicion. Por nëse mësimi i sotëm është i gjatë dhe nuk ke shumë kohë për përsëritje, atëherë përpiku të bësh sugjerimet më poshtë:

1. Takohu me ata fëmijë në mënyrë individuale në një kohë tjetër.
2. Inkurajoji të marrin pjesë në Shkollën e së Dielës, nëse i përsërit mësimet atje.
3. Inkurajoji fëmijët e tjerë që t’i ndihmojnë duke përsëritur materialet me ta.



TruthSeekers

# Si të drejtojmë një fëmijë te Krishti

## Shpallja e ungjillit

Njësoj si me tërë njerëzimin, nevoja më e madhe e fëmijës është të dëgjojë, të kuptojë dhe t'i përgjigjet Fjalës së pastër të Perëndisë. Fuqia e Perëndisë tregohet në Fjalën e Tij. Përmes Fjalës së Tij Perëndia Shumë i Lartë solli rregull nga parregullsia dhe pështjellimi, dritë nga errësira dhe jetë nga bota e pajetë. Dhe me anë të Fjalës së Tij Zoti nxjerr në dritë ligësinë e zemrës njerëzore, i jep jetë frymës së vdekur të njeriut, çliron (liron) robërit e Satanit dhe u jep dritë të verbërve frymërorë (Isaia 55:10-11; Luka 4:18; Gjoni 8:32; 1 Pjetrit 1:23-25).

Ne duhet të shpallim ungjillin në mënyrë të tillë që fëmijët e pashpëtuar të kuptojnë se meritojnë vetëm gjykimin e Perëndisë, që shpëtimi është tërësisht vepër e Perëndisë dhe se mëkatarët nuk janë në gjendje të kontribuojnë diçka (me anë të veprave) për shpëtimin e tyre.

Si të krishterë kemi përgjegjësinë për të mësuar Fjalën e Perëndisë në varësi të plotë ndaj Frymës së Shenjtë. As dituria, as aftësia njerëzore, as metodat ungjillëzuese me trysni të madhe nuk mund të shpejtojnë veprën e Frymës së Shenjtë dhe kthimin e një shpirti në besim. Nuk është përgjegjësia jonë të përcaktojmë apo të përpiqemi të shkurtojmë kohën për një lindje të re. Ne duhet të mësojmë me besnikëri atë që na është caktuar dhe t'ia lëmë veprën e shndërrimit (kthimit) Zotit.

## A e kuptojnë fëmijët e klubit ungjillin?

**A kanë fëmijët e klubit tënd një njohje bazë të Perëndisë dhe natyrës e karakterit të Tij?** Kulturat dhe njerëzit janë të ndryshëm. Ashtu siç e kemi përmendur tashmë, disa nga fëmijët e tu mund të vijnë nga prejardhje të paqarta apo me mësim të rreme. Duke pasur parasysh këto gjëra dhe duke i pyetur fëmijët rreth asaj që ata dinë apo besojnë për Perëndinë dhe Fjalën e Tij, do të jesh në gjendje të dish nëse e kuptojnë me të vërtetë ungjillin.

**Do të jetë e rëndësishme që një fëmijë të dijë mjaftueshëm rreth attributeve të Perëndisë që t'i njohë dhe t'i pranojë si të vërteta:**

- **Ai është Perëndia i vetëm dhe i vërtetë (Perëndia Atë).**  
*Për këtë je i madh, o Zot, o Perëndi. Asnjëri nuk është si ti dhe nuk ka tjetër Perëndi veç teje, me sa kemi dëgjuar me veshët tona (2 Samuelit 7:22).*
- **Ai është i shenjtë dhe pa mëkat.**  
*Kush nuk do të të druajë, o Zot, dhe nuk do të lëvdojë emrin tënd? Sepse vetëm ti je i Shenjtë; sepse të gjitha kombet do të vijnë dhe do të adhurojnë përpara teje, sepse gjykimet e tua u shfaqën (Zbulesa 15:4).*
- **Për shkak se Perëndia është Krijuesi apo zotëruesi i njeriut, Ai ka të drejtën të kërkojë bindje nga njeriu.**  
*Pranoni që Zoti është Perëndia; na ka bërë ai dhe jo ne vetë; ne jemi populli i tij dhe kopeja e kullotës së tij (Psalmi 100:3).*
- **Perëndia është i përjetshëm, edhe pse ne e kemi të pamundur që të kuptojmë plotësisht se sa e gjatë është përjetësia.**  
*Para se të kishin lindur malet dhe para se ti të kish formuar tokën dhe botën, madje nga mot dhe përjetë ti je Perëndia (Psalmi 90:2).*

Një kuptim më i plotë i shumë të vërtetave biblike arrihet përgjatë viteve të studimit të Shkrimit.

### **A kanë fëmijët e klubit tënd një njohje bazë për mëkatën dhe natyrën e tyre mëkatore?**

- **Të gjithë kanë mëkatuar përpara Perëndisë.**

*Sepse të gjithë mëkatuan dhe u privuan nga lavdia e Perëndisë (Romakëve 3:23).*

*Jemi të gjithë si një gjë e papastër, dhe të gjitha veprat tona të drejtësisë janë si një rrobe e ndotur; po fishkemi të gjithë si një gjethë dhe paudhësitë tona na çojnë larg si era (Isaia 64:6).*

- **Ndëshkimi për mëkatën është vdekja në ferr, ndarja përgjithmonë nga Perëndia.**

*Sepse paga e mëkatit është vdekja, por dhuntia e Perëndisë është jeta e përjetshme në Jezu Krishtin, Zotin tonë (Romakëve 6:23).*

- **Nuk mund të bëjmë asgjë për të bindur Perëndinë që të na japë jetën e përjetshme. Prandaj, të qenët të mirë nuk është mënyra se si shkojmë në qiell.**

*Ai na shpëtoi jo me anë të veprave të drejta që ne bëmë, por sipas mëshirës së tij, me anë të larjes së rilindjes dhe të ripërtëritjes së Frymës së Shenjtë (Tit 3:5).*

### **A kanë fëmijët e klubit tënd një njohje bazë për Jezusin dhe për atë që Ai bëri në kryq? Një fëmijë duhet të besojë:**

- **Jezusi është Perëndi (Biri i Perëndisë), prandaj Ai ka të njëjtattribute si Perëndia Atë.**

*Unë dhe Ati jemi një (Gjoni 10:30).*

- **Jezu Krishti vdiq në kryq për të paguar dënimin për mëkatet tona, u ngjall përsëri dhe është në qiell.**

*Sepse unë ju kam transmetuar para së gjithash ato që edhe unë vetë i kam marrë, se Krishti vdiq për mëkatet tona sipas Shkrimeve, se u varros dhe u ringjall të tretën ditë, sipas Shkrimeve (1 Korintasve 15:3-4).*

- **Jezusi vdiq në vendin tonë për shkak të dashurisë së Tij të madhe për ne.**

*Sepse Perëndia e deshi aq botën, sa dha Birin e tij të vetëmlindurin, që, kushdo që beson në të, të mos humbasë, por të ketë jetë të përjetshme (Gjoni 3:16).*

### **Çfarë duhet të kuptojë një fëmijë për t'u shpëtuar?**

Të gjithë fëmijët nuk do të jenë në gjendje t'i thonë tërë atributet e Perëndisë. Atëherë, sa prej të vërtetave të mësipërme rreth Perëndisë duhet të kuptojë një fëmijë për t'u shpëtuar? Bibla nuk e thotë. Një fëmijë beson te Krishti si rezultat i bindjes së Frymës së Shenjtë, jo në bazë të njëfarë njohurie. Megjithatë, personi që paraqet ungjillin ka përgjegjësinë që të ndihmojë fëmijën të kuptojë në mënyrë të qartë të vërtetën. Prandaj, përqendrohu në fakte të thjeshta si 1 Korintasve 15, ku Pali përshkruan ungjillin:

*Tani, o vëllezër, po ju deklaroj ungjillin që ju kam shpallur dhe që ju e keni marrë dhe mbi të cilin ju qëndroni, dhe me anë të të cilit ju jeni shpëtuar, nëse do ta mbani fjalën që ju kanë predikuar, veç nëse besuat kot. Sepse unë ju kam transmetuar para së gjithash ato që edhe unë vetë i kam marrë, se Krishti vdiq për mëkatet tona sipas Shkrimeve, se u varros dhe u ringjall të tretën ditë, sipas Shkrimeve*

## **Çfarë duhet të bëjë një fëmijë për t'u shpëtuar?**

Nëse fëmija ka një njohje të qartë të të vërtetave të mësipërme, atëherë:

- **Fëmija duhet të besojë te Jezusi dhe te vdekja e Tij në kryq për të paguar për mëkatet e tij dhe të pranojë dhuratën e shpëtimit të Perëndisë.**

*Dhe ata i thanë: “Beso në Zotin Jezu Krisht dhe do të shpëtohesh ti dhe shtëpia jote” (Veprat e Apostujve 16:31).*

*Ju në fakt, jeni të shpëtuar me anë të hirit, nëpërmjet besimit, dhe kjo nuk vjen nga ju, po është dhurata e Perëndisë, jo nga vepra, që të mos mburret askush (Efesianëve 2:8-9).*

*Por të gjithë atyre që e pranuan, ai u dha pushtetin të bëhen bij të Perëndisë, atyre që besojnë në emrin e tij (Gjoni 1:12).*

### **Ftesa ngatërruese**

Ne e shtrembërojmë dhe e ngatërrojmë ungjillin në mendjet e njerëzve kur përpiqemi ta paraqesim duke përdorur pohime, të cilat i shtyjnë njerëzit të mendojnë rreth asaj që duhet të BËJNË, dhe jo rreth asaj që Perëndia ka BËRË për ta përmes Jezusit. Ne duhet t'i përdorim fjalët tona për t'i drejtuar mëkatarët e penduar që të besojnë në atë që është bërë PËR TA përmes Krishtit, dhe të mos e drejtojmë vëmendjen e tyre drejt asaj që duhet bërë NË TA.

“Prano Jezusin në zemrën tënde”. “Jepja zemrën Jezusit”. “Jepja jetën Jezusit”. “Hapja derën e zemrës tënde Zotit”. “Kërkoji Jezusit të të lajë mëkatet”. “Merr vendimin tënd për Krishtin”. “Kërkoji Jezusit të të japë jetën e përjetshme”. “Kërkoji Perëndisë të të shpëtojë”. “A do ta bësh Krishtin Zot të jetës tënde?”. “A do të pendohesh për mëkatet e tua dhe të shpëtohesh?”. “A do t'i rrëfesh mëkatet e tua dhe t'i kërkosht Zotit të të falë?”. “A do t'ia dorëzosh jetën Krishtit?”. Këto shprehje moderne dhe të përdorura shpesh e ngatërrojnë njohjen e njerëzve rreth ungjillit. Nëse mendimet e njerëzve drejtohen brenda tyre, drejt veprave të tyre, edhe atyre që janë me të vërtetë të shpëtuar do t'u mungojë siguria e shpëtimit. Brenda tyre gjithmonë do të dalin pyetjet: “A isha i sinqertë sa duhet? A e bëra si duhet? A e pranova me të vërtetë Krishtin? A ia dhashë me të vërtetë zemrën time Jezusit?”.

### **Një fëmijë duhet të dijë:**

#### **Sigurohu që fëmijët të dinë**

Lajmin e keq për mëkatin:

- Ata janë mëkatarë
- Ndëshkimi për mëkatin është vdekja
- Ndëshkimi për mëkatin duhet të paguhet

Lajmin e mirë për Jezusin:

- Jezusi është Perëndia
- Jezusi na do
- Jezusi mori ndëshkimin në vendin tonë duke vdekur në kryq
- Jezusi u ngjall prej së vdekurish

Çfarë duhet të bëjnë ata:

- Të vendosin tërë besimin e tyre në atë që bëri Jezu Krishti në kryq për të paguar ndëshkimin për mëkatet e tyre.



# Si t'i përgatisësh mësimet

## Qëllimet e mësimi

Këto mësimet janë shkruar për t'u përdorur bashkë me Biblën tënde. Fëmijët do të përdorin Biblat e tyre gjatë Kohës së Mësimi dhe Kartat Awana gjatë Kohës së Skuadrës.

Kjo pjesë do të përdoret për të parë se çfarë të vërtetash biblike do të mësohen në mësimin e asaj dite. Nëse i ke parë tërë "Qëllimet" në mësimet e vitit të parë, do të shikosh se çfarë historish do të mësosh gjatë vitit të klubit.

Nëse ke dikë që jep mësimet në vendin tënd, sugjero që mësuesi t'i lexojë "Qëllimet" e mësimet para dhe pas mësimi që do të mësojë ai. Kjo gjë do ta ndihmojë atë të dijë se çfarë është mësuar javën që shkoj dhe se çfarë do të mësohet javën që vjen. Gjithashtu, do të ndihmojë mësuesin të mos japin mësimin e javës që vjen.

Pjesa "Qëllimet" do të të ndihmojë të mos dalësh nga mësimi. Kujto se je duke i ndërtuar të vërtetat biblike njëra pas tjetrës. Mos lër vrima në themele. Pjesa "Qëllimet" do të të ndihmojë të kontrollosh themelet ndërsa i hedh ato.

## Figurat

Ne të rekomandojmë fort që të përdorësh grafikët dhe figurat në *Librin e figurave Rrënjët e besimit, Kërkuesit e së vërtetës Awana*. Ai ndahet në dy pjesë: Grafikët dhe figurat. Grafikët janë në pjesën e parë. Ata bëjnë të qartë konceptet dhe kronologjitë e mësuara tashmë. Figurat janë në pjesën e dytë të librit dhe ilustrojnë mësimet biblike. Ne do të rendisim se cila figurë duhet përdorur sipas çdo mësimi dhe në ç'pjesë të mësimi do të paraqitet. Kur figura e sugjeruar do të përdoret në mësim, do të ketë një shigjetë të tillë => para emrit të figurës. Këto figura, përveçse do t'i ndihmojnë fëmijët që t'i kuptojnë më mirë të vërtetat biblike, do të bëjnë që ata të jenë të vëmendshëm.

## Historia

Historia është shkruar për të ndihmuar fëmijët që të kuptojnë të vërtetat biblike të cilat mësohen në atë mësim. Disa histori do të kenë një apo më shumë të vërteta biblike të përmendura dhe disa prej tyre do të ndihmojnë thjesht qartësimin e të vërtetave themelore.

Historitë mund të ndryshojnë pakëz sipas vendndodhjes dhe përkthimit, kështu që disa nga këto ide të paraqitura mund të mos vlejnë për fëmijët e klubit tënd. Megjithatë, të vërtetat biblike nuk do të ndryshojnë; ato duhet të paraqiten siç janë shkruar.

Historitë mund të bëhen me kukulla, si skeç apo mund të tregohen si histori. Nëse e bën historinë si skeç, gjithmonë përdor një të rritur për rolin e xhaxhi Piterit. Fëmijët kanë nevojë për një person me autoritet (nëse është e nevojshme, një zonjë mund të lexojë pjesën e xhaxhi Piterit). Është e rëndësishme që kjo pjesë të lexohet qartë, sepse shumë të vërteta paraqiten përmes saj.

Sigurohu që fëmijët e klubit tënd të kuptojnë që këto histori nuk janë nga Fjala e Perëndisë.

## “Le të shohim në Bibël”

Vargjet përmendësh paraqesin karakterin dhe atributet e Perëndisë dhe mbështesin të vërtetat që jepen në çdo mësim. Shpjegoji vargjet. Përkufizimet e fjalëve të vështira apo jo të njohura jepen me disa vargje. Përdori përkufizimet që të të ndihmojnë të mësosh domethënien e vargjeve.

Ndihmoji fëmijët e klubit tënd të mësojnë vargun përmendësh. Fëmijët gjithmonë duhet të përpiqen që të mësojnë ta thonë vargun në mënyrë të përsosur, pa ndihma. Atyre mund t'u jepen dy ndihma nëse është e nevojshme. Shumica e fëmijëve duhet ta mësojnë vargun gjatë kësaj kohe. Disa prej tyre mund të vazhdojnë ta mësojnë vargun përmendësh kur të ndahen në grupe sipas skuadrave.

Më poshtë janë disa lojëra që mund t'i përdorësh për të të ndihmuar kur t'u mësosh vargun fëmijëve. Shënim: Në shumicën e lojërave të vargut përmendësh, fëmijët duhet të recitojnë vargun së bashku disa herë para se të bëjnë lojën.

**Fjala që mungon:** Shkruaj fjalët e vargut në dërrasë. Thuaju fëmijëve ta lexojnë. Fshij një fjalë dhe thuaju të përsërisin vargun, duke plotësuar fjalën që mungon. Pastaj fshij një fjalë tjetër dhe përsërite këtë gjë derisa të thonë tërë vargun përmendësh.

**Fjala që mungon 2:** Shkruaj fjalët e vargut në copa letre. Thuaju fëmijëve t'i mbajnë copat e letrës para grupit. Thuaju fëmijëve ta lexojnë. Thuaju fëmijëve që me radhë të tregojnë fjalën që duhet të fshehin. Tërë fëmijët thonë vargun sa herë që fshihet një fjalë, duke plotësuar fjalët që mungojnë. Fëmijët përsërisin vargun derisa ta thonë të tërin përmendësh.

**Gara e shpejtësisë:** Shkruaj dy apo tri fjalë nga vargu në copa letre.

Shembull:

*I gjithë Shkrimi / është/ i frymëzuar / nga Perëndia... / 2 Timoteut 3:16*

Ndaji fëmijët në skuadra. Mund ta ndash skuadrën tënde në grupe më të vogla. Përzieji letrat. Jepi çdo anëtar skuadre, apo grupi, një letër. Thuaju fëmijëve të qëndrojnë në këmbë dhe të mbajnë letrat e tyre në rendin e duhur. Shiko se sa kohë duhet. Pastaj jepja letrat grupit tjetër dhe shiko nëse mund ta bëjnë më shpejt. Nëse është një varg i gjatë, mund t'i japësh secilit grup copat e letrave me disa fraza të vargut në to. Skuadrat apo grupet shikojnë kush mund ta vendosë i pari vargun në rendin e duhur.

**Loja “Fillo e ndalo”:** Pasi fëmijët e kanë thënë vargun disa herë, drejtuesi fillon thënien e vargut përmendësh. Drejtuesi ndalon pas disa sekondash dhe zgjedh një fëmijë që të japë fjalën apo shprehjen e radhës. Kjo gjë vazhdon derisa të mbarojë vargu. Drejtuesi mund t'i kërkojë fëmijës të thotë pjesën tjetër të vargut.

**Formuesja:** Para se të fillojë klubi drejtuesi e shkruan vargun në një copë të madhe letre. Letra pritët si një formuese. Secila pjesë e formueses përmban një fjalë të vargut. Fëmijët bashkojnë pjesët e formueses. Kjo është një lojë e bukur kujtese për festa. Priti pjesët e formueses në atë mënyrë që t'u kujtojnë fëmijëve atë festë (pema e Krishtlindjes, kryqi i Pashkës).

**Loja “Para - mbrapa”:** Kjo lojë mund të zhvillohet nga fëmija dhe drejtuesin, fëmija me fëmijën apo me tërë grupin. Dërgo fjalët e një vargu para-mbrapa. Drejtuesi thotë referencën e vargut dhe fjalën e parë. Fëmijët thonë fjalën e dytë, ti mund të thuash të tretën, ata thonë të katërtën. Kjo gjë vazhdon derisa të mbarojë vargu.



**Kokoshka:** Pasi ta lexosh vargun tri herë, fillo recitimin e tij; por ndalo pas dy apo tri fjalësh. Grupi çohet dhe thotë fjalën e radhës. Pastaj drejtuesi thotë disa fjalë të tjera dhe grupi ulet ndërsa thotë fjalën e radhës. Vazhdohet të thuhet vargu disa herë.

### “Le të mendojmë”

Këto pyetje janë shkruar në mënyrë që ti të mund të flasësh për disa nga të vërtetat biblike në histori apo varg. Ato përfshihen edhe te *Kartat Awana*. Fëmijët do t’u përgjigjen këtyre pyetjeve në grupet sipas skuadrave. Mund të jetë e nevojshme që drejtuesit e skuadrës t’i lexojnë këto pyetje me zë, sepse disa nga fëmijët mund të mos jenë në gjendje t’i lexojnë pyetjet. Sigurohu që çdo fëmijë të kuptojë pyetjen dhe se cila është përgjigjja e saktë. Le të jetë kjo një kohë argëtuese diskutimi, jo një provim.

### “Mësime nga Fjala e Perëndisë”

Do të hedhësh një themel biblik mbi të cilin do të paraqitet ungjilli më vonë. Çdo mësim mbështetet në mësimet e kaluara, ndaj sigurohu që t’i trajtosh çështjet me kujdes. Sigurohu të diskutosh tërë të vërtetat biblike që janë të shkruara te “Mësime nga Fjala e Perëndisë”, të cilat janë të ngjyrosura.


Përdore Biblën tënde kur jep këto mësime. Nxiti tërë fëmijët që kanë Bibla që t’i marrin me vete në takimin e klubit.

Disa mësime përmbajnë disa shembuj që mund të jenë ose mund të mos jenë të përshtatshëm për fëmijët e klubit tënd. Këta shembuj janë dhënë që ti t’i përdorësh nëse mendon se do t’i ndihmojnë fëmijët e klubit tënd që ta kuptojnë më të mirë atë që po u mëson. Nëse zgjedh të përdorësh shembuj të tjerë që do të jenë një ndihmë më e mirë për fëmijët e klubit tënd, sigurohu që ta bëjnë mësimin më të qartë dhe të mos kundërshtojnë Biblën.

Kur shënimet, figurat dhe vargjet nga Shkrimi për t’u lexuar janë në pjesën në të majtë të faqes, ato duhet të përdoren me informacionin që është drejt e në të djathtë. Shënimet në secilën prej kolonave janë materiale shtesë për mësuesin që t’ua tregojë fëmijëve. Megjithatë, nëse shënimet janë me shkronja të pjerrëta, informacioni është vetëm për mësuesin.



**Lexo:** Kur shikon këtë figurë, do të thotë që kjo është pjesë shtesë nga Shkrimi që duhet të lexohet me zë të lartë. Këto pjesë të Shkrimit dhe ato pjesë të Shkrimit që shoqërojnë historitë, mund të lexohen nga ti, si mësues, apo mund t’u thuash disa prej fëmijëve t’i lexojnë me zë të lartë. Sigurohu që fëmijët të dinë të lexojnë para se t’u kërkojë të lexojnë.

Ndonjëherë një varg nga Shkrimi është shkruar ngjitur me figurën  **Lexo:**, dhe një pjesë e vargut është me shkronja më të errëta. Kjo bëhet për të treguar se për cilën pjesë të vargut po flet. Zakonisht do të gjesh një shënim, që të thotë që të mos diskutosh pjesën tjetër të vargut, sepse duhet të qëndrosh në temën për të cilën po flet mësimi i asaj dite.

### “Përsëritje”

**Ky aktivitet i sugjeruar i ndihmon fëmijët të kujtojnë diçka që kanë mësuar nga vargu përmendësh apo disa të vërteta biblike nga mësimi. Ti, si mësues, do të sigurohesh që të diskutosh të vërtetat biblike që janë në çdo aktivitet. Fëmijët që nuk mund të lexojnë do të kenë nevojë për ndihmë me këtë pjesë.**



## **Pyetje dhe përgjigje**

Këto pyetje mund të bëhen në fund të takimit të klubit. Pyetjet janë shkruar për të ndihmuar mësuesin dhe fëmijën që të shohë nëse mesazhi i mësimit është mësuar në mënyrë të qartë. Pyetjet do të jenë edhe një përsëritje e asaj që është mësuar para se të shkojnë në shtëpi. Këto nuk janë pyetje për diskutim. Përgjigjet duhet të jenë dhënë në mënyrë të qartë gjatë mësimit. Ti, si mësues, duhet të sigurohesh që ke folur për të vërtetat biblike nga të cilat janë nxjerrë këto pyetje.

## **Mësimet e përsëritjes**

Përsëritja është tejet e rëndësishme; mos e kalo thjesht për të kursyer kohë. Përsëritja do të ndihmojë për të përfortuar informacionin në mendjet e fëmijëve. Përsëritja do të ndihmojë edhe ty si mësues të dish se sa mirë po komunikon, dhe se cilat fusha kanë nevojë për vëmendje shtesë ndërsa vazhdon të japësh mësim. Pavarësisht se sa mirë mund ta kesh thënë diçka, ajo që ka më shumë rëndësi është ajo që kanë mësuar fëmijët! Dhe një mënyrë e shkëlqyer për të ditur atë që është mësuar është të bësh pyetje.

## **Si të bësh pyetje?**

1. Nëse bën një pyetje dhe fëmijët nuk mund t'i përgjigjen apo japin një përgjigje të gabuar, bëje pyetjen në mënyrë të tillë që ata të jenë në gjendje ta kuptojnë më mirë apo jepu disa ndihma për t'i ndihmuar që t'i përgjigjen. Nëse nuk mund t'i përgjigjen pas ndihmës së vogël, vazhdo dhe tregojua përgjigjen. Mos rri shumë gjatë tek një pyetje nëse nuk dinë t'i përgjigjen. Mos u bërtit apo mos i sikletos nëse nuk e dinë përgjigjen. Mbaj shënim pyetjet që nuk i dinë dhe sigurohu që të kalosh kohë për t'i shpjeguar para se të vazhdosh me mësimin e radhës.
2. Nëse një apo dy fëmijë u përgjigjen shumicës së pyetjeve, mund t'u bësh pyetje fëmijëve të tjerë në mënyrë individuale. Ose bëje me radhë, një për një, duke i dhënë secilit mundësinë të përgjigjet. Mos bëj pyetje, një për një, nëse disa nga fëmijët e tu do të sikletosen apo nuk kanë qenë në tërë takimet Awana.
3. Disa nga këto pyetje do të kenë të vërteta biblike në to me të cilat jo të gjithë fëmijët mund të bien dakord. Mund të kesh fëmijë më të rritur që duan të debatojnë për këto çështje. Bëju të ditur që ti e vlerëson interesimin e tyre, por bëju të ditur, gjithashtu, se qëllimi i takimit nuk është debati. Shumë nga këto të vërteta janë diskutuar në të shkuarën dhe me siguri do të diskutohen në të ardhmen. Por qëllimi i këtij takimi është të tregojë atë që thotë Bibla dhe të mësojë Fjalën e Perëndisë në mënyrë të përpiktë. Çfarëdo gjëje që të bësh, sigurohu që të kufizosh diskutimin e këtyre të vërtetave të debatueshme. Të dalësh fitimtar në një argument, nuk ndihmon në ndryshimin e mendimit. Thjesht lejo Frymën e Shenjtë të përdorë të vërtetën dhe ji i palëkundur, por i dashur dhe i durueshëm me ata që nuk bien dakord.
4. Pyetjet për diskutim duhet të përdoren nëse ke kohë dhe zgjedh t'i përdorësh. Këto janë të dobishme nëse ke fëmijë që janë pak më të rritur. Nëse përdor këtë lloj pyetjeje për të diskutuar, është e rëndësishme që ta mbash diskutimin nën kontroll. Fëmijëve duhet t'u jepet mundësia të thonë shkurtimisht mendimin e tyre dhe jo të turpërohen për atë që mendojnë. Mos lejo një apo dy fëmijë të bëjnë pjesën më të madhe të diskutimeve, sidomos kur përgjigjet e tyre janë të gabuara. Ti po përpiqesh që të krahasosh idetë e tyre nga e kaluara me atë që po mësojnë nga mësimet e Klubit Awana. Ji i durueshëm me ta.


Nëse ndonjë nga fëmijët thotë për përgjigjen e një fëmije tjetër: “Kjo është e gabuar”, mund t’i përgjigjesh: “Shiko, ne thjesht po kërkojmë mendimin e njëri-tjetrit. Çfarë mendon ti?”.

### **Lojërat e përsëritjes**

Fëmijët e klubit tënd mund të duan të bëjnë gara kur t’u përgjigjen këtyre pyetjeve. Shumica e fëmijëve kanë qejf të bëjnë gara dhe kjo gjë e mban gjallë vëmendjen e tyre. Një mënyrë për realizimin e kësaj është ndarja e klasës në skuadra dhe zhvillimi i një konkursi me pikë. Skuadra që u është përgjigjur më shumë pyetjeve në mënyrë të saktë fiton. Kjo funksionon mirë edhe me më shumë se dy skuadra.

Nëse vendos t’i formosh skuadrat dhe të bësh konkursin, alternoji skuadrat me pyetjet. Nëse një skuadër nuk mund t’i përgjigjet pyetjes, lëre skuadrën tjetër të ketë mundësi t’i përgjigjet asaj pyetjeje. Fëmija që ngre dorën i pari duhet t’i përgjigjet pyetjes. Pastaj, nëse ai e ka gabim, skuadra tjetër ka mundësinë të përgjigjet. Të gjithë duhet të rrinë në heshtje, përveç fëmijës që ngre dorën i pari. Rendi i pyetjeve të tjera është i njëjti, pavarësisht se cila skuadër përgjigjet e para. Për shembull, nëse skuadra A pyetet e para, por përgjigjet gabim, dhe skuadrës B i bëhet pyetja, pyetja e radhës i bëhet përsëri skuadrës B, e kështu me radhë.

**Shënim:** *Nuk është mirë që pyetjet për diskutim të përdoren për lojërat e përsëritjes. Nëse po bën lojërat e përsëritjes, mund t’i përsëritësh tërë pyetjet e tjera në fillim. Pastaj, pas lojërave, trajto pyetjet e diskutimit pa dhënë pikë për përgjigjet.*



# TruthSeekers

## **Rrënjët e besimit**

**Manuali i mësuesit**

### **Pjesa 3**

**Mësimet 1 deri 33**



TruthSeekers

## Mësimet Kërkuesit e së Vërtetës

1. Bibla është Fjala e Perëndisë . . . . .	37
2. Vetëm Perëndia . . . . .	40
3. Engjëjt e Perëndisë . . . . .	43
4. Engjëlli rebel . . . . .	46
5. Diçka nga asgjëja . . . . .	49
6. Perëndia krijoi gjithçka . . . . .	52
7. Perëndia krijoi njeriun . . . . .	55
8. Kopshti i Edenit . . . . .	58
9. Perëndia bëri Evën . . . . .	61
10. Pyetje, pyetje, pyetje! . . . . .	64
11. Adami dhe Eva nuk i binden Perëndisë . . . . .	68
12. Mallkimi dhe bekimi i Perëndisë . . . . .	73
13. Gjykimi dhe sigurimi i Perëndisë . . . . .	78
14. Kaini dhe Abeli . . . . .	81
15. Perëndia gjykon tërë botën . . . . .	86
16. Perëndia kujtohet për Noeun pas përmbytjes . . . . .	91
17. Perëndia thërret Abramin . . . . .	94
18. Bindja e Abramit . . . . .	97
19. Premtimet e Perëndisë ndaj Abramit . . . . .	100
20. Perëndia shkatërron Sodomën dhe Gomorrën . . . . .	103
21. Pyetje, pyetje, pyetje! . . . . .	106
22. Perëndia i dha Isakun Abrahamit . . . . .	110
23. Bijtë e Isakut . . . . .	113
24. Premtimi i Perëndisë ndaj Jakobit . . . . .	116
25. Djali i Jakobit, Jozefi . . . . .	119
26. Izraeli shkon në Egjipt . . . . .	122
27. Pyetje, pyetje, pyetje! . . . . .	125
28. Izraelitët bëhen sklevër . . . . .	129
29. Perëndia thërret Moisiun . . . . .	132
30. Perëndia dërgon plagët në Egjipt . . . . .	135
31. Perëndia kaloi tutje Izraelit . . . . .	138
32. Perëndia çliron Izraelin në Detin e Kuq . . . . .	141
33. Pyetje, pyetje, pyetje! . . . . .	144

# Mësimi 1

## Qëllimi

Ky mësim do t'u paraqesë Biblën fëmijëve të klubit tënd. Qëllimi ynë është të paraqesë Biblën si Fjala e Perëndisë: e vërtetë, pa gabime dhe e frytshme. Është e rëndësishme që fëmijët të kuptojnë se nga ka ardhur Bibla, autoriteti i saj dhe që nuk ka asnjë libër tjetër si ai.

## Hyrje

Historia e sotme është shkruar për t'i ndihmuar fëmijët që të kuptojnë të vërtetat biblike që jepen në mësimin e sotëm.

Disa histori do të kenë një apo më shumë të vërteta biblike që përmenden dhe disa prej tyre thjesht do të bëjnë të qarta disa të vërteta të rëndësishme themelore. Historitë mund të ndryshojnë pakëz sipas vendndodhjes dhe përkthimit, ndaj disa nga idetë e paraqitura mund të mos vlejnë për fëmijët tuaj. Megjithatë, të vërtetat biblike nuk do të ndryshojnë; ato duhet të paraqiten siç janë shkruar.

Meqë nuk ka hyrje për këtë histori në Kartën Awana, duhet t'u shpjegosh sfondin fëmijëve. Kjo histori rreth Xhonit, motrës së tij, Karolës dhe xhaxhait të tyre, Piterit, do të vazhdojë çdo javë. Në disa përkthime xhaxhi Piteri u shpërngul në shtëpinë ngjitur me atë të Xhonit dhe Karolës dhe në të tjera ai ndërtoi shtëpinë e tij ngjitur me të tyren. Sipas kulturës tuaj, shpjegoju fëmijëve se çfarë lidhje ka xhaxhi Piteri me Xhonin dhe Karolën dhe që xhaxhi Piteri ka jetuar në një vend tjetër (qytet, fshat, etj.) për disa vjet. Ndërsa ishte larg, ai mësoi për Perëndinë e vërtetë dhe dëshiron t'i tregojë edhe familjes së tij për Të.

## Figurat

Përdor Librin e figurave Rrënjët e Besimit: Kërkuesit e së Vërtetës Awana për çdo mësim. Grafikët dhe figurat që do të përdoren, do të renditen në çdo mësim.

• Figura 1: Fjala e shkruar e Perëndisë



• Grafiku 1: Mësimi për Perëndinë Mund t'i mbulosh tërë atributet e Perëndisë me shiritat të veçantë letre dhe të zbulosh secilin kur thuhet për herë të parë (në çdo shirit letre shëno me laps me shkronja të vogla se cili atribut fshihet). Në këtë mësim do të theksohet vetëm një atribut: **“Perëndia komunikon me njeriun”** (Atributet e tjera të Perëndisë përmenden në këtë mësim, por do të paraqiten në mësimet e mëvonshme).

# Bibla është Fjala e Perëndisë

## Historia

Xhaxhi Piteri pa Karolën dhe Xhonin që po zbrisnin rrugës.

“Përsëritet, Karola! Përsëritet, Xhon! Çfarë po bëni sot?” – thirri xhaxhi Piteri.

“Jemi të mërzhitur” – tha Xhoni.

“Mamaja tha që mund të vinim e të vizitonim” – tha Karola. “Jam e gëzuar që erdhe të banosh afër nesh!”.

“Edhe unë” – pranoi Xhoni. “Sepse më pëlqen të vij këtu e të të takoj”.

“Të njoh unë ty!” – tha Karola. “Ty të pëlqejnë ëmbëlsirat që të jep”.

“Këtu ke të drejtë” – qeshi Xhoni.

Xhaxhi Piteri u çua dhe tha: “Më duket se kam diçka për ju. Po shkoj ta marr”.

Kur xhaxhi Piteri u kthye me ëmbëlsirat, Xhoni e pyeti se çfarë po lexonte dhe Karola i tha menjëherë: Biblën.

“Ti e lexon shumë Biblën, apo jo, xhaxhi Piter?” – pyeti Karola.

“Po, Karola, e lexoj. Është libri më i mrekullueshëm” – tha xhaxhi Piteri.

“Çfarë gjëje të mrekullueshme ka ky libër?” – pyeti Xhoni i çuditur.

“Është i mrekullueshëm, sepse është libri i Perëndisë: Perëndia e ka shkruar” – shpjegoi xhaxhi Piteri. “Ai u tha njerëzve të shkruanin fjalët e Tij, në mënyrë që Ai të komunikonte me njerëzit. Bibla është mesazhi personal i Perëndisë për secilin prej nesh”.

“Për ne?” – pyeti Karola e çuditur. “Mendova se është shkruar shumë kohë më parë”.

Xhaxhi Piteri shpjegoi se si Perëndia përdori mbi 40 njerëz, të tërë judenj përveç njërit, që të shkruanin mesazhin e Tij për vite me radhë derisa gjithçka që Ai dëshironte të na thoshte ishte shkruar. Ai tregoi se ishin dashur rreth 1500 vjet për ta shkruar të gjithën, por që Bibla është libri më i mrekullueshëm dhe më i përpiktë i tërë historisë.

“Bibla është historia e Perëndisë” – shpjegoi xhaxhi Piteri. “Ai e dha mesazhin e Tij përmes popullit jude, por mesazhi i Tij është për tërë botën”.

“Do të thuash që flet për Të?” – pyeti Xhoni. “Është një libër shumë i madh. Nuk e di se si mund ta lexojë dikush të tërin”.

“Po,” – u përgjigj xhaxhi Piteri, – “Bibla flet për Perëndinë. Është HISTORIA E TIJ! E kam lexuar disa herë dhe sa herë që e lexoj, më pëlqen më shumë. Bibla përmban të gjitha përgjigjet për tërë çështjet e rëndësishme të jetës. Bibla nuk ndryshon asnjëherë, sepse Perëndia nuk ndryshon asnjëherë. Gjithçka që ka shkruar mijëra vjet më parë është akoma e dobishme për ne sot”.

“Do të thuash që nuk është thjesht një mbledhje historish të vjetra?” – pyeti Karola.


“Absolutisht jo!” – pohoi xhaxhi Piteri. “Gjithçka e shkruar në Bibël është e vërtetë dhe është shkruar atje që ta mësojmë ne. Perëndia dëshiron që ne ta njohim”.

Xhoni, duke dëgjuar zërin e mamasë që po e thërriste, i tha xhaxhi Piterit:

“Duhet të ikim tani, xhaxhi Piter, por do të kthehem nesër për të mësuar më tepër për librin tënd të madh”.

**Frymëzuar:** Perëndia u dha Fjalën e Tij njerëzve që e shkruan mesazhin e Tij për ne

## Le të shohim në Bibël



**2 Timoteut 3:16a - "I gjithë Shkrimi është i frymëzuar nga Perëndia".**

Ndihmoji fëmijët e klubit tënd ta gjejnë këtë varg dhe, nëse ka kohë, çdo varg që do të lexohet. Shpjegoje vargun pa u nxituar, duke përdorur përkufizimet e dhëna me vargun

para se t'i ndihmosh fëmijët ta mësojnë vargun përmendësh. Shiko pjesën "Si të përgatitësh mësimet e tua" për ide se si t'ua mësosh vargun fëmijëve.

## Le të mendojmë

1. Te kush shkuan për vizitë Xhoni dhe Karola?  
a. Miqtë; b. Gjyshi; **c. Xhaxhai.**
2. Çfarë po lexonte xhaxhi Piteri kur mbërritën ata? **Biblën.**
3. Pse xhaxhi Piteri tha që Bibla është libri i mrekullueshëm?  
a. Bibla është shumë e madhe; **b. Bibla është libri i Perëndisë: Ai e ka shkruar;** c. Ka shumë figura në të.
4. Kë përdori Perëndia për të shkruar Biblën?  
**a. Mbi 40 njerëz ndihmuan për shkrimin e Biblës.** b. Treguesit e historive ndihmuan për shkrimin e Biblës; c. Mësuesit ndihmuan për shkrimin e Biblës.
5. Për kë e shkroi Perëndia Biblën? **Për ne, për tërë njerëzit.**

## Mësime nga Fjala e Perëndisë

Do të hedhësh një themel biblik mbi të cilin do të paraqitet ungjilli. Çdo mësim mbështetet mbi mësimin paraardhës, ndaj sigurohu të trajtosh çdo çështje me kujdes.

Sigurohu dhe diskuto tërë të vërtetat biblike të shkruara te pjesa "Mësime nga Fjala e Perëndisë" te Kartat Awana. Në ndihmën e mësuesit më poshtë, **informacioni i përfshirë në mësim apo histori do të jetë i ngjyrosur.**

Përdor Biblën kur jep këto mësime. Nxiti tërë fëmijët që kanë Bibla t'i marrin me vete në klub. Meqë mësimi i sotëm është rreth Biblës, tregojë pjesët e Biblës dhe se si ajo përdoret.

- Pasqyra e lëndës
- Dhiata e Vjetër
- Dhiata e Re
- Kapitujt
- Numrat e vargjeve

## Sigurohu që të vërtetat e rëndësishme më poshtë të shpjegohen në mënyrë të qartë:

### 1. Bibla është Fjala e Perëndisë

- Bibla është libri më i rëndësishëm në tërë botën, sepse është Fjala e Perëndisë.
- Perëndia është më i madh nga të gjithë dhe më i rëndësishëm nga të gjithë; Ai është autoriteti më i lartë.
  - Shpjego autoritetin: e drejta për të vendosur apo gjykuar; një e drejtë që jep pushtet; një burim i besueshëm informacioni.
- Perëndia komunikoi me njeriun.
  - Shpjego komunikimin: t'ua bësh të njohura të tjerëve mendimet apo ndjenjat. Perëndia na thotë se çfarë duhet të dimë.
  - Bibla nuk është ideja e njeriut, por Fjala e vetë Perëndisë. Perëndia është autori i Biblës.
  - Perëndia përdori më tepër se 40 autorë për të shkruar Fjalën e Tij.
  - Perëndia bëri që këta profetë (dikush që flet apo shkruan mesazhet nga Perëndia) të shkruanin saktësisht atë që Ai dëshironte që të shkruanin. Ndonjëherë Ai foli me zë të lartë.
  - Ndonjëherë u foli në vizione (ëndrra).

=> Grafiku 1: Mësimi për PerëndinëTrego: "Perëndia komunikoi me njeriun".



**Lexo:** 2 Pjetrit 1:20-21.



**Lexo:** 2 Timoteut 3:16a – "I gjithë Shkrimi është i frymëzuar nga Perëndia".

=> Figura 1: Fjala e shkruar e Perëndisë

Kjo figurë tregon një profet, i cili po shkruan mesazhin që i është dhënë nga Perëndia. Profeti po shkruan në një rrotull: një pergamenë apo lëkurë mbi të cilën shkruhej teksti me bojë. Në ato kohëra përdoreshin rrotullat në vend të letrës. Rrotulla mund të mbështillej dhe ruhej, ashtu siç mbajmë një libër në sirtar. Asnjë libër tjetër në botë nuk është shkruar në këtë mënyrë: Perëndia përdori njerëz, duke kontrolluar me përpikëri atë që ata shkruan.

## Përsëritje

Shiko vargun përmendësh:  
*I gjithë Shkrimi është i frymëzuar nga Perëndia (2 Timoteut 3:16a).*

## Pyetje dhe përgjigje

1. Si queshin njerëzit të cilëve Perëndia u foli Fjalën e Tij?  
**Judenj apo profetë.**
2. Sa vetë përdori Perëndia për të shkruar Fjalën e Tij? **Më tepër se 40.**
3. Si quhet libri që është Fjala e Perëndisë? **Bibla.**
4. Në mësimin e sotëm, për kë na flet Bibla? **Për Perëndinë.**
5. Cili është libri më i madh?  
**Bibla.**

- Ndonjëherë Ai thjesht e vendos mesazhin drejtpërdrejt në mendjet e tyre.
- Bibla nuk u shkrua e tëra përnjëherësh, por u deshën rreth 1500 vjet që tërë Bibla të shkruhej.
- Bibla përputhet si një Libër i vetëm, edhe pse Perëndia përdori mbi 40 vetë dhe u deshën rreth 1500 vjet për ta shkruar. Bibla ka një autor, Perëndinë!

### 2. Bibla është mesazhi i Perëndisë ndaj botës, të cilin e dha përmes popullit jude.

- Të gjithë njerëzit që përdori Perëndia për të shkruar Fjalën e Tij ishin judenj, përveç njërit prej tyre.
- Perëndia e dha mesazhin e Tij përmes popullit jude, por mesazhi i Tij është për tërë botën.

Tek Isaia 45:22, Perëndia thotë: *“Kthehuni nga unë... ju mbarë skaje të tokës. Sepse unë jam Perëndia dhe nuk ka asnjë tjetër”.*

### 3. E gjithë Bibla është transmetuar te ne pa gabime.

- Kopjimi i Biblës u bë me shumë kujdes, në mënyrë që të mos kishte gabime.
- Librat origjinalë të Biblës janë shkruar ose në hebraisht, aramaisht ose greqisht. Jo të gjithë njerëzit mund t'i lexonin këto gjuhë.
- Për qindra vjet, vetëm disa njerëz ishin në gjendje të kishin kopje të Biblës. Përgjatë shumë viteve Perëndia u dha njerëzve aftësinë për të përkthyer Biblën në gjuhë të ndryshme. Bibla është përkthyer në më shumë gjuhë se çdo libër tjetër. Perëndia nuk ndryshon. Fjala e Perëndisë nuk do të ndryshojë. Perëndia siguroi që askush të mos e ndryshonte Fjalën e Tij kur e përkthye. Bibla është me të vërtetë Fjala e Perëndisë!  
*Gjithnjë, o Zot, fjala jote është e qëndrueshme në qiejt (Psalmi 119:89).*
- Çdo fjalë e Biblës është e vërtetë!
- Bibla është një libër i vërtetë historie. Shumë pjesë të informacionit të lashtë, të cilat janë gjetur gjatë viteve, përputhen me atë që është shkruar në Bibël: informacion si vendet e sakta të qyteteve, ndërtesave, mënyrat se si jetonin njerëzit, emrat dhe datat.

### 4. Bibla është mesazhi personal i Perëndisë për secilin prej nesh; ai është mesazhi më i rëndësishëm që na është dhënë ndonjëherë.

- Bibla na flet për Perëndinë.
- Bibla na flet se çfarë mendon Perëndia për ne dhe çfarë shikon Ai si nevojën tonë më të madhe.
- Bibla na flet se si është plotësuar nevoja jonë më e madhe.



# Mësimi 2 Vetëm Perëndia

## Qëllimi

Ky mësim do të fillojë t'i ndihmojë fëmijët e klubit të kuptojnë të vërtetën e sovranitetit të Perëndisë, duke treguar se Perëndia ekzistonte, i vetëm, para çdo gjëje dhe që Ai nuk ka nevojë për diçka apo dikë tjetër për të ekzistuar. Gjithashtu, do të paraqesësh shkurtimisht Trininë. Duke paraqitur sovranitetin e Tij, do të japësh disa karakteristika dhetribute të Perëndisë: Ai është i përjetshëm dhe i pranishëm kudo; Ai është Frymë; Ai është Trini.

## Hyrje

Në historinë e sotme Xhoni dhe Karola mësuari që Perëndia nuk është si ne. Ai është shumë më i madh nga sa mund ta imagjinojë dikush. Ne mund të mësojmë shumë për Të duke studiuar Fjalën e Tij, Biblën. Perëndia dëshiron që ta njohim. Në mësimin e parë the që Perëndia është Ai që na dha Biblën. Bibla është një libër me histori të vërteta: histori siç i ka shkaktuar Perëndia të ndodhin. Do të studiosh çfarë Ai ka thënë për veten në Fjalën e Tij. Nga të gjitha gjërat që mund të studiojmë, të mësuarit rreth Perëndisë është gjëja më e mirë! Jeremia 9:23-24 na thotë që të njohësh Perëndinë është gjëja më e rëndësishme që mund të bëjmë.

Sa i madh është Perëndia?  
Sa i rëndësishëm është Ai?  
A ka pasur një fillim?  
A do të ketë një fund?  
Nga erdhi?

Për çfarë ka nevojë Perëndia?  
Le të hapim Biblat dhe të shohim se si u përgjigjet Perëndia këtyre pyetjeve në Fjalën e Tij.

## Figurat

- Grafiku 2: Perëndia është më i madh se të gjithë. Në këtë grafik pohimet rreth njeriut lexohen pa koment. Ato ndodhen aty për të treguar madhësinë e Perëndisë.

SHËNIM: Secila prej tetë karakteristikave të Perëndisë në këtë mësim paraqitet në grafikun **"Perëndia është më i madh se të gjithë"**. Ndërsa paraqet një karakteristikë të re të Perëndisë, trego grafikun dhe lexo karakteristikën që i korrespondon.

- Grafiku 1: Mësimi për Perëndinë. Në këtë mësim theksohen tri karakteristika: **"Perëndia nuk ka fillim dhe nuk do të ketë fund: Ai është i përjetshëm"**, **"Perëndia është kudo në çdo kohë"**, dhe **"Perëndia është më i madh dhe më i rëndësishëm se të gjithë; Ai është autoriteti më i lartë"**.

## Historia

"A e di, xhaxhi Piter?" – thirri Xhoni. "Pamë një të huaj që po flinte anës lumit".

"T'i kishe parë të gjitha gjërat që kishte me vete" – shtoi Karola. "Nuk e di se si i mban të gjitha".

"Vërtetë!" - tha Xhoni. "Ai kishte një elektrik dore, një jorgan portativ, një enë me ujë, një çantë shpine, rroba, litarë..."

"Kishte gjëra që nuk i kisha parë kurrë" – e ndërpreu Karola.

"Por nuk pashë ushqim" – tha Xhoni.

"Oh, Xhon! Ti mendon vetëm për ushqimin" – qeshi Karola.

"Ke të drejtë, Xhon" – tha xhaxhi Piteri. "Ka disa gjëra për të cilat kemi nevojë për të jetuar, si ushqimi. Megjithatë, shumë njerëz kanë më tepër nga sa u nevojitet. A e di që Perëndia nuk ka nevojë për gjë?"

"Çfarë do të thuash, xhaxhi Piter?" – pyeti Karola.

Xhaxhi Piteri shpjegoi se Perëndia ka qenë dhe do të jetë gjithmonë. Ai ka ekzistuar para çdo gjëje që ka krijuar. Ai ka ekzistuar para se të kishte dritë, ajër, ushqim apo ujë; ai ka ekzistuar para engjëjve!"

"Por, a ka pasur Perëndia një fillim?" – pyeti Xhoni.

"Jo," – tha xhaxhi Piteri, – "Perëndia është i përjetshëm: Ai nuk ka lindur dhe nuk ka fillim. Ai nuk plaket kurrë dhe nuk do të vdesë kurrë. Shiko, gjithçka tjetër ka pasur një fillim: njerëzit, kafshët, ajri, drita dhe bimët, por Perëndia është më i madh nga sa mund ta kuptojmë. Perëndia është më i madh nga të gjithë! Fjalët e para në Bibël janë: 'Në fillim Perëndia...'. Në fakt Perëndia ekzistonte para fillimit".

"Por, a nuk ishte Perëndia i vetmuar pa njerëz?" – pyeti Karola.

"Jo, Perëndia është shumë i veçantë" – u përgjigj xhaxhi Piteri. "Bibla na thotë që Ai është në të vërtetë tre persona në një. Ne e quajmë Perëndinë 'Trini'. Perëndia Atë, Perëndia Bir dhe Perëndia Frymë e Shenjtë: që janë së bashku Perëndia i madh e i vetëm: Ai ka ekzistuar përgjithmonë. Ne nuk mund të kuptojmë se sa i mrekullueshëm është Ai".

"Tani jam i ngatërruar" – tha Xhoni.


"Shiko, Xhon," – u përgjigj xhaxhi Piteri, – "unë madje as që përpiqem që t'i kuptoj disa gjëra rreth Perëndisë. Thjesht i besoj ato gjëra si të vërteta, sepse Perëndia thotë që janë të vërteta. Perëndia nuk është si ne. Ai është shumë më i madh nga sa mund ta imagjinojmë! Por mund të mësojmë shumë për Të thjesht duke studiuar Fjalën e Tij, Biblën. Perëndia është me të vërtetë i mrekullueshëm dhe Ai dëshiron që ta njohim Atë!"

"Neve na pëlqen të dëgjojmë për Të, xhaxhi Piter" – tha Karola.

"Le të shkojmë në shtëpi dhe le të numërojmë paratë, Xhon. Duam të kursejmë para që ta blejmë vetë Biblën".



## Le të shohim në Bibël



**Psalmi 90:2** - “Para se të kishin lindur malet dhe para se ti të kishe formuar tokën dhe botën, madje nga mot dhe përrjetë ti je Perëndia”.

Ndihmoji fëmijët e klubit tënd ta gjejnë këtë varg; lexoje dhe pastaj shpjegoje duke përdorur përkufizimin e fjalës “përrjetë”. Është e rëndësishme që fëmijët të kuptojmë që vetëm Perën-

dia është i përrjetshëm. Çdo gjë tjetër ka një fillim.

Kjo do t'i ndihmojë ata të kuptojnë se përse Perëndia, duke qenë i vetmi para fillimit, është i vetmi që mund të na thotë se çfarë ndodhi në fillim.

Nuk ka pasur një kohë kur Perëndia nuk ka ekzistuar.

- Ai nuk ka një fillim.
- Ai nuk është krijuar.
- Ai ka jetuar përgjithmonë.
- Nuk do të ketë një kohë kur Perëndia nuk do të ekzistojë.
- Perëndia nuk mund të vdesë kurrë: Ai jeton përgjithmonë!

## Le të mendojmë

1. A ka pasur një kohë kur Perëndia nuk ka jetuar? **Po / Jo.**
2. A do të vdesë Perëndia? **Po / Jo.**
3. A ka pasur ndonjë kohë kur nuk ka pasur njerëz? **Po / Jo.**
4. Për çfarë ka nevojë Perëndia për të jetuar?  
a. Ushqim; b. Ujë; c. **Asgjë.**
5. A mësojmë për Perëndinë në Bibël? **Po / Jo.**

## Mësime nga Fjala e Perëndisë

### 1. Perëndia është i përrjetshëm

- Gjithçka, përveç Perëndisë, ka pasur një fillim.
  - Fjalët e para që Perëndia shkroi për ne në Bibël janë: Në fillim (Zanafilla 1:1a).
  - Perëndia na dha këto fjalë, në mënyrë që të dinim se ka pasur një fillim për çdo gjë.
  - Gjithçka që shikojmë dhe gjithçka rreth të cilës mund të kemi njohuri, por që nuk mund ta shohim, ka pasur një fillim, përveç Perëndisë.
  - Para fillimit nuk kishte: gjithësi, tokë, engjëj, djall, bimë, kafshë apo njerëz. Tërë këto gjëra kanë fillim.
- Vetëm Perëndia nuk ka fillim; Perëndia nuk do të ketë fund; Perëndia është i përrjetshëm.

### 2. Perëndia është Trini në tre persona.

- Perëndia është përgjithmonë Perëndia i përrjetshëm.
  - Ndërsa studiojmë Fjalën e Perëndisë, do të zbulojmë që, edhe pse ka vetëm një Perëndi, ka tre persona që janë njësoj Perëndi.
  - Perëndia Atë (Ati është Perëndi).
  - Perëndia Bir (Biri është Perëndi).
  - Perëndia Frymë e Shenjtë (Fryma e Shenjtë është Perëndi).
  - Ne përdorim fjalën “Trini” (një grup prej tre vetash) për të përshkruar këta tre persona që janë një Perëndi i përrjetshëm. Trinia është përtej mundësisë tonë për ta kuptuar. Ne vetëm mund të përshkruajmë atë që kuptojmë nga Fjala e Perëndisë. Fakti i mahnitshëm i Trinisë është thjesht një prej gjërave që na tregojnë madhësinë e Perëndisë!



**Lexo:** Zanafilla 1:1:

Zanafilla është themeli i tërë Shkrimit dhe Zanafilla 1 është themeli i Zanafillës. Mos e kalo me nxitim Zanafillën 1, sepse zbulimet bazë të natyrës dhe karakterit të Perëndisë shfaqen në të.



**Lexo:** Zanafilla 1:26a:

Pastaj Perëndia tha: “Ta bëjmë njeriun sipas shëmbëlltyrës sonë dhe në ngjasim me ne”. Ne po shikojmë vetëm fjalët “sonë” dhe “ne” (Nëse është e mundur, thuajti tërë fëmijëve të gjejnë vargun). Të tre personat përmenden te Mateu 28:19. Mos iu ndaj temës këtu.



**Lexo:** Romakëve 11:33, 34.



**Lexo:** Psalmi 147:5: *I madh është Zoti ynë, e pamasë është fuqia e tij dhe e pafund zgjuarsia e tij.*

“E pafund” do të thotë “pa mbarim”.



**Lexo:** Psalmi 139:7-12.

## Përsëritje

Shiko vargun përmendësh:

*Para se të kishin lindur malet dhe para se ti të kishe formuar tokën dhe botën, madje nga mot dhe përjetë ti je Perëndia (Psalmi 90:2).*

## Pyetje dhe përgjigje

1. Kush e krijoi Perëndinë?  
**Askush, Perëndia nuk është krijuar. Perëndia ka ekzistuar gjithmonë.**
2. Kush është më i madh dhe më i rëndësishëm se të gjithë?  
**Perëndia.**
3. Pse nuk mund t'i fshihemi Perëndisë? **Perëndia është kudo.**
4. Pse Perëndia nuk ka nevojë për trup si ne? **Ai është frymë.**
5. Sa Perëndi ka? **Vetëm një.**

### 3. Perëndia nuk ka nevojë për ndokënd.

- Ngaqë Perëndia ka ekzistuar para çdo gjëje, ne e dimë që Ai nuk ka nevojë për gjë. Perëndia ka ekzistuar i vetëm, para tokës, diellit, hënës, yjeve dhe galaktikës.
- Perëndia nuk ka nevojë as për tokën, as për gjërat që janë në të. Ai nuk ka nevojë për ajër për të marrë frymë, për ushqim për të ngrënë apo për ujë për të pirë.
- Perëndia nuk ka nevojë për diellin. Ai mund të shikojë në mënyrë të përsosur pa dritë. Ai nuk ka nevojë të flejë; Ai nuk ka nevojë për ditën dhe natën. Perëndia nuk ka nevojë për burim energjie. Ai nuk lodhet kurrë, nuk ka etje apo uri. **Perëndia nuk ka nevojë për diçka!**

### 4. Perëndia njeh gjithçka.

- Perëndia nuk ka nevojë që ta mësojë dikush. Perëndia njeh gjithçka; Ai ka tërë njohurinë. Perëndia di gjithçka që po ndodh.

### 5. Perëndia është frymë dhe nuk ka trup material.

- Perëndisë nuk i nevojitet toka për të jetuar dhe shumë gjëra të tjera për të cilat qeniet njerëzore kanë nevojë, sepse Perëndia nuk ka trup si ne.
- Gjoni 4:24 thotë që “Perëndia është Frymë”. Perëndia nuk ka mish dhe kocka si njerëzit, kafshët, zogjtë, peshqit apo rrëshqanorët.
- Perëndia është frymë, një Trini me tre persona, të tërë me mendje, personalitet dhe vullnet.

### 6. Perëndia ndodhet në çdo vend në të njëjtën kohë.

- Perëndia dhe vetëm Perëndia është në gjendje të jetë kudo në çdo kohë. Meqë Perëndia është kudo në çdo kohë, nuk ka asnjë vend ku mund të fshihemi nga Ai (Fjalët e Urta 15:3).
- Perëndia nuk është “në gjithçka”, pra, gjithçka nuk është “Perëndi”. Ai është Krijuesi, i ndarë dhe më i madh se tërë krijimi i Tij. Perëndia është më i lartë se të gjithë. Perëndia është më i madh se gjithçka që ka bërë.

### 7. Perëndia është më i madh dhe më i rëndësishëm se të gjithë; Ai është autoriteti më i lartë.

- Perëndia është përtej të kuptuarit tonë. Ne duhet të pranojmë se është dikush që është me të vërtetë më i madh dhe më i lartë se të gjithë.

Unë jam Zoti dhe nuk ka asnjë tjetër; jashtë meje nuk ka Perëndi (Isaia 45:5a).

Mënyra se si e përshkruajmë madhësinë e Perëndisë është të themi që Perëndia është sovran. Sovran do të thotë: “sundues, më i lartë në pushtet, kryetar...”. Bibla i referohet shpesh Perëndisë si “Shumë i Larti”. *Dhe ta dinë se ti vetëm, që quhesh Zoti, je Shumë i Larti mbi gjithë dheun (Psalmi 83:18).*

### 8. Perëndia ekzistonte para fillimit të gjithçkaje.

- Vetëm Perëndia ekzistonte në fillim. Në Bibël Perëndia na ka dhënë fakte për fillimet e gjithçkaje. Vetëm Perëndia mund të na thotë saktësisht se çfarë ka ndodhur.

# Mësimi 3 Engjëjt e Perëndisë

## Qëllimi

Ky mësim përcakton që Perëndia krijoi tërë qeniet frymërore. Do t'u tregojë fëmijëve që Perëndia, i Cili është sovran dhe i shenjtë, është më i madh se tërë qeniet e krijuara dhe i krijoi tërë qeniet të përsosura. Para se të mësosh se si Perëndia krijoi tërë gjërat materiale që mund të shihen (në një mësim të ardhshëm), do të mësosh në fillim që Perëndia krijoi botën frymërore, e cila përgjithësisht nuk mund të shihet. Është më mirë të mësosh për frymërat dhe Satanin në këtë fazë, sepse tërë frymërat, pra, engjëjt, dëshmuar krijimin e tokës (Jobi 38:4-7). Nuk do të mësosh për Satanin në këtë mësim.

## Hyrje

Fëmijët e klubit tënd do të mësojnë këto gjëra në historinë e sotme:

- Bindju prindërve.
- Kërkoju falje prindërve kur nuk u je bindur.
- Të vërtetat biblike për frymërat (engjëjt) të cilat i krijoi Perëndia.

Dy temat e para janë të rëndësishme, por mos shpenzo shumë kohë duke i diskutuar. Shumicën e kohës së mësimdhënies duhet t'ua kushtosh të vërtetave biblike të përmendura te **qëllimi**. Mos fol për Satanin në këtë mësim. Do të diskutosh për Satanin në mësimin e ardhshëm.

## Figurat

- Grafiku 3: Engjëjt e Perëndisë

- Grafiku 1: Mësimi për Perëndinë

Në këtë mësim përdor këtë grafik për të përsëritur atributet e Perëndisë që janë paraqitur tashmë, dhe kur të sugjerohet, paraqit **“Perëndia është i shenjtë...”** (mos lexo pjesën tjetër të këtij atributi) dhe **“Perëndia është i plotfuqishëm; nuk ka asgjë të vështirë për të”**.

## Historia

“Ajo që dëgjova mbrëmë ishte një histori e frikshme” – tha Xhoni.

“Mamaja të tha që të mos shkoje në atë vend, Xhon. Ti dhe miqtë e tu mund të ishit futur në telashe me ata burra”.

“E di” – pranoi Xhoni. “Por historitë e tyre janë shumë interesante. Nuk doja të largohesha. O, përshëndetje, xhaxhi Piter”.

“Përshëndetje, fëmijë” – përshëndeti xhaxhi Piteri. “Ç’janë këto gjëra kaq interesante?”.

“Një histori që Xhoni dëgjoi mbrëmë” – u përgjigj Karola. “Mamaja i kishte thënë që të mos shkonte gjëkund, por ai shkoi gjithsesi, ndërsa mami shkoi te shtëpia e së motrës”.

“Xhon, nuk iu binde mamit?” – pyeti xhaxhi Piteri.

“Po, ashtu është” – pranoi Xhoni. “E di që bëra gabim, por ata burra tregojnë histori fantastike. Disa prej tyre janë interesante, por disa janë vërtet të frikshme. Ato ishin për frymërat e ndyra dhe pastaj ishin për frymërat e mira”.

“Xhon, ti duhet t’i bindesh mamit” – tha xhaxhi Piteri. “Duhet të shkosh e t’i kërkoshe falje asaj nëse nuk i ke kërkuar ende. Dhe mamaja ka të drejtë: nuk duhet t’i dëgjosh ata burra. Ata nuk tregojnë të vërtetën”.

“Por, a ekzistojnë frymërat, xhaxhi Piter?” – pyeti Xhoni.

“Le të shohim se çfarë thotë Bibla për frymërat” – sugjeroi xhaxhi Piteri.

“Në Bibël?” – pyeti Xhoni.

“Po, në Bibël” – u përgjigj xhaxhi Piteri. “Ai është vendi për të gjetur të vërtetën. Historitë e atyre njerëzve do të fusin vetëm gënjeshtër në mendjen tënde, por Fjala e Perëndisë do të të tregojë se çfarë është e vërtetë dhe e mirë. A e dije që Bibla na tregon se tërë frymërat, të quajtur engjëj, u krijuan nga Perëndia?”.

“A e thotë me të vërtetë Bibla këtë?” – pyeti Karola.


“Po” – tha xhaxhi Piteri. “Në fillim Perëndia krijoi gjithçka. Ai krijoi tërë engjëjt. Ai i krijoi për t’i shërbyer Atij dhe për të qenë lajmëtarët e Tij. Ata duhej të adhuronin Atë, sepse Ai është Perëndia. Ai madje disave prej tyre u dha aftësi dhe detyra të veçanta për të bërë. Perëndia krijoi aq shumë engjëj, sa që do të ishte e pamundur t’i numëroje”.

“Dhe të gjithë ishin të mirë?” – pyeti Xhoni.

“Perëndia është i shenjtë” – u përgjigj xhaxhi Piteri. “Gjithçka që mendon, thotë dhe bën është e përsosur, ndaj tërë engjëjt u krijuan në mënyrë të përsosur; asnjë prej tyre nuk ishte i lig apo jo i mirë. Kur të vini herën tjetër do t’ju tregoj se çfarë thotë Bibla për atë që i ndodhi njerit prej engjëjve të veçantë të Perëndisë të quajtur Lucifer”.

“Shiko, xhaxhi Piter,” – tha Xhoni i gëzuar, – “mendoj se do t’i pëlqej më tepër historitë nga Bibla, sesa ato që kam dëgjuar vërdallë”.

## Le të shohim në Bibël



Gjoni 1:3 – “Të gjitha gjërat u bënë me anë të tij (fjala), dhe pa atë nuk u bë asnjë nga ato që u bënë”.

Është e rëndësishme që fëmijët e klubit tënd të kuptojnë që Perëndia është më i madh se frymërat. Ai ka jetuar para tyre, nga përjetësia. Ai është Personi që i krijoi. Ai u dha atyre jetë.

Sigurohu që të qëndrosh në temë. Mos shpjego tërë gjërat që bëri Perëndia gjatë këtij mësimi. Do të mësosh rreth pjesës tjetër të krijimit të Perëndisë në mësimet e tjera.

## Le të mendojmë

- Çfarë lloj historish po e trembnin Xhonin?  
a. Për familjen e tij; **b. Për frymërat e këqija**; c. Për kafshët.
- A flet Bibla për frymërat? **Po** / Jo.
- A quhen frymërat engjëj? **Po** / Jo.
- Nga kanë ardhur engjëjt?  
a. Janë të lindur; b. Kanë jetuar përgjithmonë; **c. Perëndia i ka krijuar**.
- A ishin disa engjëj të këqij kur i krijoi Perëndia? **Po** / Jo.

## Mësime nga Fjala e Perëndisë


### 1. Perëndia krijoi tërë qeniet.

- Në fillim Perëndia **krijoi tërë** qeniet frymërore. Para fillimit nuk ekzistonte asnjë.
  - Bibla përdor shumë fjalë të ndryshme për qeniet frymërore:  
Frymëra  
Engjëj  
Kerubinë  
Serafinë  
Ushtria e Zotit apo ushtria e qiejve  
Pushtete  
Sunduesit në vendet e larta  
Yjet apo yjet e mëngjesit
- Perëndia nuk u dha frymërave trupa materialë kur i krijoi: frymërat nuk kanë mish dhe gjak siç kemi ne.
- Frymërat mund të lëvizin ku të duan, meqë nuk kanë trupa materialë.
- Frymërat nuk janë kudo në të njëjtën kohë si Perëndia. Frymërat mund të ndodhen në një vend në një moment të caktuar kohe.

### 2. Frymërat u krijuan për t'i shërbyer Perëndisë.

- Frymërat u krijuan të gjitha nga Perëndia për ta dashur dhe për t'i shërbyer Atij.
  - Në fillim tërë frymërat ishin engjëj të Perëndisë.
  - Fjala “engjëj” do të thotë “lajmëtarë” apo “shërbëtorë”.

=> Grafiku 3: Engjëjt e Perëndisë



=> Grafiku 1: Mësimi për Perëndinë  
Trego grafikun: "Mësimi për Perëndinë". Lexo: "**Perëndia është i shenjtë...**" (Për këtë mësim do të lexosh vetëm këtë pjesë të këtij atributi).



**Lexo:** Psalmi 103:20 thotë:  
*Bekoni Zotin ju, engjëjt e tij të pushtetshëm dhe të fortë, që bëni atë që thotë ai, duke iu bindur zërit të fjalës së tij.*

=> Grafiku 1: Mësimi për Perëndinë  
Trego grafikun: "Mësimi për Perëndinë". Lexo: "**Perëndia është i plotfuqishëm. Nuk ka asgjë të vështirë për të**".

- Duke qenë se u krijuan nga Perëndia, ata i përkasin Atij.
- Ata u krijuan për të bërë atë që donte Perëndia.

### 3. Frymërat u krijuan të përsosura nga Perëndia.

- Perëndia krijoi tërë frymërat të përsosura; asnjë prej tyre nuk ishte e keqe apo jo e mirë.
  - Gjithçka që bën Perëndia është e përsosur, sepse Perëndia është i shenjtë.
  - Perëndia është i shenjtë: gjithçka që mendon, thotë dhe bën është e përsosur.
  - Perëndia nuk ka mëkatuar dhe nuk do të mëkatojë kurrë.

### 4. Frymërat u krijuan me dituri dhe forcë të madhe.

- Engjëjt janë më të fortë se ne dhe Bibla na thotë që Perëndia u ka dhënë atyre aftësinë për të bërë gjëra të mahnitshme; por ata nuk janë të plotfuqishëm si Perëndia.
- Engjëjt janë shumë të zgjuar, por ata nuk janë të gjithëdijshëm si Perëndia. Perëndia është më i zgjuar se tërë frymërat. Është shumë e rëndësishme të kujtojmë që **Perëndia është më i madh se të gjithë!**

### 5. Frymërat nuk mund të numërohen.

- Perëndia krijoi aq shumë frymëra, saqë do të ishte e pamundur që ne t'i numëronim. Zbulesa 5:11b thotë: *Numri i tyre ishte dhjetë mijëra dhjetë mijërash dhe mijëra mijërash.*
  - Si mund të krijonte Perëndia aq shumë frymëra të mira, të forta dhe të mençura? Ai është Shumë i Larti!
  - Perëndia mund të bëjë gjithçka dhe çdo gjë që dëshiron!

### 6. Frymërat jetonin në parajsë.

- Në fillim tërë frymërat jetonin në qiell me Perëndinë.
  - Ku është parajsa?
    - Parajsa nuk është këtu në tokë!
    - Parajsa është një vend real, i përmendur disa herë në Bibël.
  - Parajsa është vendi i veçantë i Perëndisë ku Ai jeton.
    - Edhe pse Perëndia është kudo, në çdo kohë, parajsa është shtëpia e Perëndisë.
    - Psalmi 11:4 thotë që "*Zoti ka fronin e tij në qiejt*".
    - Bibla na thotë që parajsa është një vend i mrekullueshëm, shumë më i mirë se çdo vend tjetër që njohim apo imagjinojmë.

## Përsëritje

Mesazh: "Perëndia bëri gjithçka që ekziston".

## Pyetje dhe përgjigje

1. Kush i krijoi engjëjt? **Perëndia.**
2. A kanë trup engjëjt? **Jo.**
3. Perëndia është kudo, por ku jeton Ai? **Në qiell.**
4. Çfarë do të thotë fjala "i shenjtë"? **I përsosur, pa diçka të keqe apo të ligë.**
5. Kush është i shenjtë? **Perëndia.**

# Mësimi 4

## Qëllimi

Në këtë mësim fëmijët do të shohin:

- Që Perëndia është më i madh dhe më i rëndësishëm se të gjithë.
- Seriozitetin e rebelimit kundër Perëndisë.
- Sovranitetin dhe shenjtërinë e Perëndisë në trajtimin e rebelimit të tmerrshëm të Luciferit kundër Tij.

Duke përsëritur dhe mësuar Fjalën e Perëndisë, përcakto qartë të vërtetën e sovranitetit të Perëndisë mbi të gjithë.

## Hyrje

Ndërsa jep këtë mësim, do të zbulosh që fëmijët e klubit tënd kanë pyetje. Gjithashtu mund të zbulosh që shumë fëmijë dhe/ose familjet e tyre jetojnë me frikë të vazhdueshme nga paraardhësit, frymërat, magjia dhe shortaria.

Fëmijët duhet të njohin të vërtetën. Perëndia është Krijuesi sovran; Satani është një qenie e krijuar që e humbi pozicionin e tij si shërbëtor i Perëndisë.

Në vend që t'i frikësojë, kjo e vërtetë do t'u japë atyre qëndrueshmëri dhe njohje.

*Gjatë mësimit fol për madhësitë dhe epërsinë e Perëndisë: sovraniteti i Tij.*

## Figurat

- Grafiku 1: Mësimi për Perëndinë  
Në këtë mësim përdor këtë grafik për të përsëritur atributet që janë paraqitur tashmë dhe kur të paraqiten përsëri.
- Grafiku 4: Rebel

# Engjëlli rebel

## Historia

“Hej, Xhon, ku po shkon?” – pyeti Karola.

“Po shkoj të dëgjoj diçka më shumë rreth frymërave” – u përgjigj Xhoni.

E çuditur, Karola tha: “Mendova se i the mamasë që nuk do të shkoje sërish për të dëgjuar këto histori me miqtë e tu”.

“Nuk do të shkoj tek miqtë” – tha Xhoni. “Do të shkoj të dëgjoj për engjëllin e veçantë për të cilin po fliste xhaxhi Piteri javën që shkoj. A do të vish edhe ti?”.

“Sigurisht,” – u përgjigj Karola, – “të paktën tërë frymërat në Bibël janë të mirë; nuk ka asgjë për t'u frikësuar prej tyre!”.

“Përsëritet, xhaxhi Piteri” – thirri Xhoni ndërsa po vraponte për te shtëpia e xhaxhi Piterit. “Erdhëm për të dëgjuar historinë tënde rreth engjëllit të veçantë në Bibël”.

“Në rregull, uluni” – sugjeroi xhaxhi Piteri. “Ju kujtohet kur ju thashë që Perëndia u dha disa engjëjve detyra të veçanta për të bërë? Perëndia nuk i krijoi tërë engjëjt njësoj; disa ishin më të bukur, më të zgjuar dhe më të urtë se të tjerët. Perëndia krijoi një engjëll që ishte më i bukur nga të gjithë. Ai ishte shumë i zgjuar. Emri i tij ishte Lucifer. Perëndia e vendosi Luciferin përgjegjës të tërë engjëjve”.

“Luciferi duhet ta ketë dashur shumë Perëndinë që iu dha një pozitë aq e rëndësishme” – pohoi Karola.

“Ke të drejtë, Karola” – pranoi xhaxhi Piteri. “Luciferi duhet ta ketë dashur, t'i jetë bindur dhe t'i ketë shërbyer Perëndisë më shumë se çdo engjëll tjetër. Por pas ca kohësh Luciferi u bë shumë krenar për bukurinë e tij. Ai vendosi të merrte pozitën e Perëndisë si autoritet mbi çdo gjë: Luciferi u rebelua kundër autoritetit të Perëndisë mbi të”.

“Por unë mendova që Perëndia i krijoi tërë engjëjt të përsosur” – tha Xhoni.

“Perëndia i krijoi tërë engjëjt të përsosur” – tha xhaxhi Piteri. “Perëndia i donte të gjithë dhe i trajtonte shumë mirë. Asnjë engjëll nuk kishte arsye pse t'i kthente shpinën Perëndisë, sidomos Luciferi, por Luciferi u rebelua kundër Perëndisë. Ai ishte i pari që bëri të keqen”.

“Kjo është e tmerrshme” – tha Karola.

“Po, ishte” – pranoi xhaxhi Piteri. “Shumë nga engjëjt e Perëndisë ndoqën Luciferin dhe nuk iu bindën Perëndisë. Luciferi u bë drejtuesi i tyre”.

“A e dinte Perëndia se çfarë po bënin Luciferi dhe ndjekësit e tij?” – pyeti Xhoni.

“Perëndia krijoi tërë frymërat,” – u përgjigj xhaxhi Piteri, – “dhe e Ai dinte gjithçka që mendonin. Kujtoni që Perëndia është kudo dhe di çdo gjë. Ai e dinte saktësisht se çfarë po planifikonin”.

“Perëndia duhet të jetë trishtuar që ka parë engjëjt e Tij të rebelohen kundër Tij” – tha Karola e trishtuar. “Çfarë u ndodhi atyre?”.

“Karola,” – tha xhaxhi Piteri duke marrë Biblën e tij, – “në Bibël lexojmë që Perëndia është Perëndia i vetëm i vërtetë. Perëndia nuk do të lejonte Luciferin të merrte pozicionin e Tij. Ai e largoi Luciferin nga pozicioni i tij i rëndësishëm i drejtimit mbi engjëjt. Luciferi dhe engjëjt që e ndoqën nuk mund të jetonin më në qiell, as të bëheshin shërbëtorë të Perëndisë. Luciferi ishte bërë armiku i Perëndisë, ndaj Ai ia ndryshoi emrin në Satan. Satan do të thotë “armik”. Perëndia përgatiti një vend të tmerrshëm ndëshkimi të përjetshëm për ta, të quajtur liqeni i zjarrit, dhe një ditë Ai do të hedhë Luciferin dhe tërë engjëjt e tij atje”.

“Perëndia duhet të jetë i fuqishëm, xhaxhi Piteri” – tha Xhoni i mahnitur. “A është ky fundi i historisë së Luciferit?”.

“Jo, Xhon” – u përgjigj xhaxhi Piteri. “Bibla thotë më tepër për Luciferin, por, së pari, ka disa histori të tjera të rëndësishme në Bibël për të cilat dua t'ju flas”.

“Në rregull” – tha Xhoni. “Do të vijmë përsëri”.



## Le të shohim në Bibël



1 Kronikave 29:11a – “Jotja, o Zot, është madhështia, fuqia, lavdia, shkëlqimi, madhëria, sepse gjithçka që është në qiell dhe mbi tokë është jotja”.

Shpjego që “ZOT” është një emër tjetër i Perëndisë. Ky varg do t’u kujtojë përsëri fëmijëve që Perëndia është më i fortë dhe më i madh se të gjithë. Perëndia ka fitoren (fiton) mbi të gjithë, edhe ndaj frymërave që disa prej fëmijëve të klubit mund t’i kenë frikë.

### Le të mendojmë

1. A u krijuan disa engjëj të këqij? **Po / Jo.**
2. Kush është më i fuqishmi?
  - a. Luciferi; **b. Perëndia;** c. Engjëjt.
3. A ishte Luciferi engjëlli i parë që bëri të keqen? **Po / Jo.**
4. Çfarë ndodhi me Luciferin kur nuk iu bind Perëndisë?
  - a. U shpërblye; b. Asgjë; **c. Perëndia e përzuri nga qielli.**
5. Çfarë gjëje tjetër do të bëjë Perëndia ndaj Luciferit dhe tërë engjëjve të këqij?
  - a. Asgjë; **b. Do t’i ndëshkojë të gjithë në liqenin e zjarrit përgjithmonë;** c. Do t’i kthejë përsëri në parajsë.

### Mësime nga Fjala e Perëndisë

#### 1. Pozicioni origjinal i Luciferit para Perëndisë në parajsë.

Perëndia nuk i krijoi tërë engjëjt njësoj; disa ishin më të bukur, më të zgjuar dhe më të urtë se të tjerët.

- Engjëlli më i madh u quajt Lucifer.
- Perëndia i dha Luciferit një pozicion shumë të rëndësishëm në qiell.
  - Luciferit iu dha një pozicion autoriteti dhe pushteti i madh mbi tërë engjëjt.
- Luciferi, ashtu si tërë krijimi i Perëndisë, u krijua i përsosur.

#### 2. Rebelimi i Luciferit

Ngaqë Luciferi u krijua nga Perëndia dhe iu dha pozicioni më i lartë mbi tërë engjëjt, ai duhet ta ketë dashur, t’i jetë bindur dhe t’i ketë shërbyer Perëndisë. Por pas ca kohësh Luciferi u bë shumë krenar për bukurinë, zgjuarsinë dhe pozicionin e tij.

*Ti thoshe në zemrën tënde: “Unë do të ngjitem në qiell, do të ngre fronin tim përmbi yjet e Perëndisë; do të ulem mbi malin e asamblesë në pjesën skajore të veriut; do të ngjitem mbi pjesët më të larta të reve, do të jem i ngjashëm me Shumë të Lartin” (Isaia 14:13-14)* (Mos diskuto vargjet përreth, sepse do të jenë shumë pësjtjelluese. Ato përmbajnë të vërteta biblike që nuk janë pjesë e qëllimit të sotëm).

- Luciferi donte të ishte si “Shumë i Larti”.
  - Luciferi vendosi të zinte pozicionin e Perëndisë si sundues i çdo gjëje. Luciferi u rebelua kundër autoritet të Perëndisë ndaj Tij.
  - Pyeti fëmijët nëse e dinë se çfarë do të thotë “rebel”.
  - Të rebelohesh është shumë serioze.
- Luciferi u rebelua kundër Perëndisë. Ai ishte i pari që bëri të keqen (e keqja është çdo gjë që është ndryshe nga ajo që dëshiron apo me të cilën pajtohet Perëndia).
  - “Nëse Luciferi u krijua i përsosur, si mund të rebelohej?”.
  - Bibla nuk na jep një përgjigje të saktë për këtë, por na tregon shumë shembuj të faktit që Perëndia lejon **zgjedhjet** që bëjmë.



**Lexo:** Ezekieli 28:15: *Ti ishe i përsosur në rrugët e tua qysh nga dita që u krijove, derisa nuk u zbulua te ti çoroditja (ligësia, paudhësia). Lexo vetëm pjesën e errësuar të vargut, sepse kjo pjesë është ajo që po studiojmë këtu.*

=> Grafiku 4: Rebel





**Lexo:** Isaia 14:13-14.

Kur të lexosh këto vargje, shiko se çfarë tha Luciferi. Ai tha: “Unë do të ngjitem”, “do të ngre fronin”, “do të ulem”, “do të ngjitem mbi pjesët më të larta të reve, do të jem i ngjashëm me Shumë të Lartin”. Luciferi bëri një zgjedhje në mendjen e tij për t'u rebeluar kundër Perëndisë. Perëndia mund t'i bënte engjëjt si kukulla që mund të bënin vetëm atë për të cilën i krijoi. Por nuk e bëri këtë gjë. Perëndia u dha mundësinë të zgjidhnin.



**Lexo:** Isaia 14:13-14 thotë për Luciferin: *Ti thoshe në zemrën tënde: “Unë do të ngjitem... do të ngre fronin tim... do të jem i ngjashëm me Shumë të Lartin”.* Vargu tregon që Perëndia e dinte që Luciferi i kishte këto mendime.

## Përsëritje

### Pyetje dhe përgjigje

1. Kush është autoriteti më i lartë? **Perëndia.**
2. Kush donte të merrte pozicionin e Perëndisë për të sunduar mbi gjithçka? **Luciferi.**
3. Si e ka ndryshe emrin Luciferi? **Satani ose Djall.**
4. Si quhen engjëjt që ndoqën Satanin? **Demonë.**
5. Çfarë u bën Perëndia atyre që nuk i binden apo që rebelohen kundër Tij? **Perëndia i ndëshkon.**

### 3. Engjëjt të tjerë e ndoqën Luciferin në rebelimin e tij.

- Shumë nga engjëjt e Perëndisë ndoqën Luciferin. Ai u bë drejtuesi i tyre. Ata e ndoqën Luciferin duke u rebeluar kundër Perëndisë (Mateu 25:41; 2 Pjetrit 2:4 – *nëse një fëmijë të pyet nga e di që engjëjt e tjerë u rebeluan kundër Perëndisë, mund të përdorësh këto vargje për të vërtetuar shkurtimisht këtë pohim*).

### 4. Perëndia e dinte se çfarë po mendonin dhe planifikonin Luciferi dhe frymërat e tjera.

- Perëndia është kudo në çdo kohë; Ai di gjithçka.
- Perëndia i krijoi tërë frymërat dhe Ai e dinte se çfarë po mendonin dhe po planifikonin.
  - Perëndia e dinte që Luciferi ishte bërë krenar dhe donte të zinte vendin e Zotit të tij.
  - Perëndia i njihte mendimet e Luciferit dhe mendimet e secilës prej frymërave të tij rebele.
- Perëndisë nuk mund t'i fshihet gjë (Hebrenjve 4:13).
  - Asgjë nuk mund ta çudisë Perëndinë.
  - Ai e di gjithçka para se të ndodhë.
  - Ai e di se çfarë do të flasim para se mendimet të vijnë në mendjen tonë.
  - Perëndia shikon gjithçka.

### 5. Perëndia largoi Luciferin dhe ndjekësit e tij nga pozicioni i tyre si shërbëtorë të Perëndisë.

- Perëndia nuk do të lejonte Luciferin të zinte pozicionin e Tij. Perëndia është i shenjtë. Ai është i përsosur dhe i drejtë në gjithçka që mendon dhe bën.
  - Askush nuk mund të zërë vendin e Perëndisë, sepse Ai është i vetmi Perëndi i vërtetë.
- Perëndia e largoi Luciferin nga ky pozicion i rëndësishëm i drejtimit mbi engjëjt. Perëndia i hoqi edhe engjëjt e tjerë që ndoqën Luciferin nga vendi i tyre i shërbimit në qiell. Ata nuk ishin më shërbëtorë të Perëndisë.
  - Tani ne e njohim Luciferin me emra të tjerë si “Satan” dhe “Djall”.
  - Ndjekësit e Satanit quhen demonë.
- Satani dhe ndjekësit e tij, demonët, nuk mund të jetonin më në qiell. Në librin e Jobit, Bibla na thotë që Satani mund të shkonte ende të fliste me Perëndinë në qiell. Satani dhe demonët e tij vërtiten tani në mbarë tokën (Jobi 1:7; 2:2).

### 6. Perëndia përgatiti një vend të tmerrshëm, liqenin e zjarrit, për Luciferin dhe ndjekësit e tij.

- Një ditë, në të ardhmen Perëndia do të hedhë Luciferin dhe engjëjt e tij në liqenin e zjarrit për t'u ndëshkuar përgjithmonë (Mateu 25:41; Zbulesa 20:10).
- Perëndia nuk do të tolerojë mosbindjen ndaj Tij; Perëndia kërkon gjithmonë ndëshkimin për rebelimin kundër Tij.

### 7. Luciferi dhe engjëjt e tij e urrejnë Perëndinë.

- Nga koha kur Perëndia dëboi Luciferin dhe engjëjt e tij nga qielli e deri më sot, ata kanë luftuar kundër Perëndisë dhe gjithçkaje që Ai do dhe bën.
- Emri i Luciferit, Satan, do të thotë “armik, kundërshtar apo paditës”. Satani është armiku më i madh i Perëndisë. Satani lufton kundër Perëndisë ditë e natë për t'u përpjekur që të ndalë gjërat që bën Perëndia. Demonët e Satanit e ndihmojnë atë për të luftuar kundër Perëndisë.



# Mësimi 5 Diçka nga asgjëja

## Qëllimi

Ky mësim do të paraqesë faktet e vërteta biblike të krijimit. Do të tregosh që Perëndia krijoi gjithçka dhe që Ai i krijoi nga asgjëja. Megjithatë, qëllimi ynë më i rëndësishëm është të tregojmë atributet e Perëndisë përmes veprave të Tij të krijimit.

SHËNIM: Doktrina e krijimit përmendet në tërë Biblën, nga Zanafilla te Zbulesa. Edhe kur krijimi nuk përmendet me fjalë, ai është një e vërtetë mbizotëruese: Perëndia është sovran; çdo gjë filloi tek Ai (Kolosianëve 1:16-17).

## Hyrje

Kujtoju fëmijëve që Perëndia e dinte se si të krijonte. Perëndia di dhe kupton gjithçka. Bibla na thotë që nuk ka asgjë të vështirë për Perëndinë. Pyeti fëmijët: A e ke pyetur ndonjëherë veten se si erdhi gjithçka në ekzistencë?

- Nga erdhi toka?
- Nga se u bë toka?
- Po dielli, hëna dhe tërë yjet?

Bibla na thotë që Perëndia krijoi gjithçka! Ti do të studiosh tregimin e Perëndisë për krijimin, siç na e ka paraqitur në Librin e Zanafillës.

## Figurat

- Grafiku 1: Mësimi për Perëndinë

Nuk do të paraqesësh attribute të reja të Perëndisë në këtë mësim, por përdor grafikun për të përsëritur atributet e Perëndisë dhe tregoji përsëri këto attribute ndërsa i mëson në këtë mësim. Atributet e Perëndisë tregohen sërish përgjatë Shkrimit.

- Grafiku 5: Atmosfera e tokës

## Historia

“Përsëritet fëmijë!” - tha xhaxhi Piteri. “Çfarë po bëni?”.

“Përsëritet, xhaxhi Piter!” - thanë Xhoni dhe Karola në të njëjtën kohë.

“Oh, po punoj për një projekt për një nga lëndët e mia të shkollës” - tha Xhoni.

“Por kam një problem me të”.

Xhaxhi Piteri pasi e pa mirë projektin që po bënte Xhoni e pyeti: “Çfarë do të bësh, Xhon, një top?”.

“Jo, një model të botës” - u përgjigj Xhoni. “Por nuk kam tërë gjërat që më duhen për ta mbaruar. Nuk e mendova se sa shumë gjëra do të më duheshin. Kam vetëm pak argjilë dhe tela...”.

“Po, dhe po bën rrëmujë!” - e ndërpreu Karola.

“Ajo ka të drejtë, po bëj rrëmujë” - pranoi Xhoni.

“Shiko,” - tha xhaxhi Piteri, - “ky është një projekt i madh: duhet shumë punë për ta bërë. A e di se si u bë me të vërtetë bota?”.

“Nuk e di” - tha Xhoni. “A e di njeri?”.

“Po,” - u përgjigj xhaxhi Piteri, - “sepse Ai që e krijoi përdori dikë për ta shkruar se si e bëri”.

“Ku është shkruar?” - pyeti Karola.

“Në Bibël” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Perëndia, i Cili krijoi tërë frymërat, krijoi edhe tokën. Ai ishte i vetmi në fillim dhe Ai e dinte saktësisht se çfarë ndodhi. Kujtoni, Perëndia është një, megjithatë Perëndia është tre persona në një: Perëndia Atë, Perëndia Bir dhe Perëndia Frymë e Shenjtë: të gjithë kanë marrë pjesë në veprën madhështore të krijimit”.

“A thotë Bibla se si e bëri?” - pyeti Xhoni.

“Po” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Bibla thotë që Perëndia **krijoi** qiellin dhe tokën. Ai thjesht **foli** dhe u bë drita”.

“Prit pak!” - e ndërpreu Xhoni. “Çfarë përdori Perëndia për të bërë tokën dhe nga erdhi drita?”.

Xhaxhi Piteri tha duke qeshur: “Zanafilla, libri i parë i Biblës, na thotë që Perëndia bëri gjithçka nga **asgjëja**. Perëndia është i plotfuqishëm; nuk ka asgjë të pamundur për Të”.

“Por nga e dinte Perëndia se si të bënte qiellin dhe tokën?” - pyeti Karola.

Xhaxhi Piteri shpjegoi se si neve na duhet të mësojmë se si t'i bëjmë tërë gjërat që bëjmë. Ne nuk kemi lindur me njohuri dhe kuptim. Disa njerëz shkojnë në shkollë për të mësuar, megjithatë ata asnjëherë nuk do të mësojnë për çdo gjë. Perëndia nuk kishte nevojë që dikush t'i mësonte se si të bënte qiejt dhe tokën, sepse Ai njih dhe kupton plotësisht gjithçka. Perëndia është i gjithëdijshtë.

“Është shumë e vështirë të kuptosh se si dikush mund të jetë aq i fuqishëm dhe i zgjuar, apo jo?” - pyeti xhaxhi Piteri.

“Sigurisht!” - pranoi Xhoni. “Herën tjetër dua të dëgjoj se si u bë pjesa tjetër e tokës”.

Shënim: Është e rëndësishme që pjesë të Shkrimit që shoqërojnë çdo pikë të theksuar me numër të lexohen ndërsa jep mësim. Nëse fëmijët mund të lexojnë, ata duhet të nxiten të bëjnë një pjesë të leximit. Por ata mund të jenë të ngadalshëm dhe fëmijët e tjerë mund të humbasin interesin kur ka shumë për të lexuar. Ndaj, përveç fëmijëve, mund të alternosh duke i lexuar vetë disa prej pjesëve apo t'u thuash ndihmësve të tu të rritur që të lexojnë.

=> Grafiku 1: Mësimi për Perëndinë  
**Lexo:** "Perëndia është i plotfuqishëm. Nuk ka asgjë të vështirë për Të".

Thua ju fëmijëve të thonë Hebrenjve 11:3.

## Le të shohim në Bibël



Hebrenjve 11:3 - "Me anë të besimit ne kuptojmë se bota është ndërtuar me fjalën e Perëndisë, sa që ato që shihen nuk u bënë prej gjërave që shihen".

Ndihmoji fëmijët e klubit të gjejnë këtë varg, lexojë dhe pastaj shpjegojë vargun duke përdorur përkufizimet e dhëna. Shpjegoju fëmijëve që Perëndia i bëri qiejt dhe

tokën nga asgjëja! Vetëm Perëndia mund të bëjë diçka nga asgjëja. Sërish, nuk ka asgjë të vështirë për Perëndinë!

## Le të mendojmë

1. Çfarë po përdorte Xhoni për të bërë modelin e tij të botës?  
a. Asgjë; b. **Baltë dhe tela**; c. Letër.
2. Si u bë bota e vërtetë?  
a. Nuk e dimë; b. Ka ekzistuar gjithmonë; c. **Perëndia e bëri**.
3. Çfarë përdori Perëndia për të bërë botën?  
a. **Asgjë**; b. Shkëmbinj dhe baltë; c. Baltë dhe tela.
4. A foli Perëndia dhe u bë drita? **Po** / Jo.
5. A i tha dikush Perëndisë se si të bënte tokën? Po / **Jo**.

## Mësime nga Fjala e Perëndisë

Shënim: Është e rëndësishme që t'u mësosh fëmijëve për natyrën dhe karakterin e Perëndisë. Për shembull, do të mësosh që Perëndia e dinte se si të krijonte dhe që Perëndia di gjithçka. Me këto mësim bazë, do të jesh në gjendje që më vonë të mësosh që Perëndia di gjithçka për çdo person. Perëndia di për mëkatin tonë. Perëndia madje njeh mendimet tona. Nëse nuk i hedh këto themele të së vërtetës thellë në mendjen e fëmijëve të klubit tënd tani, nuk do të mund t'i përdorësh më vonë. Fryma e Shenjtë nuk do të mund ta përdorë mësimin tënd për të sjellë bindjen për mëkat.

### 1. Në fillim Perëndia krijoi qiejt dhe tokën (Zanafilla 1:1).

Ky mësim do të trajtojë atë që Perëndia tha se ndodhi në fillim. Kemi mësuar tashmë që Perëndia krijoi frymërat që nuk mund t'i shohim. Tani do të studiojmë krijimin e gjithësisë nga Perëndia: gjërat që mund t'i shohim.

- Bibla ndahet në 66 libra. Zanafilla është libri i parë në Bibël. Bibla është një histori e vërtetë: është historia e Perëndisë për atë që ka ndodhur në të vërtetë.
    - Fjala "zanafillë" do të thotë "fillimet" apo "origjinat".
    - Të gjitha gjërat kanë një fillim. Asgjë apo askush (përveç Perëndisë) nuk ka ekzistuar para fillimit.
    - "Krijuar" do të thotë "të bërë nga asgjëja". Vetëm Perëndia mund ta bëjë këtë. Vetëm Perëndia është i plotfuqishëm. Nuk ka asgjë të vështirë për Perëndinë.
- Ah, Zot, Zot! Ja, ti e sajove qiellin dhe tokën me fuqinë tënde të madhe dhe me krahun tënd të shtrirë. Nuk ka asgjë tepër të vështirë për ty (Jeremia 32:17).

### 2. Toka kur u krijua për herë të parë - Zanafilla 1:2.

- Toka nuk kishte formë; ishte tërësisht bosh.
- Toka ishte e mbuluar nga errësira.
- Toka ishte e mbuluar nga ujërat. Nuk kishte tokë të thatë.
- Nuk kishte jetë në asnjë pjesë të tokës: asnjë njeri, kafshë apo bimë.

### 3. Perëndia ishte gati të krijonte gjithçka.

- Perëndia është i plotfuqishëm dhe Ai ishte gati ta përdorte fuqinë e Tij të madhe për të krijuar.
  - Bibla thotë që Fryma e Perëndisë "fluturonte mbi sipërfaqen e ujërave".



**Lexo:** Psalmi 18:30a thotë: Rrugat e Perëndisë është e përsosur.



**Lexo:** Isaia 6:3 thotë: ...I Shenjtë, i shenjtë, shenjtë është Zoti i ushtrive...

=> Grafiku 5: Atmosfera e tokës

## Përsëritje

1. Ditën e parë Perëndia krijoi dritën, të cilën e quajti ditë dhe errësirën natë.
2. Ditën e dytë Perëndia krijoi ajrin dhe qiellin. Ku i vendosi dhe çfarë kishte sipër tyre? **Shiko figurën në të djathtë.**

## Pyetje dhe përgjigje

1. Sa libra janë në Bibël? **66.**
2. Cili është libri i parë në Bibël?  
**Zanafilla.**
3. Çfarë do të thotë fjala "e krijuar"? **Të bësh diçka nga asgjëja.**
4. Me çfarë ishte mbuluar toka kur u krijua? **Me ujë dhe errësirë.**
5. Çfarë krijoi Perëndia ditën e parë?  
**Dritën, natën dhe ditën.**
6. Çfarë krijoi Perëndia ditën e dytë?  
**Ajrin dhe qiellin, duke ndarë edhe ujin në tokë: një pjesë sipër qiellit dhe një pjesë sipër tokës.**
7. A mund ta kishte krijuar dikush tjetër tokën? **Jo.**

- Ishte **Perëndia** që i vuri tërë gjërat në lëvizje!
- Ai është burimi, fillimi i çdo energjie.


- Perëndia Atë, Perëndia Bir dhe Perëndia Frymë e Shenjtë morën pjesë të gjithë në veprën madhështore të krijimit.
  - Perëndia është një, megjithatë Perëndia është tre në një, Perëndia Shumë i Larti, Krijuesi i gjithçkaje.
  - Ne nuk mund të kuptojmë plotësisht as Trininë, as fuqinë e madhe të Perëndisë.

### 4. Dita e parë: Krijimi i dritës - Zanafilla 1:3-5.

- Vetëm Perëndia mund ta krijonte dritën thjesht duke folur!  
Diskutoni: A nuk do të ishte fantastike nëse ne thjesht do të flisnim dhe drita të shfaqej? Por nuk funksionon kështu. Jo, ne varem plotësisht nga drita që u krijua nga Perëndia që nga fillimi. (Ndihmoji fëmijët të mendojnë për lloje të ndryshme dritash, si elektrikë dore, qirinj, shkrepëse, fenerë, poça drite, rrezet e diellit, rrezet e hënës, etj.).  
Sa herë që shikojmë dritën e diellit, të hënës apo të yjeve, hapja e çelësit të dritave, ndezja e fijos së shkrepëses apo qiriut, kujtoni që ishte Perëndia që krijoi dritën në fillim. Vetëm Perëndia mund ta bëjë këtë sepse Perëndia është i plotfuqishëm dhe i gjithdijshëm. Ai krijoi dritën nga asgjëja.
- Drita që bëri Perëndia ishte shumë e mirë. Do të vësh re që sa herë që Perëndia krijoi, Ai tha: "Është e mirë".
  - Ne nuk jemi në gjendje të bëjmë **asgjë** të përsosur. Gjërat që bëjmë kanë nevojë për riparim apo vjetrohen. Por gjithçka që bëri Perëndia ishte e **përsosur**, sepse:
    - **Perëndia është i përsosur.** Perëndia është i patëmetë. Me fjalë të tjera, Perëndia është i shenjtë. (Shkruaje fjalën "i shenjtë" në mënyrë që fëmijët ta shikojnë).
- Perëndia ndau dritën nga errësira; kjo është vetëm drita, jo dielli.
  - Ai e quajti dritën "ditë" dhe errësirën "natë".
  - Kjo ishte dita e parë në fillim të botës.

### 5. Dita e dytë: Krijimi i kupës qiellore - Zanafilla 1:6-8.

- Ditën e dytë Perëndia krijoi ajrin dhe qiellin.
  - Sipër kësaj "kupe qiellore" apo "hapësirë të shtrirë" që ne e quajmë atmosferë, Perëndia vendosi një pjesë të ujit nga bota që krijoi.



Ne do të shikojmë që ky ujë është shumë i rëndësishëm në një histori më pas.

Shënim: Në fakt në Shkrim nuk na thuhet me saktësi se çfarë bëri Perëndia kur vendosi ujin sipër kupës qiellore. Megjithatë, shumë shkencëtarë të besueshëm besojnë se këto ujëra nuk janë retë, por ujë të cilin Perëndia e kthente në avull dhe e vendoste si çadër apo mbulesë rreth tokës, sipër atmosferës.

*Është e rëndësishme të përcaktojmë që Perëndia e vendosi ujin sipër tokës, në mënyrë që kur të mësosh historinë e përmbytjes, ta kesh të thjeshtë që të shpjegosh se si Perëndia bëri procesin e anasjelltë dhe ktheu në tokë ujin që kishte vendosur sipër kupës qiellore.*

- Sërisht, Perëndia thjesht foli dhe kupa qiellore u krijua.
  - Idetë e njeriut se si u krijua bota ndryshojnë herë pas here. Por historia e vërtetë e shkruar e Perëndisë për krijimin nuk ka ndryshuar dhe nuk do të ndryshojë kurrë. Ndërsa studiojmë Biblën, do të shikojmë që Perëndia është më i madh se të gjithë, më i rëndësishëm se të gjithë dhe më i fuqishëm se të gjithë!

# Mësimi 6

## Qëllimi

Ky është mësimi i dytë rreth krijimit të Perëndisë të qiellit dhe tokës, pasuar me një mësim rreth krijimit të njeriut nga Perëndia. Fëmijët do të vazhdojnë të shikojnë që Perëndia krijoi gjithçka dhe që Ai i krijoi nga asgjëja. Megjithatë, duam që fëmijët e klubit tonë të shikojnë atributet e mëposhtme të Perëndisë të dukshme përmes veprave të Tij të krijimit: Sovraniteti i Perëndisë. Dashuria e Perëndisë. Fuqia e Perëndisë.


## Hyrje

Nëse fëmijëve u mësohet evolucionin në shkollë, atëherë shpjego që Fjala e Perëndisë është e përjetshme dhe e pandryshueshme. Sidoqoftë, me kalimin e viteve, shoqëria jonë ka lejuar teoritë evolucionare të publikohen, mësohen dhe pranojnë gjerësisht si fakte. Megjithatë, shumica e të dhënave mbi të cilat evolucionistët mbështesin një herë e një kohë teoritë e tyre, kanë dalë të rreme apo mashtrime. “Të dhëna” të tjera të konsideruara më parë si evidencë për teoritë e evolucionit kanë dalë të gabuara nga zbulimet e reja shkencore, të cilat konfirmojnë FAKTIN e krijimit. Satani i ka mbyllur mendjet e njerëzve ndaj së vërtetës, por Fjala e Perëndisë është e fuqishme për t’i hapur mendjet e tyre. Ky është lajmi i mirë që mund të tregojmë: Perëndia, Krijuesi sovran, bëri çdo gjë me anë të fuqisë së Tij! Fjala e Tij, Bibla, është më i madh se tërë librat shkollorë dhe baza e tërë shkencës. Ne mund t’i mësojmë të tjerët me siguri për Perëndinë e Gjallë dhe Fjalën e Tij të pandryshueshme.

## Figurat

- Grafiku 1: Mësimi për Perëndinë. Në këtë mësim përdor këtë grafik për të përsëritur atributet që janë paraqitur tashmë dhe paraqit attribute shtesë kur të sugjerohen në mësim. Attribute të reja: “Perëndia është i dashur...” dhe “Perëndia nuk ndryshon kurrë”.

- Figura 2: Krijimi



# Perëndia krijoi gjithçka

## Historia

“Shiko, Karola! Po mbijnë!” - thirri Xhoni.

“Çfarë po mbin?” - pyeti Karola.

“Farat që mbolla në kopshtin tim” - tha Xhoni. “Shikoj!”.

“Ke të drejtë, Xhon, po mbijnë!” - thirri Karola. “Sa lloje mbolle?”.

“Mbolla tetë lloje farërash” - u përgjigj Xhoni. “Kam gjashtë lloje perimesh dhe dy lloje lulesh. Nuk mund ta besoj sa shumë lloje të ndryshme farërash kishte te dyqani që më tregoi xhaxhi Piteri në qytet”.

Duke marrë një qese të hapur farash, Karola tha: “Është e vështirë që të kuptoj se si nga çdonjëra prej këtyre farave të vogla mund të bëhet një bimë. Ato janë të thara, por kur i vendos në tokë dhe u shton ujë, mbin një bimë. Mos! Më ranë në tokë: çfarë rrëmuje! U përhapën përtokë! Oh, përshëndetje xhaxhi Piteri!”.

“Duket sikur Xhonin po e ndihmon dikush në kopsht” - tha xhaxhi Piteri duke qeshur.

“Karola po bën rrëmujë!” - u ankua Xhoni. “Dhe farat janë shumë të vështira për t’u mbledhur. Ato janë shumë të vogla”.

“Më thuaj, Karola, a ranë në rreshta të drejtë?” - pyeti xhaxhai i saj.

“Jo,” - tha Karola, - “ato u shpërndanë gjithandej. Nuk mund të gjej shumicën e tyre”.

Xhaxhi Piteri pa kopshtin e Xhonit dhe tha: “Xhon, duket se ke qenë në gjendje t’i vendosësh farat në rreshta të vegjël në kopshtin tënd. Shiko këtë rresht të drejtë të lastarëve jeshilë! Fëmijë, a e kuptoni që tërë këto fara e kanë pasur origjinën e tyre nga bimët që krijoi Perëndia në fillim? Kur Perëndia krijoi jetën bimore vendosi brenda çdo bime aftësinë për të prodhuar fara, të cilat do të bëheshin bimë të reja si e para që Ai bëri. Ndaj, edhe pse një bimë thahet, ajo bën fara që rriten në bimë si e para: dhe ato bimë prodhojnë fara që rriten në bimë të tjera si e para, e kështu me radhë. Perëndia jep jetë dhe Ai është i vetmi që vazhdon procesin!”.

“Nuk më kishte shkuar kurrë mendja këtui!” - tha Karola. “Por ti the që në Bibël thuhet që Perëndia krijoi gjithçka”.

“Mësuesi im në shkollë thotë që gjithçka ndodhi rastësisht” - tha Xhoni. “Ai thotë që tërë llojet e ndryshme të gjërave thjesht ‘evoluuan’ me kalimin e viteve”.

“Xhon, a e vure re se çfarë ndodhi me farat që hodhi Karola?” - pyeti xhaxhi Piteri.

“Ato u shpërndanë gjithandej, apo jo? Po farat që mbolle ti? A nuk janë në një rresht të drejtë? Ku qëndron ndryshimi?”.

“Ajo është rrëmujaxhie, kurse unë jo” - tha Xhoni duke qeshur.

“Xhon!” - thirri Karola. “Nuk doja t’i rrëzoja. Ato thjesht ranë përtokë”.

“Karola, mund të thuash që farat ranë atje rastësisht, apo ajo?” - pyeti xhaxhai i saj. “Por Xhoni vendosi saktësisht se ku do t’i vendoste farat e tij dhe ato janë në një rresht të drejtë. Çfarë mendoni? A mendoni që tërë modelet e ndryshme te lulet, pemët, gjethet dhe kafshët ndodhën po ashtu, thjesht rastësisht?”.

“Nuk ka mundësi!” - tha Karola. “Do të ishte e pamundur. Dikush duhet t’i ketë bërë ashtu!”.

“Ke shumë të drejtë, Karola” - pranoi xhaxhi Piteri. “Perëndia i bëri. Ai është krijuesi i çdo gjëje. Ai vendosi se si do të dukej dhe rritej gjithçka”.

“Nuk e dija që kishte kaq shumë gjëra për të mësuar në Bibël” - tha Xhoni. “Dhe ne jemi vetëm në fillim!”.

## Le të shohim në Bibël



### Zanafilla 1:1 - “Në fillim Perëndia krijoi qiejt dhe tokën”.

Kujtoju fëmijëve të klubit që tërë gjërat kanë një fillim. Zanafillë do të thotë “fillimet”. Krijoi do të thotë “bëri nga asgjëja”. Perëndia bëri qiellin dhe tokën nga asgjëja. Vetëm Perëndia mund të bëjë diçka nga asgjëja. Ndhimoi fëmijët e klubit ta mësojnë përmendësh këtë varg.

## Le të mendojmë

1. Si u vendosën farat në një rresht të drejtë në kopshtin e Xhonit?  
a. Ranë atje; b. Mbinë vetë; c. **I mbolli Xhoni.**
2. Kur Karolës i ranë farat, a ranë në një rresht të drejtë? Po / Jo.
3. A ndodhi gjithçka rastësisht: evoluoi me kalimin e viteve? Po / Jo.
4. A krijoi Perëndia gjithçka? **Po** / Jo.
5. Kush vendosi se çfarë lloje lulesh do të rriteshin në tokë?  
a. Askush; **b. Perëndia**; c. Ndodhën rastësisht.

## Mësime nga Fjala e Perëndisë

Në mësimin tonë të fundit fillove të studiosh atë që thotë Bibla rreth Perëndisë në veprat e Tij madhështore të krijimit.

- Lexuam që Perëndia e krijoi dritën vetëm duke folur.
- Ai krijoi ajrin dhe qiellin, dhe vendosi një pjesë të ujit sipër qiellit. Tani do të lexosh se si Perëndia bëri tokën dhe detet dhe i mbushi me krijesa të gjalla.

### 1. Dita e tretë: Krijimi i tokës së thatë, oqeanëve dhe tërë jetës bimore - Zanafilla 1:9-13.

- Perëndia i mbledhi ujërat në dete dhe bëri të shfaqet toka e thatë (Psalmi 95:5).
  - Vetëm Perëndia, i Cili i bëri ujërat e tokës, mund t'i kontrollojë<sup>1</sup>.
- Perëndia bëri tërë bimët dhe pemët - Zanafilla 1:11-13.
  - Perëndia bëri bimët për të prodhuar fara, të cilat do të prodhonin bimë si ato të parat. Çdo bimë prodhon fara sipas llojit të vet.
  - Vetëm Perëndia ka njohurinë dhe fuqinë për të krijuar jetën bimore dhe për të bërë që ajo të ketë vazhdimësi.
  - Bimët që kemi sot e kanë origjinën nga ato që krijoi Perëndia në fillim.
  - Pse i bëri Perëndia lulet, pemët dhe bimët? A kishte nevojë Perëndia për to?
    - Jo! Perëndia nuk ka nevojë për gjë. Perëndia i bëri bimët dhe pemët për njeriun, të cilin do ta krijonte më pas.
    - Perëndia i bëri bimët për të plotësuar nevojat tona fizike: për të siguruar ushqim për të ngrënë për ne. Për të dhënë oksigjenin për ajrin që thithim. Për të siguruar dru për të ndërtuar. Dhe për të siguruar shumë gjëra të tjera për të cilat kemi nevojë që të jetojmë.
  - Perëndia i bëri bimët për të na treguar dashurinë që ka për ne:
    - Ai nuk kishte pse të bënte kaq shumë larmi ngjyrash, masash, formash, shijesh dhe aromash. Disa lloje do t'i plotësonin nevojat tona. Perëndia e bëri tokën jo thjesht një vend për të jetuar, por me të vërtetë shumë të bukur. Ai donte të na e kujtonte përditë dashurinë e Tij të madhe për ne.
  - Perëndia donte gjithashtu që të shikojmë se Ai është një Perëndi i rregullit: **Projektuesi i madh** i çdo gjëje.<sup>2</sup>

=> Figura 2: Krijimi

<sup>1</sup> A e ke parë ndonjëherë dëmin e shkaktuar nga valët e fuqishme në një stuhi apo në një përmytje? Askush nuk mund t'i kontrollojë lumenjtë dhe oqeanet! Por nuk ka asgjë të vështirë për Perëndinë. Thjesht imagjino: Perëndia mbledhi tërë ujërat që mbulonin tërë tokën dhe formoi detet dhe tokën e thatë, ashtu siç vendosi që të ishin.

=> Grafiku 1: Mësimi për Perëndinë  
Trego grafikun dhe lexo: “**Perëndia është i dashur...**”. Duhet të lexosh vetëm këtë pjesë të atributit për këtë mësim.

<sup>2</sup> Trego se si Perëndia projekttoi lule, bimë dhe pemë të ndryshme.





**Lexo:** Isaia 44:24b thotë: *Unë jam Zoti që kam bërë tërë gjërat, që i vetëm, kam shpalosur qiejt dhe kam shtrirë tokën; kush ishte me mua?*



**Lexo:** Jeremia 10:12.

=> Grafiku 1: Mësimi për Perëndinë  
Trego figurën dhe lexo: "...**Perëndia nuk ndryshon kurrë**". Për këtë mësim do të lexosh vetëm këtë pjesë të atributit.



**Lexo:** Psalmi 104:19.

## Përsëritje

Dita e parë	Krijesat ujore dhe zogjtë.
Dita e dytë	Dielli, hëna dhe yjet.
Dita e tretë	Drita.
Dita e katërt	Kafshët.
Dita e pestë	Ajri dhe qielli (kupa qiellore).
Dita e gjashtë	Toka, deti, bimët dhe pemët.

## Pyetje dhe përgjigje

- Çfarë bëri Perëndia për të krijuar diellin, hënën dhe yjet? **Perëndia vetëm foli.**
- Pse Perëndia krijoi aq shumë lloje lulesh, bimësh dhe pemësh? **Sepse Ai na do.**
- A mundet dikush përveç Perëndisë të bëjë krijesa të gjalla? **Jo.**
- Kush e projektoi gjithçka në gjithësi? **Perëndia.**
- Çfarë tha Perëndia për gjithçka që krijoi? **Ai tha që ishte e mirë.**

- Gjithçka që krijoi Perëndia në këtë ditë ishte e mirë. Tërë bimët ishin të mira e të këndshme: të krijuara në mënyrë të përsosur. Gjembat dhe barërat e këqija nuk ekzistonin. Asnjë frutë nuk ishte helmuese. Perimet dhe frutat nuk pësonin sëmundje apo prishje. Në fillim gjithçka ishte e përsosur, sepse Perëndia është i përsosur dhe gjithçka që Ai bën është e përsosur.

## 2. Dita e katërt: Krijimi i diellit, hënës dhe yjeve - Zanafilla 1:14-19.

- Perëndia foli dhe dielli, hëna dhe yjet erdhën në ekzistencë.  
- Vetëm Perëndia ka fuqinë për të krijuar diçka aq të madhe!  
Kemi parë tashmë se si bimët që krijoi Perëndia tregojnë që Ai është Projektuesi i madh. Tani shikojmë që tërë gjithësia tregon veprën e Projektuesit të Madh!
- Perëndia krijoi edhe galaktikat dhe yjet më të largëta: Ai krijoi gjithçka.  
- Largësia nuk është një problem për Perëndinë. Perëndia është kudo (Jeremia 23:23-24).  
- Ne nuk mund të imagjinojmë se sa e madhe është gjithësia apo madhështia e Perëndisë.  
- Ndonëse Perëndia është i pranishëm kudo në gjithësi, Ai është Krijuesi; Ai nuk është ndonjë nga gjërat që ka krijuar. **Ideja që Perëndia është gjithçka dhe gjithçka është Perëndi është gënjeshtër e Satanit. Ka vetëm një Perëndi të vërtetë, jo shumë "perëndi". Bibla i referohet gjithësisë dhe gjithçkaje në të si krijimi i Perëndisë, dhe jo si pjesë e qenies së tij.**
- Dituria dhe njohuria e madhe e Perëndisë shfaqen në gjithësinë që krijoi.  
- Perëndia donte që ne të kishim një botë të rregullt me ditë, netë, stinë dhe baticat të besueshme. Perëndia nuk ndryshon kurrë, as ligjet e krijimit të Tij. Mendoni:  
A ka pasur një ditë në jetën tënde kur dielli nuk ka lindur apo nuk ka perënduar? Ai mund të jetë fshehur nga retë, por ka bërë atë që bën zakonisht, ditë pas dite. Po hëna? A e dije që lëvizjet dhe pozicioni i hënës dhe i tokës janë tërësisht të parashikueshme? Kjo me siguri nuk ka ndodhur rastësisht; është projektuar në atë mënyrë nga vetë Perëndia. Çdo ditë Perëndia na tregon gjërat që ka krijuar.
- Gjithçka që bëri Perëndia ditën e katërt ishte e mirë.

## 3. Dita e pestë: Krijimi i tërë jetës ujore dhe zogjve - Zanafilla 1:20-23.

- Perëndia bëri shumë lloje krijesash ujore dhe zogjsh me madhësi e forma të panumërta e shumëngjyrëshe (Diskutoni larminë e jetës ujore dhe zogjve në zonën tuaj).  
- Pse krijoi Perëndia kaq shumë larmi e bukuri? Ai e bëri për të treguar dashurinë e Tij për ne. Ai e bëri për të na treguar fuqinë dhe njohurinë e Tij të madhe.

## 4. Dita e gjashtë: Krijimi i botës shtazore - Zanafilla 1:24-25.

- Perëndia krijoi një numër dhe larmi të pabesueshme kafshësh.  
Mendoni për tërë llojet e ndryshme të kafshëve dhe gjërat mahnitëse që mund të bëjnë! Arinjtë polarë notojnë në oqeanin e akullit; pandat jetojnë lart në male dhe hanë bambu; jaguarët dhe çitat mund të vrapojnë më shpejt se njeriu; gjarpërinjtë lëshojnë lëkurën e tyre; rosat mund të notojnë në ujë, ecin në tokë dhe fluturojnë në ajër.
- Perëndia e krijoi çdo lloj kafshe me karakteristika unike dhe çdo lloj kafshe është në gjendje të riprodhojë vetëm kafshë të tjera si vetja.
- Vetëm Perëndia ka fuqinë për të krijuar kafshë. Njeriu nuk ka krijuar kurrë një kafshë. Njeriu nuk do të jetë kurrë në gjendje të krijojë një kafshë.
- Tërë qeniet e gjalla që bëri Perëndia në ditën e pestë dhe të gjashtë ishin të mira. Gjithçka që krijoi Perëndia ishte e mirë. Ngaqë Perëndia është i përsosur, gjithçka që bëri ishte e përsosur.

# Mësimi 7

## Qëllimi


Ky mësim paraqet Perëndinë si Krijuesin sovran dhe Zotin e njeriut. Gjithashtu, ai paraqet njeriun si krijimin unik të Perëndisë, të ndryshëm nga çdo gjë tjetër që ka krijuar Perëndia, bërë sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë. Kur të diskutohni "Shëmbëlltyrën e Perëndisë", do t'u mësosh fëmijëve rreth mendjes, emocioneve dhe vullnetit. Gjithashtu, do t'u tregosh fëmijëve të klubit tënd planin fillestar të Perëndisë që njeriu të ishte sunduesi i tërë tokës.

## Hyrje

Nga kjo histori duhet që fëmijët e klubit tënd të kuptojnë që Perëndia nuk i krijoi qiejt dhe tokën për vete. Ai nuk ka nevojë për gjë! Perëndia, duke qenë më i madh se të gjithë, e bëri tërë këtë vepër të mrekullueshme të krijimit, jo vetëm për lavdinë e Tij, por edhe ngaqë Ai është i dashur dhe i mirë. Perëndia e krijoi gjithçka me dashuri, me kujdes dhe në mënyrë të përsosur, si përgatitje për krijimin e Tij përfundimtar: njeriun! Isaia 45:18 thotë që Perëndia e bëri tokën për t'u banuar, pra, për t'u populluar! Gjithçka për të cilën njeriu do të kishte nevojë, po e priste dhe ishte gati për të.

## Figurat

- Grafiku 1: Mësimi për Perëndinë  
Në këtë mësim përdor këtë grafik për të përsëritur atributet që janë përmendur tashmë.
- Grafiku 6: Perëndia e krijoi njeriun sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë
- Figura 2: Krijimi



Përdore këtë figurë në fund të këtij mësimi. Përsërit atë që ka krijuar Perëndia dhe se si Perëndia i ka dhënë Adamit përgjegjësinë për ta mbikëqyrur.

# Perëndia krijon njeriun

## Historia

"Xhon, ku po shkon me atë kafazin?" - thirri Karola. "Ai është i imi!"

"Oh, përshëndetje Karola" - tha Xhoni duke qeshur. "Do të vija të të pyesja nëse mund ta merrja".

"Jo, nuk mund ta marrësh!" - tha Karola e zemëruar. "E bëra dhe e përshtata atë kafaz për papagallin tim".

"A ka dikush ndonjë problem?" - pyeti xhaxhi Piteri, ndërsa po shkonte drejt Xhonit dhe Karolës. "Arrita t'ju dëgjoj që nga shtëpia ime".

"Përshëndetje, xhaxhi Piter" - tha Karola. "Jam e mërëzitur me Xhonin. Bëra një kafaz shumë të këndshëm për papagallin tim. Ka një vend për të vendosur ushqim dhe ujë, një degë që të ulet dhe një mbulesë për ta mbrojtur nga dielli dhe shiu. U lodha shumë që ta bëja këtë kafaz siç duhet, sepse ky zog është shumë i veçantë për mua. Tani Xhoni do që ta marrë dhe ta përdorë".

"Por ti nuk e ke futur akoma papagallin brenda, Karola" - tha Xhoni. "Kështu që mendova se mund ta përdorja".

"Por e kam bërë unë!" - tha Karola. "Më përket mua dhe mund të bëj çfarë të dua me të".

"Mund të nxjerrim një mësim të mirë nga ky kafaz" - tha xhaxhi Piteri.

"Çfarë do të thuash?" - pyeti Xhoni.

"Shiko," - u përgjigj xhaxhi Piteri, - "Karola bëri këtë kafaz. Ajo e ka të sajën dhe i takon asaj të bëjë atë që do me të, sepse ajo e bëri. Ajo e projektoi për një qëllim të veçantë. A je ndalur ndonjëherë për të menduar që Perëndia bëri njeriun?"

"Perëndia bëri njeriun?" - pyeti Xhoni. "Mësuesi i shkollës thotë se njeriu ka evoluuar".

"Bibla na thotë që Perëndia e bëri njeriun nga pluhuri i tokës" - tha xhaxhi Piteri.

"Por trupi nuk kishte jetë në të, derisa Perëndia hukati në trupin e njeriut, pastaj ai u bë një person i gjallë. Vetëm Perëndia mund t'i japë jetë njeriut. Ata që mendojnë se njeriu ka evoluuar nuk e kuptojnë që Perëndia është Krijuesi i njeriut, zotëruesi i njeriut. Njeriu i përket Perëndisë. Perëndia është Ai që e di se çfarë është më e mira për njeriun".

"Oh, tani e kujtoj, xhaxhi Piter," - tha Karola e gëzuar, - "ti na the herën e kaluar që Perëndia ka krijuar tokën, dritën, ujin, bimët dhe pemët për njeriun, të cilin do ta krijonte më pas".

"Ke të drejtë, Karola" - pranoi xhaxhai i saj. "Perëndia e krijoi gjithçka në mënyrë të dashur, të kujdesshme dhe të përsosur, si përgatitje për krijimin e Tij përfundimtar: njeriun! Çfarë vendi të veçantë i dha Perëndia njeriut. Perëndia e quajti njeriun e parë Adam. Ai është paraardhësi i tërë njerëzve. Njeriu duhet të kujdeset për gjërat e Perëndisë këtu në tokë dhe të sundonte mbi peshqit, zogjtë dhe kafshët. Perëndia kishte të drejtën të vendoste se kujt do t'ia jepte tokën, sepse Ai krijoi dhe zotëronte gjithçka. Prandaj, Ai mund t'ia jepte kujt të donte".

"Ke të drejtë, xhaxhi Piter" - pranoi Xhoni. "Unë me të vërtetë nxora një mësim sot! Më vjen keq që ta mora kafazin, Karola. Ai të përket ty dhe ti ke të drejtën të bësh çfarë të duash me të, ashtu si Perëndia ka të drejtën të bëjë atë që do me krijimin e Tij".

## Le të shohim në Bibël



**Zanafilla 1:27 - “Kështu Perëndia krijoi njeriun simbas shëmbëlltyrës së vet, simbas shëmbëlltyrës së Perëndisë; Ai krijoi mashkullin e femrën”.**

Bëje të qartë se kur thotë që njeriu u krijua sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë, nuk po thotë që u krijua sipas shëmbëlltyrës fizike të Perëndisë. Se çfarë do të thotë sipas

“shëmbëlltyrës së Perëndisë” do të diskutohet në “Mësime nga Fjala e Perëndisë”.

## Le të mendojmë

1. Kush e bëri kafazin?
  - a. Xhoni; b. Karola; c. Xhaxhi Piteri.
2. Kush e kishte kafazin?
  - a. Xhaxhi Piteri; b. Xhoni; c. Karola.
3. Kush e krijoi njeriun?
  - a. Njeriu evoluoi; b. Perëndia; c. Askush nuk e di.
4. Kujt i përket njeriu?
  - a. Askujt; b. Engjëjve; c. Perëndisë.
5. A e krijoi Perëndia tokën që njeriu të jetonte në të? Po / Jo.

## Mësime nga Fjala e Perëndisë

### 1. Plani i Perëndisë për të krijuar njeriun sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë - Zanafilla 1:26.

- Kujt mendon se po i fliste Perëndia kur tha: “...Ta bëjmë njeriun sipas shëmbëlltyrës sonë...”?
  - Ishte Perëndia Atë, Perëndia Bir dhe Perëndia Frymë e Shenjtë që po flisnin së bashku. Ata po diskutonin për planin e tyre për ta bërë njeriun sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë.
- Perëndia është autoriteti më i lartë; Ai është sovran. Vetëm Perëndia vendosi se si do të bëheshin tërë gjërat, ashtu siç vendosi të bënte engjëjt, diellin, hënën, yjet, tokën dhe tërë gjërat në tokë.
  - Perëndia është më i madh se të gjithë dhe më i rëndësishëm se çdo gjë, dhe njeriu ishte gjëja më e rëndësishme që Perëndia krijoi në tokë. Ai krijoi njeriun sipas shëmbëlltyrës së Tij.
- Çfarë nënkupton Perëndia kur na thotë në Fjalën e Tij që njeriu i parë u bë sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë?
  - Ne e dimë që nuk flet për trupat tanë. Perëndia nuk ka trup prej mishi e kockash si ne.
  - Por Perëndia po i referohej anës që nuk mund të shihet. Bibla e quan këtë anë, e cila nuk mund të shihet, shpirti dhe fryma jonë. Trupi i njeriut u krijua për të qenë “shtëpia” e kësaj ane të padukshme, shpirtit dhe frymës.
  - Perëndia planifikoi që ana e padukshme e njeriut të kishte një **mendje, emocione dhe një vullnet, krijuar sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë**.
- **Mendja e njeriut:** aftësia e tij për të menduar:
  - Ngaqë Perëndia ka mendje, Ai planifikoi që t’i bënte njerëzit me një mendje e cila ka aftësinë për të njohur Perëndinë.
  - Perëndia donte të fliste me njeriun dhe Ai donte që njeriu të fliste me Të.
  - Perëndia donte të ishte në gjendje të komunikonte me njeriun,<sup>3</sup> jo vetëm me anë të fjalës së folur, por edhe me anë të Fjalës së Tij të shkruar, Biblës.

=> Grafiku 6: Perëndia e krijoi njeriun sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë

#### PERËNDIA KRIJOI NJERIUN SIPAS SHËMBËLLTYRËS SË PERËNDISË

1. Me MENDJE në mënyrë që njeriu të mund të NJOHË PERËNDINË
2. Me EMOCIONE në mënyrë që njeriu të mund të DONTË PERËNDINË
3. Me VULLNET në mënyrë që njeriu të mund të ZGJIDHTE TË BINDEJ

<sup>3</sup> Ne kuptojmë që Perëndia u ka dhënë edhe kafshëve mendje. Por një kafshë nuk ka të njëjtën lloj mendjeje që ka njeriu. Kafshët nuk kanë aftësinë të flasin me ne; ato nuk mund të kenë mendimet tona dhe nuk mund të marrin vendimet që marrim ne; ato nuk mund të komunikojnë me ne me anë të gjuhës apo shkrimit.



<sup>4</sup> Sigurisht, kjo nuk do të thotë që çdo njeri mund të mendojë dhe arsyetojë saktësisht siç mendon dhe arsyeton Perëndia.

<sup>5</sup> Njerëzit ndonjëherë mendojnë që emocionet janë të këqija. Por emocionet janë shumë të nevojshme dhe të dobishme. Perëndia na i dha emocionet për të mirën tonë.

<sup>6</sup> Perëndia mund ta kishte bërë njeriun e parë që të mos e kishte mundësinë e zgjedhjes. Kështu i bëri diellin, hënën dhe yjet. Perëndia i krijoi në mënyrë të tillë që të bëjnë të njëjtat gjëra çdo ditë, çdo muaj dhe çdo vit. Por Perëndia nuk planifikoi ta bënte njeriun si këto gjëra. Njeriu ishte gjëja më e rëndësishme që Perëndia krijoi në tokë dhe për shkak se Perëndia ka një vullnet dhe vendos se çfarë do të bëjë, Ai donte që njeriu të ishte në gjendje të merrte vendime.

## Përsëritje

PERËNDIA E KRIJOI NJERIUN SIPAS SHËMBËLLTYRËS SË PERËNDISË

Me një MENDJE në mënyrë që njeriu të mund të NJOHË PERËNDINË.

Me EMOCIONE në mënyrë që njeriu të mund të DOJË PERËNDINË.

Me një VULLNET në mënyrë që njeriu të mund të ZGJEDHË TË BINDET.

## Pyetje dhe përgjigje

1. Për kë e përgatiti Perëndia tokën? Për njeriun.
2. Kush është i vetmi që mund të japë jetë? Perëndia. 3. Cila pjesë e njeriut u krijua sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë? **Mendja, emocionet dhe vullneti.**
4. Kush është paraardhësi i të gjithë njerëzve? **Adami.**
5. Cilin caktoi Perëndia që të kujdesej për gjërat e Tij këtu në tokë? **Njeriun, Adamin.**
6. Pse e kishte Perëndia autoritetin që ta vinte njeriun përgjegjës të tokës? **Sepse Perëndia krijoi gjithçka.**

- Perëndia donte që njeriu të ishte në gjendje të bënte punën e Perëndisë këtu në tokë.
- Perëndia donte që njeriu të ishte në gjendje të mendonte dhe të arsyetonte në të njëjtën mënyrë si Perëndia.<sup>4</sup>
- Më e rëndësishmja, Perëndia i dha njeriut një mendje, në mënyrë që njeriu të **njihte Perëndinë.**

### ● Emocionet e njeriut: ndjenjat e tij:

- Kur flasim për emocionet tona, po flasim për ndjenjat tona: gëzimin, trishtimin, dashurinë, zemërimin dhe kështu me radhë.<sup>5</sup>
- Bibla na tregon që Perëndia ka emocione: Ai është shumë i mirë e i dashur, por zemërohet kundër asaj që është e keqe. Ne mund të shikojmë te Perëndia që emocionet janë të mira. Perëndia do, urren, ndjen trishtim dhe ndjen gëzim.
- Ngaqë Perëndia ka ndjenja (emocione), Ai vendosi që ta krijonte njeriun me ndjenja. Perëndia planifikoi që ta donte njeriun, por Perëndia donte që edhe njeriu të ishte në gjendje ta donte Atë. Perëndia i dha njeriut **emocione**, në mënyrë që njeriu të mund të **donte Perëndinë.**

### ● Vullneti i njeriut: aftësia e tij për të zgjedhur.<sup>6</sup>

- Perëndia ka edhe një vullnet; Ai mund të vendosë të bëjë diçka apo të mos e bëjë. Prandaj, Perëndia vendosi ta bënte njeriun të aftë për të qenë në gjendje që të merrte vendime. Perëndia planifikoi ta bënte njeriun, në atë mënyrë që ai të mund të **zgjidhte** ta donte dhe t'i bindej Perëndisë.
- Perëndia do t'i jepte njeriut një punë të veçantë në krijimin e Tij. Perëndia i dha njeriut mendje, emocione dhe vullnet, në mënyrë që njeriu të bënte punën e Perëndisë, sipas mënyrës që donte Perëndia. Kjo do t'i bënte të lumtur si Perëndinë, ashtu edhe njeriun!

## 2. Krijimi i Adamit - Zanafilla 1:27; 2:7.

- Në fillim Perëndia krijoi burrin dhe gruan. Perëndia krijoi në fillim burrin dhe pastaj, pasi burri ishte gjallë, Perëndia bëri një partnere për të. (Sot do të flasim vetëm për burrin.) Perëndia ia vuri emrin "Adam" që do të thotë "burrë".
  - Pasi Perëndia bëri çdo pjesë të trupit të burrit, ai nuk kishte ende jetë. Trupi i Tij nuk merrte frymë, sepse pjesa që duhet të ishte sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë nuk po jetonte akoma në trupin e tij. Vetëm pasi Perëndia hukati në hundët e njeriut, atëherë ai u bë menjëherë një person i gjallë që mund të njihte, të donte dhe t'i bindej Perëndisë.
- Vetëm Perëndia mund t'i jepte jetë Adamit.
  - As dielli, as hëna apo zogjtë, kafshët, peshqit, engjëjt e Perëndisë, njeriu, Satani dhe as ndjekësit frymëra të tij nuk mund të japin jetë. Tërë gjërat e morën jetën e tyre nga Perëndia dhe nuk janë në gjendje t'i japin jetë diçkaje apo dikujt tjetër.

## 3. Adami ishte burri i parë dhe i vetëm që Perëndia krijoi nga dheu - Zanafilla 2:7.

- Perëndia bëri vetëm një njeri nga dheu dhe një grua prej tij, dhe Perëndia u tha atyre të kishin fëmijë, në mënyrë që tërë bota të mbushej me njerëz.
- Adami është paraardhësi i tërë njerëzve në çdo vend e komb: njerëzit e çdo race, ngjyre dhe gjuhe. Të gjithë kemi rrjedhur nga ky njeri i parë.

## 4. Njeriu u vendos si sunduesi i tokës - Zanafilla 1:28-30.

- Perëndia e vuri Adamin përgjegjës të tokës dhe të gjithçkaje në të. Njeriu duhet të kujdesej për gjërat e Perëndisë këtu në tokë dhe të sundonte mbi peshqit, zogjtë dhe kafshët.
- Perëndia zotëronte gjithçka; Ai mund t'ia jepte kujtdo që dëshironte (Psalmi 24:1).
- Duke i dhënë njeriut atë përgjegjësi, Perëndia i bëri njeriut një nder të madh (Psalmi 8:3-9).

## 5. Gjithçka që bëri Perëndia ishte e mirë - Zanafilla 1:31.

- Në fillim nuk kishte asgjë në botën e kafshëve që mund t'i bënte dëm njeriut. As njeriu, as kafsha nuk kishin pse të vrisnin për të ngrënë. Gjembat, gjembaçët dhe barërat nuk rriteshin siç rriten tani.

# Mësimi 8

## Qëllimi

Për të paraqitur Perëndinë si Krijuesi sovran, i dashur, i zgjuar dhe zotëruesi i njeriut. Për të përcaktuar që ndëshkimi për mëkatin është vdekja.

Do të bësh që fëmijët e klubit tënd:

- Të kuptojnë nevojën për të njohur Perëndinë.
- Të kuptojnë nevojën e tyre për të qenë të nënshtruar ndaj Perëndisë.
- Të vlerësojnë kujdesin e Perëndisë ndaj tyre dhe të shohin që ndëshkimi për mëkatin është vdekja.

## Hyrje

Pyeti fëmijët e klubit tënd: A ke filluar ndonjë gjë dhe nuk e ke mbaruar? (Jepu fëmijëve një rast për të përmendur disa nga arsyet e tyre se përse nuk e kanë mbaruar atë që kanë filluar.) Pse nuk ke mbaruar atë që ke filluar? A ndryshove mendje apo humbe interesin? A të rezultoi shumë e vështirë për t'u bërë apo një punë më e madhe nga sa e kishe menduar? Perëndia nuk është si ne. Ai nuk heq kurrë dorë nga ajo që planifikon të bëjë. Kur fillon diçka, Ai gjithmonë e mbaron.

## Figurat

- Grafiku 1: Mësimi për Perëndinë  
Në këtë mësim përdor këtë grafik për të përsëritur atributet që janë paraqitur tashmë dhe për të paraqiturtribute shtesë kur sugjerohen në mësim. Atribute të reja: **“Perëndia është besnik; Ai bën gjithmonë atë që thotë; Ai nuk ndryshon kurrë”**.
- Grafiku 7: Ndëshkimi për mëkatin është vdekja

# Kopshti i Edenit

## Historia

“Çfarë po bën, Xhon” - pyeti Karola. “Duket sikur po bën një kafaz zogjsh si i imi”.

“Po, i premtova Tomit që do t'i bëja një të tillë” - pohoi Xhoni.

“Ku e more sharrën?” - pyeti Karola. “Unë i thashë xhaxhi Piterit të priste dërrasën, sepse ai tha se ishte shumë e rrezikshme që ne të përdornim sharrën”.

“E di,” - u përgjigj Xhoni, - “por xhaxhi Piteri ka ikur dhe unë nuk doja që të prisja për të, ndaj ia mora. Do ta përdor me kujdes. Mos ki merak”.

“Xhon, më mirë mos e përdor atë sharrë!” - e paralajmëroi Karola. “Xhaxhi Piteri do të mërzhitet shumë me ty”.

“Përse do të mërzhitem?” - pyeti xhaxhi Piteri, ndërsa po shkonte drejt Xhonit dhe Karolës.

“I thashë Xhonit që ti do të mërzhiteshe, sepse nuk doje që ne të përdornim sharrën,” - tha Karola, - “por ai mendon se e di se çfarë është më e mira për të”.

“Jam shumë i zhgënjyer nga ty, Xhon” - tha xhaxhi Piteri i trishtuar. “Ta thashë qartë që nuk doja që ta përdorje atë sharrë. Të thashë ngaqë jam në merak për ty dhe nuk dua që të lëndohesh. Tani nuk mund të të lejoj që t'i përdorësh veglat e mia, sepse nuk kam besim se ti mund të më bindesh”.

“Atëherë, nëse nuk mund të përdor sharrën,” - tha Xhoni, - “nuk do ta bëj dot kafazin që i premtova mikut tim. Atij do t'i duhet ta bëjë vetë!”.

“Jam i gëzuar që Perëndia nuk heq dorë nga ajo që planifikon të bëjë” - tha xhaxhi Piteri. “Kur Ai fillon të bëjë diçka, Ai gjithmonë e mbaron! Po sikur Perëndia të reshtte së krijuari tokën dhe tërë gjërat që bëri për t'i vendosur në të? Po sikur Ai të mos mbaronte së bëri njeriun? Ne nuk do të ishim gjallë, apo jo?”.

“As Ai nuk do të mund ta kishte mbaruar nëse do të kishte të njëjtat probleme që kam unë me projektin tim” - u ankua Xhoni.

“Perëndia nuk është si ne, Xhon” - tha xhaxhi Piteri. “Asgjë dhe askush nuk mund të ndalojë Perëndinë për të bërë tërë planet e Tij. Askush nuk mund ta ndalojë Perëndinë. Satani nuk mund ta ndalojë Perëndinë. Perëndia është më i madh se të gjithë! Kur Perëndia **premt**on të bëjë diçka, ne mund të jemi plotësisht të sigurt që Ai do ta bëjë!”.

“A e mbaroi Perëndia gjithçka që planifikoi të bënte në gjashtë ditët për të cilat folëm, xhaxhi Piteri?” - pyeti Karola.

“Po” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Perëndia e **mbaroi** për gjashtë ditë gjithçka që donte të bënte. Ditën e shtatë ai bëri pushim nga puna e Tij e krijimit”.


“Perëndia duhet të ketë qenë shumë i lodhur nga tërë ajo vepër!” - tha Karola.

“Jo” - tha xhaxhai i saj. “Perëndia nuk ishte i lodhur. Ai pushoi, sepse Ai mbaroi gjithçka që kishte planifikuar të bënte! Ai nuk kishte asgjë tjetër për të bërë”.

“Çfarë i ndodhi njeriut të quajtur Adam, i cili ishte krijuar nga Perëndia?” - pyeti Xhoni.

Xhaxhi Piteri u ul në një trung dhe shpjegoi: “Ngaqë Perëndia e donte shumë Adamin, ai bëri një kopsht të bukur posaçërisht për të. Në kopsht Perëndia vendosi tërë perimet dhe frutorët që Adami kishte nevojë për të qëndruar i shëndetshëm, i fortë dhe i lumtur. Bibla na tregon për Adamin dhe këtë kopsht të veçantë. Le të shohim se çfarë thotë”.

## Le të shohim në Bibël



**Psalmi 24:1** - “Zotit i përket toka dhe të gjitha gjërat që janë mbi të, bota dhe banorët e saj”.

Ky varg u tregon fëmijëve nga Fjala e Perëndisë që Perëndia është zotëruesi i tërë botës dhe i gjithçkaje në të.

## Le të mendojmë

1. A mund t'i besonte xhaxhi Piteri Xhonit pasi ky nuk iu bind atij? **Po / Jo.**
2. A e mbajti Xhoni premtimin që i bëri mikut të tij? **Po / Jo.**
3. A i mban Perëndia premtimet e Tij? **Po / Jo.**
4. Sa ditë iu deshën Perëndisë për të mbaruar krijimin e gjithçkaje?  
a. Shtatë ditë; b. Ai nuk e mbaroi; c. **Gjashtë ditë.**
5. A bëri Perëndia një kopsht të veçantë për Adamin meqë e donte? **Po / Jo.**

## Mësime nga Fjala e Perëndisë

### 1. Perëndia mbaroi së bëri gjithçka që kishte planifikuar - Zanafilla 2:1.

- Perëndia mbaroi gjithçka që kishte planifikuar të bënte.
  - Perëndia nuk ndryshon kurrë mendjen për diçka që planifikon.
  - Asgjë dhe askush nuk mund të ndalojë Perëndinë për të bërë gjithçka që ka planifikuar. Asnjë njeri nuk mund ta ndalojë. Satani nuk mund ta ndalojë Perëndinë.
  - Perëndia është më i madh se të gjithë. Ai bën gjithmonë atë që planifikon të bëjë. Prandaj, kur Perëndia premton të bëjë diçka, ne mund të jemi plotësisht të sigurt se Ai do ta bëjë.

### 2. Perëndia pushoi nga vepra e Tij e krijimit ditën e shtatë - Zanafilla 2:2-3.

- Perëndia mbaroi në gjashtë ditë gjithçka që planifikoi të bënte, kështu ditën e shtatë Ai bëri pushim (ndaloj) nga puna e Tij e krijimit.<sup>7</sup>  
*Isaia 40:28a thotë: Nuk e di ti, vallë, nuk e ke dëgjuar? Perëndia i përjetësisë, Zoti, krijuesi i kufijve të tokës, nuk mundohet dhe nuk lodhet.*
  - Perëndia kishte bërë gjithçka që kishte planifikuar dhe Ai ishte shumë i kënaqur me gjithçka që kishte bërë.

### 3. Avulli, jo shiu, ujiste tokën - Zanafilla 2:4-6.

- Kur Perëndia krijoi në fillim gjithçka, Ai nuk e ujiste tokën me anë të shiut, por me anë të avullit që dilte nga toka.<sup>8</sup>

### 4. Perëndia bëri një kopsht - Zanafilla 2:7-8.

- Perëndia përfshiu në atë kopsht tërë perimet dhe frutorët që kishte nevojë Adami për të qëndruar i shëndetshëm, i fortë dhe i lumtur.

### 5. Perëndia e vendosi Adamin në kopshtin e Edenit - Zanafilla 2:8.

- Kur Perëndia e bëri kopshtin gati, Ai e vendosi Adamin atje.
  - Perëndia nuk e pyeti Adamin nëse donte të jetonte atje.
  - Pse e bëri këtë Perëndia? Duke qenë se Perëndia e krijoi njeriun, Ai kishte të drejtën për ta vendosur atë ku të donte Ai dhe t'i thoshte se çfarë të bënte.

=> Grafiku 1: Mësimi për Perëndinë  
Trego grafikun dhe lexo: “**Perëndia është besnik; Ai bën gjithçka që thotë; Ai nuk ndryshon kurrë.**”

<sup>7</sup> A mendoni që Perëndia pushoi ngaqë ishte i lodhur? Ai kishte bërë miliona vje, diellin dhe hënën. Shikoni tërë gjërat që krijoi në tokë. A mendoni që pushoi dhe tha: “Jam i lodhur. Do të pushoj sot”? Jo, Perëndia nuk lodhet apo përgjimet si ne. Ai nuk ka një trup fizik që ka nevojë për pushim apo gjumë. Perëndia është frymë. Ai është gjithmonë njësoj. Ai është akoma njësoj sot, siç ishte kur bëri për herë të parë tokën. Perëndia nuk do të ndryshojë kurrë.

<sup>8</sup> Ky shpjegim është përgatitje e nevojshme për historinë e përmbytjes dhe shiun e parë që njeriu pa. *Me anë të besimit Noe, i lajmëruar hyjnisht për ato që ende nuk shiheshin, u frikësua dhe ndërtoi një arkë (Hebrenjve 11:7a).*

<sup>9</sup> Çfarë ndodhi? Pse gjërat janë kaq ndryshe tani? Bibla na thotë saktësisht se çfarë ndodhi që ndryshoi gjithçka dhe ne do ta studiojmë këtë gjë në një mësim tjetër.

<sup>10</sup> Perëndia na udhëzon në mënyrë të qartë. Ai nuk na ka lënë ne që të vendosim vetë se çfarë është e drejtë dhe e gabuar. Perëndia na ka dhënë Biblën, në mënyrë që të mund të dimë se çfarë i pëlqen dhe çfarë nuk i pëlqen Atij.

<sup>11</sup> Të jesh i pavarur do të thotë të bësh atë që mendon: të refuzosh t'u bindesh autoriteteve sipër teje.

=> Grafiku 7: Ndëshkimi për mëkatin është vdekja Trego këtë grafik ndërsa shpjegon numrin shtatë (7).

## Përsëritje

1. Perëndia bën gjithmonë atë që planifikon. Perëndia bën gjithmonë atë që **TMERONP** (premtan).
2. Perëndia pushoi ditën e shtatë, sepse tërë puna e Tij e krijimit ishte **RAUMABR** (mbaruar).
3. Në fillim tërë bimët ujiteshin nga një avull që dilte nga toka; nuk kishte **HIS** (shi);

## Pyetje dhe përgjigje

1. Çfarë bëri Perëndia ditën e shtatë? **Ai pushoi nga vepra e Tij e krijimit.**
2. Si e ujitte Perëndia tokën në fillim? **Me anë të avullit që dilte nga toka.**
3. Cilat ishin dy pemët e rëndësishme që Perëndia mbolli në mes të kopshtit? **Pema e jetës, pema e njohjes të së mirës e të së keqes.**
4. Nga cila pemë i tha Perëndia Adamit që të mos hante? **Nga pema e njohjes të së mirës e të së keqes.**
5. Cili është ndëshkimi për mosbindjen ndaj Perëndisë? **Vdekja, ndarja nga Perëndia.**

- Perëndia është zotëruesi i çdo gjëje. Ai ka të drejtën të bëjë atë që do me ne dhe me tërë gjërat e tjera që ka krijuar. Ai ka të drejtën të na thotë se çfarë të bëjmë.

- Perëndia krijoi Adamin, kështu që ai i përkiste Perëndisë.

- Perëndia i tha Adamit të kujdesej për kopshtin, por Adami nuk kishte pse të punonte shumë, sepse gjithçka ishte e përsosur.<sup>9</sup> Barërat e këqija nuk rriteshin. Kërmijtë, larvat dhe insektet nuk i shkatërronin frutat apo perimet. Gjithçka ishte shumë e bukur dhe e përsosur!

### 6. Pema e jetës dhe pema e njohjes të së mirës dhe të së keqes - Zanafilla 2:9.

- Perëndia mbolli dy pemë shumë të rëndësishme në mes të kopshtit: pemën e jetës dhe pemën e njohjes të së mirës e të së keqes.
- Perëndia ishte burimi i jetës së Adamit - Zanafilla 2:16-17.
  - Perëndia donte që Adami të kishte atë që ishte e mirë; ai varej nga Perëndia për gjithçka.
- Perëndia i tha Adamit se çfarë nuk duhet të bënte dhe çfarë do të ndodhte nëse nuk bindej.
  - Nga tërë pemët që Perëndia mbolli për Adamin për t'u ushqyer, ishte vetëm një pemë nga e cila Adami nuk duhet të hante, pema e njohjes të së mirës e të së keqes.
- Perëndia e dinte se çfarë ishte më e mira për Adamin. Adami nuk dinte se çfarë ishte e liga apo e keqja, sepse Perëndia i kishte dhënë gjithçka që ishte e mirë<sup>10</sup>.
- Adami mund të zgjidhte të bindej apo të mos bindej.
  - Nëse Adami i bindej Perëndisë dhe hante vetëm atë që i kishte thënë Perëndia se ishte e mirë, ai mund të hante nga pema e jetës dhe të jetonte përgjithmonë.
  - Por nëse Adami nuk i bindej Perëndisë dhe hante frutën e pemës së njohjes të së mirës e të së keqes, kjo gjë do të ndodhte sepse ai do të kishte vendosur të ishte i pavarur nga Perëndia<sup>11</sup>.
  - Në momentin që Adami do të hante, ai do të njihte se çfarë ishte e mira dhe e keqja. Në vend që të linte Perëndinë që t'i thoshte se çfarë ishte e mirë dhe e keqe, ai do të zgjidhte vetë.
- Nëse Adami nuk do t'i bindej Perëndisë dhe do të donte të ishte i pavarur nga Ai, atëherë rezultati do të ishte vdekja, ndarja nga Perëndia.

### 7. Vdekja është ndëshkimi për mosbindjen ndaj Perëndisë - Zanafilla 2:17.

Çfarë nënkuptoi Perëndia kur e paralajmëroi Adamin: Nëse do të hash frutën e kësaj peme, do të vdesësh menjëherë?

- **Ndarja nga Perëndia:** prishja e marrëdhënies së njeriut me Perëndinë.
  - Adami do të ndahej menjëherë nga Perëndia, burimi i jetës dhe i çdo gjëje që është e mirë.
  - Perëndia e paralajmëroi Adamin që, nëse ai nuk i bindej urdhrit të Tij, ai do të ndahej nga dashuria dhe miqësia e Perëndisë. Adami do të bëhej armiku i Perëndisë, ashtu si Satani.
  - Ajo pjesë e Adamit që ishte krijuar sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë, në mënyrë që Adami të njihte, të donte dhe t'i bindej Perëndisë, do të ndahej nga Perëndia nëse Adami do të hante frutën e ndaluar.
- **Ndarja nga trupi:** vdekja e trupit fizik të njeriut.
  - Perëndia nuk po thoshte që Adami do të vdiste fizikisht në të njëjtën ditë që do të hante frutën. Perëndia nënkuptonte që atë ditë Adami do të shpërbëhej nga Perëndia që ishte burimi i tij i jetës. Për shkak të kësaj ai do të vdiste fizikisht një ditë në të ardhmen.
- **Ndarja përgjithmonë në liqenin e zjarrit:** ndarje ndaj çdo gëzimi të Perëndisë dhe bekimeve të Tij.
  - Së fundi, nëse Adami nuk do t'i bindej Perëndisë, atëherë jo vetëm trupi i tij do të vdiste, por ai do të shkonte përfundimisht në liqenin e zjarrit. Ky është i njëjti vend i tmerrshëm ndëshkimi, të cilin Perëndia e përgatiti për Satanin dhe ndjekësit e tij.
  - Ndëshkimi i Adamit do të ishte i përhershëm.

Perëndia është sovran; Ai kishte të drejtën t'i thoshte Adamit se çfarë duhet të bënte. Perëndia e bëri Adamin dhe i dha atij jetën e Tij. Adami i përkiste Perëndisë. Perëndia i tha Adamit se çfarë duhet të bënte, sepse Ai është i dashur.

# Mësimi 9 Perëndia bëri Evën

## Qëllimi

Për të treguar që Perëndia në sovranitetin, dashurinë, shenjtërinë, diturinë dhe pushtetin e Tij siguroi një grua për Adamin. Fëmijët e klubit tënd duhet të shohin gjithashtu:

- Diturinë dhe dashurinë e Perëndisë duke siguruar gjithçka që kemi nevojë.
- Që Perëndia i çmon shumë edhe burrin, edhe gruan.
- Që martesë u caktua nga Perëndia.


## Hyrje

Pyeti fëmijët e klubit tënd: Sa prej jush kanë marrë pjesë në një dasmë? A e dinit që Perëndia ishte Ai që vendosi që burri dhe gruaja të marthoheshin?

Te Zanafilla 2 gjejmë një pjesë të ceremonisë martesore për të cilën flitet në shumë kultura sot. Burrat dhe gratë, martesë dhe fëmijët janë shumë të rëndësishëm për Perëndinë. Por disa njerëz nuk e njohin apo nuk e besojnë atë që thotë Perëndia për martesën. Ata thonë që martesë është diçka për t'u provuar për pak kohë, sa për të parë nëse do t'i bëjë të lumtur. Sot do të shohim se çfarë thotë Bibla për martesën.

## Figura

- Grafiku 1: Mësimi për Perëndinë  
Në këtë mësim përdor këtë grafik për të përsëritur atributet që kemi paraqitur tashmë.
- Figura 3: Adami dhe Eva në kopsht



Shënim: Përdore këtë figurë në pikën gjashtë, vetëm nëse je i sigurt që nuk është fyese për fëmijët apo prindërit e tyre.

## Historia

“Ky gripi është i tmerrshëm” - u ankua Xhoni.

“Më duket se do të më zërë edhe mua” - tha Karola.

“Edhe unë e kalova para një jave” - shtoi xhaxhi Piteri. “A e dini që në fillim nuk kishte sëmundje?”.

“Kjo do të ishte fantastike!” - thirri Xhoni i gëzuar. “Sepse kur jam i sëmurë, nuk mund të dal jashtë nëse moti nuk është i mirë”.

“Në fillim,” - tha xhaxhi Piteri, - “moti ishte i përsosur. Gjithçka ishte e përsosur, dhe ishte e tillë sepse Perëndia është i përsosur, dhe Ai krijoi gjithçka të përsosur dhe të mirë”.

“A ishte edhe Adami i përsosur?” - tha Karola.

“Po, Karola, ishte” - u përgjigj xhaxhai i tij. “Perëndia e krijoi Adamin të përsosur. Adamit nuk i duhej që të punonte shumë për ta mbajtur kopshtin të pastër. Nuk kishte barëra të këqija që rriteshin në të”.

“Adami duhet të ketë qenë i lumtur në një vend të tillë të mrekullueshëm” - tha Karola. “Imagjino tërë pemët, lulet, perimet, pemët frutore dhe frutat e pyllit: tërë ngjyrat, aromat, zërat dhe gjërat e mira për t'u ngrënë!”.

“Po” - pranoi xhaxhi Piteri. “Mendoj që ishte. Perëndia e dinte me saktësi se për çfarë kishte nevojë Adami. Perëndia e dinte që Adami kishte nevojë për një shoqe me të cilin të fliste dhe të qëndronte. Perëndia i bëri Evën që të jetonin së bashku në kopsht”.

“A e bëri atë nga pluhuri?” - pyeti Xhoni.

“Jo” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Bibla na thotë këtu në librin e Zanafillës që Perëndia e vuri Adamin në gjumë dhe hoqi një prej brinjëve të Adamit. Nga ajo brinjë Perëndia bëri gruan e parë, të quajtur Eva”.

“Si e bëri Perëndia këtë?” - pyeti Karola.

“Perëndia e di si t'i bëjë gjërat” - kujtoi xhaxhi Piteri. “Ai është i plotfuqishëm dhe Ai njeh gjithçka!”.

“A u martuan?” - pyeti Karola.

“Po, u martuan” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Ky ishte plani i përsosur i Perëndisë për Adamin dhe Evën. Ata kishin miqësi të përsosur me njëri-tjetrin dhe me Perëndinë. Perëndia madje shkonte dhe fliste me ta në kopsht, dhe Ai u dha punën më të rëndësishme në tokë: të ishin sunduesit e çdo gjëje që bëri Ai”.



## Le të shohim në Bibël



**Zanafilla 2:23** - “Dhe njeriu tha: ‘Kjo së fundi është kocka e kockave të mia dhe mishi i mishit tim. Ajo do të quhet grua sepse është nxjerrë nga burri’”.

Shpjego që vetëm Perëndia mund të krijojë një grua nga një burrë. Perëndia di gjithçka dhe mund të bëjë gjithçka që dëshiron. Perëndia bëri vetëm një burrë nga pluhuri i tokës

dhe një grua prej tij. Asnjë njeri tjetër nuk u krijua në këtë mënyrë.

## Le të mendojmë

1. A kishte sëmundje në fillim? **Po / Jo.**
2. A ishte moti i përsosur në fillim? **Po / Jo.**
3. Nga çfarë e bëri Perëndia Evën?  
a. Nga pluhuri; b. Nga asgjëja; c. **Nga brinja e Adamit.**
4. A i bëri Perëndia Adamin dhe Evën të përsosur? **Po / Jo.**
5. A u martuan Adami dhe Eva? **Po / Jo.**

## Mësime nga Fjala e Perëndisë

### 1. Perëndia e dinte që Adami kishte nevojë për një shoqe.

- Perëndia vendosi që Adami të mos jetonte vetëm - Zanafilla 2:18.
  - Perëndia ishte Krijuesi i tij dhe e dinte se çfarë ishte më e mira për të.
  - Perëndia nuk e pyeti Adamin se çfarë donte apo se çfarë mendonte se ishte më e mira.
  - Perëndia mori vendimin për t'i bërë një shoqe Adamit.
- Perëndia e donte Adamin dhe dëshironte që ai të ishte i plotësuar.
  - Perëndia e dinte që Adami nuk mund të vazhdonte të ishte i lumtur nëse qëndronte vetëm.
  - Duke qenë se Perëndia e donte Adamin dhe donte më të mirën për të, Ai vendosi t'i bënte një shoqe.
- Perëndia e di që më përpara se cilat do të jenë nevojat tona dhe Ai di edhe mënyrën më të mirë për t'i plotësuar ato nevoja.
  - Perëndia nuk e krijoi shoqen e Adamit në të njëjtin moment apo në të njëjtën mënyrë që krijoi Adamin.
  - Perëndia e krijoi në kohën e duhur dhe në mënyrën e duhur për të plotësuar nevojat e Adamit për shoqëri.

### 2. Perëndia solli para Adamit tërë kafshët që t'u vinte emra - Zanafilla 2:19-20.

- Perëndia e kishte vendosur Adamin si zotërues mbi tërë kafshët, prandaj Ai i dha Adamit edhe përgjegjësinë për t'u vendosur emra. Perëndia i solli Adamit çdo krijesë që bëri dhe Adami u vuri të gjithave emra.

### 3. Nuk kishte shoqe të përshtatshme për Adamin midis kafshëve<sup>12</sup> - Zanafilla 2:20.

- Perëndia e krijoi njeriun shumë të ndryshëm nga kafshët.
  - Njeriu ishte bërë sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë, në mënyrë që ai të njihnte, të donte dhe t'i bindej Perëndisë.
  - Kafshët nuk mund të njihnin, të donin dhe t'i bindeshin Perëndisë ashtu si njeriu.
- Adami kishte nevojë për dikë me të cilën mund të fliste dhe të bënte të njëjtat gjëra që bënte ai.
  - Asnjë kafshë nuk mund të ishte një shoqe e përshtatshme për njeriun.
  - Ai kishte nevojë për dikë si vetja.
- Njeriu nuk mund të bënte asgjë për të siguruar një shoqe për vete.

<sup>12</sup> Përkthimi i Biblës në shqip: “Ndihmë që i leverdis”.

<sup>13</sup> Mendo: Meqë Perëndia e krijoi gjithçka të përsosur, ne thjesht mund të imagjinojmë se sa e veçantë ishte kjo grua! Perëndia e bëri Evën që të ishte ajo shoqja e përsosur për të cilën Adami kishte nevojë. Perëndia kishte urdhëruar Adamin dhe Evën të mbushnin tokën dhe ta sundonin. Adamit duhet t'i jetë dukur shumë i mirë bashkimi me Evën në martesë!



**Lexo:** Jakobi 1:17 na thotë që: *Çdo gjë e mirë që na jepet dhe çdo dhuratë e përsosur vjen prej së larti dhe zbret nga Ati i dritave.*

## Përsëritje

Vendosi këto pjesë të vargut në rendin e tyre të duhur:

- A. 4 Ajo do të quhet grua
- B. 2 "Kjo së fundi është kocka e kockave të mia
- C. 5 Sepse është nxjerrë nga burri".
- D. 1 Dhe njeriu tha:
- E. 3 Dhe mishi i mishit tim.

## Pyetje dhe përgjigje

1. Kush vendosi që Adami kishte nevojë për një shoqe? **Perëndia.**
2. Pse vendosi Perëndia që të bënte një shoqe për Adamin? **Ngaqë Perëndia e donte Adamin dhe nuk mendonte se ishte mirë për të që të ishte vetëm.**
3. A kishte të drejtë Perëndia që vendosi ta bënte këtë pa e pyetur Adamin? **Po, Perëndia krijoi Adamin.**
4. Si e bëri Perëndia gruan e parë? **Perëndia e vuri Adamin në gjumë. Ai nxori një prej brinjëve të Adamit.**
5. Kush i tha Adamit dhe Evës të martoheshin dhe të kishin fëmijë? **Perëndia, Krijuesi i tyre.**

- Vetëm Perëndia mund t'i bënte një shoqe Adamit.  
- Perëndia e donte njeriun dhe nuk donte që ai të ishte vetëm.

### 4. Perëndia krijoi Evën nga brinja e Adamit - Zanafilla 2:21-22.

- Vetëm Perëndia mund ta bënte këtë.  
- Perëndia di gjithçka.  
- Perëndia mund të bëjë gjithçka që dëshiron.

Mendoni:

Edhe pse tërë kafshët duhet t'i jenë dukur shumë interesante (dhe Adami i pa të gjitha, sepse u vuri emra), imagjinoni sa i lumtur do të ketë qenë Adami kur pa këtë grua të bukur, të cilën Perëndia e bëri për të! Ajo, ashtu si Adami, u krijua nga Perëndia, por Perëndia nuk e bëri nga pluhuri i tokës, ashtu siç kishte bërë Adamin. Perëndia e bëri nga një pjesë e trupit të Adamit, kockës së Adamit. Sa e çmuar dhe e afërt është ndier me Adamin! Dhe Perëndia i kishte dhënë mendje, emocione dhe vullnet, në mënyrë që të ishte në gjendje të komunikonte me Perëndinë dhe Adamin.

### 5. Martesa u caktua nga Perëndia - Zanafilla 2:23-24.

- Perëndia e bëri gruan nga burri në mënyrë që të martoheshin, të jetonin së bashku dhe të kishin fëmijë. "...Të jeni të frytshëm dhe shumëzohuni, mbushni tokën e nënshtrojeni..." (Zanafilla 1:28).  
- Ky ishte urdhri i Perëndisë ndaj Adamit.<sup>13</sup>
- Martesa ishte plani i përsosur i Perëndisë për Adamin dhe Evën.  
- Eva ishte shoqja e përsosur për Adamin, krejtësisht e përshtatshme për Adamin.  
- Gjithçka që bën dhe thotë Perëndia është e mirë, sepse Ai është i përsosur. Perëndia nuk mund të mendojë, thotë, apo bëjë diçka të keqe apo të ligë.  
- Martesa është e mirë, sepse ishte Perëndia Ai që ia dha martesën njeriut.  
- Fëmijët dhe familjet janë shumë të veçantë për Perëndinë; ishte ideja e Perëndisë që burri dhe gruaja të kishin fëmijë.

### 6. Adami dhe Eva ishin të pavetëdijshëm se ishin të zhveshur dhe nuk ishin fare në siklet - Zanafilla 2:25.

- Adami dhe Eva nuk ishin në siklet, sepse nuk kishin mendime të këqija.
- Gjithçka që dinin ishte e mirë dhe ata nuk kishin asgjë për t'u turpëruar.

### 7. Jeta ishte e përsosur për Adamin dhe Evën.

- Perëndia u kishte dhënë atyre gjithçka për të cilën kishin nevojë. Gjithçka rreth tyre ishte shumë e bukur.  
- Ata ishin në gjendje të komunikonin me Perëndinë dhe me njëri-tjetrin.  
- Perëndia i bëri sundues mbi tërë krijimin e Tij.  
- Perëndia ishte atje me ta për t'i drejtuar në çdo vendim.  
- Puna e tyre nuk ishte e vështirë. Ata ishin përsosmërisht të shëndetshëm.
- Fjala e Perëndisë nuk ka ndryshuar.  
- Mijëra vjet kanë kaluar që kur Adami dhe Eva u bënë burrë e grua, por Perëndia nuk e ka ndryshuar asnjëherë atë që ka shkruar në fillim për martesën.

# Mësimi 10 Pyetje, pyetje, pyetje!

## Qëllimi

Ky mësim është përsëritje e asaj që kemi mësuar në nëntë mësimet e para rreth Biblës, Perëndisë, engjëjve, Satanit dhe njeriut. Kjo përsëritje është përgatitje e rëndësishme për Zanafillën 3, historinë e rënies së njeriut, e cila trajtohet në mësimet në vijim. Mund të bësh pyetje të tjera ose t'i përshtatësh pyetjet sipas moshës së fëmijëve të klubit tënd. Të lutem referoju për ndihmë faqeve 33-34, për të zhvilluar mësimet dhe lojërat e përsëritjes.

## Hyrje

Shpjegoju fëmijëve të klubit: Ashtu siç tha xhaxhi Piteri në histori, para se të mësojmë më tepër rreth historisë së Adamit dhe Evës, do të përsërisim atë që kemi mësuar tashmë. Përsëritja do të përfshijë Biblën, Perëndinë, engjëjt, Satanin, burrin dhe gruan e parë që krijoi Perëndia.

## Figurat

- Grafiku 1: Mësimi për Perëndinë Përdore këtë për të përsëritur atributet e Perëndisë.
- Grafiku 2: Perëndia është më i madh se të gjithë

## Historia

Karola dhe Xhoni panë xhaxhi Piterin të ulur në oborrin e tij dhe iu afruan për të folur me të.

“Xhaxhi Piter, a të thashë se sa e gëzuar jam që more shtëpi afër nesh?” - tha Karola.

“Po, më the Karola, dhe unë jam i gëzuar që u shpërngula këtu” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Më pëlqen shumë që flas me ty dhe Xhonin për Biblën”.

“Kjo është një prej arsyeve se përse jam kaq e gëzuar që erdhe kaq afër nesh, xhaxhi Piter” - tha Karola. “Pasi na flet për një histori në Bibël, unë me Xhonin kthehem në shtëpi dhe mendojmë për pyetjet e shumta që kemi për atë që thotë Bibla, por meqë ti jeton afër nesh, ne thjesht mund të vijmë në çdo kohë dhe të t'i bëjmë ty pyetjet”.

“Jam i gëzuar që mund t’ju ndihmoj ty dhe Xhonin për të gjetur përgjigjet për pyetjet tuaja” - tha xhaxhi Piteri.

“Kur të kurseni para të mjaftueshme për të blerë Biblën tuaj, do të jeni në gjendje t’i gjeni vetë përgjigjet e disa prej pyetjeve”.

“Ne po pyesnim veten,” - tha Xhoni, - “se ku ndodhet ky kopsht i bukur i Edenit dhe kush po kujdeset tani për të?”.

“Këto janë pyetje me vend, Xhon,” - tha xhaxhi Piteri, - “por së pari dua t’ju pyes ty dhe Karolën për disa nga historitë e Biblës për të cilat kemi folur. Është e rëndësishme që ju të kuptoni gjërat për të cilat kemi folur deri tani, para se t’ju tregoj se çfarë i ndodhi kopshtit të Edenit”.

“E di” - tha Xhoni i gëzuar. “Le ta bëjmë si lojë! Ti bëj pyetje, xhaxhi Piter, dhe do të shohim se kush do t’u përgjigjet më shumë pyetjeve, Karola apo unë”.

“Kjo është ide e shkëlqyer, Xhon” - tha Karola. “Mendoj se do të jetë qejf të shohim se sa nga gjërat që na ka mësuar xhaxhi Piteri nga Bibla kujtojmë”.

“Në rregull” - pranoi xhaxhi Piteri. “Bëhuni gati për shumë pyetje. Ngrini dorën nëse dini përgjigjen. Ai që e ngre dorën i pari ka mundësinë të përgjigjet i pari”.



## Le të shohim në Bibël



Le të shohim se sa vargje përmendësh kanë mësuar fëmijët dhe sa janë në gjendje t'i thonë. Bëj një pyetje për secilin nga nëntë vargjet që keni përdorur në nëntë mësimet e fundit. Shembull: Kush mund të thotë 2 Timoteut 3:16?

2 Timoteut 3:16; Psalmi 90:2; Gjoni 1:3; 1 Kronikave 29:11; Hebrejve 11:3; Zanafilla 1:1; Zanafilla 1:27; Psalmi 24:1; Zanafilla 2:23.

## Le të mendojmë

Ndërsa ke mësuar nga Zanafilla 1 dhe 2, ke paraqitur Perëndinë, Satanin dhe njeriun, tre karakteret kryesore në tërë tregimet historike të regjistruara në Shkrim. Tani je gati të mësosh Zanafillën 3, një prej kapitujve më të rëndësishëm në tërë Biblën. Origjina e mëkatit, vdekjes së njeriut dhe mjerimeve të tërë tokës, së bashku me premtimin e parë për një Shpëtimtar zbulohen te Zanafilla 3. Megjithatë, të vërtetat themelore historike dhe doktrinale të Zanafillës 3 nuk mund të kuptohen pa një njohje bazë të karakterit të Perëndisë, Satanit dhe njeriut. Për të qenë të sigurt që fëmijët e klubit tënd e kuptojnë me të vërtetë, mësimi 10 është një përsëritje e pikave kryesore që kemi mësuar tashmë rreth këtyre tre personave. Te mësimi 10 përfshihen edhe disa pyetje që theksojnë autoritetin e Fjalës së Perëndisë, Biblës.

**Bibla:** Perëndia na dha Biblën, sepse Ai dëshiron që të komunikojë me ne. Ai dëshiron që ta njohim Atë dhe që të dimë se si të jetojmë.

1. Kush është autori i Biblës? **Perëndia**
2. Kë përdori Perëndia për të shkruar Biblën? **Ai përdori mbi 40 vetë, të gjithë judenj përveç njërit.**
3. Për kë është shkruar Bibla? **Për çdo njeri në tërë botën.**
4. A ka ndryshuar Bibla gjatë viteve që kur është shkruar? **Jo, Bibla nuk ka ndryshuar dhe nuk do të ndryshojë.**
5. Për sa vjet është shkruar Fjala e Perëndisë? **1500 vjet.**

**Perëndia:** Perëndia është sovran. Perëndia është më i madh se të gjithë dhe më i rëndësishëm se të gjithë; Ai është autoriteti më i lartë.

1. A ka Perëndia një trup fizik? **Jo, Ai është Frymë dhe nuk ka mish dhe kocka si ne.**
2. A ka pasur ndonjë kohë kur Perëndia nuk ka ekzistuar? **Jo.**
3. A ndryshon Perëndia ose a mund të vdesë? **Jo, Perëndia është gjithmonë i njëjti. Ai nuk mund të vdesë kurrë, sepse është i përjetshëm.**
4. Ne kemi nevojë për ushqim, ujë, ajër, tokën për të ecur dhe diellin për të na ngrohur, por për çfarë ka nevojë Perëndia? **Perëndia nuk ka nevojë për diçka.**
5. Ku është Perëndia? **Perëndia është kudo në çdo kohë.**
6. Sa perëndi ka? **Ka vetëm një Perëndi.**
7. Kush janë tre personat e Trinisë? **Perëndia Atë, Perëndia Bir dhe Perëndia Frymë e Shenjtë.**
8. Çfarë përdori Perëndia për të bërë qiejt dhe tokën? **Perëndia nuk përdori asgjë. Ai e bëri gjithçka nga hiçi.**
9. Si krijoi Perëndia gjithçka? **Duke folur dhe i duke urdhëruar gjërat që të shfaqen. Nuk ka asgjë që Ai nuk mund ta bëjë. Ai di gjithçka dhe ka fuqi të bëjë çdo gjë.**

10. Çfarë tha Perëndia për gjithçka që kishte bërë? **Ai tha që gjithçka ishte e mirë.**
11. Pse e bëri Perëndia gjithçka të përsosur? **Sepse Ai është i përsosur.**
12. Pse përgatiti Perëndia kaq larmi dhe bukuri dhe bëri aq shumë gjëra të mira në tokë për njeriun? **Sepse Perëndia është i dashur dhe i mirë.**
13. Pse Perëndia është me të drejtë zotëruesi i çdo gjëje? **Sepse Ai krijoi çdo gjë dhe i dha jetë çdo gjëje.**
14. Pse Perëndia ka të drejtën për të kërkuar bindje nga ne? **Sepse Ai është Krijuesi dhe zotëruesi ynë.**

#### **Engjëjt dhe Satani:**

1. Nga erdhën të gjitha frymërat? **Ato u krijuan nga Perëndia.**
2. A i krijoi Perëndia frymërat me trupa prej mishi dhe kockash? **Jo.**
3. A i krijoi Perëndia tërë frymërat të mira apo i krijoi disa të mira e disa të këqija? **Perëndia i krijoi të gjitha të mira.**
4. Pse i krijoi Perëndia frymërat? **Për të qenë shërbëtorët e Tij.**
5. Ku jetonin ata në fillim kur Perëndia i krijoi? **Me Perëndinë në qiell.**
6. A është secila prej frymërave kudo në të njëjtën kohë si Perëndia? **Jo, ka frymëra në mbarë botën, por ato nuk mund të jenë kudo në të njëjtën kohë si Perëndia.**
7. Kush ishte engjëlli më i zgjuar dhe më i bukur i krijuar nga Perëndia? **Luciferi.**
8. Çfarë pozicioni i dha Perëndia Luciferit? **Drejtimin mbi tërë engjëjt e tjerë.**
9. Kujt duhet t'i shërbente dhe t'i bindej Luciferi? **Perëndisë, Krijuesit të tij.**
10. Çfarë planifikoi të bënte Luciferi? **Ai planifikoi të ishte si Perëndia dhe të zinte pozicionin e Perëndisë.**
11. Kush tjetër e ndoqi Luciferin në rebelimin e tij kundër Perëndisë? **Shumë nga engjëjt.**
12. Çfarë bëri Perëndia për rebelimin e tyre? **Perëndia e hoqi Luciferin dhe engjëjt që u bashkuan me të në rebelim nga pozicioni i tyre si shërbëtorë të Perëndisë.**
13. Cili është emri i Luciferit tani dhe çfarë do të thotë ai emër? **Satani, që do të thotë armik, kundërshtar dhe paditës.**
14. Çfarë vendi ndëshkimi përgatiti Perëndia për Satanin dhe demonët e tij? **Liqenin e zjarrit, si vendin e tyre të ardhshëm të ndëshkimit.**
15. Kundër kujt është Satani? **Kundër Perëndisë dhe gjithçkaje që do Ai.**

**Njeriu:** Perëndia nuk i krijoi njësoj njeriun dhe kafshët. Kishte një ndryshim të madh ndërmjet tyre! Perëndia e bëri njeriun sipas shëmbëlltyrës së Tij. Kjo do të thotë që Perëndia e bëri njeriun si vetja: me mendje në mënyrë që njeriu të mund të njihte Perëndinë, me emocione në mënyrë që njeriu të donte Perëndinë dhe me vullnet në mënyrë që njeriu të mund të zgjidhte t'i bindej Perëndisë.

1. A ishte njeriu i mirë apo i keq kur Perëndia e krijoi? **Njeriu ishte i mirë.**
2. Pasi u krijua njeriu i parë, Adami, mbi kë i dha kontroll Perëndia? **Mbi tokën dhe gjithçka që kishte në të.**
3. Ku e vendosi Perëndia Adamin pasi e krijoi? **Në një kopsht të bukur, të quajtur Eden, të cilin vetë Perëndia e përgatiti për Adamin.**
4. Cilat ishin dy pemët shumë të rëndësishme që Perëndia i vendosi në kopshtin e Edenit? **Pemën e jetës dhe pemën e njohjes të së mirës e të së keqes.**

=> Grafiku 1: Mësimi për Perëndinë

=> Grafiku 2: Perëndia është më i madh se të gjithë

Përko referencën me vargun e saktë.

- |                      |                        |
|----------------------|------------------------|
| 1. 2 Timoteut 3:16a; | 2. Psalmi 90:2;        |
| 3. Gjoni 1:3;        | 4. 1 Kronikave 29:11a; |
| 5. Hebrejve 11:3;    | 6. Zanafilla 1:1;      |
| 7. Zanafilla 1:27;   | 8. Psalmi 24:1;        |
| 9. Zanafilla 2:23    |                        |

- 9 Dhe njeriu tha: “Kjo së fundi është kocka e kockave të mia dhe mishi i mishit tim. Ajo do të quhet grua sepse është nxjerrë nga burri”.
- 6 Në fillim Perëndia krijoi qiejt dhe tokën.
- 7 Kështu Perëndia krijoi njeriun sipas shëmbëlltyrës së vet, sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë; Ai krijoi mashkullin e femrën.
- 2 Para se të kishin lindur malet dhe para se ti të kishe formuar tokën dhe botën, madje nga mot dhe përjetë ti je Perëndia.
- 3 Të gjitha gjërat u bënë me anë të tij (fjala), dhe pa atë nuk u bë asnjë nga ato që u bënë.
- 8 Zotit i përket toka dhe të gjitha gjërat që janë mbi të, bota dhe banorët e saj.
- 4 Jotja, o Zot, është madhështia, fuqia, lavdia, shkëlqimi, madhëria.
- 1 I gjithë Shkrimi është i frymëzuar nga Perëndia.
- 5 Me anë të besimit ne kuptojmë se bota është ndërtuar me fjalën e Perëndisë, sa që ato që shihen nuk u bënë prej gjërave që shihen.

5. Për cilën frutë i tha Perëndia Adamit se do të vdiste nëse do ta hante? **Nga pema e njohjes të së mirës e të së keqes.**

6. Çfarë nënkuptonte Perëndia kur tha që njeriu do të vdiste? **Njeriu do të ndahej menjëherë nga Perëndia: nuk do të ishin më miq. Ai nuk do të jetonte përgjithmonë: një ditë ai do të vdiste dhe do të shkonte përfundimisht në të njëjtin ndëshkim të tmerrshëm, në liqenin e zjarrit, të cilin Perëndia e përgatiti për Satanin dhe ndjekësit e tij.**

7. Kë krijoi Perëndia për Adamin pasi e vuri atë në kopshtin e Edenit? **Perëndia krijoi Evën.**

8. Pse e krijoi Perëndia Evën? **Perëndia e donte Adamin dhe nuk donte që Ai të ishte vetëm. Meqë asnjë kafshë nuk do të ishte një shoqëri e mirë për të, Perëndia bëri dikë të veçantë për Adamin. Gjithashtu Perëndia donte që njeriu të kishte fëmijë.**

## Pyetje për diskutim

1. Shumë njerëz besojnë se gjithçka erdhi në ekzistencë rastësisht. Çfarë thotë Bibla? **Bibla thotë që Perëndia krijoi gjithçka dhe që Ai e bëri në një mënyrë shumë të organizuar. Rastësia nuk është pjesë e krijimit.**

2. Shumë njerëz besojnë se njeriu evoluoi nga gjëra të tjera. Çfarë na thotë Bibla te Zanafilla 1 dhe 2? **Bibla na thotë se njeriu u krijua i veçantë dhe ndryshe nga pjesa tjetër e krijimit: njeriu u krijua sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë. Perëndia hukati te njeriu frymën e jetës; Eva u krijua nga brinja e Adamit. Nuk përmendet “asnjë proces evolucionar” në Bibël.**

3. Jep disa prova nga gjërat që mund të shohësh përreth teje dhe nga ato që di rreth Biblës, të cilat tregojnë që jeta u krijua dhe nuk evoluoi. **Kafshët, bimët dhe njeriu kanë sisteme të ndërlikuara (gjëra të gjalla që janë të vështira për t'u kuptuar dhe për t'u shpjeguar) që nuk mund të kenë ndodhur rastësisht. Macet kanë kotele; qentë qenushë: çdo lloj kafshe ka foshnja sipas llojit të vet. Bibla është një histori e vërtetë, jo një libër teorish (hamendjesh). Bibla thotë që Perëndia krijoi gjithçka. Bibla nuk ka ndryshuar përgjatë shekujve; teoritë e njeriut po ndryshojnë vazhdimisht.**

4. Perëndia na ka treguar shumë rreth vetes me anë të asaj që ka bërë: çdo ditë shohim krijimin e Tij dhe duhet të dimë që dikush më i madh se ne i ka bërë këto gjëra. Ke mësuar edhe shumë gjëra rreth karakterit të Perëndisë përmes asaj që kemi studiuar deri tani në Fjalën e Tij. Çfarë kujton për karakterin e Perëndisë? **Përgjigjja nuk duhet të jetë e drejtë apo e gabuar. Thjesht po dëgjon atë që kujtojnë ata.**

5. A ishte Adami i vetmi që mund të komunikonte me Perëndinë? **Jo, edhe Eva u krijua sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë dhe iu dha mendje, emocione dhe vullnet, në mënyrë që ajo të mund të komunikonte me Perëndinë dhe Adamin.**

6. Duke marrë në konsideratë atë që kemi mësuar rreth Perëndisë dhe njeriut, çfarë mendon për këto pohime: “Shiko punën tënde!”, “Nuk kam pse dëgjoj njeri!” dhe “Mund të bëj ç'të dua me jetën time, sepse më përket mua”.

# Mësimi 11 Adami dhe Eva nuk i binden Perëndisë

## Qëllimi

Në mësimin e sotëm do të tregosh urrejtjen e Satanit për Perëndinë dhe për njeriun, dhe karakterin e Satanit si gënjeshtar, mashtrues, paditës dhe vrasës. Do të tregosh edhe zgjedhjen e njeriut për të mos iu bindur me dashje Perëndisë dhe rezultat-eve të menjëhershme të atij mëkatit.

Gjithashtu duhet që fëmijët e klubit tënd:


- Të shikojnë që Satani është armiku i Perëndisë dhe armiku i fëmijës.
- Të njohin disa nga planet e Satanit.
- Të kuptojnë nevojën për të njohur dhe për t'i besuar Fjalës së Perëndisë.
- Të shikojnë rezultatet e tmerrshme të mëkatit.

## Hyrje


Shpjegoju fëmijëve që disa njerëz mendojnë se Satani është thjesht një histori apo mit, sepse ata nuk e kanë lexuar apo nuk e kanë studiuar Biblën. Por është e rëndësishme që fëmijët të kujtojnë që Satani është armiku i Perëndisë dhe armiku i tyre. Në mësimin e sotëm do të zbulosh se për çfarë po fliste xhaxhi Piteri kur tha që Adami zgjodhi të mos i bindej Perëndisë dhe se çfarë ndodhi për shkak të mosbindjes së tij.

## Figurat

- Figura 4: Rënia e njeriut



- Figura 5: Mbulesat prej gjetesh fiku



- Një degë peme me gjethe jeshile
- Grafiku 8: Perëndia dhe njeriu
- Grafiku 9: Njeriu i ndarë nga Perëndia
- Grafiku 10: Perëndia dhe njeriu - Pamja e jashtme

## Historia

“Nuk arrij ta besoj atë që dëgjova” - thirri Xhoni.

“Çfarë Xhon?” - pyeti Karola.

“Një mikun tim e arrestuan sot në qytet” - u përgjigj Xhoni. “Ai gjithmonë bën gjëra të çmendura dhe vjedh ndonjëherë. Këtë herë e kapën duke vjedhur te shtëpia e një polici. A mund ta besosh këtë?”.

“A do të shkojë në burg?” - pyeti Karola.

“Nuk e di,” - u përgjigj Xhoni, “por ai e dinte se ajo që po bënte ishte e gabuar dhe se mund të futej në telashe të mëdha po të vidhte. Ai tha se e shtyu djalli të bënte një gjë të tillë”.

“Kjo është qesharake” - tha Karola. “Kush do të donte të ndiqte djallin? Unë me siguri që jo!”.

“As unë” - pranoi Xhoni.

Xhaxhi Piteri, i cili po dëgjonte Xhonin dhe Karolën, tha: “A do të çuditeshit po t’ju thoja se shumica e njerëzve që e ndjekin djallin nuk planifikojnë ta ndjekin? Satani është shumë i zgjuar. Por ai shpesh e ndryshon veten, në mënyrë që njerëzit të mos e kuptojnë që është ai”.

“Por, a nuk është gjithçka rreth djallit e keqe?” - pyeti Karola.

“Po,” - u përgjigj xhaxhai, “por ai shpesh bën që të duket shumë i mirë dhe njerëzit mashtrohen”.

“Nuk besoj se djalli do të më mashtrohte mua!” - pohoi Xhoni me krenari.

“Bën mirë të mos flasësh kaq shpejt, Xhon” - paralajmëroi xhaxhi Piteri. “Emri Satan, një emër tjetër i djallit, do të thotë mashtrues, dinak. Kujto Adamin dhe Evën, burrin dhe gruan e përsosur që krijoi Perëndia? Satani shkoi edhe tek ata”.

“Do të thuash që shkoi në kopsht?” - pyeti Karola.

“Po, shkoi” - u përgjigj xhaxhi Piteri i trishtuar. “Te Zanafilla 3 na tregohet gjithçka për këtë. Xhon, miku yt tha se djalli e ‘shtyu’ të vidhte, por njerëzit jo vetëm që mashtrohen për të mos iu bindur Perëndisë, por ata gjithashtu zgjedhin që të mos i binden Atij”.

“A u mashtrua Adami apo **zgjodhi që të mos bindej?**” - pyeti Xhoni.

“Adami nuk u mashtrua,” - u përgjigj xhaxhi Piteri, - “ai zgjodhi të mos bindej. Bibla thotë se Eva u mashtrua, por jo Adami. Ai e dinte se çfarë po bënte dhe se do të futej edhe në telashe! Le ta lexojmë tërë historinë te Zanafilla 3”.

Shuma: E tërë

Të drejta: Tërësisht të mira

Dekretet: Ligjet

Qëndrojnë përjetë: zgjasin përgjithmonë

## Le të shohim në Bibël



Psalmi 119:160 - “Shuma e fjalës sate është e vërteta; dhe të gjitha dekretet e tua të drejta qëndrojnë përjetë”.

Ndërsa jep mësimin e sotëm, përdore këtë varg për t’u treguar fëmijëve që Fjala e Perëndisë është e vërtetë.

Perëndia nuk ndryshon mendjen rreth gjykimeve që bën.


## Le të mendojmë

- Çfarë bëri shoku i Xhonit?  
a. U largua; b. **Vodhi**; c. Kopjoi.
- A tha shoku i Xhonit: “Djali më shtyu që ta bëj”? **Po** / Jo.
- Si e ka ndryshe emrin Djalli?  
A. Adam; b. Eden; c. **Satan**.
- A do të thotë “mashtues” emri i Satanit? **Po** / Jo.
- A zgjedhin disa njerëz të ndjekin Satanin? **Po** / Jo.

## Mësime nga Fjala e Perëndisë

Sot do të studiosh disa nga ndodhitë më të rëndësishme në histori. **Kjo ndodhi e vetme ndikoi të gjithë ata që kanë jetuar!** (Sigurohu që të trajtosh çdo të vërtetë në mënyrë të plotë.)

=> Grafiku 8: Perëndia dhe njeriu



<sup>14</sup> Ne e dimë që Satani ishte i vetëdijshëm për këtë paralajmërim për shkak se ia përsëriti në mënyrë të rreme Evës. (Zanafilla 3:1)

### 1. Jeta në kopshtin e Edenit.

- Jeta në kopshtin e Edenit ishte e kënaqshme për Adamin dhe Evën; gjithçka ishte e përsosur. Ata kishin gjithçka që u nevojitej.
- Ata kishin miqësi dhe përbashkësi të përsosur me Perëndinë dhe me njëri-tjetrin.
  - Perëndia ishte miku i tyre; Ai i donte dhe ata ishin shumë të lumtur.
- Po Satani, armiku i madh i Perëndisë?
  - Satani e dinte paralajmërimin e Perëndisë ndaj Adamit rreth pemës së njohjes të së mirës e të së keqes.<sup>14</sup>
  - Ngaqë Satani e urren Perëndinë, ai donte të shkatërronte burrin dhe gruan që kishte krijuar Perëndia.
  - Prandaj Satani planifikoi të mashtonte Evën. (Të mashtosh do të thotë të gënjeshtër).

### 2. Satani përdori gjarprin për t’u maskuar dhe për të mashtuar Evën - Zanafilla 3:1.

- Ky nuk ishte thjesht një gjarpër që po fliste me Evën. Vetë Satani ishte futur te gjarpri.
  - Satani u maskua si gjarpër, në mënyrë që të mashtonte Evën.
- Satani është mashtues. Ai nuk lejoi që Eva të mësonte që ishte ai që po i fliste përmes gjarprit.
  - Sa më tepër mëson nga Fjala e Perëndisë, aq më tepër kupton se sa mashtues dhe se sa i lig është Satani. Ai e di që gënjen. Emri i tij do të thotë “mashtues” apo “paditës”. **Ai dëshiron që të gjithë të shkojnë në vendin e ndëshkimit, në liqenin e zjarrit.**
- Satani mund të shndërrohet në gjithçka, edhe në një engjell drite.
  - Këtë herë Satani zgjodhi të shkonte tek Eva duke iu afruar në formën e një gjarpri. Deri në atë kohë kafshët nuk ishin të dëmshme ndaj Adamit dhe Evës apo ndaj njëra-tjetres, prandaj Eva nuk kishte frikë.



**Lexo:** Gjoni 8:44 thotë që Satani është gënjeshtar dhe vrasës.



**Lexo:** 2 Korintasve 11:14.

<sup>15</sup> Kjo pjesë nuk ka si qëllim t'i frikësojë fëmijët, por që t'i ndihmojë ata të njohin armikun. Shumica e fëmijëve do të vlerësojnë t'i dinë karakteristikat e Satanit. Ata sulmohen përditë nga planet e tij dhe është e dobishme për ta që të dinë se nga vijnë këto gjëra të këqija. Këtë herë nuk po u mëson atyre se si të sillen; ti po u jep atyre mësimin bazë rreth karakteristikave të Satanit dhe për mënyrat se si punon ai për të mashtruar njerëzit. Fëmijët duhet të dinë që ky mashtrues i lashtë është akoma i njëjtë edhe sot.

### 3. Satani i mashtron ende njerëzit<sup>15</sup>.

- Satani përpiket akoma t'i mashtrojë dhe t'i shkatërrojë njerëzit. Ai nuk përdor gjarprin siç bëri me Evën, por përdor çfarëdo lloj gjëje të pranueshme nga njerëzit.
- Shumë herë Satani i mashtron njerëzit duke thënë gënjeshtra në mendjet e tyre.

Shpjego:

Në fakt Satani vetë mund të jetë vetëm në një vend në një kohë të caktuar. Por mund të kujtosh që shumë engjëj e ndoqën Satanin në rebelimin e tij kundër Perëndisë. Perëndia hoqi Satanin dhe ndjekësit e tij nga pozicioni i tyre i shërbimit ndaj Perëndisë në qiell. Këta engjëj rebelë, të quajtur demonë, enden pa u dukur në tokë dhe punojnë me Satanin, duke futur gënjeshtra në mendjet e njerëzve kundër Perëndisë dhe njerëzve.

- Satani nuk do që dikush të njohë apo të besojë te Perëndia.
  - Ai mund të të sjellë në mendje një pyetje si: "Pse duhet t'i besoj Biblës?"
  - Ndonjëherë Satani përdor njerëzit e tjerë me anë të të cilëve na thotë gënjeshtra.
- Satani na gënjën dhe përpiket të na mashtrojë, ashtu siç gënjeu dhe mashtroi Evën.
  - Ai përpiket të na bëjë të ndihemi sikur do të humbasim diçka të mirë nëse nuk e ndjekim atë. Ai na thotë që ai di diçka më të mirë se ajo që na kanë thënë Perëndia, prindërit tanë apo mësuesit e klubit Awana.
  - Kur i besojmë gënjeshttrat e Satanit, e zbulojmë shumë vonë se ajo gjë që dukej shumë e mirë ishte me të vërtetë diçka shumë e keqe.
- Satani dëshiron të na shkatërrojë.
  - Cilat janë disa nga gënjeshttrat e Satanit?
    - Gjithçka që të thotë të rebelohesh kundër Perëndisë, prindërve, mësuesve apo autoriteteve të tjera, që Perëndia ka vendosur mbi ty.
    - Gjithçka që thotë se mund të parashikojë të ardhmen, si horoskopi dhe falli.
    - Gjithçka që e bën të keqen të duket e mirë, tërheqëse apo e kënaqshme.
    - Lojërat, muzika apo diçka tjetër që lavdëron të keqen apo të thotë të gënjeshtër, të vjedhësh, të thuash fjalë të pista apo të bësh diçka të keqe.
    - Gjithçka që mohon Perëndinë apo të vërtetën e Biblës.
    - Tërë këto lloj gjërash janë me të vërtetë nga Satani.

### 4. Satani tundoj dhe mashtroi Evën - Zanafilla 3:1-3.

- Pse Satani ia bëri Evës këtë pyetje?
  - Satani e dinte tashmë përgjigjen e saktë. Atij nuk i interesonte ajo që kishte thënë Perëndia. Ai po e vinte në provë Evën, në mënyrë që ta mashtronte.
  - Satani po përpiquej që ajo të Fjalën e Perëndisë: kjo është një ndër hilet e parapëlqyera të Satanit.
- Satani e kishte pështjelluar Evën tashmë. Përgjigjja e saj nuk ishte ajo që kishte thënë Perëndia.
  - Perëndia nuk kishte thënë që ata të mos e **preknin** frutën. Ai kishte thënë të mos e **hanin**.
  - Urdhri i Perëndisë ishte si për Adamin, ashtu edhe për Evën. Duket se Adami i kishte thënë Evës atë që kishte thënë Perëndia. Çfarëdo lloj gjëje që Perëndia i kishte thënë Adamit përfshinte edhe Evën.
- Satani po e quante Perëndinë gënjeshtar. Vetë Satani është gënjeshtari<sup>16</sup> - Zanafilla 3:4-5.
- Çfarë fshihej në të vërtetë pas gënjeshtres së Satanit?
  - Satani ishte rebeluar kundër autoritetit të Perëndisë. Ai mëkatoi kur donte të zinte vendin e Perëndisë. Ai nuk donte t'i bindej më Perëndisë.
  - Tani Satani po i sugjeronte Evës që ajo duhet të rebelohet kundër Perëndisë.
  - Satani po i sugjeronte Evës që ajo duhet të hante frutën, në mënyrë që të ishte si Perëndia, për të njohur se çfarë ishte e mirë dhe çfarë ishte e keqe.
  - Satani donte që Eva të besonte se nuk kishte nevojë që Perëndia t'i thoshte asaj se çfarë ishte e drejtë dhe çfarë e gabuar.

<sup>16</sup> Mendo: Perëndia kishte thënë: Nëse ha frutin nga pema e njohjes të së mirës e të së keqes, do të vdesësh po atë ditë. Perëndia nënkuptonte që Adami dhe Eva do të ndaheshin nga Perëndia, nga Ai që u dha atyre jetën. Perëndia tha: "Ti do të vdesësh". Satani tha: "Ti nuk do të vdesësh". Satani po gëniente.



# Mësimi 11

## (vazhdim)

# Adami dhe Eva nuk i binden Perëndisë

=> Figura 4: Rënia e njeriut

<sup>17</sup> SHFAQ DEGËN:

Shikojeni këtë degë. E këputa nga pema. Gjethet e saj nuk u bënë menjëherë ngjyrë kafe kur e këputa nga pema. Edhe tani ka disa gjethë jeshile. Por po thahet, sepse nuk është më e lidhur me pemën nga e cila merrte jetë. E njëjta gjë ndodhi me Adamin dhe Evën. Trupat e tyre nuk ranë të vdekur ditën që nuk iu bindën Perëndisë. Por në sytë e Perëndisë ata kishin vdekur. Edhe trupat e tyre do të vdisnin një ditë.



**Lexo:** Isaia 59:2: *Por paudhësitë tuaja kanë shkaktuar një ndarje midis jush dhe Perëndisë tuaj, dhe mëkatet tuaja kanë bërë të fshihet fytyra e tij prej jush, që të mos ju dëgjojë më.*  
Shënim: Pjesa me të zeza në këtë varg është pjesë e asaj për të cilën po flet.

=> Grafiku 9: Njeriu i ndarë nga Perëndia. Shpjego se ky është një grafik që tregon se si mëkati e ndan njeriun nga Perëndia.


- Ja e vërteta:
  - Perëndia nuk i bëri njerëzit që të jetonin sipas ideve dhe mendimeve të tyre. Perëndia na bëri që të drejtohem nga Fjala e Tij.

### 5. Eva hëngri dhe ia dha frutën edhe Adamit - Zanafilla 3:6.

- Satani mashtroi Evën.
  - Eva besoi që Satani po thoshte të vërtetën.
  - Ajo besoi se do të ishte e mençur si Perëndia.
- Edhe pse Adami e dinte që Perëndia kishte thënë të mos hante, ai nuk iu bind me dashje urdhrit të Perëndisë.
  - Adami iu largua varësisë ndaj Perëndisë. Ai donte të ishte i pavarur nga Perëndia.
  - Adami donte të vendoste vetë se çfarë ishte e mirë dhe çfarë e keqe. Ai nuk donte që Perëndia të kishte më autoritet mbi të.
- A e kishte Perëndia të drejtën të kishte autoritet mbi Adamin?
  - Po, Perëndia është krijuesi i tij. Gjithçka që kishte Adami ishte nga Perëndia. A ka të drejtë Perëndia të na thotë atë që duhet të bëjmë?
  - Po, gjithçka që kemi vjen nga Perëndia; Ai na dha jetën.

### 6. Mëkati i Adamit dhe Evës i ndau ata nga Perëndia - Zanafilla 3:7-8.

- Çfarë tha Perëndia se do t'u ndodhte nëse hanin nga pema e njohjes të së mirës e të së keqes? (Zanafilla 2:17).
  - Çfarë nënkuptonte Perëndia me "vdekje"?<sup>17</sup>
  - Ata nuk ranë menjëherë të vdekur kur hëngrën frutën.
  - Ata ecnin akoma vërdallë.
  - Ata bënë për vete mbulesa prej gjethesh.
  - A do të thotë kjo që Fjala e Perëndisë nuk u realizua? A kishte të drejtë Satani në fund të fundit?
  - Jo! Ata u ndanë menjëherë nga Perëndia kur hëngrën frutën.
  - Perëndia bën atë që thotë; Ai nuk ndryshon kurrë.
  - Ai nuk i harron kërcënimet e Tij për të ndëshkuar mosbindjen ndaj urdhrave të Tij.
- Pse i ndau mëkati i tyre nga Perëndia?
  - Meqë Perëndia është i shenjtë dhe i drejtë, Ai nuk mund të vazhdojë miqësinë me ata që nuk i binden urdhrave të Tij.
  - Perëndia urren gjithçka që është e gabuar dhe ndëshkon çdo mosbindje ndaj urdhrave të Tij me anë të vdekjes. Romakëve 3:23 thotë: "...paga e mëkatisë është vdekja...".
  - Meqë Adami dhe Eva nuk iu bindën Perëndisë, ata prishën miqësinë e tyre me Perëndinë. Marrëdhënia e tyre me Perëndinë mori fund.



- Ata i dolën në krah armikut të madh të Perëndisë, Satanit dhe, edhe ata gjithashtu, ishin armiq të Perëndisë.

### 7. Shenjat e ndarjes nga Perëndia.

- Këto ishin shenjat që Adami dhe Eva ishin tani të ndarë nga Perëndia.
  - Së pari, qëndrimi ndaj trupave të tyre ndryshoi menjëherë. Para se të rebelonin ndaj Perëndisë, ata ishin të zhveshur, por nuk viheshin në siklet. Tani ishin të ndarë nga Perëndia dhe nuk ishin në një mendje me Perëndinë.
  - Mendjet e tyre u bënë të liga dhe qëndrimet e tyre ndaj trupave të tyre ndryshuan.
  - Ata u vunë në siklet për shkak të trupave të tyre të zhveshur.
  - Së dyti, Adami dhe Eva u përpoqën të siguronin për nevojat e tyre. Para se të ndaheshin nga Perëndia, ata i drejttoheshin Perëndisë që të siguronin gjithçka që kishin nevojë. Por tani ata u përpoqën të bënin gjëra për vete.

=> Figura 5: Mbulesat prej gjethesh fiku

=> Grafiku 10: Perëndia dhe njeriu - Pamja e jashtme



**Lexo:** 1 Samuelit 16:7b thotë:  
Zoti nuk shikon si shikon njeriu,  
njeriu shikon pamjen, kurse Zoti  
shikon zemrën.

<sup>18</sup> Mendoni: A keni miq të cilët keni qejf t'i vizitoni? Perëndia e donte Adamin dhe Evën dhe kështu Ai shkonte në mbrëmje për të folur me ta. Para se të ndaheshin nga Perëndia, ata e donin Atë dhe donin të flisnin me Të. Por kur Perëndia erdhi pasi nuk i ishin bindur Atij, Adami dhe Eva u fshehën. Qëndrimi i tyre ndaj Perëndisë kishte ndryshuar. Për shkak të mosbindjes së tyre ndaj Perëndisë, ata nuk ishin më miqtë e Tij. Kur ju nuk u bindeni me dashje prindërve tuaj, a dëshironi të jeni afër tyre? Nëse dy miq zihen, a do të vazhdojnë të peshkojnë apo të shkojnë për gjueti së bashku? A do të flasin dhe do të qeshin së bashku siç bënin para se të ziheshin? Jo! Njerëzit që kanë mendime dhe qëndrime të ndryshme apo që kanë një mosmarrëveshje nuk duan të jenë së bashku.

## Përsëritje

Shëno se cilat nga këto karakteristika janë të Perëndisë dhe cilat të Satanit.

1. Perëndia; 2. Satani

1. Ai ka gjithmonë të drejtë.
2. Ai është gënjeshtar dhe mashtrues.
1. Ai është i përsosur.
2. Ai urren Perëndinë dhe njeriun.
1. Ai e do njeriun.

## Pyetje e përgjigje


1. A e dinte Eva se kush ishte Satani kur i foli asaj në kopsht? **Jo.**
2. Çfarë përdori Satani për t'u maskuar kur i foli Evës? **Gjarprin.**
3. Perëndia tha që Adami dhe Eva do të vdisnin nëse do të hanin frutën e pemës së njohjes të së mirë e të së keqes. Satani tha që nuk do të vdisnin. Kush foli të vërtetën? **Perëndia.**
4. A përpjet akoma Satani t'i mashtronte njerëzit? **Po.**
5. Satani është shumë i fortë. A ishte i tërë faji i tij që Adami dhe Eva mëkatuan? **Jo, Adami dhe Eva zgjodhën të mëkatonin. Perëndia ua kishte bërë të qarta udhëzimet e Tij; Ai ishte treguar shumë i dashur me ta. Ai u dha një vullnet për të bërë një zgjedhje; ata zgjodhën që të mos bindeshin.**

- Ata u veshën me gjethe fiku.

- Ata nuk i besonin më Perëndisë për t'u dhënë atë që u nevojitej.

- Mbase ata mendonin që nëse visheshin vetë, Perëndia nuk do të vinte re se çfarë kishte ndodhur.

- Por Perëndia nuk na pranon sipas pamjes tonë të jashtme.



Mendoni:

Ashtu si Adami dhe Eva u përpoqën të bëheshin të pranueshëm para Perëndisë duke bërë rroba, shumë njerëz sot mendojnë se mund të bëhen të pranueshëm para Perëndisë duke bërë gjëra që i bëjnë të duken të mirë. Ja disa shembuj: bërja e veprave të mira, të shkuarit në kishë dhe të dhuruarit ndaj të varfërve.

- Adami dhe Eva jo vetëm u përpoqën të mbulonin lakuriqësinë e tyre, por, kur Perëndia shkoi t'i vizitonte, ata u përpoqën të fshiheshin nga Ai<sup>18</sup>.

- Mëkati, mosbindja ndaj Perëndisë, sjell frikë dhe turp dhe shkakton që njerëzit të largohen nga Perëndia.

- Kur Perëndia krijoi Adamin dhe Evën, ata nuk kishin frikë nga asgjë. Nuk kishte asgjë për të pasur frikë. Perëndia ishte miku i tyre. Asnjë kafshë nuk u bënte ndonjë të keqe. Sëmundja dhe vdekja nuk ekzistinin.

- Mosbindja ndaj Perëndisë është arsyeja se përse ne kemi frikë në botë sot.

- Që kur Adami dhe Eva nuk iu bindën Perëndisë, ka pasur frikë të tmerrshme në zemrat e burrave, grave dhe fëmijëve.

- Thuaju fëmijëve të mendojnë për disa gjëra nga të cilat njerëzit kanë frikë si për shembull: sëmundja, vdekja, problemet financiare, plaçkitësit, lufta dhe frymërat e këqija.

- Pyeti fëmijët: A mendoni se Adami dhe Eva duhet të kenë pasur frikë nga Perëndia? A do t'i ndëshkonte me të vërtetë Perëndia për mosbindjen e tyre? A është Perëndia si shumë njerëz që bëjnë vetëm kërcënime?

Mendoni:

A të kanë kërcënuar ndonjëherë prindërit për diçka dhe pastaj nuk e kanë bërë? Mbase kanë harruar ose mbase kanë qenë shumë të zënë. Por a mendon se Perëndia është kështu? Mos vallë Perëndia thjesht i kërcënoi Luciferin dhe engjëjt kur u rebeluan? Jo! Perëndia bën gjithmonë atë që ka premtuar të bëjë.

- A ishin paralajmëruar Adami dhe Eva për rezultatet e mëkati?

- Po! Perëndia i paralajmëroi në mënyrë të qartë.

- Djalli nuk i bëri "të mëkatojnë"; ata zgjodhën vetë të mëkatonin.

- Tani Adami dhe Eva kishin arsye me vend për të pasur frikë nga Perëndia. **Pse? Sepse nuk i ishin bindur Perëndisë, Krijuesit të tyre.**

- Ata vareshin nga Perëndia për gjithçka.

- Vetë frymëmarrja në trupat e tyre u ishte dhënë nga Perëndia.

- Por Adami nuk i ishte bindur me dashje urdhrat të Perëndisë.

- Duhet të ketë gjithmonë ndëshkim për mosbindjen (mëkatin).

A ishin Adami dhe Eva në gjendje të fshiheshin nga Perëndia? Jo! Perëndia i pa Adamin dhe Evën kur po përpjeteshin të fshiheshin.

A mund të fshihet dikush nga Perëndia? A mundet dikush të shkojë në një vend ku nuk është Perëndia? Jo! Perëndia është kudo. Askush nuk mund të fshihet nga Perëndia. Perëndia ka dëgjuar dhe ka parë gjithçka që kemi thënë dhe bërë nga dita që kemi lindur.



# Mësimi 12 Mallkimi dhe premtimi i Perëndisë

## Qëllimi

Në mësimin e sotëm do të tregosh:

- Që Perëndia di gjithçka dhe do të ndëshkojë çdo mëkat.
- Që Perëndia nuk do ta lejonte Satanin ta bindte njeriun për të mëkatuar gjithmonë, por që Ai do të dërgonte një Çlirimtar, i Cili do ta mundte Satanin dhe do ta çlironte njerëzimin nga pushteti i tij.
- Rezultatet e tmerrshme e të vazhdueshme të mëkatit.
- Që njeriu nuk mund të shpëtojë veten nga mëkati.

Gjithashtu, ky mësim duhet t'i ndihmojë fëmijët të kuptojnë që:

- Askush nuk mund të anashkalojë mëkatin.
- Perëndia ka siguruar një mënyrë për të mundur Satanin.
- Tërë problemet në botë kanë ardhur si rezultat i mëkatit.

## Hyrje

Pyeti fëmijët e klubit tënd se çfarë ideje kanë për atë që mendoj Perëndia për Adamin dhe Evën pasi ata nuk u bindën. Kujtoji për këto më poshtë:

- Perëndia i ka krijuar: sipas shëmbëlltyrës së vet dhe për lavdinë e Tij.
- Ata i përkasin Perëndisë.
- Perëndia i donte.
- Perëndia u kishte dhënë gjithçka që kishin nevojë.
- Perëndia i kishte paralajmëruar Adamin dhe Evën për rezultatet e mosbindjes.
- Adami dhe Eva kishin zgjedhur të mos i bindeshin Perëndisë.

Nxiti të dëgjojnë me vëmendje ndërsa studiojnë përgjigjen e Perëndisë ndaj mëkatit të Adamit dhe Evës.

## Figurat

- Grafiku 11: Çlirimtari
- Grafiku 12: Mëshira
- Grafiku 13: Hiri
- Grafiku 1: Mësimi për Perëndinë  
Përdore këtë grafik si përsëritje kur sugjerohet; përdore edhe për të paraqitur attribute të reja: Perëndia është plot hir dhe i mëshirshëm.

## Historia

“Si është puna, fëmijë?” - pyeti xhaxhi Piteri. “Dukeni sikur keni humbur diçka”.

Xhoni dhe Karola i shpjeguan xhaxhi Piterit se çfarë kishte ndodhur. Ata i kishin thënë vëllait të tyre më të vogël dhe mikut të tij që të qëndronin larg bojës që po përdorte Xhoni, sepse mund të binte mbi ta dhe të prishte rrobat e tyre. Kur Xhoni u largua për pak minuta, ata nuk iu bindën dhe u bënë me bojë anembanë. Dy djemtë e vegjël nuk e dinin që Xhoni i kishte parë, ndaj u larguan dhe u fshehën në mënyrë që askush të mos i shikonte bluzat e tyre dhe të mësonte që e kishin bërë ata. Xhoni e pa se ku u fshehën, por i thirri për të parë nëse do të dilnin dhe do t'i thonin atij se çfarë kishin bërë. Djemtë nuk po dilnin nga vendi ku ishin fshehur.

“Xhoni nuk e di se çfarë duhet të bëjë më pas” - pohoi Karola. “A duhet të shkojë t'i nxjerrë apo të presë derisa të dalin vetë?”.

“Shiko, kjo ngjan shumë me atë që i ndodhi Adamit dhe Evës në Bibël” - tha xhaxhi Piteri. “Pasi Adami dhe Eva hëngrën nga pema e njohjes të së mirës e të së keqes, ata e dinin që kishin bërë gabim dhe u përpoqën t'i fshiheshin Perëndisë. Por ngaqë Perëndia shikon gjithçka, Ai pa gjithçka që bënë dhe kudo ku shkuan. Ai madje e thirri Adamin me emër, ashtu si Xhoni thirri vëllanë, për të parë nëse Adami dhe Eva do të dilnin nga vendi i fshehtë dhe do të pranonin që kishin gabuar që i kishin besuar Satanit në vend të Tij”.

“A u përgjigjën ata kur i thirri Perëndia?” - pyeti Xhoni.

“Po,” - u përgjigj xhaxhi Piteri, - “por kishin frikë nga Perëndia, sepse nuk i ishin bindur Atij. Adami dhe Eva kishin arsye për të pasur frikë! Ata e dinin që kishin vepruar gabim dhe e dinin se çfarë u kishte thënë Perëndia se do të ndodhte nëse nuk do t'i bindeshin Atij. Ndaj, në vend që të thoshin që e kishin gabim, Adami fajësoi Evën që i dha frutën nga pema”.

“Atëherë, a i dënoi Perëndia,” - pyeti Karola, - “apo thjesht i paralajmëroi që të mos e bënin përsëri?”.

“Perëndia di gjithçka dhe nuk do të lejojë asnjë që t'i shpëtojë ndëshkimit duke fajësuar dikë tjetër” - tha xhaxhi Piteri. “Jo vetëm që Adami dhe Eva u ndëshkuan, por Perëndia e dinte që ishte Satani që foli përmes gjarprit për të tunduar Evën. Kështu që edhe ai u ndëshkua!”.

Xhoni u mendua për një çast dhe pastaj tha: “Mendoj se duhet të shkoj e të nxjerr vëllanë e vogël dhe të flas me të dhe shokun e tij. Nuk mendoj se janë aq të vegjël sa të mos nxjerrin një mësim nga Adami dhe Eva!”.

## Le të shohim në Bibël



**Hebrenjve 4:13** - “Dhe nuk ka asnjë krijesë që të jetë e fshehur para tij, por të gjitha janë lakuriq dhe të zbuluara para syve të Atij, të cilit ne do t'i japim Ilogari”.

Nga ky varg fëmijët duhet të shikojnë që në Fjalën e Perëndisë na thuhet që Perëndia shikon gjithçka dhe di gjithçka që kemi bërë.

## Le të mendojmë

1. Pse u fshehën Adami dhe Eva nga Perëndia?  
a. Për qejf; b. **Kishin frikë, sepse nuk iu bindën Atij**; c. Ata donin të flinin.
2. A mund të fshihet dikush nga Perëndia? Po / **Jo**.
3. Kë fajësoi Adami për mosbindjen ndaj Perëndisë?  
a. Gjarprin; b. Perëndinë; c. **Evën**.
4. Kë fajësoi Eva për mosbindjen ndaj Perëndisë?  
a. Perëndinë; b. **Gjarprin**; c. Adamin.
5. A e dinte Eva që ishte Satani ai që foli përmes gjarprit? Po / **Jo**.

## Mësime nga Fjala e Perëndisë

Mund të thuash që ky mësim shpjegon “rrëmujën në të cilën ndodhemi”. Shpesh dëgjojmë burra dhe gra që fajësojnë Perëndinë për problemet e tyre dhe për problemet e botës rreth tyre. Por Zanafilla 3 e pohon shumë qartë të vërtetën: mëkati i njeriut është shkaku i problemeve të tij. Fëmijët duhet ta njohin këtë të vërtetë.

### 1. Perëndia thërret Adamin - Zanafilla 3:9.

- Ngaqë Adami dhe Eva nuk shkuan për të folur me Perëndinë, Perëndia i thirri: “Adam, ku je?”
    - Pse e thirri Perëndia Adamin? A nuk e dinte Ai se ku ishin fshehur?
    - Po, Perëndia mund të shikonte se ku ishin fshehur Adami dhe Eva. Perëndia thirri Adamin sepse, edhe pse Perëndia kishte si qëllim të ndëshkonte Adamin dhe Evën për mëkatin e tyre, Ai i **donte** akoma. Perëndia po u jepte mundësinë **të pajtoheshin me Të që kishin bërë gabim** që i kishin besuar Satanit në vend të Tij.
  - Perëndia nuk ka ndryshuar; Ai akoma thërret sot, edhe pse nuk mund ta dëgjojmë zërin e Tij si Adami.
    - Si na thërret Perëndia sot?
- Shembull:
- Çdo ditë zëri i Perëndisë na thotë: “Më dëgjo, unë jam Krijuesi i çdo gjëje. Unë jam Perëndia i vërtetë. Unë di gjithçka. Unë jam Shumë i Larti. Shiko tërë gjërat që kam krijuar për ty. Unë të dua. Shiko tërë ushqimin që kam bërë për ty. Unë të dua. Shiko jetën që të kam dhënë. Unë të dua. Më dëgjo dhe më kërko”.
- Sa herë që shikojmë gjërat që ka krijuar Perëndia, Ai dëshiron që të mendojmë për Të.
  - Perëndia jo vetëm na flet përmes gjërave që ka krijuar; por Ai na thërret edhe përmes Fjalës së Tij. Bibla është mesazhi i Perëndisë për secilin prej nesh.



**Lexo:** Veprat e Apostujve 17:25  
thotë: ...Ai u jep të gjithëve jetë,  
hukatje dhe çdo gjë...

## 2. Adami dhe Eva u përpoqën të fshiheshin nga Perëndia - Zanafilla 3:10.

- Adami dhe Eva kishin frikë nga Perëndia për shkak se nuk i ishin bindur Atij. Adami dhe Eva kishin arsye të kishin frikë. Ata e dinin se çfarë kishin bërë. Ata e dinin se çfarë u kishte thënë Perëndia se do të ndodhte nëse nuk i bindeshin Atij.

## 3. Perëndia e merr Adamin në pyetje - Zanafilla 3:11.

- Perëndia merr në pyetje Adamin dhe Evën për t'u dhënë një mundësi për t'u penduar, pra, për të ndryshuar mendje dhe për t'u pajtuar me Perëndinë që ata kishin bërë gjënë e gabuar.
  - Perëndia kishte të drejtën të pyeste Adamin, sepse e kishte krijuar. Ata të dy i përkisnin Perëndisë. Ai i krijoi që ta donin dhe t'i bindeshin Atij.
  - Perëndia na jep jetë edhe neve dhe tërë njerëzve, prandaj, Ai është zotëruesi ynë.
  - Adami dhe Eva duhet të përgjigjeshin përpara Perëndisë për atë që kishin bërë. Pa Çlirimtarin edhe neve do të na duhet të përgjigjemi përpara Perëndisë për gjithçka që kemi menduar dhe kemi bërë gjatë jetës tonë.

## 4. Adami dhe Eva u përpoqën të pasonin fajin - Zanafilla 3:12-13.

- Adami ia hodhi fajin Evës dhe Eva fajësoi gjarprin. Por Perëndia e dinte tashmë gjithçka që kishte ndodhur; Atij nuk mund t'i fshihet asgjë.

Mendoni:

A ke fajësuar dikë tjetër për një gabim që ke bërë? A të kanë fajësuar për një gabim që e ka bërë dikush tjetër? Ne mund të përpiqemi t'ia hedhim fajin dikujt tjetër, ashtu siç u përpoqën Adami dhe Eva; por Perëndia di gjithçka dhe nuk do të lejojë që dikush t'i shpëtojë ndëshkimit duke fajësuar dikë tjetër.

## 5. Mallkimi i Perëndisë ndaj gjarprit - Zanafilla 3:14.

- Perëndia e mallkoi gjarprin, sepse ishte përdorur nga Satani.
  - Perëndia nuk na thotë se si ishte gjarpri para se ta përdorte Satani për të mashtruar Evën, por e dimë që nuk zvarritej kur Perëndia e krijoi.
  - Por tani Perëndia tha që gjarpri duhet të zvarritej dhe të hante pluhur. Perëndia e dinte që ishte Satani ai që foli përmes gjarprit për të tunduar Evën.
  - Perëndia di gjithçka që Satani dhe frymërat e tij të këqija mendojnë apo planifikojnë të bëjnë.
- Perëndia do të ndëshkojë Satanin dhe tërë ndjekësit për tërë veprat e tyre të këqija dhe mosbindjen e tyre të tmerrshme ndaj Perëndisë.

## 6. Fara e premtuar e gruas - Zanafilla 3:15.

- Sapo Adami dhe Eva nuk iu bindën Perëndisë dhe ndoqën këshillën e Satanit, ata u ndanë nga Perëndia dhe u vendosën nën kontrollin e Satanit.
  - Ata nuk ishin më bijtë e Perëndisë.
  - Ata ishin bijtë e Satanit.
- Satani u bë sunduesi i kësaj bote.
  - Në këtë kohë Satani mbase mendoi se e kishte mundur Perëndinë dhe se ai do të kishte kontroll të plotë mbi botën dhe tërë njerëzit.
  - Këtë kishte dashur Satani. Por askush nuk mund të fitojë ndaj Perëndisë. Perëndia është Krijuesi Shumë i Lartë.
- Perëndia premtoi që Ai do të dërgonte një çlirimtar që do të mundte (mposhte) Satanin dhe do të çlironte njerëzimin nga pushteti i tij.
  - A e di se çfarë është një çlirimtar?<sup>19</sup>
  - Një çlirimtar është dikush që na shpëton: një çlirimtar na çliron.
  - Perëndia planifikoi që Çlirimtari i premtuar do të ishte fëmija i një gruaje të virgjër.
  - Një e virgjër është një grua që nuk është martuar kurrë apo që nuk ka qenë grua e një burri.

Shënim:

Vër re që nuk thotë pasardhësi "i tyre". Burri nuk përmendet në këtë varg.

- Kur lexojmë për shtypjen e "kokës", kjo është një tablo e shtypjes së drejtimit apo autoritetit të një pushteti të madh. Kur "koka" shtypet, trupi nuk mund të jetojë. Por "thembra" e atij që shtypet jeton, edhe pse është plagosur.

=> Grafiku 11: Çlirimtari  
(Sigurohu që fëmijët të kuptojnë këtë fjalë.)

<sup>19</sup> Prezantimi i Çlirimtarit krijon mundësitë për shumë komente nga nxënësit e tu. Ata mund të pyesin nëse Jezusi është Çlirimtari, për të cilën përgjigja do të jetë: "Po".

Bëju të ditur që mezi pret të flasësh për Jezu Krishtin dhe që do të jesh i kënaqur të flasësh me këdo që është i interesuar pas takimit. Por për momentin thjesht vazhdo me historinë nga Zanafilla.

# Mësimi 12

## Mallkimi dhe premtimi i Perëndisë

(vazhdim)

=> Grafiku 1: Mësimi për Perëndinë  
Lexo tërë grafikun, përveç: "Perëndia është dashuri..."



**Lexo:** Psalmi 145:8 thotë: Zoti është i dhembshur dhe mëshirplot, i ngadalshëm në zemërim dhe i madh në mirësi.

Shpjego:

Çlirimtarit do të ndeshej me Satanin dhe Çlirimtarit do të fitonte. Satani do të luftonte kundër Çlirimtarit dhe do ta plagoste, por Satani nuk do të ishte në gjendje të fitonte ndaj Çlirimtarit. Ky Çlirimtar i premtuar do të shkatërronte Satanin dhe do të çlironte njerëzimin nga pushteti i Satanit, në mënyrë që njeriu të ishte në harmoni me Perëndinë.

- Duke studiuar Zanafillën 1 dhe 2 kemi mësuar tashmë shumë gjëra rreth Perëndisë!

=> Pas leximit të tërë këtyretributeve në pankartë, vazhdo pastaj me:

- Tani do të shohim që Perëndia është i dhembshur dhe i mëshirshëm.
- Hiri dhe mëshira janë dy fjalë të mrekullueshme.
- "Hiri" është mirësia e Perëndisë ndaj mëkatarëve që nuk e meritojnë (që nuk janë të denjë).
- "Mëshira" është rruga që Perëndia u ofron mëkatarëve për t'i shpëtuar ndëshkimit që meritojnë!

Shpjego:

Nga ajo që kemi mësuar rreth Perëndisë e dimë që Ai e ndëshkon gjithmonë mëkatën. Por Perëndia, në dashurinë e Tij të madhe, premtoi të gjente një rrugë shpëtimi duke dërguar një çlirimtar, në mënyrë që njeriu të mund të shpëtohej nga ndëshkimi që meritonte. Perëndia mund t'i kishte lënë Adamin dhe Evën të vdisnin dhe të pësonin ndëshkimin e përgjithshëm. Kjo ishte ajo që meritonin ata. Por Perëndia premtoi një Shpëtimtar që do t'i çlironte ata dhe tërë njerëzimin nga kontrolli i Satanit dhe që do t'i afronte me Perëndinë.

### 7. Mallkimi i Perëndisë ndaj gruas - Zanafilla 3:16.

- Perëndia i foli Evës dhe i tha asaj që, për shkak se nuk iu bind Atij:
  - Ajo dhe tërë nënat e ardhshme do të vuanin gjatë lindjes së fëmijëve.
  - Burri i saj do të sundonte mbi të.

### 8. Mallkimi i Perëndisë ndaj burrit dhe tokës - Zanafilla 3:17-19.

- Adami kishte dëgjuar si i marrë Evën në vend që t'i bindej asaj që i kishte thënë Perëndia.
  - Adami e dinte se çfarë kishte thënë Perëndia.
  - Adami ishte gati të ndiqte sugjerimin e Evës në vend që të bënte atë që e dinte se ishte vullneti i Perëndisë.
- Për shkak se Adami dhe Eva dëgjuan Satanin, ata ranë në kurthin e tij dhe nuk iu bindën Perëndisë.
  - Prandaj Perëndia tha që toka do të ishte e mallkuar që prej asaj dite.

Mendoni:

Para se Adami të mëkatonte, gjithçka rritej pa u dashur që Adami të bënte ndonjë punë të madhe. Barishtet e këqija nuk rriteshin; nuk kishte insekte të dëmshme.

Por kur Adami mëkatoi, Perëndia mallkoi tokën. Shumë barëra të këqija u rritën. Kjo e bënte punën e Adamit të vështirë.

- Rezultatet e mëkatit prekën jo vetëm Adamin dhe Evën, por edhe kopshtin e dashur që Perëndia u kishte dhënë atyre. Në fakt **tërë gjërat e këqija në botë ekzistojnë për shkak të mosbindjes ndaj Perëndisë.**
  - Satani dhe ndjekësit e tij nuk iu bindën Perëndisë dhe tani toka rënkton.
  - Kur njeriu nuk u bind, mëkati i tij preku tërë krijimin e Perëndisë.
- Pse mëkati i njeriut duhet të prekte tërë krijimin?
  - Perëndia e kishte bërë tokën për njeriun (Isaia 45:18).
  - Duke qenë se Perëndia e donte njeriun, Ai i dha njeriut gjithçka që i nevojitej.
  - Perëndia donte që njeriu të jetonte në miqësi me Të përgjithmonë.
  - Por tani njeriu nuk iu bind Perëndisë.
    - Njeriu e kishte refuzuar dashurinë e Perëndisë.
    - Pjesë e rezultateve të mosbindjes së tij ishte që njeriu nuk do të jetonte më në një botë të përsosur.
- Ne jetojmë në një botë që e vuan akoma atë mallkim.

<sup>20</sup> Kjo e vërtetë është shumë e rëndësishme: mos e anashkalo.

## Përsëritje

Me shkronjat e ngatërruara më poshtë formo fjalën që do të thotë:

MIRËSIA E PAMERITUAR E PERËNDISË.  
IHR (hir)

DIKUSH QË NA SHPËTON. (ARLÇRIMIT)  
(çlirimtar).

## Pyetje dhe përgjigje

1. Pse Perëndia ka të drejtën të kërkojë bindje? Sepse Perëndia i dha jetën secilit.
2. Kë premtoi Perëndia të dërgonte? Perëndia premtoi të dërgonte një Çlirimtar.
3. Si do të vinte Çlirimtari? Përmes farës së gruas.
4. Çfarë tha Perëndia se do të bënte Biri i virgjëreshës? Ai do të mundte Satanin dhe do të çlironte njeriun nga vdekja dhe pushteti i Satanit.
5. Pse premtoi Perëndia për të dërguar një Çlirimtar? Sepse Perëndia i do tërë njerëzit.

- Njerëzit luftojnë vazhdimisht kundër sëmundjes, dhimbjes, dobësisë, dhimbjeve gjatë lindjes së fëmijës, punës së rëndë, kushteve të vështira të motit, insekteve të dëmshme, barërave të këqija, brengave, trishtimit dhe vdekjes.

- Perëndia, kur krijoi Adamin dhe Evën, nuk kishte synim që ata të vdisnin.

- Por tani Adami dhe Eva duhet të vdisnin për shkak të mosbindjes së tyre ndaj Perëndisë.

### - Ndëshkimi për mëkatin është vdekja.

- Trupi i Adamit duhet të vdiste, ashtu siç kishte thënë Perëndia.

- Ngaqë Adami mëkatoi, Perëndia i tha Adamit që trupi i tij duhet të vdiste dhe të kthehej në tokë.

## 9. Adami dhe Eva janë prindërit e tërë njerëzve - Zanafilla 3:20.

- Edhe pse njerëzit kanë ngjyra të ndryshme lëkure, ne e kemi prejardhjen nga të njëjtët prindër, Adami dhe Eva. Veprat e Apostujve 17:26 thotë që Perëndia “... ka bërë nga një gjak i vetëm të gjitha racat e njerëzve...”<sup>20</sup>.
  - Eva është gruaja e parë dhe nëna e çdo qenieje njerëzore.
  - Adami është babai ynë.
- Adami u nda nga Perëndia, sepse nuk iu bind Atij.
  - Mëkati i Adamit prishi marrëdhënien e tij të përsosur me Perëndinë dhe gjithashtu përsosurinë e tokës që Perëndia i kishte dhënë për të jetuar.
  - Mëkati i Adamit ishte fillimi i shumë dhimbjeve.
  - Djalli nuk e “detyroi Adamin që të mëkatonte”.
  - Të dy, Adami dhe Eva, e dinin atë që kishte thënë Perëndia.
  - Ata e dinin që Perëndia i donte.
  - Por ata nuk u bindën gjithsesi.
  - Ne jetojmë me rezultatet e mëkatit të tyre çdo ditë.
- Për shkak të mëkatit të Adamit, ai do të vdiste dhe tërë fëmijët e tij do të vdisnin gjithashtu. Romakëve 5:12 thotë që “... ashtu si me anë të një njeriu të vetëm mëkati hyri në botë dhe me anë të mëkatit vdekja...”.
- Tërë njerëzit në çdo vend vdesin për shkak se jemi pasardhës të Adamit.

Por Perëndia, që në fillim, premtoi të dërgonte një çlirimtar: dikë që do ta shpëtonte njeriun nga Satani, mëkati dhe vdekja.



# Mësimi 13 Parashikimi dhe gjykimi i Perëndisë

## Qëllimi

Në mësimin e sotëm do të flasësh për shenjtërinë dhe hirin e Perëndisë. Këtu do të shohësh filijimin e parë me gjak për mëkatin dhe veprën plot hir të Perëndisë të veshjes së Adamit dhe Evës. Perëndia po paraqet faktin e paafësisë së njeriut për të shpëtuar veten dhe po jep një analogji (krahasim) rreth Çlirimtarit që do të vinte.

Gjithashtu do t'u tregosh fëmijëve:

- Që Perëndia di gjithçka dhe do të ndëshkojë mëkatin.
- Që vetëm Perëndia mund ta bëjë njeriun të pranueshëm në sytë e Tij.
- Që mëkati i Adamit ka kaluar te të gjithë njerëzit.

Shënim: Ky mësim paraqet disa parime (besime) bazë që shumica e shoqërisë sonë ka zgjedhur t'i ndryshojë apo t'i refuzojë tërësisht.

Para së gjithash, fjala është shumë e qartë kur pohon se Perëndia vrau kafshët për të bërë mbulesa të pranueshme për Adamin dhe Evën. Edhe pse gjaku i kafshëve nuk mund të paguante kurrë për mëkatin, që nga kjo kohë deri te vdekja e Krishtit, Perëndia pranoi gjakun e kafshëve si figurë të ndëshkimit që meritonin tërë mëkatet. *Romakëve 6:23a thotë: Paga e mëkatit është vdekja. Hebrejve 9:22b thotë: Pa derdhje gjaku nuk ka falje mëkatesh.*

Së dyti, fjala na tregon që njeriu nuk mund t'i afrohet Perëndisë sipas kushteve të tij; njeriu duhet t'i afrohet Perëndisë sipas mënyrës që ka parashikuar Perëndia si rrugën e pranueshme. Veshjet prej gjetheje të Adamit dhe Evës nuk ishin të pranueshme para Perëndisë; gjithashtu as ndonjë gjë që mund të përpiqemi të bëjmë për t'u bërë të pranueshëm para Perëndisë. Refuzimi apo shtrembërimi i këtyre dy parimeve ka nxjerrë shumë fe të rreme. Sa i tunduar është njeriu të ndjekë një fe që anashkalon ndëshkimin e rëndë për mëkatin! Sa i tunduar është njeriu për t'u përpjekur që të gjejë një rrugë të vetën për të zgjidhur problemin e mëkatit! Sa gënjeshtar është mëkati! Sa e pashërueshme është zemra e njeriut! Dhe sa mashtrues është armiku!

## Hyrje

Në historinë e sotme mësuam që nuk mund të bëjmë gjë për t'u bërë të pranueshëm para Perëndisë. Perëndia nuk do të pranojë diçka që bëhet sipas ideve të njeriut. Perëndia pranon vetëm atë që bëhet sipas vullnetit të Tij. Njerëzit sot bëjnë akoma shumë gjëra për ta bërë veten të pranueshëm para Perëndisë; ata përpiqen të "mbulojnë" mëkatet e tyre, ashtu si Adami dhe Eva.

Shembull:

Disa njerëz mendojnë se nëse ata shkojnë në kishë apo bëjnë shumë vepra të mira, këto gjëra do t'i ndihmojnë që të shlyejnë gjërat e gabuara që kanë bërë (të mijët mund të mendojnë për shembuj të tjerë për këto lloj mbulesash për mëkatin të sajua nga njerëzit). Syri i Perëndisë është depërtues dhe këto gjëra janë tërësisht të papranueshme për Të.

## Historia

Xhaxhi Piteri po shikonte Karolën që po nderte rrobat pas shtëpisë së saj kur i tha: "Me sa duket boja nuk ka dalë nga bluzat e Tomit".

"Ke të drejtë" - pranoi Karola. "Nuk mund ta besoj se çfarë bëri vëllai im i vogël! Ai me shokun e tij u përpoqën t'i hiqte vetë bojërat, në vend që të kërkonin ndihmë. Kjo gjë vetëm sa e përhapri bojën më shumë dhe tani bluza nuk bën më. Nëse do të kishte ardhur te ne, do të mund ta hiqnim bojën".

"Shiko, Karola," - tha xhaxhai i saj, - "ndonjëherë të gjithë duhet të sjellim ndër mend që ka disa gjëra që nuk mund t'i bëjmë dot për veten. Kemi nevojë për ndihmë. Kujtoj disa raste kur ti dhe Xhoni kishit të njëjtat probleme".

"Për shembull?" - pyeti Xhoni ndërsa po i afrohej xhaxhi Piterit nga pas.

"Unë po mendoja për problemin tonë të mëkatit, Xhon" - u përgjigj xhaxhi Piteri. "Mëkatet janë ato gjëra të këqija që bëjmë, dhe kujtoj shumë raste kur ti dhe Karola nuk bindeshit dhe pastaj përpiqeshit të mbulonit atë që kishit bërë gabim, apo të rregullonit atë që kishit thyer. Nuk funksionoi me prindërit tuaj; as Perëndia nuk do të pranojë asnjë gjë që do të përpiqemi të bëjmë vetë për të zgjidhur çështjen e mëkateve tona".

"Ashtu si Adami dhe Eva bënë kur u përpoqën të mbulonin trupat e tyre me gjethe fiku?" - pyeti Karola.

"Ke të drejtë" - pranoi xhaxhi Piteri. "Perëndia refuzoi t'i pranonte veshjet që bëri Adami dhe Eva. Ai donte t'i mësonte ata që qysh në çastin kur mëkatuan, nuk mund të bënin asgjë për të qenë të pranueshëm para Perëndisë. Idetë e njeriut nuk janë të mira. Perëndia pranon vetëm atë që bëhet sipas mënyrës së Tij".

"Atëherë, çfarë donte Perëndia që të vishnin ata?" - pyeti Xhoni. "Atje nuk kishte vend për të blerë rroba".

"Jo, nuk kishte," - u përgjigj xhaxhi Piteri, - "por Perëndia kishte tashmë një plan për të siguruar veshje për fajtorët: për Adamin dhe Evën. Perëndia vrau një kafshë. Ishte vdekja e parë në botë e shkaktuar nga mëkati. Gjaku i kafshës u derdh, pastaj Perëndia mori lëkurët e kafshës, bëri rroba me lëkurën e saj dhe veshi me të Adamin dhe Evën. Perëndia e bëri këtë gjë për Adamin dhe Evën, edhe pse ata nuk e meritonin".

"Pse nuk u tha Perëndia që t'i bënin vetë rrobat?" - pyeti Karola.


"Ata tashmë ishin përpjekur me gjethe e fiku" - kujtoi xhaxhi Piteri. "Vetëm Perëndia mund t'u siguronte rroba që i bënin të pranueshëm para Tij".

"Ata duhet të kenë qenë të trishtuar kur kanë parë një nga kafshët e tyre të vdiste në mënyrë që të kishin rroba" - tha Karola e trishtuar.


"Po, me siguri kanë qenë," - pranoi xhaxhi Piteri, - "por Perëndia po u kujtonte Adamit dhe Evës që mosbindja ndaj Tij solli vdekjen në botë".

## Figurat

- Grafiku 8: Perëndia dhe njeriu
- Figura 5: Mbulesat prej gjethesh fiku



- Figura 6: Adami dhe Eva nxirren jashtë kopshit



- Grafiku 14: Adami e TËRË pasardhësit e Adamit, dhe Perëndia

**Mëkat:** Gjëra të këqija, të liga.

**Vdekja:** Ndarja përgjithmonë nga erëndia

<sup>21</sup> Vargu 22 flet për Perëndinë Atë, Perëndinë Bir dhe Perëndinë Frymë e Shenjtë. Ata po flisnin për Adamin dhe Evën.

## Le të shohim në Bibël



Romakëve 5:12 - “Prandaj, ashtu si me anë të një njeriu të vetëm mëkati hyri në botë dhe me anë të mëkatit vdekja, po ashtu vdekja u shtri tek të gjithë njerëzit, sepse të gjithë mëkatuan”.

Shpjego që për shkak se Adami nuk iu bind Perëndisë dhe u nda prej Tij, tërë njerëzit në këtë botë kanë lindur mëkatarë, të privuar apo të ndarë nga Perëndia.

## Le të mendojmë

1. A janë mëkat gjërat e këqija që bëjmë? **Po** / Jo.
2. A i pëlqeu Perëndia rrobat që bënë Adami dhe Eva? **Po** / **Jo**.
3. Çfarë përdori Perëndia për të bërë rroba për Adamin dhe Evën? a. Copë; b. Gjethe; c. **Lëkurë kafshësh**.
4. Nga se u shkaktua vdekja e parë në botë? a. Aksident; b. **Mëkati**; c. Sëmundja.
5. A është vdekja ndëshkimi për mosbindjen ndaj Perëndisë? **Po** / Jo.

## Mësime nga Fjala e Perëndisë

### 1. Perëndia i refuzoi rrobat që bënë Adami dhe Eva - Zanafilla 3:21

*Atëherë iu hapën sytë të dyve dhe e panë që ishin lakuriq; kështu ata qepën gjethe fiku dhe bënë breza për t'u mbuluar (Zanafilla 3:7).*

=> Figura 5: Mbulesat prej gjethesh fiku

- Adami dhe Eva u vunë në siklet për shkak të trupave të tyre të zhveshur, kështu që përgatitën vetë rroba prej gjethesh fiku. Perëndia refuzoi të pranonte veshjet që bënë ata.
- Askush nuk mund të bëjë diçka për t'u bërë i pranueshëm para Perëndisë. Perëndia pranon vetëm atë që bëhet sipas mënyrës së Tij. => Trego grafikun 8: Perëndia dhe njeriu.

### 2. Perëndia vrau kafshët.

- Vdekja e parë në botë ndodhi për shkak të mëkatit.
  - Perëndia vrau kafshët. Gjaku i kafshëve u derdh. Pastaj Perëndia mori lëkurët e kafshëve.
  - Adami dhe Eva nuk e bënë këtë. Perëndia vrau kafshët dhe u mori lëkurët.
  - Perëndia po u kujtonte Adamit dhe Evës që mosbindja ndaj Tij solli vdekjen në botë.

### 3. Perëndia u siguroi veshje Adamit dhe Evës.

- Perëndia u siguroi Adamit dhe Evës veshje nga lëkurët e kafshëve që vrau, edhe pse ata nuk e meritonin.
- Vetëm Perëndia mund t'u siguronte veshje që do t'i bënin të pranueshëm para Tij.

### 4. Perëndia i nxori Adamin dhe Evën jashtë kopshtit, larg pemës së jetës - Zanafilla 3:22-23<sup>21</sup>.

- Në fillim kur Perëndia krijoi Adamin dhe Evën, ata nuk e njihnin të keqen.
- Por kur nuk iu bindën Perëndisë, Krijuesit të tyre, ata u turpëruan dhe patën frikë. Tani e dinin që jo gjithçka ishte e mirë, dhe që disa gjëra ishin të këqija.



<sup>22</sup> Zanafilla 3:22 thotë që arsyeja se përse Perëndia i nxori nga kopshti ishte që ata të mos hanin nga pema e jetës dhe të jetonin përgjithmonë. Kjo ishte në fakt një vepër e mëshirës së Perëndisë. Perëndia nuk donte që njerëzit të jetonin përgjithmonë fizikisht si mëkatarë. (Pyeti fëmijët: A mund të imagjinosh se si do të ishte bota nëse tërë njerëzit e këqij që kanë jetuar të ishin gjallë akoma sot?)

=> Figura 6: Adami dhe Eva dëbohen nga kopshti

<sup>23</sup> Kur mëson që njeriu u nxor nga kopshti, duhet ta bësh të qartë që nuk kishte mundësi kthimi pas. Përmes mësimi të Fjalës së Perëndisë, ne po hedhim themelet që fëmijët e klubit tonë të kuptojnë që, nëse Perëndia nuk siguron një rrugë kthimi për tek Ai, ata janë të paracaktuar për ndëshkim të përjetshëm.

=> Grafiku 14: Adami dhe TËRË pasardhësit e Adamit, dhe Perëndia

<sup>24</sup> Disa njerëzve u pëlqen të mendojnë se ne jemi "të gjithë bij të Perëndisë". Kjo tingëllon mirë, apo jo?! Por Bibla nuk thotë kështu. Bibla na thotë që Perëndia na krijoi. Por mëkati i Adamit i futi tërë njerëzit në familjen e Satanit. Kështu ne nuk kemi lindur si "bij të Perëndisë", por të Satanit, të ndarë nga Perëndia.

## Përsëritje

Shiko vargun përmendësh:

*Prandaj, ashtu si me anë të një njeriu të vetëm mëkati hyri në botë dhe me anë të mëkatiit vdekja, po ashtu vdekja u shtri tek të gjithë njerëzit, sepse të gjithë mëkataran (Romakëve 5:12).*

## Pyetje dhe përgjigje

1. A mundet një person ta bëjë veten të pranueshëm para Perëndisë? **Jo.**
2. Kush është i vetmi që mund ta bëjë njerëzimin të pranueshëm para Perëndisë? **Perëndia.**
3. Pse i vrau Perëndia kafshët për të bërë veshje për Adamin dhe Evën? **Sepse Perëndia po i kujtonte Adamit dhe Evës që ndëshkimi për mëkatin është vdekja.**
4. A mundet dikush ta gënjejë apo ta mashtrojë Perëndinë? **Jo.**
5. Pse kemi lindur të gjithë mëkatarë dhe të ndarë nga Perëndia? **Sepse Adami është edhe ati ynë.**

- Adami dhe Eva duhet t'i kishin besuar Perëndisë. Perëndia e dinte se çfarë ishte e mira dhe e keqja.  
- Adami dhe Eva duhet t'i kishin besuar Perëndisë që t'u thoshte se çfarë ishte e mira dhe e keqja në vend që ta zbulonin vetë.
- Perëndia u kishte dhënë atyre çdo gjë të mirë për të ngrënë: Ai u kishte ofruar shansin të hanin nga pema e jetës. Por ata zgjodhën të mos i bindeshin Perëndisë dhe të hanin nga pema e njohjes të së mirës e të së keqes: pema e vetme nga e cila Perëndia i kishte ndaluar të hanin.
- Tani, për shkak se Adami dhe Eva nuk iu bindën Perëndisë, Ai nuk do t'i lejonte të hanin nga pema e jetës.<sup>22</sup>
- Duke qenë se ishin të ndarë nga Perëndia, ata do të vdisnin edhe fizikisht. Prandaj Perëndia i nxori Adamin dhe Evën, babanë dhe nënën tonë, jashtë kopshtit, larg pemës së jetës.
- Perëndia nuk pyet dikë se çfarë duhet të bëjë; Ai është Shumë i Larti i tërë gjithësisë. Ne nuk mund ta gënjejme apo ta mashtrojmë Perëndinë. Askush nuk mund të ndeshet kundër Perëndisë dhe të fitojë.
- Perëndia e urren mosbindjen ndaj urdhrave të Tij dhe nuk do të lejojë asnjë person të pabindur që të jetojë me Të.

### 5. Perëndia vendosi kerubinë dhe një shpatë flakëruese për të ruajtur rrugën për te pema e jetës - Zanafilla 3:24.


- Në lindje të kopshtit të Edenit Perëndia vendosi disa engjëjt të mirë të quajtur kerubinë dhe një shpatë zjarri që vërvitej nga çdo anë për të siguruar që Adami dhe Eva të mos ktheheshin dhe të hanin nga fruti i pemës së jetës.<sup>23</sup>  
- Nëse do të ishin përpjekur të ktheheshin, engjëjt e mirë të Perëndisë do t'i kishin parë dhe Adami dhe Eva do të ishin vrarë nga shpata e zjarrit.  
- Ata nuk mund të bënin asgjë. Kur Perëndia i nxori nga kopshti, ky ishte fundi. Nuk kishte asnjë mënyrë që ata të ktheheshin për te pema e jetës.
- Ata tani do të plakeshin dhe do të vdisnin.

### 6. Perëndia është dhuruesi i jetës - Zanafilla 4:1.

- Eva e tha këtë, sepse e dinte që Perëndia është dhuruesi i jetës (Psalmi 100:3).

### 7. Kaini dhe Abeli lindën të dy jashtë kopshtit - Zanafilla 4:2.

- Kaini dhe Abeli lindën jashtë kopshtit, larg pemës së jetës, sepse Adami, ati i tyre, ishte jashtë kopshtit.
- Kaini dhe Abeli lindën mëkatarë, sepse babai i tyre, Adami, ishte mëkatar. Nëse Adami nuk do të kishte mëkatar, ata do të kishin lindur me aftësinë për të njohur, për të dashur dhe për t'u bindur Perëndisë.
- Adami nuk ishte vetëm babai i Kainit dhe i Abelit, por ishte edhe ati i çdo njeriu në botë. Prandaj tërë njerëzit në këtë botë kanë lindur mëkatarë, të veçuar nga Perëndia, me Satanin si atin e tyre.<sup>24</sup>
- Perëndia është i vetmi që u jep jetë të gjithëve, por ne nuk kemi lindur në miqësi apo në harmoni me Perëndinë.



- Satani ka zënë vendin e Perëndisë si ati ynë frymëror, që do të thotë që edhe ne kemi lindur me pamundësinë që të njohim, të duam dhe t'i bindemi Perëndisë. Edhe pse Perëndia na jep jetë, nga lindja ne jemi nën kontrollin e Satanit. Ne, dhe tërë qeniet njerëzore, kemi lindur mëkatarë, të ndarë nga Perëndia, me Satanin si atin tonë.

# Mësimi 14

## Qëllimi

Në mësimin e sotëm do të shikosh se si Perëndia e pranon Abelin, i cili iu afrua Atij me anë të besimit sipas mënyrës së kërkuar nga Perëndia dhe se si Perëndia e refuzon Kainin, i cili u përpoq t'i afrohej Perëndisë sipas mënyrës së vet.

Do t'u tregosh gjithashtu fëmijëve të klubit tënd:


- Që mëkati i Adamit u transmetua te të gjithë njerëzit.
- Që njeriu mund t'i afrohet Perëndisë vetëm sipas vullnetit dhe planit të Perëndisë.
- Që njeriu duhet të ketë besim për t'i pëlqyer Perëndisë dhe që të shpëtohet.
- Që Perëndia filloi një pasardhje të re me Setin që zëvendësoi pasardhjen e Abelit. Perëndia po mbante premtimin e tij për të dërguar një çlirimtar.

## Hyrje


Në historinë e sotme dëgjuat Karolën të thoshte se ajo nuk e dëgjoji mamanë e saj dhe vendosi të mos u bindej udhëzimeve të saj. Karola dhe Xhoni nuk besuan se do të përbënte problem nëse do të bënin atë që mendonin vetë. Sa serioz është mëkati i mosbindjes? Po sikur dikush të refuzojë t'i besojë Perëndisë dhe të zgjedhë të mos i bindet Atij? A mund të thuash: "Shiko, kjo është puna e tij, nëse do të bëjë atë gjë"? A i prek mëkati i dikujt njerëzit e tjerë? A mund të gjejmë një mënyrë për të zgjidhur çështjen e mëkateve tona? A mund të zgjedhim njerëzit rrugën e tyre për t'u afruar Perëndisë? A nuk do të pranojë Perëndia ndonjë përpjekje të sinqertë tonën? (Mos u kërko fëmijëve që t'u përgjigjen këtyre pyetjeve.) Në mësimin e sotëm do të shohësh përgjigjet që Perëndia jep për këto pyetje ndërsa studion historinë e bijve të Adamit dhe Evës, Kainit dhe Abelit.

## Figurat

- Grafiku 11: Çlirimtari
- Grafiku 13: Hiri
- Figura 7: Kani dhe Abeli i sjellin oferta Perëndisë



• Figura 8: Kaini vret Abelin



# Kaini dhe Abeli

## Historia

"Përsëritet, Karola. Përsëritet, Xhon" - përsëritet xhaxhi Piteri. "Dukeni shumë të lumtur. Si është puna?"

"Kemi një surprizë për mamin!" - tha Karola. "Do të gëzohet shumë!"

"Keni ujitur kopshtin?" - pyeti xhaxhi Piteri.

"Jo," - u përgjigj Xhoni, - "bëmë diçka më të mirë se kjo! Pastruam oborrin".

"A i mban mend ato lulet që kishte në dorë kur ishte ulur me ne në verandë?" - pyeti Karola. "Atëherë, ne i mbollëm përreth shtëpisë. A nuk duken fantastike! Mamaja do të jetë me të vërtetë e habitur! Mezi po pres të shoh fytyrën e saj".

"Fëmijë," - tha xhaxhi Piteri, - "erdha t'ju takoj sepse, para se të shkonte për të bërë pazarin, mamaja juaj më kërkoi që të vija dhe të shikoja nëse po ujinis kopshtin".

"Oh, e dimë që ajo na tha të bënim këtë," - tha Xhoni, - "por bimët nuk ishin fishkur akoma. Pamë që kopshti ishte rrëmujë dhe filluam ta pastronim".

"Dhe mendova se ajo do të ishte vërtetë e lumtur po t'i shikonte ato lulet të mbjella këtu përreth" - shtoi Karola. "Asaj i pëlqejnë gjërat e bukura".

"Fëmijë, më vjen keq t'ju prish qejfin," - tha xhaxhi Piteri i trishtuar, - "por a nuk mendoni se duhet të kishit ujitur kopshtin në fillim, ashtu siç ju kërkoi mamaja?"

"Shiko, siç tha Xhoni," - u përgjigj Karola, - "bimët nuk ishin aq të thara. Ato mund të prisnin edhe një ditë, ndaj ne bëmë diçka që menduam se asaj do t'i pëlqente më shumë. Dhe u kënaqëm më shumë".

"E shikoj që jeni kënaqur" - tha xhaxhi Piteri. "Nuk mendoj se e keni kuptuar se çfarë keni bërë, por nuk i jeni bindur mamasë tuaj. Dhe ju nuk keni besuar me të vërtetë se ajo e ka pasur me tërë mend atë që ju ka thënë".

"Por ne bëmë diçka vërtetë të mirë!" - thirri Xhoni.

"Xhon, Karola, kemi të bëjmë me diçka shumë serioze këtu" - tha xhaxhi Piteri. "Kush i jep udhëzimet në shtëpinë tuaj?"

"Babi dhe mami" - u përgjigj Karola.

"A e dëgjove mamanë dhe a i besove asaj kur të tha se çfarë donte që të bëje?" - pyeti xhaxhai i saj.

"Jo," - u përgjigj Karola, - "por ne e ndihmuam atë në një mënyrë tjetër, duke pastruar kopshtin dhe duke mbjellë lulet".

"Më vjen keq t'ju them," - tha xhaxhi Piteri, - "por ju, jo vetëm nuk i jeni bindur asaj, por keni bërë diçka që nuk duhet ta kishit bërë. Mamaja juaj ju tha që ato lule duhet të mbilleshin rreth shtëpisë së gjyshes, jo tuajës".

"Do të thuash që harxhova tërë atë kohë duke i mbjellë?" - tha Xhoni duke psherëtirë.

"Oh, Xhon," - tha Karola, - "kemi bërë një gjë të gabuar! Më vjen keq!"

"Fëmijë," - i ndërpreu xhaxhai i tyre, - "besimi dhe bindja janë shumë të rëndësishme. Ju shkoni të ujinis kopshtin ndërsa unë do të shkuloj lulet. Pastaj dua që të shohim diçka në Bibël. Është historia e dy vëllezërve, Kainit dhe Abelit".

## Le të shohim në Bibël



**Fjalët e Urta 14:12 - “Është një rrugë që njeriut i duket e drejtë, por në fund ajo të nxjerr në rrugët e vdekjes”.**

Përmes këtij vargu dhe mësimit të sotëm duam që fëmijët të shikojnë se idetë e njeriut për t'i pëlqyer Perëndisë dhe për t'u pranuar prej Tij, nuk janë mënyrat e Perëndisë.

Mënyrat e Tij, të shkruara në Fjalën e Tij, janë të vetmet të pranueshme për Të.

### Le të mendojmë

1. A donte Xhoni dhe Karola ta bënin mamane e tyre të lumtur? **Po** / Jo.
2. Çfarë u kërkoi të bënin mamaja e Xhonit dhe Karolës?  
a. Të mbillnin lule; b. Të pastronin oborrin; c. **Të ujisnin kopshtin.**
3. A do të ishte e lumtur mamaja e Xhonit dhe Karolës kur të shikonte lulet e mbjella? Po / **Jo.**
4. A besuan dhe u bindën Xhoni dhe Karola mamasë së tyre? Po / **Jo.**
5. A i erdhi keq Xhonit që nuk u bind? **Po** / Jo.

### Mësime nga Fjala e Perëndisë

Historia e Kainit dhe Abelit është si shoqëria jonë sot. Shumë njerëz largohen nga Perëndia. Ndërsa bëjnë një gjë të tillë, ata lëndojnë veten, gënjejnë, vjedhin dhe vrasin burra e gra. Perëndia e urren mëkatin. Njeriut i jepet zgjedhja që të besojë dhe t'i bindet Perëndisë. Njeriu është përgjegjës për zgjedhjet e tij. Mëkati nuk është faji i Perëndisë. Mëkati nuk mund të paguhet me përpjekjet tokësore të njeriut. Mësoji këto të vërteta në mënyrë të qartë. Nëse nuk i mëson, disa fëmijë mund të mos i dëgjojnë kurrë. Perëndia do ta nderojë Fjalën e Tij në zemrat e tyre.

#### 1. Perëndia u tha atyre se çfarë duhet të bënin kur t'i afroreshin për ta adhuruar.

- Nuk kishte mundësi që Adami dhe Eva apo Kaini dhe Abeli t'i afroreshin Perëndisë.
  - Ata ishin mëkatarë dhe Perëndia urren mëkatin.
  - Ata ishin të ndarë nga Perëndia.
  - Ndëshkimi për mëkatin është vdekja.
  - Ata nuk mund t'i jepnin **asgjë** Perëndisë që të paguanin për mëkatet e tyre.
- Por Perëndia planifikoi një mënyrë që ata t'i afroreshin, sepse i **donte**.
  - Kjo nuk ishte mënyra e njeriut. Ishte Perëndia që e vendosi këtë mënyrë.
  - Askush tjetër nuk mund të gjente një mënyrë për ta.
- Perëndia duhet t'i ketë thënë Adamit dhe Evës se çfarë duhet të bënin nëse donin që t'i afroreshin Atij.
  - Ndoshta Adami dhe Eva u thanë Kainit dhe Abelit atë që kishte thënë Perëndia se duhet të bënin nëse donin që t'i afroreshin Atij.<sup>25</sup>
  - Bibla na jep arsye të forta për të besuar se Perëndia ua tha këto gjëra Adamit dhe Evës, dhe që Abeli dhe Kaini i dinin.
- Ja se çfarë mund t'u ketë thënë Perëndia:
  - Kur t'i afroreshin, ata duhet të sillnin një dele, dhi apo dem si ofertë për Të.
  - Ata duhet të vrisnin kafshën në mënyrë të tillë që gjaku i kafshës të rridhte.

<sup>25</sup> Ideja e flijimit të kafshëve nuk filloi me Abelin. Perëndia nuk e pranon diçka që e ka burimin te njeriu. Disa nga pjesët e shumta të Shkrimit që tregojnë që Abeli po ndiqte urdhrin e Perëndisë për flijimet janë: Levitiku 1:1-3; Levitiku 3:16; Levitiku 17:11. Me siguri nuk ishte rastësi që Abeli zgjodhi të parëlindurit e vathës së tij, më të mirët që kishte, dhe figurën më të përsosur të Birit të panjollë të Perëndisë (1 Pjetrit 1:19-20).

<sup>26</sup> Është e rëndësishme që fëmijët ta kuptojnë këtë. Shumica e fëmijëve janë të butë. Ata duhet të kuptojnë që arsyeja për vdekjen e kafshës është mëkati i njeriut.

=> Grafiku 13: Hiri

=> Figura 7: Kaini dhe Abeli i sjellin oferta Perëndisë

<sup>27</sup> Këto dy mendime (të ngjyrosura me gri) janë shumë të rëndësishme. Sigurohu që ata të kuptojnë që gjaku i kafshëve nuk mund tënd. Mund t'u thuash që t'i përsërisin këto dy mendime me ty.

=> Grafiku 11: Çlirimtari

<sup>28</sup> Është e rëndësishme që në çdo histori fëmijëve të klubit tënd t'u mësohet hiri. Ata duhet të kuptojnë që njeriu nuk mund të kontribuojë asgjë për shpëtimin e tij. Sigurohu që ata të kuptojnë që gjaku i kafshëve nuk mund dhe nuk pagoi për mëkatin. Mëkati duhet të paguhet nga çdo jetë njerëzore. Gjaku i kafshëve apo jeta e tyre nuk janë njësoj si jeta njerëzore (Hebrenjve 10:4-5). Sigurohu që ta bësh shumë të qartë se Perëndia nuk do të anashkalojë mëkatin. Mëkati duhet të paguhet plotësisht. Shpirti që mëkaton duhet të vdesë (Ezekieli 18:4b), pra, do të ndahet përgjithmonë nga Perëndia.

- Gjaku i kafshëve nuk mund të shlyente mëkatin e tyre; atëherë, përse u tha Perëndia atyre të vrisnin një dele, dhi apo dem?
  - Sepse Perëndia donte që ata të kujtonin që ndëshkimi për mëkatin është vdekja.
  - Ai donte që ata të kujtonin që mund të vdisnin dhe mund të shkonin në ndëshkim të përjetshëm nëse Ai nuk i shpëtonte.
  - Nëse binin dakord me Perëndinë që ishin mëkatarë dhe që vetëm Ai mund t'i shpëtonte nga ndëshkimi i përjetshëm, atëherë ata duhet të sillnin një dele, dhi apo dem dhe ta vrisnin, ashtu siç u tha Perëndia të bënin.

Mendoni:

Perëndia nuk po tregohej mizor duke kërkuar vdekjen e një kafshe. Jo, arsyeja se përse kafsha duhet të vdiste ishte për shkak të mëkatit të njeriut. Perëndia e do njeriun dhe do që njeriu të dijë që ndëshkimi për mëkatin është vdekja. Kafsha ishte një flajm: ajo që vdiste në vend të mëkatarit<sup>26</sup>.

- Bibla thotë në mënyrë të qartë që për mëkatin duhet të derdhet gjak.
  - Perëndia premtoi që nëse njeriu do t'i afrohej me anë të besimit, duke i ofruar Atij gjakun e kafshëve, Ai do ta pranonte dhe do të falte mëkatet e tij.
  - Gjaku i flajmit për mëkatin ishte pjesë e planit të hirshëm të Perëndisë për të çliruar njeriun nga mëkati, Satani dhe vdekja.

## 2. Si Kaini ashtu edhe Abeli shkuan t'i ofronin flajme Perëndisë - Zanafilla 4:3-5.

- Si Kaini ashtu edhe Abeli e dinin që Perëndia ekzistonte dhe të dy shkuan për t'i ofruar flajme. Mendoni:
 

*Thjesht të diturit që Perëndia ekziston dhe madje, edhe të ofruarit e asaj që ne e mendojmë si shumë të mirë, nuk do ta na bëjë të pranueshëm para Tij.*

## 3. Oferta e Abelit ishte e pranueshme për Perëndinë - Zanafilla 4:4.

- Abeli solli një prej deleve të tij si ofertë për Perëndinë.
  - Ishte një qengj i parëlindur.
  - Abeli theri qengjin, në mënyrë që gjaku i tij të rridhte. Ai ia ofroi qengjin, bashkë me yndyrën, Perëndisë.
  - Pse ia solli Abeli këtë ofertë Perëndisë?<sup>27</sup>
  - **Ngaqë pranoi para Perëndisë që ishte mëkatar.**
  - **Dhe ai besoi që vetëm Perëndia mund ta shpëtonte nga ndëshkimi i përjetshëm.**
- Abeli u besoi premtimeve që Perëndia u kishte dhënë prindërve të tij ndërsa ishin akoma në kopshtin e Edenit. **Perëndia kishte premtuar se Ai do të dërgonte një Çlirimtar të madh.**
  - Perëndia premtoi që Çlirimtari do të shkatërronte Satanin dhe do të shpëtonte njeriun nga pushteti i Satanit.
- A ishte Perëndia i kënaqur me ofertën e Abelit? A e pranoi Perëndia Abelin?
  - Po, e pranoi. Perëndia ishte shumë i lumtur me ofertën e Abelit dhe Ai e pranoi atë. Shpjego:
 

*Është e rëndësishme të kuptojmë që gjaku i kafshëve nuk mund ta shlyejë kurrë mëkatin. Perëndia nuk e pranoi qengjin e Abelit si pagesë për mëkatin e tij. Perëndia e fali mëkatin e Abelit dhe e pranoi sepse ai besoi, jo tek vetja, por te Perëndia që kishte premtuar se do të dërgonte Çlirimtarin.<sup>28</sup>*

## 4. Oferta e Kainit u refuzua nga Perëndia - Zanafilla 4:5.

- Si ofertë për Perëndinë Kaini solli prodhimet që ai kishte rritur.
  - Por Perëndia nuk do të pranonte Kainin apo ofertën e tij. Përse?
  - Ngaqë prodhimet që rriti Kaini dhe që i solli Perëndisë nuk ishin të mira?
  - Ngaqë Perëndia nuk i pëlqente prodhimet që ishin rritur në tokë?
  - Jo, nuk janë këto arsytet.
  - A e refuzoi Perëndia ofertën e Kainit ngaqë ky ishte mëkatar më i keq se Abeli?
  - Jo, nuk ishte kjo arsyeja se përse Perëndia nuk e pranoi atë. Si Kaini ashtu edhe Abeli kishin lindur mëkatarë.

# Mësimi 14 Kaini dhe Abeli

## (vazhdim)

<sup>29</sup> Është e rëndësishme të theksojmë besimin si motivin e ofertës së Abelit dhe mosbesimin si motivin për veprimet e Kainit. Nëse theksojmë bindjen në vend të besimit, mendjet e njerëzve do të kthehen më shumë drejt bërjes së veprave të mira se sa drejt besimit. Sipas Hebrejve 11 Perëndia pranoi Abelin dhe ofertën e tij, sepse Abeli i besoi Perëndisë. Besimi ishte ndryshimi i madh midis Kainit dhe Abelit. E vërteta themelore e besimit te Perëndia duhet të paraqitet në mënyrë të qartë, në mënyrë që kur të arrijmë tek ungjilli, fëmijët do të dinë që Perëndia na pranon vetëm me anë të besimit. Por duhet të kemi një baraspeshë midis besimit dhe veprave. Ngaqë Abeli i besoi Perëndisë, ai i ofroi një qengji. Ngaqë Noeu i besoi Perëndisë, ai ndërtoi një arkë. Ngaqë Abrahami i besoi Perëndisë, ai shkoi në vendin që zgjodhi Perëndia.

<sup>30</sup> Dikush mund të pyesë: "Cila është rruga e Perëndisë?". Sigurisht, përgjigjja është Jezu Krishti; por disa nga fëmijët e klubit mund të kenë nevojë që t'i kuptojnë më mirë gjërat para se t'u paraqesësh ungjillin. Mund të thuash: "Pa dyshim që Perëndia ka siguruar një rrugë dhe ky është qëllimi i këtij studimi biblik. Ai do të dërgonte një Çlirimtar, ashtu siç kishte premtuar. Nëse ke dëshirë, jam i gatshëm që të flasim për këtë pas orës së mësimi". Ne duhet të jemi vazhdimisht të ndjeshëm ndaj Frymës së Shenjtë. Fëmija që pyet mund të ketë me të vërtetë një zemër të përgatitur për të vendosur besimin e Tij në Jezu Krishtin si Shpëtimtarin e tij. Ose thjesht mund të jetë "duke menduar me zë të lartë" për atë që ka dëgjuar, por nuk e kupton sa duhet apo nuk është aq i bindur që është mëkatar. Perëndia premtonte të na japë urtësi nëse ia kërkojmë (Jakobi 1:5) dhe ne mund t'i besojmë për të na dhënë atë që na ka premtuar.

<sup>31</sup> Mendo: Shumë njerëz sot janë si Kaini; ata refuzojnë ta dëgjojnë Perëndinë dhe kështu përfundojnë duke lënduar njëri-tjetrin.

<sup>32</sup> Mendo: Perëndia është Krijuesi i tërë njerëzve. Ai i dha Adamit jetën dhe i dha jetën secilit prej nesh. Edhe pse kemi lindur në këtë botë, të ndarë nga Perëndia, ne i përkasim Atij. Perëndia interesohet për atë që na ndodh, edhe pse jemi mëkatarë.

- Është e rëndësishme që ta kemi të qartë në mendjen tonë se përse Perëndia refuzoi Kainin dhe ofertën e tij, por pranoi Abelin dhe ofertën e tij.

Shpjego:

Te Hebrejve 11 Perëndia thotë që pa besim është e pamundur t'i pëlqesh Atij. Ai na thotë gjithashtu që Abeli ishte një njeri me besim; Kaini jo. Pastaj te Letra drejtuar Romakëve Perëndia na thotë që besimi mbështetet gjithmonë në Fjalën e Perëndisë.

[Romakëve 10:17 thotë: "Besimi, pra, vjen nga dëgjimi, dhe dëgjimi vjen nga fjala e Perëndisë"].

Perëndia do të pranojë vetëm një person që i afrohet sipas mënyrës që Ai ka dhënë në Fjalën e Tij. Çdo mënyrë tjetër është mëkat. Abeli besoi atë që Perëndia tha se do të bënte, kështu që Perëndia e pranoi.

- Perëndia refuzoi Kainin dhe ofertën e tij, sepse:

- Kaini nuk iu afrua Perëndisë duke pranuar se ishte mëkatar.

- Kaini iu afrua Perëndisë sipas mënyrës e sipas ideve të tij dhe jo sipas mënyrës që kishte urdhëruar Perëndia.

- Kaini nuk besoi te Perëndia.

- Kaini nuk besoi në mënyrën se si Perëndia i kishte thënë njeriut t'i afrohej. Kjo është arsyeja se përse Perëndia e refuzoi atë.<sup>29</sup>

Mendoni:

A e kujtoni se si Perëndia i refuzoi veshjet që bënë Adami dhe Eva për vete? Pse Perëndia refuzoi t'i pranonte veshjet që bënë ata? Sepse Perëndia donte t'u tregonte atyre që ata nuk mund të bëheshin të pranueshëm para Perëndisë me anë të asnjë gjëje që mund të bënin vetë. Afrimi te Perëndia duhet të bëhet sipas mënyrës së Perëndisë. Kafshët duhet të vdisnin dhe gjaku i tyre duhet të derdhej, në mënyrë që Adami dhe Eva të mund të kishin veshje të pranueshme për Perëndinë. Në të njëjtën mënyrë Perëndia nuk mund t'i pranonte Kainin dhe Abelin nëse nuk besonin tek Ai dhe nuk i afroreshin Atij sipas asaj që Ai kërkonte. Perëndia do t'i pranonte vetëm nëse do të sillnin një kafshë dhe do ta therrnin, duke derdhur gjakun e saj. Abeli i besoi Perëndisë dhe iu afrua sipas mënyrës që Ai kërkonte, prandaj Perëndia e pranoi. Kaini erdhi duke pasur besim te mënyra e tij, prandaj Perëndia e refuzoi. Perëndia nuk ka ndryshuar; Ai është i njëjtë edhe sot. Ai nuk na urdhëron tani që të bëjmë flijime kafshësh, por Ai është i vetmi që mund të sigurojë mënyrën se si t'i afrohem Atij. Ne duhet të afrohem sipas mënyrës së Perëndisë; përndryshe Ai do të na refuzojë siç refuzoi Kainin<sup>30</sup>.

### 5. Perëndia diskutoi me Kainin e pezmatuar - Zanafilla 4:6-7.

- Edhe pse Kaini refuzoi t'i besonte Perëndisë dhe i bëri gjërat sipas mënyrës së tij, Perëndia i foli Kainit për qëndrimin dhe bindjen e tij ndaj Perëndisë.

- Për shkak të dashurisë dhe mëshirës që kishte për të, Perëndia i foli Kainit dhe u përpoq që ta bënte atë që t'i afrohej Atij sipas mënyrës së duhur.

- Perëndia donte që Kaini të dinte që edhe ai do të pranohej nëse do t'i afrohej si vëllai i tij, duke i besuar Fjalës së Perëndisë, duke ofruar gjakun dhe duke besuar te Perëndia dhe te premtimi i Tij për Çlirimtarin.

### 6. Kaini refuzoi të dëgjonte Perëndinë dhe vrau Abelin - Zanafilla 4:8.

=> Figura 8: Kaini vret Abelin.

- Kaini ishte shumë i zemëruar. Ai nuk e dëgjoi Perëndinë. Ai po dëgjonte Satanin, ashtu siç kishin bërë mamaja dhe babai i tij në kopsht. 1 Gjonit 3:12 thotë: *Jo sikundër Kaini, i cili ishte nga i ligu dhe vrau vëllanë e vet.*<sup>31</sup>

### 7. Gjykimi i Perëndisë ndaj Kainit - Zanafilla 4:9.

- Edhe pse Perëndia bëri këtë pyetje, Ai e dinte tashmë që Kaini kishte vrrarë Abelin.

- Perëndia e pa atë duke e vrrarë, sepse Ai di dhe njeh gjithçka.

- Perëndia është hakmarrësi për çdo mëkat - Zanafilla 4:10-15.

- Çdo mëkat kundër njerëzve të tjerë është gjithashtu mëkat kundër Perëndisë.

- Perëndia është Krijuesi i tërë njerëzve; prandaj ndëshkimi është për këdo që thotë apo bën diçka të dëmshme ndaj një personi tjetër.<sup>32</sup>



<sup>33</sup> Duhet të kemi kujdes se si ua mësojmë fëmijëve pendimin. Shumë njerëz mësojnë që pendim do të thotë të lësh apo të premtosh të lësh çdo mëkat. Por kjo nuk është e saktë. Pendim është ndryshimi i mendësisë, një ndryshim qëndrimi ndaj Perëndisë, vetes dhe mëkatit. Pendimi është pranimi i mëkatit para Perëndisë: "O Perëndi, Ti ke të drejtë. Unë e kam gabim. Gjithçka që urdhëron është e mirë, e drejtë dhe e shenjtë. Unë kam dështuar. Nuk kam shpresë në vetvete". Ky është pendimi i vërtetë. Sigurohu që të theksosh besimin, dhe jo bindjen apo bërjen e veprave. Nëse theksojmë bindjen, do të kemi ndjekës dhe bërës, dhe jo besimtarë. Perëndia nuk i kërkon mëkatarit të premtojë që të lërë mëkatin e tij dhe "të mos e bëjë më", para se ta shpëtojë. Perëndia nuk bën një marrëveshje me mëkatarin. Ai nuk thotë: "Ti bëj këtë dhe unë do të bëj këtë". Perëndia nuk kërkon ndryshim para shpëtimit.

## Përsëritje

Vendos pjesët e vargut siç duhet dhe shkruaje në vijat më poshtë ose vendos një numër për çdo pjesë të vargut.

4. por në fund ajo të nxjerr
  1. Është një rrugë
  5. në rrugët e vdekjes
  2. që njeriut i duket
  3. e drejtë
- Fjalët e Urta 14:12

## Pyetje dhe përgjigje

1. Pse Perëndia pranoi Abelin dhe ofertën e tij? **Abeli i besoi dhe iu bind Perëndisë. Ai solli atë lloj oferte që i kishte kërkuar Perëndia.**
2. Pse Perëndia refuzoi Kainin dhe ofertën e Tij? **Kaini nuk i besoi dhe nuk iu bind Perëndisë. Ai nuk solli atë ofertë që i kishte kërkuar Perëndia.**
3. Çfarë bëri Kaini kur Perëndia nuk pranoi ofertën e tij? **Ai u zemërua dhe vrau Abelin.**
4. Nga e dinte Perëndia se çfarë kishte bërë Kaini? **Perëndia shikon dhe di gjithçka.**
5. Pse Perëndia ua dha Setin Adamit dhe Evës?
  - a. Perëndia ua dha Setin për të zëvendësuar Abelin;
  - b. **Perëndia dha Setin në mënyrë që Çlirimtari të lindte përmes pasardhësve të tij.**

- Ndëshkimi për mëkatin është vdekja: asnjë pagesë tjetër nuk është e pranueshme.
  - Çdo mëkat do të ndëshkohet një ditë nga Perëndia, sepse Ai është zotëruesi i vërtetë i çdo personi.
- Prapëseprapë, Kaini nuk ia vuri veshin Perëndisë - Zanafilla 4:16.
  - Kaini u largua nga Perëndia, duke ndjekur rrugët e Satanit.
  - Kaini nuk u pendua; ai refuzoi të ndryshonte qëndrimin e tij ndaj Perëndisë dhe ndaj mëkatit të tij<sup>33</sup>.

### 8. Pasardhësit e Kainit kishin prirje materialiste - Zanafilla 4:17-24.

- Pasardhësit e Kainit ndoqën shembullin e tij. Ata jetonin pa menduar për Perëndinë.
  - Por e mbushën jetën me punë dhe zotërime: gjërat që donin të kishin.
  - Ata ndërtuan qytete, ngritën kështjella dhe bënë vegla dhe instrumente muzikore.
  - Nuk ka asgjë të gabuar në këto gjëra, por e gabuara ishte që e kishin mbushur jetën e tyre me këto gjëra dhe që nuk donin t'ia dinin për Perëndinë.
  - Ata i mbushën mendjet dhe kohën e tyre me gjërat që dëshironin. Ata nuk kishin interes apo kohë për Perëndinë dhe për gjërat që Ai donte që të dinin.
  - Ata ishin nën kontrollin e Satanit.

Mendoni:

E shikoni se çfarë efekti të tmerrshëm kishte sjellë tashmë në botë mosbindja ndaj Perëndisë! Meqë Adami dhe Eva mëkatuan, tërë pasardhësit e tyre lindën mëkatarë, u ndanë nga Perëndia dhe nuk ishin në të njëjtën mendje me Të. Djali i tyre i parë, Kaini, vrau djalin e tyre të dytë, Abelin. Kaini u largua nga Perëndia dhe nuk dëgjonte fjalën e Tij. Si rezultat fëmijët e Kainit dhe fëmijët e tyre ndoqën rrugët e tyre në vend të rrugëve të Perëndisë. Ata jetuan sipas rrugëve të tyre mëkatore, sepse as nuk e njihnin Perëndinë dhe, as e kërkonin Atë apo të vërtetën e Tij.

### 9. Perëndia dha Setin për të zëvendësuar Abelin - Zanafilla 4:25.

- Perëndia i dha Adamit dhe Evës një fëmijë tjetër në vend të Abelit, i cili u vra nga Kaini.
- Në kopsht Perëndia kishte premtuar të dërgonte një çlirimtar që do të mposhte Satanin.
  - Ky Çlirimtar do të vinte përmes pasardhjes së Abelit që kishte besuar te Perëndia.
  - Por Satani drejtoi Kainin për të vrarë Abelin. Satani u përpoq në çdo mënyrë për të penguar planin e Perëndisë për të dërguar Çlirimtarin.

Mendoni:

A do të thotë kjo që plani dhe premtimi i Perëndisë për të dërguar Çlirimtarin morën fund? Jo! Perëndia bën gjithmonë atë që premtton. Ai nuk heq dorë apo nuk ndryshon për shkak të gjërave që bën Satani.

- Në vend të Abelit Perëndia u dha Setin Adamit dhe Evës.
  - Edhe Seti lindi i ndarë nga Perëndia, por ai i besoi Atij, ashtu siç bëri Abeli.
  - Perëndia planifikoi që Çlirimtari do të vinte në botë përmes pasardhjes së Setit.

Perëndia interesohet për mëkatarët. Perëndia interesohet për ty dhe mua. Asgjë nuk mund t'i ndalë planet e Tij. Abeli besoi te Perëndia dhe, edhe pse Abeli vdiq, Perëndia po e mbante premtimin e Tij për të dërguar një çlirimtar për të gjithë ata që, si Abeli, besuan te Perëndia.

# Mësimi 15 Perëndia gjykon tërë botën

## Qëllimi

Ky mësim përfshin kohën nga Kaini dhe Abeli deri te Noeu dhe përmbytja. Tregon gjithëdijen e Perëndisë dhe zemërimin e Tij kundër mëkatit, por edhe hirin dhe durimin e Tij duke kërkuar që tërë njerëzit të pendohen. Sovraniteti dhe plotfuqia e Perëndisë tregohen në kontrollin që Ai ka mbi tërë njerëzimin.

Fëmijëve të klubit do t'u tregosh gjithashtu:


- Që Perëndia bën atë që thotë; Ai do të ndëshkojë çdo mëkat.
- Që Perëndia shpëton ata që besojnë te Ai dhe që i afrohen sipas mënyrës së Tij.
- Që ka vetëm një mënyrë për t'iu afruar Perëndisë.
- Që Perëndia është i vetmi që mund të na shpëtojë.
- Që Perëndia është besnik; Ai i mban gjithmonë premtimet e Tij.

## Hyrje

Shpjegoi fëmijëve të klubit që pothuajse çdo kulturë ka historinë e përmbytjes. Është një fakt historik. Por historitë, përveç tregimit të Zanafillës, janë të mbushura me karaktere mitologjike dhe shpesh me shumë hollësi të çuditshme që nuk i afrohen rrëfimit biblik. Pse? Sepse çdo histori tjetër është transmetuar brez pas brezi gojë më gojë. Rrugës njerëzit e këtyre shoqërive, që nuk njihnin apo nuk besonin Perëndinë e vërtetë, ndryshuan, shuan dhe hoqën nga e vërteta. Këto histori kanë vetëm një pjesë të vogël të asaj që ka ndodhur në të vërtetë. Satani është duke bërë pjesën e tij për të ngatërruar mendjet e njerëzve për të vërtetën. Por Perëndia i pa të gjitha dhe është në gjendje të na thotë saktësisht se çfarë ka ndodhur. Ai ua tregoi profetëve të Tij hollësitë e vërteta rreth përmbytjes. Sa mirë që kemi Biblën. Ne nuk duhet të varem nga ajo që thonë njerëzit e tjerë për njohjen tonë të Perëndisë!

## Figurat

- Figura 13: Hiri
- Grafiku 15: Një derë
- Grafiku 5: Atmosfera e tokës
- Figura 9: Arka e Noeut



## Historia

“Xhaxhi Piter, a e kujton atë shokun për të cilin të fola që kishte vjedhur te shtëpia e një polici?” - pyeti Xhoni.

“Po, e kujtoj” - u përgjigj xhaxhi Piteri.

“E di çfarë, e pashë sot” - tha Xhoni. “Ai nuk kishte nxjerrë ndonjë mësim nga arrestimi. Ai po mburrej sot se sa shumë gjëra kishte vjedhur dhe nuk ishte kapur”.

“Kam qenë duke pyetur veten” - tha Karola.

“Për çfarë, Karola” - pyeti xhaxhai i saj.

“Po sikur një person të mos kapet?” - pyeti Karola. “Dua të them, nëse vjedh diçka apo bën diçka të keqe, por askush nuk e di. Mendoj që nuk do të ndëshkohet kurrë, apo jo?”.

“Nuk është e vërtetë, Karola” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “A kujton se çfarë ndodhi me Adamin dhe Evën kur u nxorën nga kopshti? A mund të futeshin në kopsht pa e marrë vesh Perëndia?”.

“Jo,” - tha Karola, - “Perëndia sheh gjithçka”.

“Ke të drejtë” - pranoi xhaxhi Piteri. “Perëndia shikon dhe do të ndëshkojë çdo mëkat. Ndëshkimi për mëkatin ishte vdekja për Adamin dhe Evën, ndëshkimi i cili është i njëjtë edhe për ne sot”.

“Po mëkatet e vogla?” - pyeti Xhoni.

“Mëkati është mëkat” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Perëndia është i shenjtë. Ai nuk do të tolerojë mëkatin. Mëkati na ndan nga Perëndia. Ne të gjithë kemi lindur mëkatarë. Vetëm Perëndia mund të sigurojë një mënyrë se si njeriu mëkatar t'i afrohet Atij”.

“Xhaxhi Piter, kam një pyetje” - tha Karola. “Nëse mëkati është kaq i tmerrshëm dhe Perëndia do të gjykojë çdo mëkat, pse njerëzit vazhdojnë të mëkatojnë?”.

“Pyetje me vend” - tha xhaxhi Piteri. “Bibla na thotë që në fakt njerëzit duan më shumë mëkatin e tyre sesa Perëndinë. Ajo na thotë edhe që erdhi një kohë kur njerëzit u bënë aq mëkatarë, saqë e kishin mendjen vetëm që të bënin gjëra të këqija”.

“Kjo është e tmerrshme!” - tha Karola. “Ata duhet të kenë pasur ndonjë person si ty që duhet t'u ketë folur për mëkatin e tyre”.

“Shiko,” - tha xhaxhi Piteri duke buzëqeshur, - “ata kishin Noeun dhe Bibla e quan atë predikues të drejtësisë. Për 120 vjet Perëndia dhe Noeu i paralajmëruan njerëzit e kohës së tij që të pendoheshin: të pranonin se ishin mëkatarë dhe t'i besonin premtimit të Perëndisë për një çlirimtar. Por ata refuzuan të dëgjonin. Ata interesoheshin vetëm për vete dhe për kënaqësitë e tyre”.

“Kujtoj që kam dëgjuar për përmbytjen, arkën dhe kafshët” - tha Xhoni.

“Kjo është vetëm një pjesë e saj” - tha xhaxhi Piteri. “Pjesa e rëndësishme e historisë është gjykimi i mëkatit nga Perëndia ndaj tërë botës dhe mbrojtja e tij ndaj Noeut dhe familjes së tij. Ata i besuan Perëndisë dhe Perëndia i shpëtoi”.



## Le të shohim në Bibël



**Ezekieli 18:32** - “Unë në fakt nuk ndej asnjë kënaqësi me vdekjen e atij që vdes” thotë Zoti, Zoti. “Ndërroni rrugë, pra, dhe do të jetoni”.

## Le të mendojmë

1. Cili është ndëshkimi i Perëndisë për mëkatën?  
a. Burgimi; b. **Vdekja**; c. Pagesa e një gjobe.
2. A është e vërtetë që nëse nuk kapesh, nuk ndëshkohesh? **Po / Jo**.
3. A ndëshkohemi për mëkatet e vogla? **Po / Jo**.
4. A i duan njerëzit mëkatet e tyre më tepër sesa duan Perëndinë? **Po / Jo**.
5. A u shpëtuan Noeu dhe familja e tij nga përmbytja, sepse besuan në Perëndinë? **Po / Jo**.

## Mësime nga Fjala e Perëndisë

Këto pjesë nga Zanafilla janë për ne sot, që të njohim karakterin e Perëndisë: urrejtjen e Tij ndaj mëkatit, durimin e Tij ndaj njerëzve, dëshirën e Tij që të gjithë njerëzit të shpëtohen, gjykimin e Tij të shpejtë dhe të sigurt, kujdesin dhe shpëtimin e Tij plot hir për të gjithë ata që i afrohen Atij me anë të besimit. Sa e rëndësishme është për ne që t'i mësojmë historitë e Biblës si e **vërteta e Perëndisë**, jo si mit apo alegori!

Në mësimin tonë të fundit mësuam për sigurimin e hirshëm të Perëndisë, të një mënyre se si njerëzit mund t'i afroreshin Atij me anë të besimit. Ju patë edhe rezultatet e tmerrshme të mëkatit, të transmetuara nga njëri brez në tjetrin. Historia që do të lexosh përmendet shumë herë në Bibël dhe paraqitet si fakt historik.

### 1. Popullsia e botës ishte rritur.

- Në kohën e Noeut, Semit, Kamit dhe Jafetit kishte një popullsi të madhe njerëzish që jetonin në tokë.
- Por shumica e njerëzve ishin të interesuar vetëm për të kaluar atë që atyre u dukej si kohë e mirë për ta.<sup>34</sup> Ata nuk mendonin aspak për mënyrën se si mund t'i pëlqenin Perëndisë.

### 2. Perëndia Frymë e Shenjtë po hahej me njerëzit - Zanafilla 6:3.

- Perëndia e pa dhe e urrente mëkatën e këtyre njerëzve, por Ai i donte ata dhe donte që të pendoheshin.
  - Perëndia donte që të ndryshonin mendje; të pranonin se e kishin gabim.
  - Perëndia donte që ata të besonin tek Ai.
- Perëndia Frymë e Shenjtë po u thoshte vazhdimisht që të pendoheshin, por ata nuk pendoheshin.
- Perëndia i paralajmëroi se nuk do t'ua thoshte në mënyrë të vazhdueshme mesazhin e Tij.
  - Nëse do të vazhdonin ta kundërshtonin, Ai do t'i linte të ndiqnin Satanin dhe Ai do t'i ndëshkonte.
  - Perëndia tha që do t'u jepte 120 vjet kohë. Nëse nuk pendoheshin për 120 vjet, Ai do t'i ndëshkonte.

*Shënim: Emrat e brezave të besimtarëve (linja e Çlirimtarit) nga Adami te Noeu janë: Adami, Seti, Enoshi, Kenani, Mahalaleeli, Jaredi, Enoku, Metuselahu, Lameku dhe Noeu. Nga Adami te Noeu ishin 10 breza të njerëzve që i besuan Perëndisë dhe vazhduan të prisnin për Çlirimtarin, i Cili ishte premtuar në kopshtin e Edenit. Pjesa e historisë së Biblës që do të studiojmë sot flet për hirin e Perëndisë ndaj Noeut dhe për tre bijtë të Tij Semin, Kamin dhe Jafetin dhe familjet e tyre. Kjo histori ka ndodhur 1500 vjet apo më shumë pas krijimit të Adamit (Zanafilla 5) duke hamendësuar se nuk ka ndërprerje kohe.*

<sup>34</sup> Ti po mëson me të vërtetë nga Zanafilla 6:1-2, por këto vargje janë shumë të vështira për t'u interpretuar dhe mund të shkaktojnë diskutim të panevojshëm në klasë. Prandaj është mirë që t'i shmangësh.

☺ Thuaj fëmijëve të klubit të thonë Ezekielin 18:32.

<sup>35</sup> Mendo: Jo vetëm njerëzit në kohën e Noeut, por edhe ne të gjithë jemi pasardhës të Adamit. Të gjithë ne kemi lindur mëkatarë, të ndarë nga Perëndia. Njerëzit mëkatojnë edhe sepse, e duan mëkatin e tyre (referou historisë së sotme). Akush nuk mund të fajësojë dikë tjetër. Ne nuk mund të fajësojmë Adamin, Perëndinë apo Satanin. Ne vetë kemi zgjedhur të mëkatojmë.

<sup>36</sup> Ti po parafrazon këtë listë mëkatesh (po e thua me fjalë të tjera) Romakëve 1:29-32.

<sup>37</sup> Dikush mund të pyesë si mund të "pendohet" Perëndia nëse Ai nuk ndryshon kurrë. Mund t'i përgjigjesh duke i thënë që fjala "pendim" në shumë vende të Dhiatës së Vjetër do të thotë "të të vijë keq për diçka" apo "të trishtësohesh". Ky interpretim është sipas parimeve për të kuptuar Biblën: Ne duhet ta shikojmë gjithmonë një pjesë në kontekstin e saj, pra, të lidhur me vargjet përreth; dhe më e rëndësishmja në bazë të asaj që është bërë e njohur në mënyrë të qartë rreth Perëndisë. Të vërtetat e mëdha apo doktrinat, pohohen në mënyrë të qartë shumë, shumë herë. Prandaj një rast i vetëm që duket se kundërshton atë që kemi parë në shumë pjesë të tjera nuk duhet të merret si kontradiktë, por si një ndodhi që ka nevojë për njohje të veçantë apo thellim të mëtejshëm. E vërteta nuk ndryshon. Perëndia na i ka bërë shumë të qarta ato gjëra që janë të domosdoshme që ne ta njohim Atë dhe Fjalën e Tij. Nëse një pjesë nuk është e qartë, mund të mbështetemi në faktin që me studim të mëtejshëm apo në kontekstin e duhur, Perëndia do të na ndihmojë ta kuptojmë.

### 3. Shtimi i ligësisë - Zanafilla 6:5, 11.

- Shumica e njerëzve ndiqnin rrugët jo të perëndishme të Kainit.
  - Ata po mëkatonin gjithmonë e më shumë.
  - Ata refuzuan t'i besonin mesazhit të Perëndisë dhe t'i zinin besë Atij.
- Këta njerëz kishin lindur mëkatarë, sepse ishin pasardhës të Adamit. Ata e donin edhe mëkatin e tyre dhe me dashje refuzuan të pajtoheshin me Perëndinë.<sup>35</sup>
- Njerëzit në kohën e Noeut refuzuan ta pranonin Perëndinë, edhe pse e dinin që Ai ekzistonte.
  - Vepra e Projektuesit (Perëndisë) ishte rreth tyre në krijimin e Tij, por ata nuk ishin mirënjohës ndaj Perëndisë, as nuk besonin tek Ai.
  - Perëndia u foli atyre edhe përmes njerëzve që quheshin profetë.
  - Një prej pasardhësve të Setit, Enoku, ishte një prej profetëve të Perëndisë. Tani Perëndia po i fliste Noeut. Noeu u dha njerëzve mesazhin e Perëndisë, por ata refuzuan të pendoheshin.
  - Njerëzit nuk kishin asnjë arsye për sjelljen e tyre. Ata po rebeloheshin kundër Perëndisë. Mendjet e tyre ishin të përqendruara te gjërat materiale, te trupat e tyre dhe te gjërat që dëshironin të kishin në jetë<sup>36</sup>.
  - Ata ishin krenarë, egoistë dhe mburravecë.
  - Ata donin atë që kishin të tjerët.
  - Ata haheshin me fjalë dhe ziheshin tërë kohën.
  - Ata ishin mizorë dhe shumë prej tyre madje ishin vrasës.
  - Ata bënë dredhi, gënjenin dhe mashtronin njëri-tjetrin vazhdimisht.
  - Ata përgojonin dhe thoshin gjëra të këqija për të tjerët pas shpine vazhdimisht.
  - Ata injoronin planin fillestar të Perëndisë për martesën; njerëzit merrnin shumë gra dhe nuk ishin besnikë ndaj familjeve të tyre.

### 4. Perëndia pa botën mosbesuese dhe mëkatin e saj - Zanafilla 6:4, 12.

- Perëndia pa tërë mëkatin e tyre (Hebrenjve 4:13).
  - Ata mund t'i kishin fshehur gënjeshttrat e tyre, mëkatet seksuale, vjedhjen dhe vrasjen nga të tjerët, por asgjë nuk fshihet para Perëndisë; Ai pa gjithçka. Perëndia shikon përherë gjithçka.
  - Perëndia i njeh mendimet tona dhe shikon gjithçka që bëhet në fshehtësi.

### 5. Perëndia vendosi të shkatërronte botën - 6:6-7.<sup>37</sup>

- Njerëzit ishin aq të ligj, saqë Zoti tha se do t'i shkatërronte ata dhe gjithçka në tokën që Ai kishte bërë dhe që ua kishte dhënë atyre.

*Mendoni:*

*A mendoni se Perëndia do t'i shkatërronte me të vërtetë të gjithë ata që nuk do të pendoheshin dhe që nuk do të besonin tek Ai? Po, Perëndia bën atë që thotë.*

*Mendoni përsëri:*

*Në kopshtin e Edenit Perëndia i tha Adamit dhe Evës se, nëse do të hanin frutën e pemës së njohjes të së mirës e të së keqes, ata do të vdisnin. Ata nuk u bindën dhe vdiqën, ashtu siç kishte thënë Perëndia. Perëndia ua bëri të qartë Kainit dhe Abelit se, nëse donin t'i afroheshin Atij dhe të pranoheshin prej Tij, duhet të sillnin një kafshë dhe të derdhnin gjakun e saj. Perëndia e kishte me tërë mend atë që tha. Ai e refuzoi Kainin, sepse ai iu afrua sipas mënyrës së tjetër. Tani, në kohën e Noeut, Perëndia tha që do të shkatërronte tokën dhe tërë jetën në të, duke dërguar një përmbytje të madhe. Perëndia do të dërgonte shiun, edhe pse nuk kishte rënë shi më parë. A e mban Perëndia Fjalën e Tij? A ishin ato vetëm kërcënime?*

*Sa herë ke kërcënuar të bësh diçka kur ke qenë i zemëruar dhe pastaj ke harruar kur je "zbutur"? Ose sa herë kanë kërcënuar të të ndëshkojnë dhe pastaj kanë harruar ta bëjnë? A është Perëndia si njerëzit? A bën Ai thjesht kërcënime? Jo! Perëndia bën gjithmonë atë që thotë.*

# Mësimi 15

## (vazhdim)

<sup>38</sup> Fakti që Noeu i solli flijime Zotit tregohet te:

1. Zanafilla 8:20: ai flijoi mbi altar;
  2. Shkrimi nuk ka një model tjetër për faljen e mëkatit. Para se të vinte Jezu Krishti, të gjithë ata që besonin sillnin flijime si një akt besimi në premtimin e Perëndisë për të dërguar një Shpëtimtar.
- Levitiku 17 dhe Hebrejve 9:22b e ilustron në mënyrë të qartë këtë parim.

<sup>39</sup> Nëse fëmijët pyesin se si ishte arka, thuaju që nuk e dimë me saktësi se si ngjante arka, por në Bibël Perëndia tregon saktësisht përmasat që janë domethënëse për ne sot. Përmasat që Perëndia i dha Noeut për arkën ishin me të njëjtën gjatësi, gjerësi e lartësi me vaporët e mëdhenj që ndërtoheshin në 1900. Perëndia krijoi gjithësinë; Perëndia caktoi ligje që i bëjnë gjërat të pluskojnë; Perëndia nuk e kishte problem të krijonte një plan të përsosur për një anije të madhe! Dhe, me aq sa dimë, asnjë anije kaq e madhe nuk është ndërtuar që nga koha e arkës deri në shekullin e 20-të! Këto janë hollësi interesante të cilat na kujtojnë për njohjen e thellë që ka Perëndia për tërë gjërat dhe për të vërtetën e Biblës.

=> Trego grafikun 15: Një derë. *Shënim: Sigurohu që të mësosh në mënyrë të qartë konceptin e "një dere" dhe "një arke". Do t'i referohesh kësaj më vonë kur të mësosh për Jezu Krishtin, i Cili është "rruga e vetme" e shpëtimit.*

Bibla na thotë që para përmbytjes njerëzit jetonin për qindra vjet. Zanafilla 5 jep shumë shembuj për këtë. Shkencëtarët kanë sugjeruar teori të ndryshme për këto periudha të gjata kohe, por ne nuk kemi një arsye të qartë të pohuar në Fjalën e Perëndisë; ne thjesht e dimë që kjo është e vërtetë. Duke marrë në konsideratë që njeriu jetonte për qindra vjet, periudha 120- vjeçare e paralajmërimit të Perëndisë ishte brenda periudhës së jetës së një njeriu mesatar. Njerëzit nuk kishin arsye të refuzonin së dëgjuari Perëndinë (as njerëzit sot nuk kanë arsye).

## Perëndia gjykon tërë botën

### 6. Perëndia tregoi hir ndaj Noeut - Zanafilla 6:8-10.

- Për shkak të dashurisë dhe mëshirës së Perëndisë, një njeri dhe familja e tij nuk do të shkatërroheshin.
- Noeu kishte lindur mëkatar, nën kontrollin e Satanit, ashtu si tërë pasardhësit e Adamit.
  - Noeu nuk meritonte të shpëtohej nga Perëndia. Edhe Noeu meritonte të ndëshkohej.
- Por Noeu iu afrua Perëndisë si Abeli, Seti dhe Enoku, duke sjellë gjakun e kafshëve.
  - Noeu dëgjoi fjalët që Perëndia i tha atij.
  - Noeu u pendua, besoi dhe iu afrua Perëndisë sipas mënyrës që i kishte thënë Ai.<sup>38</sup>
  - Noeu i besoi Perëndisë që ta shpëtonte përmes Çlirimtarit që do të vinte.
- Për shkak të hirit të Tij Perëndia e fali dhe e pranoi Noeun. (Kemi folur më parë për hirin: le të shohim nëse mund të mbajmë mend domethënien e kësaj fjale të mrekullueshme.) => Trego grafikun 13: Hiri. Përmende përkufizimin e kësaj fjale disa herë dhe thuaju fëmijëve që ta thonë së bashku.

### 7. Perëndia i dha udhëzime Noeut - Zanafilla 6:13-21.

- Për shkak se njerëzit ishin të këqij dhe nuk ndryshonin mendjen dhe t'i afroheshin Perëndisë, Ai vendosi të shkatërrojë tërë tokën. Po Noeu dhe familja e tij?
  - Perëndia i tha Noeut se Ai do të dërgonte një përmbytje të madhe që do të mbulonte tërë tokën.
  - Perëndia i tha gjithashtu Noeut të ndërtonte një arkë të madhe, në mënyrë që tërë ata që besonin te Perëndia të shpëtoheshin.
  - Kjo arkë duhet të ndërtohej ashtu siç i tha Perëndia Noeut. Arka duhet të ndërtohej sipas planit të Perëndisë. Perëndia i dha Noeut udhëzime shumë të mira.<sup>39</sup>
  - Ka një gjë shumë të rëndësishme që duhet të kujtojmë rreth mënyrës se si Perëndia i tha Noeut ta ndërtonte këtë arkë. Perëndia i tha Noeut të bënte vetëm **një derë** në një anë të arkës.
  - Kishte vetëm një mënyrë për t'u futur brenda.
  - Çdo person dhe çdo kafshë që do të shpëtohej nga gjykimi i Perëndisë duhet të futej në arkë nga dera e Tij.
  - Kishte vetëm **një arkë** në të cilën njerëzit mund të shpëtoheshin nga zemërimi i Perëndisë dhe kishte vetëm një derë nga e cila njerëzit mund të futeshin në arkë.

### 8. Noeu iu bind Perëndisë - Zanafilla 6:22.

- Noeu besoi te Perëndia. Ai i zuri besë Perëndisë dhe u mbështet tek Ai për të shpëtuar atë dhe familjen e tij nga përmbytja, të cilën Perëndia tha se do ta dërgonte.
  - Kujtoni, nuk kishte rënë kurrë shi në tokë. Deri në atë kohë bota ujitej nga vesa e cila ngrihej nga toka. Askush nuk kishte parë shi.
- Megjithatë, Noeu besoi që Perëndia nuk do të gënjente kur tha se do të dërgonte përmbytjen.
- Noeu i besoi Perëndisë, kështu që iu bind Atij dhe ndërtoi arkën.

### 9. Perëndia i tha Noeut të sillte familjen e tij, kafshët dhe zogjtë në arkë - Zanafilla 7:1-5.

- Noeu i paralajmëroi njerëzit për gjykimin e ardhshëm të Perëndisë.
- Njerëzit në kohën e Noeut nuk i pranuan paralajmërimet e Perëndisë të dhëna përmes Noeut.
- Perëndia priti me durim për 120 vjet që ata të ndryshonin mendje, por Ai nuk do të priste më; ishte koha që Perëndia t'i ndëshkonte.<sup>40</sup>
- Para se të fillonte të binte shi, Perëndia i tha Noeut të merrte familjen e tij dhe kafshët e zgjedhura në arkën e përfunduar.
- Noeu besoi që Perëndia do të shkatërronte tërë botën.

## Përsëritje

A	Y	L	B	B	N	F	P	V	O	I	S
N	O	E	U	B	N	N	E	C	C	F	S
B	U	L	L	B	F	F	R	C	C	M	A
V	K	B	B	V	V	F	M	L	C	M	A
B	K	S	H	I	U	F	B	L	A	K	A
A	I	B	B	V	F	F	Y	L	A	K	A
R	K	N	D	B	N	F	T	L	G	A	T
K	Y	N	E	O	O	G	J	G	G	T	T
A	U	N	R	O	N	G	A	G	G	I	T
U	U	O	A	N	O	O	K	K	K	F	F
I	Y	N	O	O	K	A	F	S	H	E	T
O	Y	O	N	N	N	H	H	J	J	K	K

## Pyetje e përgjigje

1. Cili ishte qëndrimi i shumicës së njerëzve në kohën e Noeut? **Ata mendonin vetëm për t'i pëlqyer vetes. Ata ishin egoistë dhe të dhunshëm. Ata nuk ishin të interesuar ta njihnin dhe t'i pëlqenin Perëndisë.**
2. Çfarë tha Perëndia se do të bënte duke qenë se njerëzit nuk pendoheshin? **Perëndia tha që do të shkatërronte çdo qenie të gjallë në tokë.**
3. Pse vendosi Perëndia të shpëtonte Noeun? **Sepse Noeu ra dakord me Perëndinë që ishte mëkatar dhe i besoi Atij për ta shpëtuar përmes Çlirimtarit që do të vinte.**
4. Çfarë i tha Perëndia Noeut të bënte? **Perëndia i tha Noeut të ndërtonte një arkë.**
5. Si u futën në arkë ata që shpëtuan nga përmbytja? **Ata u futën përmes derës së vetme, derë të cilën Perëndia i kishte thënë Noeut ta bënte në cep të arkës.**

- Noeu besoi edhe se ai dhe familja e tij mund të shpëtoheshin vetëm nga Perëndia, kështu që ai bëri atë që i tha Ai.
- Perëndia nuk e shpëtoi Noeun për shkak të jetës së tij të mirë. Perëndia e shpëtoi Noeun sepse Ai u pajtua me Perëndinë dhe besoi në Të.

### 10. Të gjithë ata u futën përmes një dere - Zanafilla 7:15-16.

- Noeu, familja e tij dhe tërë kafshët e zgjedhura, u futën në arkë përmes një dere të vetme, të cilën Perëndia i tha Noeut që ta bënte. Kjo ishte mënyra e vetme që dikush mund të shpëtohej nga përmbytja, si dhe zemërimi i madh i Perëndisë kundër mëkatit.

### 11. Perëndia mbyll derën nga jashtë - Zanafilla 7:16b.

- Pasi ishin të gjithë brenda, Perëndia mbylli derën.  
Mendoni:  
Zoti e mbylli derën. Ndonjëherë lexojmë gjëra të mrekullueshme në Bibël pa kuptuar atë që ka thënë Perëndia! Vetë Perëndia mbylli Noeun, po ashtu edhe familjen e tij bashkë me tërë kafshët brenda, në vendin e sigurt.
- Perëndia nuk do të linte më tepër kohë që njerëzit e tjerë të ndryshonin mendjen dhe t'i besonin Atij.
  - Kur Perëndia e mbylli derën, ishte shumë vonë. Edhe nëse thërrisnin apo përgjëroheshin pas dere, ata nuk do të futeshin në arkë.
  - Noeu nuk mund t'i fuste, sepse dera ishte mbyllur nga Perëndia. Ata nuk kishin mundësi të shpëtoheshin.
- Ata që ishin brenda arkës ishin të sigurt, sepse Perëndia i kishte mbyllur brenda.

Mendoni:

Kur Perëndia i nxori Adamin dhe Evën nga kopshti, larg pemës së jetës, a kishte ndonjë mundësi për ta për t'u kthyer pas? Jo, asnjë! Kur Perëndia vendos që ka ardhur koha të ndëshkojë botën, nuk ka shpëtim.

### 12. Perëndia shkatërroi të gjithë ata që ishin jashtë arkës - Zanafilla 7:17, 23.

- Pasi Perëndia e mbylli derën e arkës, Ai dërgoi shiun.
  - Perëndia ka kontroll mbi tërë tokën, shiun, erën, diellin, hënën, yjet dhe çdo gjë tjetër. Ai i krijoi tërë këto gjëra dhe i kontrollojnë të gjitha.
- Kishte aq shumë ujë, saqë e mbuloi tërë botën, deri edhe malet më të larta. Nga doli tërë ai ujë?
  - Tani kur kishte ardhur koha që Perëndia të dërgonte përmbytjen në tokë, Perëndia bëri që uji që kishte vendosur në qiell të binte në tokë si shi.
- => Grafiku 5: Atmosfera e tokës
- Ky nuk ishte shi i zakonshëm; ky ishte një **rrebesh**! Uji doli edhe nga poshtë burimeve tokësore (Zanafilla 8:2). Perëndia mund të bëjë gjithçka. Vetëm Ai është Shumë i Larti.
- Perëndia bëri të bjerë shi për 40 ditë e net derisa tërë toka u mbulua.
  - => Figura 10: Arka e Noeut
- Vetëm Noeu dhe familja e tij besuan te Zoti dhe u futën në arkë.
- Tërë njerëzit e tjerë kishin refuzuar të besonin dhe Perëndia i shkatërroi të gjithë.

Perëndia është i shenjtë dhe i drejtë. Ai është edhe i durueshëm dhe një Perëndi dashurie, por Ai është me siguri një Perëndi i zemërimit të madh kundër mëkatit. Ngaqë Noeu dhe familja e tij besuan te Perëndia, Ai i ruajti të sigurt brenda arkës.

# Mësimi 16 Perëndia kujtohet për Noeun pas përmbytjes

## Qëllimi

Ky mësim plotëson historinë e shpëtimit të Noeut dhe familjes së tij nga Perëndia dhe vendosjen e tyre në tokë pas përmbytjes. Ti do t'u tregosh fëmijëve të klubit:


- Që Perëndia nuk do të lejojë asnjë përpjekje për të hedhur poshtë autoritetin e Tij.
- Se si Perëndia krijoi grupet e ndryshme të gjuhës.
- Sovraniteti i Perëndisë në tërë çështjet e njerëzve.
- Gjithashtu mund të duash që fëmijët:
- Të kuptojnë që Perëndia nuk do të miratojë ndonjë përpjekje për hedhur poshtë autoritetin e Tij.
- Të kuptojnë që Perëndia është më i larti dhe Ai është suprem.
- Të kuptojnë që çdo pjesë e historisë sonë është e rrënjësuar në veprat dhe planet e Perëndisë.
- Të shikojnë që Bibla paraqet një histori të njeriut të bazuar në fakte.

## Hyrje


Shpjegoju fëmijëve të klubit tënd që edhe pse emri i Perëndisë është “hequr” nga shumë libra të historisë, emri i Tij nuk mund të fshihet kurrë nga e vërteta! Perëndia është kontrolluesi sovran i çështjeve njerëzore. Çdo përpjekje për të shpjeguar rrjedhën e historisë duhet të përfshijë Krijuesin tonë dhe Perëndinë sovran. Në këto mësimet do të njohësh Perëndinë e mbarë historisë: Perëndinë e Biblës.

## Figurat

- Figura 10: Flijimi i Noeut dhe ylberi



- Figura 11: Kulla e Babelit



## Historia

“Xhaxhi Piter, po mendoja për diçka” - tha Xhoni.

“Për çfarë?” - pyeti xhaxhai.

“Kam vënë re,” - u përgjigj Xhoni, - “që në klasën time në shkollë dhe në librat e historisë, nuk thuhet asgjë për Perëndinë”.

“Ajo që po thua është shumë e vërtetë” - tha xhaxhi Piteri. “Shumë njerëz nuk i besojnë Perëndisë dhe ata nuk shohin ndonjë nevojë për ta përfshirë Atë dhe veprat e Tij të mëdha në histori”.

“Kjo është qesharake” - tha Karola. “Perëndia është më i madhi! A e dinë ata se si është Perëndia?”.

“Kjo është një pyetje me vend” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Shumë njerëz vetëm sa kanë dëgjuar për Të dhe janë shumë të ngarkuar në jetët e tyre, sa nuk kanë kohë as të mendojnë për Perëndinë. Edhe pse Perëndia është më i rëndësishmi, përgjatë historisë, njerëzit kanë refuzuar ta dëgjojnë Atë. Atyre nuk u intereson Fjala e Tij. Ata madje sajuan perëndi të rremë për veten dhe i adhuruan ata”.

“Por Perëndia krijoi gjithçka” - tha Xhoni. “Ai është më i madh se çdo gjë apo se cilido perëndi i rremë që mund të bëjnë ata!”.

“Ke të drejtë” - pranoi xhaxhai i tij. “Por njerëzit janë më tepër të interesuar t’i pëlqejnë vetes, se sa të kujdesen për njohjen e Atij që i krijoi”.

“A e lejoj këtë Perëndia?” - pyeti ai Karolën.

“Karola, a e kujton përmbytjen” - kujtoi xhaxhi Piteri. “Perëndia gjykoi tërë botën atëherë, sepse njerëzit refuzuan të besojnë tek Ai! Të gjithë vdiqën përveç Noeut dhe familjes së tij. Ata besuan te Perëndia, si pasojë Ai u kujdes për ta”.

“Çfarë ndodhi pas përmbytjes?” - pyeti Xhoni. “A besuan te Perëndia tërë njerëzit që lindën nga familja e Noeut?”.

“Më vjen keq t’ju them se nuk besuan” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Njerëzit ishin mëkatarë në atë kohë, ashtu si edhe tani. Perëndia mban një regjistër të çdo veprë të njerëzve. Megjithatë, edhe pse Perëndia njeh çdo mendim që kemi dhe çdo fjalë që themi, Ai nuk do të dërgojë një përmbytje përsëri për t’i shkatërruar tërë njerëzit”.

“Çdo mendim dhe veprë? Kjo është e frikshme!” - tha Xhoni. “Perëndia e urren akoma mëkatin, apo ajo?”.

“Po” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Perëndia nuk ndryshon kurrë. Ai është gjithmonë i drejtë, i shenjtë dhe besnik. Le të shohim në Bibël ku na tregohet për një rast tjetër kur gjykimi i Perëndisë ndaj mëkatis të njeriut ndryshoi rrjedhën e historisë”.



## Le të shohim në Bibël



Isaia 45:18 - “Sepse kështu thotë Zoti që ka krijuar qiejt, ai, Perëndia që ka formuar tokën dhe e ka bërë; ai e ka vendosur, nuk e ka krijuar pa trajtë, por e ka formuar që të banohej: ‘Unë jam Zoti dhe nuk ka asnjë tjetër’”.

## Le të mendojmë

1. A është Perëndia më i fuqishmi në historinë tonë? **Po** / Jo.
2. A duan të gjithë njerëzit të mësojnë dhe mendojnë për Perëndinë? **Po** / Jo.
3. A adhurojnë disa njerëz perëndi dhe gjëra të rreme, të cilat i kanë bërë me duart e tyre? **Po** / Jo.
4. A është Perëndia më i madh se gjithçka që ka krijuar apo që ka bërë njeriu? **Po** / Jo.
5. A e urren apo e ndëshkon përsëri Perëndia mëkatin? **Po** / Jo.

## Mësime nga Fjala e Perëndisë

Shpjegoi fëmijëve të klubit tënd që shumë shkencëtarë sot shikojnë që historia biblike e përmbytjes është shpjegimi shkencor për numrin e madh të mbetjeve fosile të kafshëve, si dinozaurët dhe kafshët e tjera që nuk janë zhdukur.

Përmbytja e madhe është edhe shkaku i shumë shkëmbinjve dhe formimeve të tokës. Këto nuk u formuan miliona vjet më parë (ashtu siç mësojnë disa), por u formuan përmes përmbytjes. Sa më tepër mësojmë për Biblën, aq më tepër kuptojmë që Fjala e Perëndisë është një histori e mahnitshme, e përpiktë dhe shkencore.

### 1. Perëndia u kujtua për Noeun dhe tërë ata që ishin në arkë - Zanafilla 8:1-4, 14-17.

- Perëndia e ruajti të sigurt në arkë Noeun, familjen e tij, ashtu si edhe kafshët.
  - Perëndia nuk e harroi Noeun dhe të tjerët në arkë. Ai tha se do t'i shpëtonte dhe e mbajti fjalën. Ai bën atë që thotë. Perëndia nuk ndryshon kurrë; Ai nuk harron kurrë. Perëndia tha se Ai do të shkatërronte gjithçka jashtë arkës dhe e mbajti fjalën.
- Perëndia ndali shiun. Ai dërgoi një erë të fortë për të tharë ujërat dhe u shfaq toka e thatë. Perëndia kontrollon shiun dhe erën.

### 2. Perëndia i dha urdhra dhe premtime Noeut - Zanafilla 9:1-2.

- Perëndia i dha Noeut dhe bijve të tij, Semit, Kamit dhe Jafetit, kontroll mbi tërë kafshët, zogjtë dhe peshqit, ashtu siç i kishte dhënë Adamit në fillim.
  - Bota dhe gjithçka në të i përket Perëndisë. Por Ai ia dha njeriut për t'u kujdesur për Të.

### 3. Perëndia dha ylberin si shenja e Tij - Zanafilla 9:12-15.

- Ylberi u dha si shenjë e Perëndisë për të treguar se Ai nuk do të shkatërronte më tokën me anë të përmbytjes. Kur shikon një ylber, kujto që Perëndia e dha ylberin si shenjë që Ai nuk do të shkatërrojë më botën me anë të përmbytjes.
- Mijëra vjet kishin kaluar që nga përmbytja. Perëndia e ka mbajtur Fjalën e Tij.

### 4. Qëndrimi rebel e krenar i njerëzve - Zanafilla 11:1-4.

- Shumë vjet kishin kaluar pasi Perëndia shpëtoi Noeun dhe gruan e tij, tre bijtë e tij dhe gratë e bijve të tyre nga përmbytja e madhe. Përsëri jetonin shumë njerëz në tokë.
- Shumica e pasardhësve të Noeut e harruan shpejt gjykimin e tmerrshëm të Perëndisë në tokë me anë të përmbytjes. Ata e shpërfillën me dashje Perëndinë.



**Lexo:** Psalmi 104:6-9

=> Figura 10: Flijimi i Noeut dhe ylberi

<sup>41</sup> Komentet rreth këtyre njerëzve dhe largimit të tyre në rritje ndaj Perëndisë mbështetet te Romakëve 1:18-32.

<sup>42</sup> Mendo: Satani është i zgjuar. Ai i njeh dobësitë tona dhe e di se çfarë gënjeshtash do të pranojnë njerëzit. Adhurimi ka të bëjë me dhënien e mendimeve tona, kohës tonë dhe parave tona, goftë edhe jetëve tona, për t'i shërbyer gjësë apo personit që adhurojmë. Përveç Perëndisë, cilat janë disa nga gjërat, që adhurojnë njerëzit sot? (Lejo fëmijët të japin disa përgjigje).

=> Figura 11: Kulla e Babelit



**Lexo:** Zanafilla 1:28 dhe 9:1-2. Kërko fëmijëve nëse kujtojnë se cili ishte urdhërimi para se të lexoni Shkrimin.

<sup>43</sup> A kujton që Perëndia tha në fillim: "Le ta bëjmë njeriun sipas shëmbëlltysë tonë" (Zanafilla 1:26)? Tani shohim përsëri Perëndinë Atë, Perëndinë Bir dhe Perëndinë Frymë e Shenjtë, duke diskutuar se çfarë do të bënin.

## Përsëritja

Vendosi këto pjesë të vargut përmendësh në rendin e duhur duke u vendosur numra.

Isaia 45:18

2. ai, Perëndia që ka formuar tokën dhe e ka bërë

5. por e ka formuar që të banohej

6. "Unë jam Zoti dhe nuk ka asnjë tjetër".

4. nuk e ka krijuar pa trajtë

3. ai e ka vendosur

1. Sepse kështu thotë Zoti që ka krijuar qiejt

## Pyetje dhe përgjigje

1. Çfarë shenje dha Perëndia për të treguar se Ai nuk do të shkatërronte më tokën me përmbytje? **Ylberin.**
2. A e adhuroan Perëndinë pasardhësit e Noeut? **Vetëm disa besuan dhe e adhuruan Perëndinë.**
3. Pse filluan të ndërtojnë kullën e Babelit? **Në mënyrë që ata të mos shpërndaheshin në mbarë botën, ashtu siç kishte urdhëruar Perëndia.**
4. Çfarë bëri Perëndia për të ndaluar ndërtimin e kullës? **Ai u dha gjuhë të ndryshme familjeve të ndryshme. Ata nuk mund të kuptonin më njëri-tjetrin.**
5. Çfarë ndodhi kur familjet nuk mund t'i flisnin njëri-tjetrit? **Familjet e ndryshme u ndanë nga njëra-tjetra dhe u zhvendosën në vende të ndryshme.**

- Ata nuk donin të besonin te Zoti dhe as ta njihnin Atë si Abeli, Seti dhe Noeu.
  - Ata i kthyen kurrizin me dashje asaj që e njihnin se ishte e vërteta rreth Perëndisë dhe mendjet e tyre u bënë më të keqja dhe të marra. Ata bënë shëmbëlltira dhe i adhuruan.<sup>41</sup>
  - Ata ishin nën kontrollin e Satanit dhe kishin të njëjtën mënyrë të menduari si ai. Satani po drejtonte paraardhësit tanë për t'u rebeluar kundër Perëndisë.
  - Ata donin të ishin të mëdhenj dhe të rëndësishëm.
  - Ata nuk ishin të interesuar për të njohur, për të adhuruar apo për të besuar te Perëndia, ashtu si as për t'iu bindur Fjalës së Tij. Ata adhuronin perëndi të rreme dhe mendonin për veten.
  - Satani do që njerëzit të adhurojnë perënditë e rreme.<sup>42</sup>  
*Adhurimi vjen nga fjala "i denjë". Perëndia, dhe vetëm Perëndia, është i denjë për lavdërimin dhe adhurimin tonë. Perëndia është sovran.*
- Njerëzit u mbledhën për të ndërtuar kullën e Babelit, sepse nuk donin të përhapeshin në mbarë tokën (Zanafilla 11:4).
  - Ndërtuesit e Babelit (të quajtur gjithashtu Babilon) nuk po mendonin për Perëndinë e vërtetë.
  - Ata po mendonin për veten. Këta persona ishin të mbushur me krenari. Ata donin të ngrinin lart veten e tyre dhe jo të lavdëronin emrin e Perëndisë.
- Perëndia i dha një urdhër Adamit dhe Noeut, si dhe pasardhësve të Noeut.
  - Perëndia u kishte thënë Adamit dhe Noeut që ata duhet të shumoheshin dhe të merrnin kontrollin mbi kafshët, zogjtë dhe peshqit në mbarë botën.
  - Perëndia nuk donte që njerëzit të jetonin së bashku në një vend, duke bërë ashtu siç u pëlqente.
  - Perëndia e dinte se nëse ata do të rrinin së bashku në të njëjtin vend, do të harronin shpejt për Perëndinë dhe vullnetin e Tij. Perëndia e krijoi njeriun për të bërë vullnetin e Tij në tokë.
  - Perëndia është Krijuesi dhe zotëruesi ynë, pavarësisht se ku jetojmë, çfarë ngjyre jemi apo çfarë gjuhe flasim.
- Këta njerëz nuk iu bindën me dashje urdhrit të Perëndisë dhënë përmes Noeut dhe Adamit.
  - Ata nuk donin të shpërndaheshin në pjesë të ndryshme të botës siç kishte thënë Perëndia.
  - Ata u mbledhën në një vend, ndërtuan një qytet dhe filluan të ndërtonin një kullë të madhe e të lartë.

### 5. Perëndia i pa - Zanafilla 11:5.

- Perëndia i njihnte mendimet dhe planet e njerëzve. Askush nuk mund të mbajë sekrete para Perëndisë.  
*Sytë e Zotit janë kudo për të shikuar të këqijtë dhe të mirët (Fjalët e Urta 15:3).*

### 6. Perëndia i shpërndau - Zanafilla 11:6-9:3<sup>43</sup>.

- Zoti Perëndi bëri që njerëzit të flisnin gjuhë të ndryshme.
  - Meqë njerëzit nuk mund ta kuptonin më njëri-tjetrin, ata u ndanë në familjet e tyre të ndryshme dhe u larguan.
  - Pas shumë vitesh ata u zhvendosën në pjesë të ndryshme të botës.
    - Ky ishte plani fillestar i Perëndisë: që njerëzit të jetonin në mbarë tokën.
- Mendo: Nëse duam të njohim fillimet e vërteta dhe historinë e njeriut, ne duhet të lexojmë Biblën. Kjo pjesë te Zanafilla na thotë se si filluan kombet dhe racat e ndryshme, përfshi ato të paraardhësve tanë. Ky është fillimi i historisë së familjes sonë, si pjesë e një kombësie apo grupi gjuhe. Paraardhësit tanë u larguan nga e vërteta e Perëndisë që njihnin dhe ndoqën idetë, ide që u dhanë nga Satani dhe frymërat e tij.
- Ka disa njerëz që vazhduan të adhuronin Perëndinë e vërtetë e të gjallë, por pjesa më e madhe e tyre u largua nga Perëndia.

Mund të vësh re se ajo që ka ndodhur në këto histori të vërteta e të lashta është shumë e ngjashme me atë që ndodh sot: njerëzit ende rebelohen kundër Perëndisë. Duhet të dimë se as Perëndia nuk ka ndryshuar. Ai e di dhe interesohet për atë që po ndodh në jetën e çdo personi. Ai akoma e gjykon mëkatën. Ai akoma po thërret njerëz që të besojnë në Të.



# Mësimi 17 Perëndia thërret Abramit

## Qëllimi

Zanafilla 12 është fillimi i premtimeve të Perëndisë ndaj Abramit: Që Ai do të bënte prej tij një komb të madh dhe se tërë familjet e tokës do të bekoheshin në të (Çlirimtari do të vinte përmes pasardhjes së Abramit). Në këtë mësim do t'u tregosh fëmijëve:

- Që Perëndia është besnik për të zbatuar planet e Tij dhe për të përmbushur premtimet e Tij.
- Nevoja e njeriut për t'i besuar dhe për t'iu bindur Perëndisë, pavarësisht nga ajo që po bëjnë njerëzit e tjerë.

Ky mësim do t'i ndihmojë gjithashtu fëmijët të:

- Shikojnë unitetin e Biblës.
- Shikojnë që Perëndia nuk i ndryshon veprimet e Tij për shkak të njerëzve. Por Ai është gjithmonë besnik për të zbatuar atë që ka premtuar të bëjë.
- Të hedhin vështrimin te historia e Çlirimtarit.

## Hyrja

Dëshira jote është që fëmijët e klubit të mësojnë rreth besimit të Abramit te Perëndia. Ai nuk është thjesht një i moshuar, historia e jetës të të cilit është në Bibël. Ai është "ati" ynë në besim. Pyeti fëmijët: "Sa prej jush e dinë emrin e stërgjyshit? Sa prej jush dinë emrin e katragjyshit? Jo shumë prej nesh i dinë emrat e paraardhësve tanë, por sot do të flasim për një njeri që jetoi rreth 4000 vjet më parë dhe kujtohet akoma sot nga pasardhësit e tij.

## Figurat

=> Grafiku 16: Disa nga premtimet e Perëndisë ndaj Abrahamit

## Historia

"Përsëendetje, xhaxhi Piter" - thirri Karola. "Po prisnim që të vije mbrëmë për të ngrënë me ne, por nuk erdhe".

"Oh, Karola, më vjen keq. Harrova" - tha xhaxhi Piteri. "Kisha disa gjëra për të bërë në qytet. U ktheva vonë mbrëmë në shtëpi".

"Si mund të harrojë dikush të hajë?" - pyeti Xhoni. "Sidomos ti, xhaxhi Piter. Nuk mendoj që ti harron diçka. Ti i bën gjithmonë gjërat siç duhet".

"Do të doja që kjo të ishte e vërtetë për mua" - u përgjigj xhaxhi Piteri. "Por nuk jam besnik gjithmonë dhe jam harraq. Jam i kënaqur që Perëndia nuk është si unë".

"Çfarë do të thuash?" - pyeti Xhoni.

"Perëndia është absolutisht i përsosur" - u përgjigj xhaxhi Piteri. "Ai nuk harron kurrë një premtim dhe Ai është gjithmonë besnik për të bërë gjithçka që thotë se do të bëjë. Ne mund të kemi gjithmonë besim tek Ai".

"A ka shumë premtime në Bibël, xhaxhi Piter?" - pyeti Karola.

"Ka qindra premtime në Bibël, Karola" - u përgjigj xhaxhi Piteri.

"Qindra?!" - tha Karola e çuditur. "Këto janë shumë. Si mund t'i mbajë mend Perëndia të gjitha këto?".

"Perëndia nuk e ka këtë problem" - u përgjigj xhaxhi Piteri. "Ai kujton gjithçka në mënyrë të përsosur dhe Ai përmbush çdo premtim në kohën e duhur".

"A ka në Bibël ndonjë premtim që nuk është përmbushur akoma?" - pyet Xhoni.

"Shumë!" - tha xhaxhi Piteri. "Por ne e dimë që një ditë ato do të përmbushen, saktësisht siç ka thënë Perëndia. Kur Perëndia përmbush një premtim, Ai e plotëson në çdo hollësi. Ndonjëherë duhet të kalojë shumë kohë para se të bëjë atë që ka premtuar".

"Urrej të pres që të ndodhin gjërat" - tha Karola.

"Edhe unë urrej të pres" - tha xhaxhi Piteri. "Por sikur të lë vajzën time të vogël të ecë vetëm në rrugë?".

"Oh, xhaxhi Piter, ajo nuk mund ta bëjë këtë!" - kërceu Karola. "Ajo nuk mund të ecë mirë. Ajo mund të lëndohet. Ajo duhet të presë derisa të bëhet më e madhe".

"Ke të drejtë, Karola" - tha xhaxhi Piteri. "Edhe pse vajza ime nuk e di se çfarë është e drejtë për të, si babai i saj, unë e di, kështu që e lë të presë derisa të rritet. Perëndia është njësoj. Ai pret kohën e duhur për të përmbushur premtimet e Tij. **Të presësh Perëndinë dhe t'i besosh Atij është pjesë e besimit**, duke i besuar Atij se do të bëjë atë që thotë, në kohën e duhur".

"Është e vështirë të presësh kur nuk mund të shikosh se do të ndodhë diçka" - tha Xhoni.

"Ashtu është" - tha xhaxhi Piteri. "Por prandaj besimi është kaq i veçantë. Bibla na thotë për një njeri që quhej Abram, i cili u bë i njohur për besimin e tij. Ne mund të shikojmë historinë e tij, nëse ju pëlqen, por gjëja më e rëndësishme për t'u mbajtur mend është kjo: **Perëndia është besnik**. Njerëzit (ashtu si unë) harrojnë dhe dështojnë. Por Perëndia bën gjithmonë atë që thotë se do të bëjë. A e mbani mend premtimin e parë për një Çlirimtar?".

"Do të thuash premtimin e dhënë kopsht?" - pyeti Karola.

"E mbaj mend atë premtim!" - ndërpreu Xhoni. "Meqë Adami dhe Eva, burri dhe gruaja e parë, mëkatuan, ata dhe tërë njerëzimi i lindur në tokë, do të ndaheshin nga Perëndia dhe do të kontrolloheshin nga Satani. Satani mendoi se e kishte mundur Perëndinë dhe do të kishte përgjithmonë sundimin e plotë mbi botën dhe njerëzit. Por Perëndia premtoi se Ai do të dërgonte një çlirimtar që do ta shpëtonte tërë njerëzimin nga pushteti i Satanit".

"Askush nuk mund të fitojë kundër Perëndisë!" - kujtoi Karola. "Ai është Krijuesi shumë i lartë. Pyes veten se kur do të dërgojë Perëndia Çlirimtarin për ta shtypur Satanin ashtu siç ka premtuar?".

"Të dy keni të drejtë" - tha xhaxhi Piteri. "Tani, le të shikojmë historinë e Abramit në Bibël. Perëndia dha disa hollësi të mrekullueshme rreth premtimit të Çlirimtarit ndërsa foli me Abramit. Kujtoni, Abrami nuk kishte libër për ta lexuar. Perëndia i foli atij në mënyrë të drejtpërdrejtë!".

## Le të shohim në Bibël



**Zanafilla 12:2** - “Unë prej teje do të bëj një komb të madh, do të të bekoj dhe do ta bëj të madh emrin tënd, dhe ti do të jesh një bekim”.

Shpjegoi fëmijëve se edhe pse Abrami dhe Saraj nuk kishin fëmijë, Perëndia i premtoi Abramit që ai do të bëhej ati i një kombi të madh. Perëndia premtoi edhe se Ai do të mbronte dhe do ta begatonte Abramin, në mënyrë që ai të bëhej një njeri i rëndësishëm dhe që, përmes tij, të tjerët të merrnin gjithashtu dobi (apo të mira) të mëdha dhe ndihmë. Ndihoji fëmijët e klubit tënd ta mësojnë përmendësh këtë varg.

## Le të mendojmë

1. Kush është i përsosur?  
a. Xhaxhi Piteri; b. Xhoni dhe Karola; c. **Perëndia**.
2. Kush i zbaton të gjitha premtimet e Tij?  
a. Satani; b. **Perëndia**; c. Abrami.
3. Kush do ta shtypë Satanin një ditë?  
a. Abrami; b. Adami; c. **Çlirimtari**.
4. Çfarë do të thotë të presësh Perëndinë dhe të kesh besim tek Ai?  
a. Të harrosh; b. **Të kesh besim**; c. Të mban premtimet.
5. Kush mund të fitojë kundër Perëndisë?  
a. Satani; b. Engjëjt; c. **Askush**.

## Mësime nga Fjala e Perëndisë

Këto mësime nuk trajtojnë pjesën rreth mëkateve të Abramit. Për historinë e Agarit dhe Ismaelit nuk flitet; as për rrethprerjen. Ne po paraqesim vetëm ato histori dhe hollësi që janë themelore për paraqitjen e karakterit të Perëndisë dhe sigurimit të shpëtimit me anë të besimit.<sup>44</sup>

<sup>44</sup> Abrami na paraqitet si një shembull besimi, megjithatë ai ishte edhe shumë njerëzor: duke pasur shumë dështime dhe kohë kur besimi i tij lëkundej. Por ne shohim tek Abrami një njeri që pendohej për mëkatën e tij dhe vazhdonte gjithmonë ecjen e tij me Perëndinë.

### 1. Abrami ishte pasardhës i Semit

Noeu kishte tre djem: Semin, Kamin dhe Jafetin; Abrami ishte pasardhës i Semit. Abrami, biri i Terahut, jetonte afër vendit ku njerëzit kishin filluar të ndërtonin kullën e madhe të Babelit.

- Abrami u martua me Sarajn, por Abrami dhe Saraj nuk kishin fëmijë. Zanafilla 11:27-30.  
Shënim:  
Në atë kohë burrat dhe gratë që nuk kishin fëmijë përbuzeshin nga shoqëria. Fëmijët meshkujt ishin më të parapëlqyer, në mënyrë që burri të kishte trashëgimtarë për të vazhduar mbiemrin e familjes.
- Terahu, babai i Abramit, u zhvendos nga Uri dhe udhëtoi drejt Haranit - Zanafilla 11:31-32.
  - Terahu mori Abramin dhe Sarajn me vete.
  - Terahu mori me vete edhe Lotin, nipin e tij, sepse babai i Lotit kishte vdekur në Ur.
- Terahu planifikoi të shkonte në Kanaan, por Terahu vdiq kur mbërritën në Haran.

### 2. Perëndia thërret dhe urdhëron Abramin - Zanafilla 12:1.

- Perëndia e thirri Abramin dhe i tha të largohej nga vendi i tij dhe të shkonte në tokën e Kanaanit.
  - Perëndia foli drejtpërdrejt me Abramin dhe i tha atij se çfarë duhet të bënte; Bibla nuk ishte shkruar ende në kohën e Abramit.
  - Perëndia nuk na flet përmes zërit në kohën e sotme.
  - Perëndia na flet përmes Fjalës së Tij të shkruar, Biblës.

<sup>45</sup> A do të thotë kjo që Abrami nuk ishte mëkatar? Jo, Abrami ishte gjithashtu pasardhës i Adamit, ndaj ai ishte mëkatar.

## Përsëritje

1. Kush do ta shpëtojë tërë njerëzimin nga pushteti i Satanit? **Çlirimtari.**
2. Kujt i premtoi Perëndia se do të bëhej ati i një kombi të madh? **Abramit.**
3. Cili është premtimi më i madh që i bëri Perëndia Abramit? **Pasardhësi i Tij do të ishte Çlirimtari.**
4. Kush ishte gruaja e Abramit? **Saraj.**
5. Çfarë adhuronin njerëzit në vendin ku jetonte Abrami? **Idhujt.**

## Pyetje dhe përgjigje

1. Çfarë i tha Perëndia Abramit të bënte? **Perëndia i tha atij të largohej nga vendi i tij dhe të shkonte në vendin që i kishte premtuar të çonte.**
2. Sa fëmijë kishin Abrami dhe Saraj kur u tha Perëndia të shpërnguleshin? **Asnjë.**
3. Çfarë i premtoi Perëndia Abramit?
  - a. **Pasardhësit e Abramit do të bëheshin një komb i madh;**
  - b. **Perëndia do të mbronte dhe do të begatonte Abramin. Ai do të bëhej një njeri i rëndësishëm dhe përmes tij të tjerët do të merrnin të mira dhe ndihmë.**
  - c. **Perëndia tha që Ai do t'i ndihmonte ata që do ta ndihmonin Abramin, por Ai do t'i sillte të këqija kujtdo që do ta trajtonte keq Abramin.**
  - d. **Perëndia tha që tërë kombet dhe fiset në botë do të merrnin ndihmën e Perëndisë, përmes një pasardhësi të Abramit.**
4. Kush do të ishte ky pasardhës i Abramit? **Ai do të ishte Çlirimtari.**
5. Çfarë bëri Abrami kur Perëndia i dha atij premtimet? **Abrami i besoi Perëndisë. Ai u largua nga vendi i tij dhe shkoi ku e drejtoi Perëndia.**

Rruga e vetme për të njohur Perëndinë dhe mesazhin e Tij për veten tonë është përmes fjalëve të këtij libri, Biblës.

- Atje ku jetonte Abrami, në Mesopotami, njerëzit adhuronin idhujt.
  - Njerëzit nuk kishin besim, nuk e donin Perëndinë, dhe as nuk i bindeshin Atij, Krijuesit të tyre.
  - Jozueu 24:2 na thotë që babai i Abramit, Terahu, adhuronte idhujt.
- Abrami i besoi Perëndisë<sup>45</sup>.
  - Ai iu afrua Perëndisë sipas mënyrës që kishte treguar Ai.
  - Ai i besoi Perëndisë dhe premtimeve të Tij.
- Plani i Perëndisë për Abramin nuk mund të realizohej atje ku jetonte Abrami, midis atyre njerëzve që adhuronin idhujt.
  - Abrami duhet të largohej nga vendlindja e tij.
  - Abrami duhet të shkonte në vendin në të cilin Perëndia premtoi se do ta drejtonte.
  - Perëndia kishte të drejtën t'i thoshte Abramit se çfarë të bënte.
  - Perëndia është më i madh se të gjithë. Perëndia është zotëruesi ynë dhe autoriteti ynë më i lartë.
- Paraardhësit tanë, pasardhësit e Noeut, ishin larguar me dashje nga Perëndia dhe e vërteta.
  - Ata adhuronin gjërat që kishte krijuar Perëndia në vend të Perëndisë, Krijuesit të tyre.
  - Ata u rebeluan kundër Tij duke filluar të ndërtimin e kullës së Babelit.
- Edhe pse njerëzit ishin shumë mëkatarë, Perëndia nuk e ndaloi planin e Tij për ta shpëtuar njerëzimin nga pushteti i Satanit dhe nga ndëshkimi i përjetshëm.
  - Askush dhe asgjë nuk mund të ndalë Perëndinë që t'i zbatojë planet e Tij.
  - Çfarëdo lloj gjëje që Perëndia premtonte të bëjë, Ai e bënte. Çfarëdo lloj gjëje që Ai fillon, e çon deri në fund.
  - Asgjë nuk mund të pengojë Perëndinë që t'i realizojë planet e Tij dhe që t'i përmbushë qëllimet e Tij.
- Thirrja e Abramit ishte hapi i radhës i Perëndisë në planin e Tij për t'i çliruar njerëzit nga skllavëria e tyre e mëkatit.
  - Perëndia është i njëjtë sot, ashtu siç ka qenë në kohën e Abramit.
  - Perëndia është ende i dashur, i mëshirshëm dhe plot hir.
  - Perëndia nuk e ka harruar planin e Tij për t'i shpëtuar njerëzit nga ndëshkimi i përjetshëm.
  - Perëndia dëshiron që të gjithë të shpëtohen nga pushteti i Satanit dhe nga mëkati.

### 3. Premtimet e Perëndisë ndaj Abramit - Zanafilla 12:2-3.

- Perëndia i premtoi Abramit që ai do të bëhej ati i një kombi të madh.
  - Perëndia i premtoi Abramit dhe Sarajt që ata do të bëheshin me shumë fëmijë.
- Perëndia premtoi që Ai do të mbronte dhe do të begatonte Abramin.
  - Abrami do të ishte një person i rëndësishëm.
  - Përmes Abramit njerëzit e tjerë do të merrnin të mira dhe ndihmë (bekime).  
=> Trego grafikun 16: Disa nga premtimet e Perëndisë ndaj Abrahamit.  
Ne do të mbajmë një listë me disa nga këto premtime të veçanta që Perëndia i bëri Abramit (emri i të cilit u ndryshua më vonë në "Abraham"), në mënyrë që të mund të shohim se si Perëndia i realizoi këto premtime.
- Perëndia premtoi gjithashtu që Ai do t'i ndihmonte ata që do ta ndihmonin Abramin, por Ai do të sillte të keqen mbi këdo që do ta trajtonte keq Abramin.
  - Fundi i vargut 3 thotë: *"Te ti do të jenë të bekuara tërë familjet e tokës".*
  - Ky është premtimi më i madh dhënë Abramit, sepse flet për Çlirimtarin.

A ju kujtohet që në kopshtin e Edenit, Perëndia premtoi se do të dërgonte një Çlirimtar në botë për të rrëzuar pushtetin e Satanit? Perëndia premtonte tani që një prej pasardhësve të Abramit do të ishte ai Çlirimtar! Tërë familjet e tokës do të bekoheshin përmes pasardhësit të Adamit. Ai premtim të përfshin ty dhe mua dhe tërë njerëzit në botë.

# Mësimi 18 Bindja e Abramit

## Qëllimi

Do të vazhdosh me historinë e "Thirrjes së Abramit nga Perëndia". Ne do të paraqesim gjithashtu zgjedhjen e Lotit rreth asaj që iu duk si toka më e mirë: zona e Sodomës dhe Gomorrës. Në këtë mësim do t'u tregosh fëmijëve të klubit tënd:


- Nevojën që ka njeriu për t'i besuar dhe për t'iu bindur Perëndisë pavarësisht nga ajo që bëjnë njerëzit e tjerë.
- Që Perëndia nuk i anulon qëllimet e Tij nga veprimet e njerëzve, por Ai është gjithmonë besnik ndaj asaj që ka premtuar.

## Hyrje

Diskuto me fëmijët e klubit tënd që nuk është gjithmonë e lehtë të bësh gjënë e duhur. Nuk është gjithmonë e lehtë të bësh atë që Perëndia dëshiron që ne të bëjmë. Perëndia e kupton se sa të vështirë e kemi të bëjmë disa gjëra që Ai na i kërkon. Por Perëndia nuk do të na kërkojë të bëjmë diçka nëse pas saj nuk ekziston një arsye e fortë. Ai dëshiron që të zgjedhim të bëjmë atë që dëshiron Ai, edhe pse mund të mos e kuptojmë arsyen. Këtë bëri Abrami dhe Perëndia i premtoi se do ta bekonte atë dhe tërë njerëzimin, duke qenë se ai iu bind Atij.

## Figurat

=> Figura 12: Largimi nga Harani



## Historia

Xhaxhi Piteri shkoi te Karola që ishte ulur në një pemë dhe i tha: "Karola, dukesh sikur je zhytur në mendime".

"Oh, përshëndetje, xhaxhi Piter" - u përgjigj Karola. "Po, po mendoja për Perëndinë që i kërkoi Abramit të largohej nga vendi i tij dhe të shkonte në Kanaan. E di që the se Perëndia kishte të drejtën t'i thoshte Abramit të largohej, sepse Perëndia është zotëruesi i njeriut dhe autoriteti më i lartë, por mendoj se do të jetë shumë e vështirë të largohesh nga shtëpia dhe të shkosh në një vend që nuk e njeh".

"Ke të drejtë, Karola," - tha xhaxhi Piteri, - "por ndonjëherë Perëndia na kërkon të bëjmë gjëra që janë të vështira, me qëllim që të ndihmohen njerëz të tjerë. Perëndia është i dashur, i mëshirshëm dhe plot hir. Ai dëshiron që secili të shpëtohet nga pushteti i Satanit dhe mëkati, dhe Abrami ishte pjesë e planit të Perëndisë për të bërë këtë. Abrami kishte një zgjidhje për t'iu bindur Perëndisë dhe për të shkuar në Kanaan, ose të mos i bindej dhe të refuzonte të ishte pjesë e planit të Perëndisë për të dërguar Çlirimtarin".

Xhoni, i cili ishte ulur afër Karolës nën pemë, pyeti: "Si shkuan Abrami dhe Saraj në këtë vend të ri që quhet Kanaan? Ata nuk kishin makina, autobusë dhe avionë në atë kohë, apo jo?".

"Jo," - u përgjigj xhaxhi Piteri, - "ata nuk kishin makina, autobusë apo avionë. Ata duhet të ecnin apo të ngisnin gomarë".

"Ata nuk mund të kenë marrë shumë gjëra me vete" - tha Karola. "Çfarë bënin ata për rrobat, çarçafët, dhe...".

"Po ushqimin?" - ndërpreu Xhoni.

"Abrami ishte shumë i pasur" - tha xhaxhi Piteri. "Ai kishte shumë shërbëtorë, gjedhë, dele dhe dhi. Ai mori me vete gjithçka që kishte".

"Çfarë menduan miqtë dhe fqinjët e tij për të, për faktin që u largua nga shtëpia për të shkuar aq larg?" - pyeti Xhoni.

"Njerëzit po e shikonin, Xhon" - u përgjigj xhaxhi Piteri. "Abrami ishte një njeri i pasur dhe i rëndësishëm. Ata mbase janë talluar me të, por Abramit nuk i bëhej vonë se çfarë mendonin njerëzit. Ai i besoi Perëndisë dhe donte t'i bindej Atij".

"Mendoj se gjëja më e vështirë do të ishte t'u thoshte lamtumirë kushërinjve" - tha Karola.

"Abrami nuk kishte përse t'u thoshte të gjithëve lamtumirë" - tha xhaxhi Piteri. "Ai mori nipin e tij, Lotin, me vete. Edhe Loti besonte te Perëndia dhe te premtimet e Tij. Ai, bashkë me të gjitha zotërimet e tij, udhëtoi dhe jetoi në çadra bashkë me Abramin dhe Sarajn".

"Do të jetë dashur një kohë e gjatë për të bërë një rrugë të gjatë me tërë ato kafshë" - tha Karola.

"Po, ashtu është," - tha xhaxhi Piteri, - "por Zoti e drejtoi Abramin me besnikëri për në Kanaan, tokën që i kishte premtuar t'i jepte".

"Mendoj se do të ketë qenë argëtuese të udhëtoje me tërë kafshët dhe të vizitoje një vend të ri" - tha Xhoni.

"Shiko," - tha xhaxhi Piteri, - "ata patën disa probleme rrugës. Mendoj se kam kohë të mjaftueshme për t'ju thënë për një problem të madh që ndodhi midis Abramit dhe Lotit".

## Le të shohim në Bibël



### Malakia 3:6a - “Unë jam Zoti, nuk ndryshoj”.

Kujtoju fëmijëve që Perëndia bën akoma atë që thotë. Askush nuk mund ta ndalojë Perëndinë që t’i realizojë planet e Tij. Gjithashtu kujtoi që Perëndia është i dashur, i mëshirshëm dhe plot hir. Ai nuk e harron kurrë premtimin e Tij për të çliruar popullin nga ndëshkimi i përjetshëm. Perën-

dia nuk do të ndryshojë kurrë.

## Le të mendojmë

1. Kush është autoriteti më i lartë?  
a. Njeriu; b. Abrami; c. **Perëndia**.
2. Kujt i tha Perëndia të shkonte në Kanaan?  
a. **Abramit**; b. Adamit; c. Noeut.
3. A kishte Abrami një zgjedhje për t’u zhvendosur në Kanaan? **Po** / Jo.
4. Kush shkoi me Abramin dhe Sarajn në Kanaan?  
a. **Loti**; b. Semi; c. Kami.
5. A ndryshon ndonjëherë Perëndia? Po / **Jo**.

## Mësim nga Fjala e Perëndisë

Meqenëse ky është një mësim i shkurtër, do të kesh kohë të mjaftueshme për të përsëritur mësimin e javës së kaluar. Përsëritja e mësimin të kaluar është shumë e rëndësishme, nëse ke fëmijë që e studiojnë këtë mësim, por që nuk ishin javën e shkuar. Është e rëndësishme që fëmijët të njohin Abramin për besimin e tij te Perëndia dhe premtimet që Perëndia i bëri atij.

### 1. Abrami i besoi dhe iu bind Perëndisë - Zanafilla 12:4-5.

- Abrami po jetonte në një vend ku njerëzit adhuronin idhujt.
- Abrami dhe Saraj nuk kishin fëmijë.
- Abrami u besoi premtimeve të Perëndisë.
  - Abrami besoi që Perëndia do të dërgonte Çlirimtarin dhe Çlirimtari do të ishte një prej pasardhësve të tij.
  - Abrami, ashtu si Noeu, i besoi Fjalës së Perëndisë dhe për këtë arsye ai iu bind Perëndisë.

Kujtoni:


Ndërsa studiojmë historinë e Abramit, le të kujtojmë që ai ishte një person real në histori, i cili është përmendur shumë herë përgjatë Dhiatës së Vjetër e të Re.

Shënim: Zbulimet arkeologjike në Ur, Mari, Ebla dhe vende të tjera të lashta përputhen me hollësitë në Bibël rreth jetës në kohën e Abramit, pra, rreth 2000 vjet para Krishtit. Kohët e fundit kanë dalë në dritë shumë hollësi të reja rreth udhëtimit dhe tregtisë, martesës dhe familjes dhe madje emrave të zakonshëm, emra që janë si ata të shkruar në Bibël. Qyteti nga i cili Abrami u largua më herët, Uri i Kaldeasve, ishte një qendër urbane me shtëpi dhe tempuj të ngjashëm në vendin e Irakut sot.

- Abrami i besoi Perëndisë dhe iu bind Atij. Abrami kuptoi që Perëndia ishte tërësisht i denjë për besimin e tij.
  - Abrami u largua nga shtëpia e tij dhe udhëtoi duke jetuar nëpër çadra.
  - Loti, nipi i Abramit, shkoi gjithashtu me të dhe Sarajn.
  - Loti i besoi gjithashtu Perëndisë dhe besoi te premtimet e Tij.
  - Perëndia e drejtoi besnikërisht Abramin në Kanaan, tokën që i kishte premtuar.



## Përsëritje



Kanaani

## Pyetje dhe përgjigje

1. Për ku e drejtoi Perëndia Abramin? **Drejt Kanaanit.**
2. Kush shkoi me Abramin dhe Sarajn? **Loti.**
3. Çfarë i premtoi Perëndia Abramit?
  - a. **Pasardhësit e Abramit do të bëheshin një komb i madh;**
  - b. **Perëndia do të mbronte dhe do të bekonte Abramin. Ai do të bëhej një njeri i rëndësishëm dhe përmes tij, të tjerët do të merrnin të mira, si edhe ndihmë;**
  - c. **Perëndia tha se Ai do të ndihmonte ata që do të ndihmonin Abramin, por Ai do të sillte të keqen ndaj kujtdo që e trajtonte keq Abramin;**
  - d. **Perëndia tha që tërë kombet dhe fiset në botë do të merrnin ndihmën e Perëndisë përmes një pasardhësi të Abramit.**
4. Pse u largua Loti nga Abrami? **Abrami dhe Loti kishin aq shumë kafshë, sa që nuk kishte bar apo vend të mjaftueshëm që të jetonin së bashku.**
5. Cili nga ata bëri një zgjedhje egoiste? **Loti.**

## 2. Problemi midis barinjve të Lotit dhe Abramit - Zanafilla 13:5-7.

- Edhe Loti, nipi i Abramit, ishte i pasur si xhaxhai i tij.
- Meqë të dy kishin shumë dele dhe gjedhë, nuk kaloi shumë kohë para se të nisnin problemet midis njerëzve që punonin për ta, njerëz që kujdeseshin për kopetë dhe tufat.

## 3. Zgjidhja e Abramit - Zanafilla 13:8-9.

## 4. Zgjedhja e Lotit - Zanafilla 13:10-11.

- Loti pa përreth për të bërë zgjedhjen e tij; ai zgjodhi fushat me bar, për të cilat mendonte se do të ishin më të mirat për kafshët e tij.
  - Edhe pse Loti besonte te Perëndia, ai nuk po mendonte atë që ishte më e mira për të dhe familjen e tij, dhe se si kjo lëvizje do t'i ndikonte për njohjen e Perëndisë apo aftësinë e tyre për t'i pëlqyer Atij.
  - Loti mbase po mendonte vetëm se si të bënte para.
  - Disa gjëra të tmerrshme i ndodhën Lotit për shkak të zgjedhjes së tij.

Kujtoni:

Kujtoni vendimin e marrë të Kainit për të injoruar Perëndinë? Tërë pasardhësit e tij u mbytën te përmbytja. Ne duhet të jemi të kujdesshëm për zgjedhjet që bëjmë.

*Fjalët e Urta 14:12 thotë: "Është një rrugë që njeriut i duket e drejtë, por në fund ajo të nxjerr në rrugët e vdekjes".*

Mendo:

Nëse një njeri zgjedh të mos mësojë atë që Perëndia ka shkruar për të në Bibël, ai person do të ndiejë keqardhje përgjithmonë. Çfarë dobie do të kemi nëse zotërojmë gjithçka në botë e më pas, kur të vdesim të jemi të ndarë përgjithmonë nga Perëndia? Askush nuk dëshiron të flasë për këto gjëra. Ne priremi vazhdimisht të kemi më tepër gjëra dhe të mendojmë më pak për Perëndinë. Por Perëndia na thërret përmes Fjalës së Tij: Ai dëshiron që ne ta dëgjojmë dhe të besojmë tek Ai.

Krahaso: Abrami i besoi Perëndisë. Ai qëndroi në kodrat dhe malet shkëmbore dhe e la Lotin të merrte atë që dukej si toka më e mirë.

Loti zbriti në fushë: ku ecja ishte e lehtë dhe bari ishte më i shumtë për kafshët e tij.

Në sytë e njerëzve do të dukej që Abrami ishte "humbës" në këtë ndarje të tokës. Por Perëndia e njeh të vërtetën, të cilën ne nuk mund ta shohim me sytë tanë.

- Poshtë në fusha kishte dy qytete, Sodoma dhe Gomorra - Zanafilla 13:12-13.
  - Këto qytete ishin të liga.
  - Njerëzit që jetonin atje nuk donin ta njihnin Perëndinë apo atë që donte Perëndia për ta.
  - Ata mendonin vetëm për veten e tyre dhe për gjërat e këqija që po bënin.
- Perëndia e dinte që njerëzit ku Loti zgjodhi të jetonte ishin të këqij.
  - Perëndia do t'i tregonte Lotit që njerëzit ishin të këqij, nëse ai do ta pyeste Atë.
  - Por Loti zgjodhi atë që dukej më e mira për të.
  - Ngaqë Loti bëri zgjedhjen e tij, ai bëri një lëvizje të keqe larg Perëndisë dhe në një vend tmerrsisht të rrezikshëm, ku ligësia ishte e madhe.

Loti e bëri zgjedhjen e tij në bazë të dëshirave egoiste. Por Abrami iu bind Perëndisë, sepse besoi që Perëndia do të bënte gjithçka që kishte premtuar.



# Mësimi 19 Premtimet e Perëndisë ndaj Abramit

## Qëllimi

Do t'u tregosh fëmijëve të klubit:

- Që Perëndia ia llogariti besimin Abrahamit si drejtësi.
- Perëndia komunikoi me njeriun, siç tregohet në premtimet e Tij me Abrahamin.  
Shënim: Do t'u referohesh këtyre premtimëve në mësimet e mëvonshme, kështu që sigurohu që t'i mësonsh që tani.
- Nevoja e njeriut për t'u afruar Perëndisë me anë të besimit, treguar në përgjigjen e Abrahamit.

## Hyrje


Pyeti fëmijët e klubit tënd: “A ke marrë diçka të mirë, të cilën nuk e ke merituar?”. Perëndia na jep shumë gjëra të mira, të cilat ne nuk i meritojmë! Pyeti fëmijët: “Çfarë fjale përdorim për të përshkruar këtë lloj dashurie?”.

=> Trego grafikun 13: Hiri.

*Thuaju fëmijëve ta lexojnë disa herë me zë të lartë. Kujtoju fëmijëve që “hiri” është mirësia e Perëndisë ndaj mëkatarëve që nuk e meritojnë.*

## Figurat

- Grafiku 13: Hiri
- Grafiku 16: Disa nga premtimet e Perëndisë ndaj Abrahamit
- Grafiku 17: Abrahami i besoi Perëndisë
- Figura 13: Abrahami, Sara dhe vizitorët e tyre qiellorë (me zgjedhje)



## Historia

“Xhaxhi Piter!” - thirri Karola ndërsa vrapoi për të takuar xhaxhain e saj. “Nuk ke për ta besuar se çfarë ndodhi!”.

“Mezi pres ta dëgjoj!” - tha xhaxhi Piteri duke qeshur.

“Edhe unë mezi pres!” - tha Xhoni. “Duhet të kishe ardhur për të parë se çfarë na dha znj. Devis!”.

“Të gjithë e njohin znj. Devis” - tha xhaxhi Piteri. “Ajo është një zonjë e mirë që ka ndihmuar shumë njerëz këtu përreth. Fëmijët e saj janë të gjithë të martuar. Atëherë çfarë të dha?”.

“Nuk ke për ta besuar!” - përsëriti Karola. “Mësuesja jonë tha në shkollë që znj. Devis kishte një piano elektrike për t'ia dhuruar një djali apo vajze që do të mësonte t'i binte”.

“Duhet t'i kishe dëgjuar disa prej fëmijëve” - tha Xhoni i trishtuar. Ata thanë: “Unë do të preferoja një kasetofon, jo një piano të vjetër elektrike!”.

“Një vajzë tha që nuk donte të harxhonte kohën për të mësuar se si t'i binte pianos elektrike” - shtoi Karola. “Gjithmonë kam dashur t'i bie pianos, por nuk kishim shumë para për të blerë një të tillë dhe na duhej gjithashtu të paguanim për mësuesin. Por shkova te mësuesja dhe pyeta për znj. Devis. I tregova mamasë atë që më tha ajo dhe dje mamaja, Xhoni dhe unë shkuam të flisnim me znj. Devis për pianon”.

“Ne u çuditëm!” - thirri Xhoni. “Znj. Devis kishte një piano që mund të punonte si me korrent, ashtu edhe me bateri. Ishte e re dhe ishte aq e vogël, sa mund ta çonim kudo me lehtësi”.

“Po pse donte ajo ta falte pianon?” - pyeti xhaxhi Piteri.

“Ajo e kishte blerë pianon për nipërit e saj, që ata të mësonin t'i binin,” - u përgjigj Xhoni, - “por ata nuk donin të harxhonin kohë për ta mësuar, kështu që ajo nuk donte ta mbante”.

“Nuk mbaron këtu” - tha Karola e gëzuar. “Znj. Devis do të na mësojë edhe se si t'i biem. Nuk do të na kushtojë asgjë, edhe pse do të na mësojë”.

“Ke të drejtë Karola” - pranoi xhaxhi Piteri. “Nuk kisha për ta menduar kurrë që do t'ju bëhej një surprizë kaq e bukur. Është e mrekullueshme!”.

“Xhaxhi Piter” - tha Xhoni. “Pyes veten nëse duhet ta kishim pranuar pianon nga znj. Devis. Mendoj se do t'i ketë kushtuar shumë para”.

“Ke të drejtë, Xhon” - tha xhaxhi Piteri. “Ka kushtuar shumë. Por ajo donte që t'ua jepte, apo jo?”.

“Po, ashtu mendoj,” - u përgjigj Xhoni, - “sepse ajo vazhdonte të thoshte: ‘Po kërkoja dikë që do të më besonte që doja të falja këtë piano’”.

“Por ne nuk jemi pjesë e familjes së saj dhe nuk bëmë gjë për ta merituar pianon” - tha Karola.

“A duhet ta kishim pranuar me të vërtetë, xhaxhi Piter?”.

“Patjetër!” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Znj. Devis e bleu atë piano për t'u përdorur dhe për t'u gëzuar. Por nipërit e saj e refuzuan. Jam i bindur që kjo e ka mërzi-tur. Por, siç tha edhe ajo, po kërkonte dikë që thjesht të kishte besim tek ajo, besim që ajo do të falte diçka të mirë. Ti i besove fjalëve të saj dhe ajo ishte e gëzuar që ta dha ty”.

“Nuk kam pasur kurrë diçka kaq të mirë” - tha Karola.

“As unë” - shtoi Xhoni. “Dhe ishte dhuratë!”.

“Xhon e Karola,” - tha xhaxhi Piteri, - “ne nuk e meritojmë as mirësinë që na jep Perëndia. Shumica e njerëzve as nuk kujtohen për Perëndinë. Ai është i lumtur kur dikush beson me të vërtetë tek Ai. Ne kemi folur tashmë për Abramin, por tani dua që të shohim pak më tepër se si Perëndia tregoi mirësi ndaj Abramit. Ai i dha Abramit diçka që asnjë njeri nuk mund ta meritonte. Ai i dha Abramit drejtësi. Edhe pse Abrami ishte mëkatar, Perëndia e pranoi sikur Abrami të ishte përsosmërisht i drejtë”.

## Le të shohim në Bibël



**Zanafilla 15:6 - “Dhe ai i besoi Zotit, që ia vuri në llogari të drejtësisë”.**

Shpjegoi fëmijëve të klubit tënd që njeriu duhet të ketë besim te Perëndia. Abrami ishte mëkatar, por për shkak të besimit të tij te Perëndia, ai u pranua nga Perëndia sikur të

ishte përsosmërisht i drejtë. Ti do ta shpjegosh këtë më tepër gjatë mësimit.

### Le të mendojmë

1. A donte znj. Devis para për pianon? Po / Jo.
2. Kush dëshironte ta kishte pianon që donte të jepte znj. Devis?  
a. Nipërit e saj; b. Shumë njerëz; c. **Vetëm Xhoni dhe Karola.**
3. Kush e meriton mirësinë e Perëndisë?  
a. Të gjithë; b. **Askush;** c. Njerëzit e mirë.
4. Sipas Zanafillës 15:6, kush i besoi Perëndisë?  
a. Askush; b. **Abrami;** c. Të gjithë.
5. Çfarë do të thotë drejtësi?  
a. Të japësh përgjigjen e drejtë; b. Ana e drejtë;  
c. **Një marrëdhënie e drejtë me Perëndinë.**

### Mësime nga Fjala e Perëndisë

#### 1. Perëndia ia përsërit premtimet Abramit - Zanafilla 13:14-17.

- Pasi Loti u largua nga Abrami, Zoti i foli Abramit dhe i premtoi përsëri se do t'i jepte atij tokën e Kanaanit dhe do ta bënte një komb të madh.

Mendo:

Gjatë javës merr pak dhe apo rërë. Përpiqu t'i numërosh kokrrizat e rërës. Imagjino se sa kokrriza të veçanta ka në një fushë apo në një plazh plot me rërë. Tani mendo t'i shumëzosh tërë kokrrizat e rërës apo dheut në tokë! Kaq shumë pasardhës i tha Perëndia se do të kishte Abrami.

- Perëndia i premtoi Abramit, edhe para se të kishte një djalë, që pasardhësit e tij do të ishin sa yjet e qiellit! - Zanafilla 15:5-6.

Mendo:

Një natë Perëndia e çoi Abramin jashtë çadrës së tij dhe i tha të ngrinte sytë dhe të shikonte nëse mund t'i numëronte yjet. Nëse mundesh, provoje edhe ti këtë javë. Shiko se sa yje mund të numërosh. Dhe kujto, mund të shikosh vetëm disa prej tyre. Askush nuk mund t'i numërojë të gjithë!

- Abrami i besoi Perëndisë.

- Ajo që kishte premtuar Perëndia do t'i qe dukur e pamundur.

- Abrami dhe Saraj ishin martuar prej shumë vitesh dhe tani ishin të moshuar, por nuk kishin qenë kurrë në gjendje të kishin fëmijë.

- Megjithatë, Abrami i besoi Perëndisë për t'i dhënë një fëmijë dhe për të dërguar Çlirimtarin si një prej pasardhësve të tij.

- Ngaqë Abrami i besoi Perëndisë, Perëndia e pranoi atë sikur të mos kishte mëkat.
  - Por Abrami ishte mëkatar, një pasardhës i Adamit, ashtu si ne. Pse duhet ta pranonte Perëndia Abramin, një mëkatar?
  - Çfarë pa Perëndia tek Abrami që t'ia konsideronte atë si drejtësi?
  - Çfarë është drejtësia?
  - Rrënja e fjalës është “i drejtë”.

=> Trego grafikun 16: Disa nga premtimet e Perëndisë ndaj Abramit dhe trego numrin 1.

Thuaju fëmijëve të citojnë Zanafillën 15:6.

=> Grafiku 17: Abrahami besoi te Perëndia

=> Trego grafikun 16: Disa nga premtimet e Perëndisë ndaj Abrahamit dhe trego numrin 2.  
Shënim: I njëjti Çlirimtar që do të vinte përmes pasardhjes së Abramit, do të ishte në gjendje që të shpëtonte edhe tërë njerëzimin nga Satani, mëkati dhe vdekja.

=> Trego grafikun 16: Disa nga premtimet e Perëndisë ndaj Abrahamit dhe trego numrin 3.

## Përsëritje

Shiko vargun përmendsh:  
*Dhe ai (Abrami) i besoi Zotit, që ia (Perëndia) vuri në llogari të drejtësisë.*  
Zanafilla 15:6

## Pyetje dhe përgjigje

- Çfarë i tha Perëndia Abramit, pasi u largua Loti?
  - Perëndia i tha që Ai do t'i jepte tërë tokën e Kanaanit;
  - Perëndia premtoi që pasardhësit e Abramit do të ishin më shumë se yjet;
  - Perëndia tha që pasardhësit e Abramit do të shkonin të jetonin në një vend tjetër dhe që ata do të keqtrajtoheshin për katërqind vjet, por pas asaj kohe Perëndia do t'i sillte në tokën e Kanaanit, të cilën Perëndia ia kishte premtuar Abramit.
- Çfarë emrash të rinj i dha Perëndia Abramit dhe Sarajt? **Abraham dhe Sara.**
- Pse Abrahami dhe Sara nuk mund të kishin fëmijë, nëse Perëndia nuk do të kryente një mrekulli për ta?
  - Sara nuk ishte në gjendje të kishte fëmijë;
  - Të dy ishin të moshuar.
- Kush e krijoi burrin dhe gruan e parë dhe i jep jetë çdo foshnje? **Perëndia.**
- Kush e njeh të ardhmen e çdo personi? **Vetëm Perëndia.**

- Perëndia e trajtoi apo pranoi Abramit sikur ai të ishte tërësisht i drejtë.
- Arsyeja e vetme se pse Perëndia e llogariti si të drejtë Abramit ishte për shkak se Abrami i besoi Perëndisë.



- Abrami ishte mëkatar; por për shkak të besimit të tij te Perëndia, ai u pranua prej Tij, sikur të ishte përsosmërisht i drejtë - Romakëve 4:3.
- Abrami e dinte që ai nuk mund të shpëtonte veten nga mëkatet e tij, por **besoi** që Perëndia do të dërgonte një Çlirimtar që do të ishte në gjendje ta shpëtonte nga Satani, mëkati dhe vdekja. Në këtë mënyrë Perëndia do të bekonte tërë njerëzit në tokë.

- Perëndia e dinte se çfarë do t'u ndodhte pasardhësve të Abramit, madje qysh para se të lindnin - Zanafilla 15:13-16.

Mendo:

A e di se çfarë do të ndodhë javën tjetër, vitin tjetër, apo pas 10 vjetësh? Po pas 100 apo 200 vjetësh? Askush nuk e di përgjigjen e këtyre pyetjeve përveç Perëndisë. Vetëm Perëndia di gjithçka për të ardhmen tënde. Le t'i kujtojmë këto premtime dhe të shohim se si i realizon Perëndia më vonë.

- Perëndia i foli përsëri Abramit kur ishte 99 vjeç - Zanafilla 17:1-5.
  - Perëndia e ndryshoi emrin e Abramit në Abraham, sepse Perëndia i premtoi që ai do të bëhej babai i shumë pasardhësve. Abram do të thotë: "atë i ngritur lart";
  - Abraham do të thotë: "atë i një morie fëmijësh".

## 2. Premtimi i Perëndisë që Abrahami dhe Sara do të kishin një djalë - Zanafilla 17:15-16.

- Perëndia ndryshoi edhe emrin e Sarajt në Sara, sepse, edhe pse nuk kishte qenë në gjendje të kishte fëmijë, Perëndia i premtoi se do të kishte një djalë.
  - Saraj do të thotë "princeshë", por Sara do të thotë "nëna e kombeve".
  - Ajo do të bëhej nëna e miliona pasardhësve.

- Dukej e pamundur që Abrahami dhe Sara të kishin një djalë - Zanafilla 17:17.  
Shënim:

*Për studim të mëtejshëm, mund të lexosh Zanafillën 18:1-15. Nëse i lexon këto vargje, mund të përdorësh gjithashtu Figurën Kronologjike 15: "Abrahami, Sara dhe vizitorët e tyre qiellorë".*

Hiri i Perëndisë dhe njohja e Tij e çdo gjëje tregohet në kapitullin 18 në njohjen e Tij të përgjigjes së Sarës (vargu 12-15).

*Shpjegoi fëmijëve më të mëdhenj që disa herë në Bibël, Perëndia u është shfaqur individëve shkurtimisht, në formën e një njeriu. Këto shfaqje quhen "teofani".*

- Abrahami ishte 100 vjeç.
- Sara ishte 90 vjeç.
- Por premtimi nuk varej nga ata dhe tek aftësitë e tyre. Ishte **Perëndia** që e bëri premtimin dhe Ai është Shumë i Larti. Nuk ka asgjë të vështirë për Perëndinë!

*Jeremia 32:17 thotë: "Ah, Zot, Zot! Ja, ti e sajove qiellin dhe tokën me fuqinë tënde të madhe dhe me krahun tënd të shtrirë. Nuk ka asgjë tepër të vështirë për ty".*

# Mësimi 20

## Qëllimi

Në mësimin e sotëm do të shohim, jo vetëm interesin e Perëndisë për tërë njerëzit, por edhe gjykimin e Tij të sigurt për mëkatin, treguar në historinë e Sodomës dhe Gomorrës. Në këtë mësim do t'u tregosh fëmijëve:


- Që Perëndia e gjykon mëkatin.
- Rezultatet e zgjedhjeve të gabuara.
- Interesimin e Perëndisë për çdo person.
- Gjithashtu ky mësim do t'i ndihmojë fëmijët:
- Që të kuptojnë që askush nuk mund ta "heqë qafe" mëkatin.
- Që të shikojnë seriozitetin e mëkatit dhe rebelimin kundër Perëndisë.
- Që të shikojnë se Bibla është e vërtetë.

## Hyrje


Nga kjo histori duhet që fëmijët të kuptojnë që gjithçka që lexojnë në Bibël rreth Perëndisë është e vërtetë, pavarësisht nëse e kuptojnë apo jo. Në historinë e Sodomës dhe Gomorrës do të shikojmë thellësinë e hirit të Perëndisë dhe faktin që Ai i njeh të gjitha gjërat. Ai i tregon këto attribute të Tij në mënyra të ndryshme përgjatë Biblës. Kujtoi fëmijëve që, edhe pse njerëzit mund të kenë mëshirë për njëri-tjetrin, "mëshira" është mënyra e Perëndisë që mëkatarët t'i shpëtojnë ndëshkimit që meritojnë!

## Figurat

- Figura 14: Largimi i Lotit dhe i vajzave të tij



- Figura 15: Shkatërrimi i Sodomës dhe Gomorrës



# Perëndia shkatërroi Sodomën dhe Gomorrën

## Historia

Karola dhe Xhoni shkuan te xhaxhi Piteri me Biblën e tyre të re dhe thanë: "Xhaxhi Piter, po lexonim te Bibla jonë e re dhe kemi disa pyetje".

"Jam i lumtur t'u përgjigjem pyetjeve tuaja" - tha xhaxhi Piteri. "Jam shumë i gëzuar që ti dhe Xhoni mundët të kursenit mjaftueshëm para, për të blerë Biblën tuaj. A nuk është kënaqësi të jesh në gjendje të lexosh atë që thotë Perëndia për ju në Fjalën e Tij?".

"Sigurisht!" - thirri Xhoni. "Unë me Karolën po e lexojmë çdo ditë. Pasi flasim me ty për diçka në Bibël, ne kthehemi në shtëpi dhe e kontrollojmë në Bibël dhe lexojmë më tepër për të".

"Po lexonim për historinë e Abramit, dua të them Abrahamit, dhe Lotit," - tha Karola, - "dhe ishim pak të ngatërruar për atë që the rreth Perëndisë dhe asaj që lexojmë te Zanafilla, kapitulli 18. Në këtë kapitull thuhet se tre burra vizituan Abrahamin dhe njëri prej tyre ishte Perëndia. E di që ti the që Perëndia është kudo, por mendoja që Perëndia jetonte në parajsë apo në qiell".

"E kuptoj se pse jeni ngatërruar Karola" - tha xhaxhi Piteri. "Por a kujton që thashë se kohë më parë kur jetonte Abrahami njerëzit nuk kishin një Bibël si ne, kështu Perëndia fliste drejtpërdrejt me ta. Dhe, disa herë në Bibël, Perëndia iu shfaq njerëzve shkurtimisht, në formën e një njeriu".

"Disa gjëra rreth Perëndisë janë akoma të vështira për mua që t'i kuptoj" - tha Xhoni. "Si për shembull, kur the që Perëndia njeh gjithçka. Pastaj në të njëjtin kapitull Perëndia vepron sikur nuk e di se çfarë po ndodh në Sodomë dhe Gomorrë".

"E kuptoj ku e ke fjalën" - tha xhaxhi Piteri. "Prandaj Perëndia i tha Abrahamit se ai ishte i drejtë. Abrahami besoi atë që tha Perëndia, pavarësisht nëse e kuptonte apo jo çdo gjë rreth Tij. Perëndia nuk gënjen. Megjithatë, ne nuk e dimë gjithmonë se përse Perëndia bën atë që bën apo se si e bën. Kur Perëndia i tha Abrahamit që Ai do të zbriste në Sodomë dhe Gomorrë për të parë se çfarë po ndodhte, nuk ishte ngaqë nuk e dinte, sepse Perëndia e dinte me saktësi se çfarë po ndodhte dhe Ai nuk e pëlqente atë që po bënin njerëzit. Megjithatë, Perëndia donte që Abrahami të dinte se kishte një problem në Sodomë dhe Gomorrë, atje ku jetonte Loti, dhe se Ai do të bënte diçka për atë problem".

"E di!" - tha Karola. "Është njësoj kur mamaja thotë: 'Mendoj se duhet të shkoj të shikoj nëse janë hequr barërat e këqija rreth kopshtit të luleve përballë shtëpisë'. Ajo e di tashmë që barërat e këqija nuk janë hequr, sepse i ka parë më herët, por po më lë mua të kuptoj që pamja e kopshtit të luleve ka rëndësi për të. Ajo po më jep gjithashtu një rast për të bërë diçka për këtë, para se të më ndëshkojë që nuk i kam hequr barërat e këqija".

"Kjo quhet mëshirë, apo jo, xhaxhi Piter?" - pyeti Xhoni. "Mamaja po tregon mëshirë ndaj Karolës. Në vend që ta ndëshkojë Karolën që nuk i ka hequr barërat në kohën e duhur, ajo po i jep një mundësi tjetër për ta bërë".

"Pikërisht ashtu!" - tha xhaxhi Piteri. "As Perëndia nuk ka dëshirë t'i ndëshkojë njerëzit, por Ai urren mëkatin. Kur njerëzit mëkatojnë e mëkatojnë, Perëndia do t'i japë fund dhe do t'i ndëshkojë. Kur Abrahami zbuloi që Perëndia nuk ishte i lumtur me atë që po ndodhte në Sodomë dhe Gomorrë, ai iu lut Perëndisë që të mos i shkatërronte qytetet".

"Si mund të shkatërronte një person tërë qytetin, xhaxhi Piter?" - pyeti Xhoni.

"E di!" - tha Karola. "Perëndia është i plotfuqishëm. Nuk ka asgjë të pamundur për Perëndinë".

"Perëndia është i dashur dhe i mëshirshëm, gjithashtu" - tha xhaxhi Piteri. "Prandaj, në fund të kapitullit 18, lexojmë që Perëndia tha se nuk do t'i shkatërronte qytetet, nëse atje do të ishin të paktën dhjetë njerëz të drejtë".

"Nuk e kemi lexuar ende kapitullin tjetër" - tha Xhoni. "A kishte të paktën dhjetë njerëz të drejtë në Sodomë dhe Gomorrë?".

"Le ta shohim këtë te Biblat tuaja dhe të mësojmë se çfarë ndodhi në Sodomë dhe Gomorrë" - tha xhaxhi Piteri.



**I pabesi:** Keqbërësi, mëkatari  
**Neveri:** Mospëlqim  
**Drejtësi:** Ajo që i pëlqen Perëndisë

## Le të shohim në Bibël

**Fjalët e Urta 15:9 - “Rrugat e të pabesit është një neveri për Zotin, por ai do atë që ndjek drejtësinë”.**

Shumë njerëzve u pëlqen të mendojnë se një “Perëndi i dashur” nuk do ta ndëshkojë kurrë një person. Dhe shumë të tjerë mendojnë se Perëndisë duhet vetëm t’ia kemi frikën; Ai nuk ka dashuri, por mund të manipulohet për të bërë atë që do njeriu. Por Perëndia është i drejtë dhe, edhe pse është me siguri i dashur, Ai duhet pasur frikë. Pe

## Le të mendojmë

1. A u flet Perëndia njerëzve ballë për ballë sot? **Po / Jo.**
2. A gënjen ndonjëherë Perëndia? **Po / Jo.**
3. A i pëlqen Perëndisë t’i ndëshkojë njerëzit? **Po / Jo.**
4. A është Perëndia i dashur dhe i mëshirshëm? **Po / Jo.**
5. A e urren Perëndia mëkatën? **Po / Jo.**

## Mësimet nga Fjala e Perëndisë

Pjesa e Shkrimit që po studion sot është e vlefshme për t’u mësuar prej nesh për shkak të atij lloj mëkati në Sodomë dhe Gomorrë. Homoseksualizmi (dhe çdo lloj tjetër mëkati seksual) praktikohet nga shumë njerëz në kohën tonë dhe shumë e justifikojnë mëkatën e tyre si një “stil jete i zgjedhur”. Stili i jetës pa Perëndisë është bërë popullor dhe i pranueshëm nga ana shoqërore. Por Perëndia nuk ka ndryshuar. Perëndia nuk e ka pranuar dhe nuk do ta pranojë kurrë sjelljen imorale<sup>46</sup>.

### 1. Qëndrimi i Perëndisë ndaj Sodomës dhe Gomorrës - Zanafilla 18:20-21.

- Loti dhe familja e tij u larguan nga Abrahami, sepse nuk kishte as vend dhe as bar të mjaftueshëm për tërë kafshët e tyre, për të jetuar bashkë. Loti u shpërngul afër dy qyteteve të Sodomës dhe Gomorrës.
- Perëndia ishte i pakënaqur me këto qytete të liga për një kohë të gjatë, edhe pse Loti u shpërngul afër tyre.
  - Edhe pse kishte shumë njerëz në botë në atë kohë, Perëndia pa gjithçka që bënin njerëzit në Sodomë dhe në Gomorrë, dhe Ai dëgjoi gjithçka që ata thoshin.
  - Për një kohë të gjatë Zoti (Perëndia) ishte treguar i duruar me njerëzit që jetonin atje, por tashmë erdhi koha kur vendosi që nuk mund ta duronte më sjelljen e tyre mëkatore.
  - Ata nuk mund t’i shpëtonin gjykimin të Perëndisë.

Mendoni:

Pyeti fëmijët nëse e mbajnë mend se si Perëndia priti me durim që njerëzit të pendoheshin në ditët kur jetonte Noe? Por erdhi koha kur Perëndia vendosi që u kishte dhënë kohën e mjaftueshme që ata të pendoheshin. Asnjë nga ata që refuzuan të pajtoheshin me Perëndinë nuk i shpëtoi ndëshkimit të Tij. Duke qenë se Perëndia nuk e ndëshkon mëkatën menjëherë, mund të duket sikur Ai e anashkalon atë. Megjithatë, Perëndia do të ndëshkojë çdo mëkat. Askush nuk mund të shpëtojë nga Perëndia, Krijuesi i tyre shumë i lartë. Ai e sheh mëkatën dhe do ta ndëshkojë atë, te çdo person.

- Këta njerëz ishin krenarë; ata hanin më tepër nga sa kishin nevojë dhe nuk u bëhej vonë për nevojat e të tjerëve.

### 2. Engjëjt e Perëndisë zbritën në Sodomë - Zanafilla 19:1-3

- Ku ishte Loti?
  - Më parë, kur Loti u largua nga Abrahami, ai po jetonte afër qytetit.
  - Tani ishte futur brenda qytetit dhe po jetonte me këta njerëz të këqij.
- Kush ishin vizitorët e tij dhe pse kishin ardhur?
  - Ata ishin dy engjëj të mirë të Perëndisë që nuk kishin ndjekur Satanin.
  - Perëndia i dërgoi në Sodomë për një qëllim të veçantë. Ai i dërgoi ata engjëj për të paralajmëruar Lotin dhe familjen e tij se çfarë do të ndodhte.
  - Perëndia e dinte që Loti i besonte Atij, edhe pse jetonte midis njerëzve të Sodomës dhe Gomorrës.

<sup>46</sup> Si mësues mund të ngurrosh t’ua përmendësh fëmijëve të klubit sjelljen imorale të njerëzve të Sodomës dhe Gomorrës. Edhe pse është një histori e trishtuar e mënyrës së tyre të jetës, ajo është një pjesë shumë reale e botës në të cilën jetojmë. Fëmijët duhet të dëgjojnë pikëpamjen biblike rreth çështjeve që u paraqiten dhe u shfaqen në shkollë dhe në mediat e botës. Ata duhet të dinë që Perëndia e shikon dhe e ndëshkon mëkatën; dhe se Ai është një Perëndi i hirshëm, që gjen një rrugë shpëtimi për ata që besojnë tek Ai.



**Lexo:** Ezekieli 16:49-50.  
Këto vargje na thonë se si ishin njerëzit e Sodomës.

## Përsëritje

Ç	L	I	R	I	M	T	A	R	C	C	I
L	N	N	N	C	C	C	S	S	S	X	M
L	I	F	U	Q	I	S	H	E	M	X	E
P	D	D	D	M	M	X	M	M	X	B	S
R	D	I	D	A	S	H	U	R	X	B	H
E	T	Y	B	P	P	N	N	N	K	B	I
M	T	S	V	P	M	M	B	N	K	K	R
T	T	I	D	R	E	J	T	E	L	L	S
O	Q	S	S	C	X	C	X	C	L	I	H
N	H	H	H	V	V	V	Y	Y	Y	I	E
L	L	N	D	E	S	H	K	O	N	Y	M

## Pyetje dhe përgjigje

- Si e dinte Perëndia për të keqen që po ndodhte në Sodomë dhe Gomorrë? **Perëndia di gjithçka.**
- A do t'i shpërfillë Perëndia mëkatet e disa njerëzve? **Jo, Perëndia do të gjykojë çdo person.**
- A mund ta ndalojë dikush Perëndinë për të mos i ndëshkuar njerëzit, kur Ai vendos që kanë pasur kohë të mjaftueshme për t'u menduar (ndryshuar mendjen)? **Jo, Perëndia është më i larti.**
- Pse i dërgoi Perëndia engjëjt e Tij për të shpëtuar Lotin dhe familjen e tij? **Sepse Loti u pajtua me Perëndinë se ishte mëkatar dhe besoi në premtimet e Perëndisë për të dërguar Çlirimtarin.**
- Pse e shndërroi Perëndia gruan e Lotit në një statujë kripe? **Sepse ajo nuk iu bind urdhrit të Perëndisë, që ata të mos e kthenin kokën pas, te qytetet që po digjeshin.**

### 3. Mëkatet e sodomitëve - Zanafilla 19:4-7.

Mendo:

Çfarë historie e neveritshme. Por Perëndia e ka vendosur këtu për ne, në mënyrë që ta lexojmë. Ndaluhet dhe mendo: a janë njerëzit e sotëm më të mirë?

Plani i vetëm i Perëndisë për seksin ishte që kjo të ishte lidhja e veçantë midis burrit dhe gruas të tij dhe mënyra për të pasur fëmijë. Por këtyre njerëzve nuk u interesonte Perëndia. Ata donin vetëm t'i pëlqenin vetes. Trupat e tyre ishin jashtë kontrollit, ashtu sikurse ndodh me shumë njerëz sot. Tërë bota jonë është e kërcënuar nga një sëmundje e tmerrshme për shkak se burrat dhe gratë kanë refuzuar planin e Perëndisë për jetët e tyre. Zgjedhja nga ana e Lotit e tokës "më të mirë" shfaqet krejt ndryshe tani, apo jo?! Nëse Perëndia nuk do të kishte dërguar engjëjt e Tij, çfarë fundi të tmerrshëm do të kishin pasur Loti dhe vajzat e tij! Por Bibla na thotë që Loti i besoi Perëndisë dhe Perëndia e shpëtoi.

### 4. Loti, gruaja dhe vajzat e tij u shpëtuan nga Sodoma - Zanafilla 19:10-17.

- Perëndia nuk i shpëtoi Lotin, gruan dhe vajzat e tij sepse ata ishin të mirë.
  - Loti nuk po jetonte një jetë të keqe si njerëzit e Sodomës, por edhe ai, kishte lindur mëkatar, si gjithë të tjerët.
  - Por Loti u pajtua me Perëndinë se ai ishte mëkatar dhe besoi në mëshirën e Perëndisë.
  - Loti u besoi premtimeve të dhëna, si Adamit, ashtu edhe xhaxhait të tij Abrahamit, premtime rreth Çlirimtarit që do të vinte.
- Engjëjt e Perëndisë e nxorën Lotin jashtë, para se të shkatërroheshin qytetet e këqija.
- Perëndia i shpëton gjithmonë ata që pajtohen me Të dhe besojnë tek Ai.
  - => Figura 16: Shpëtimi i Lotit dhe i vajzave të tij
    - Abeli u pajtua me Perëndinë dhe i besoi Atij, dhe Perëndia e pranoi Abelin.
    - Noeu u pajtua me Perëndinë dhe i besoi Atij, dhe Perëndia e shpëtoi Noeun nga përmbytja.
    - Loti u pajtua me Perëndinë dhe i besoi Atij, dhe Perëndia e çliroi para se të shkatërrohej Sodoma.

### 5. Perëndia shkatërroi Sodomën dhe Gomorrën - Zanafilla 19:24-25.

=> Figura 17: Shkatërimi i Sodomës dhe i Gomorrës

Shënim: Sapo Loti që i sigurt jashtë qytetit, Perëndia e shkatërroi Sodomën dhe Gomorrën. Perëndia e urren mëkatin. Ashtu siç e shkatërroi botën me anë të përmbytjes në kohën e Noeut, tani i shkatërroi këta njerëz të këqij me zjarr. Te 2 Pjetrit 2:6 Perëndia e quan shkatërrimin e këtyre dy qyteteve një shembull të asaj që do të ndodhë ndaj njerëzve jo të perëndishëm.

### 6. Gruaja e Lotit ktheu vështrimin pas - Zanafilla 19:26.

- Kur engjëjt nxorën Lotin, gruan e tij dhe dy vajzat nga Sodoma, ata u thanë që të mos shikonin pas, por të vraponin në male. Gruaja e Lotit nuk u bind.
- Perëndia e dinte se çfarë kishte në zemrën e Lotit.
  - Gruaja e Lotit ishte si Kaini; ajo nuk besonte te Perëndia.
- Ajo ishte e marrë që shpërfillti paralajmërimet e Perëndisë, sepse, kur ktheu vështrimin pas, Perëndia e ktheu në një statujë kripe.
  - Perëndia nuk kërcënon për të ndëshkuar dhe pastaj të harrojë. Ai i kujton dhe i mban premtimet e Tij për të bekuar ata që besojnë tek Ai dhe për të ndëshkuar ata që nuk i binden Atij.



# Mësimi 21

## Qëllimi

Ky mësim është një përmbledhje e asaj që kemi mësuar në 10 mësimet e fundit. Mund të bësh pyetje të tjera apo t'i përshtatësh pyetjet sipas moshës së fëmijëve të klubit. Të lutem referoju për ndihmë faqeve 33-34, për të zhvilluar mësimet dhe lojërat e përsëritjes.

## Hyrje

Shpjegoju fëmijëve të klubit: Ashtu si Xhoni dhe Karola, edhe ne duam që të përsërisim atë që kemi mësuar që nga hera e fundit që kemi bërë përsëritjen (testin). Nëse fëmijët nuk kanë dëgjuar për sesionet pyetje-përgjigje, të quajtur test, atëherë mësoi me këtë term. Ne do t'i quajmë këto ditë të veçanta përsëritje Testi Awana. Para se të mësojmë më tepër për Abrahamin dhe premtimet e Perëndisë ndaj tij dhe ndaj pasardhësve të tij, ne do të përsërisim atë që kemi mësuar për Adamin dhe Evën, Noeun dhe pasardhësit e tij, si dhe për Abrahamin dhe familjen e tij.

## Figurat

Shënim: Nëse e bën këtë përsëritje pas pyetjeve të testit, mund të kalosh më tepër kohë për të përsëritur ato pjesë të mësimave që fëmijët e klubit nuk i mbajnë mend mirë.

- Grafiku 1: Mësimi për Perëndinë
- Përdore këtë për të përsëritur atributet e Perëndisë.
- Grafiku 2: Perëndia është më i madh se të gjithë

# Pyetje, pyetje, pyetje!

## Historia

Xhoni dhe Karola ishin duke shkruar në blloqet e tyre të shënimeve, kur xhaxhi Piteri erdhi drejt tyre në oborr dhe i pyeti: “Çfarë po shkruani?”.

“Oh, përshëndetje, xhaxhi Piter!” - thanë Xhoni dhe Karola.

“Ne po mendonim për të gjithë njerëzit për të cilët po mësojmë në Bibël” - tha Xhoni. “Ne po i shkruanim emrat e atyre që kujtonim dhe pastaj do të ta tregonim listën”.

“Mendoj se i kujtuam të gjithë, xhaxhi Piter” - tha Karola e gëzuar.

“Në rregull” - tha xhaxhi Piteri. “Pa na thuaj ata që kujton”.

“I pari është i lehtë” - tha Xhoni. “Adami është i thjeshtë, sepse ai është njeriu i parë që krijoi Perëndia”.

“Pastaj vjen Eva, gruaja e Adamit” - shtoi Karola.

“Dhe fëmijët e tyre, Kaini dhe Abeli, janë personat e tjerë për të cilët folëm” - tha Xhoni.

“Ne folëm për Noeun dhe tërë njerëzit mëkatarë që jetuan gjatë kohës së tij” - tha Karola. “Dhe pastaj mësuam që pasardhësit e tij mëkatuan gjithashtu, kur u përpoqën të ndërtonin një kullë në qiell”.

“Pastaj, më vonë kemi folur për Abrahamin, gruan e tij, Sarën dhe nipin e tyre, Lotin” - shtoi Xhoni.

“Që të dy keni kujtesë të mirë” - tha xhaxhi Piteri. “Jam krenar për ju! Megjithatë, mund të mendoj për dy vetë që nuk i përmendët. Secili prej tyre pati një rol në jetën e secilit njeri që përmendët”.

“Në çfarë mënyre, xhaxhi Piter?” - pyeti Xhoni. “Ata duhet të ishin rreth 2000 vjeç. Askush nuk mund të jetë aq i moshuar!”.

“E di!” - tha Karola. “Ne harruam Satanin, dhe më të rëndësishmin, Perëndinë!”.

“Ke të drejtë, Karola!” - tha xhaxhi Piteri. “Sa herë që ka njerëz që mëkatojnë, edhe Satani është atje. Nga mendon se i morën besimet e tyre të rreme fetare, paraardhësit tanë të hershëm?”.

“Nga Satani?” - pyeti Xhoni.


“Ke të drejtë” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Nga Satani dhe nga idetë e tyre kur haptazi i kthyen kurrizin të vërtetës rreth Perëndisë”.

“Nuk arrij ta besoj që harruam Perëndinë” - tha Karola e trishtuar. “Ne mësuam shumë gjëra rreth Tij. Ne mësuam se Ai është i gjithëdijshëm, i plotfuqishëm, i dashur, i mëshirshëm, besnik, i ndershëm...”.

“E di,” - ndërpreu Xhoni, - “le ta lemë xhaxhi Piterin të na bëjë pyetje rreth asaj që kemi mësuar që nga hera e fundit që na ka bërë pyetje. Mbase këtë herë do të fitoj unë dhe do të kem përgjigje për më tepër pyetje sesa ti!”.

“Në rregull,” - tha Karola, - “por bëhu gati të humbasësh përsëri!”.

## Le të shohim në Bibël



Le të shohim se sa shumë vargje kanë mësuar përmendësh fëmijët dhe sa janë në gjendje t'i thonë. Bëj një pyetje për secilin prej dhjetë vargjeve që kemi përdorur në dhjetë mësimet e fundit. Shembull: "Kush mund të thotë Psalmin 119:160?" Shiko Kartën Awana për dhjetë vargjet. Fëmijët mund të fitojnë pikë shtesë për recitimin e tërë vargjeve pas Kartës Awana.

Psalmi 119:160; Hebrenjve 4:13; Romakëve 5:12; Fjalët e Urta 14:12; Ezekieli 18:32; Isaia 45:18; Zanafilla 12:2; Malakia 3:6; Zanafilla 15:6; Fjalët e Urta 15:9.

## Le të mendojmë

Ndërsa ke mësuar përgjatë Zanafillës 3 deri në 19, mësimet kanë përfshirë periudhën kohore nga Adami dhe Eva te Noeu, te Abrahami dhe Loti, dhe te Sodoma e Gomorra. Këto mësimet kanë paraqitur gjithëdijen e Perëndisë dhe zemërimin e tij kundër mëkatarëve, por edhe hirin dhe durimin e Tij në përpjekjen për t'i tërhequr tërë njerëzit te vetja. Sovraniteti dhe gjithëdija e Perëndisë tregohen në kontrollin që Ai ka mbi tërë krijimin.

**Adami dhe Eva:** Këto pyetje rreth Adamit dhe Evës fillojnë me kohën kur Satani u fut në historinë e tyre. Mësuam për urrejtjen e Satanit për Perëndinë dhe për njeriun; ai është gënjeshtar, mashtrues, paditës dhe vrasës.

1. Në kopshtin e Edenit, Satani vizitoi Evën. Satani nuk donte që Eva ta dinte se ishte ai. Si u maskua Satani, për të mashtruar Evën? **Si gjarpër.**
2. Perëndia tha që Adami dhe Eva do të vdisnin nëse do të hanin frutën e pemës të njohjes të së mirës dhe të së keqes. Çfarë i tha Satani Evës që do t'u ndodhte nëse do të hanin nga pema e njohjes të së mirës e të së keqes? **Satani tha që ata nuk do të vdisnin, por ata do të bëheshin si Perëndia dhe do të ishin në gjendje të vendosnin vetë se çfarë ishte e mirë dhe e keqe.**
3. A i detyroi Satani Adamin dhe Evën të hanin nga pema që Perëndia u kishte thënë të mos hanin? **Jo, Adami dhe Eva zgjodhën vetë të mëkatonin. Perëndia i kishte bërë udhëzimet e Tij të qarta për ta; Ai ishte treguar shumë i dashur me ta. Ai u dha atyre një vullnet për të bërë zgjedhje; ata zgjodhën që të mos bindeshin.**
4. Adami dhe Eva nuk vdiqën menjëherë kur hëngrën frutën e pemës të njohjes të së mirës dhe të së keqes. Perëndia kishte thënë që ata do të vdisnin për mosbindjen e tyre. Çfarë nënkuptoi Ai? **Ai nënkuptoi që menjëherë ata nuk do të kishin një marrëdhënie me Perëndinë, mikun e tyre dhe burimin e jetës; trupat e tyre do të vdisnin një ditë dhe një ditë trupi, shpirti dhe fryma e tyre do të ndaheshin përherë nga Perëndia në liqenin e zjarrit.**
5. Çfarë bënë Adami dhe Eva pasi hëngrën nga pema? **Ata bënë për vete veshje me gjethe fiku dhe u fshehën nga Perëndia.**
6. A është e mundur t'i fshihemi Perëndisë? **Jo, Perëndia është kudo dhe shikon gjithçka.**
7. Pse i refuzoi Perëndia veshjet që bënë Adami dhe Eva? **Sepse Perëndia donte t'i mësonte Adamit dhe Evës që ata nuk mund të bënin diçka për t'u bërë të pranueshëm para Perëndisë.**
8. Satani ishte i lumtur që Adami dhe Eva nuk u bindën. Ai mendoi se ai e kishte mundur Perëndinë dhe se tërë njerëzit do të ishin të tijtë përgjithmonë. A kishte të drejtë Satani? A fitoi ai? **Jo, askush nuk mund të fitojë kundër Perëndisë. Ai është Krijuesi më i lartë.**
9. Duke qenë se Perëndia i donte Adamin dhe Evën aq shumë, Ai premtoi të dërgonte Dikë një ditë, Dikë që do të mundte Satanin dhe do të shpëtonte njerëzimin nga pushteti i tij. Kë do të dërgonte Perëndia? **Perëndia do të dërgonte një Çlirimtar. Një çlirimtar është dikush që na shpëton. Një çlirimtar na bën të lirë.**
10. Si do të vinte ky Çlirimtar? **Përmes farës së gruas (një virgjëreshe).**

11. A e meritonin Adami dhe Eva dashurinë e Perëndisë dhe premtimet e Tij për një çlirimtar? **Jo, ata meritonin të shkonin në ndëshkim të përjetshëm.**
  12. Çfarë evidence ka në botë sot për mallkimin e Perëndisë ndaj Adamit dhe Evës, si edhe ndaj tokës? **Sëmundje, brenga, dhimbje gjatë lindjes, vdekje, punë të vështira, gjemba dhe barëra të këqija, thatësi, stuhi shkatërruese, bimë helmuese, insekte të dëmshme ndaj kafshëve janë të gjitha shenja të mallkimit të Perëndisë.**
  13. Pse vdesin tërë njerëzit? **Meqë Adami nuk iu bind Perëndisë, tërë pasardhësit e Adamit do të vdesin.**
  14. Pse Perëndia i vrau kafshët për të bërë veshje për Adamin dhe Evën? **Sepse Perëndia po u kujtonte atyre që ndëshkimi për mëkatin është vdekja.**
  15. Pse u bëri Perëndia veshje? **Sepse, edhe pse kishin mëkatuar, Ai i donte ata ende, dhe Ai dëshironte t'u tregonte se ishte i vetmi që do t'i bënte të pranueshëm për Të.**
  16. Pse Perëndia i dëboi Adamin dhe Evën jashtë kopshtit? **Në mënyrë që ata të mos ishin në gjendje të hanin frutën nga pema e jetës dhe të jetonin përgjithmonë në mëkat.**
  17. Çfarë bëri Perëndia për të siguruar që ata të mos ktheheshin në kopsht? **Ai vendosi engjëjt të quajtur kerubinë dhe një shpatë zjarri që vërtitej në çdo drejtim për t'i mbajtur larg.**
  18. A mundet dikush të gënjejë apo të mashtrojë Perëndinë? **Jo.**
  19. Kush i jep çdo personi jetën e tij? **Perëndia.**
  20. Cilët ishin prindërit e parë? **Adami dhe Eva.**
  21. Ku lindën Kaini dhe Abeli? **Jashtë kopshtit të Edenit.**
  22. Pse Kaini dhe Abeli lindën mëkatarë dhe u ndanë nga Perëndia? **Sepse babai i tyre, Adami, mëkatoi.**
  23. Pse tërë njerëzit kanë lindur mëkatarë dhe të ndarë nga Perëndia? **Për të njëjtën arsye, sepse Adami është edhe babai/paraardhësi i tyre.**
  24. Pse Perëndia e pranoi Abelin dhe ofertën e tij? **Abeli besoi dhe iu bind Perëndisë.**
  25. Pse Perëndia e refuzoi ofertën e Kainit? **Kaini nuk i besoi dhe nuk iu bind Perëndisë.**
  26. Çfarë bëri Kaini kur Perëndia e refuzoi ofertën e tij? **Ai ishte i zemëruar dhe vrau Abelin.**
  27. Si e dinte Perëndia atë që i kishte bërë Kaini Abelit? **Perëndia shikon gjithçka.**
  28. A i erdhi keq Kainit që vrau Abelin? **Jo, ai u largua nga Perëndia.**
  29. Pse Perëndia i dha Setin, Adamit dhe Evës? **Perëndia ua dha për të zëvendësuar Abelin.**
- Noeu dhe pasardhësit e tij:** Njerëzit në kohën e Noeut mendonin vetëm për veten. Ata ishin të dhunshëm. Ata nuk ishin të interesuar për ta njohur Perëndinë, apo për t'i pëlqyer Atij.
1. Çfarë tha Perëndia se do të bënte, si pasojë e refuzimit të njerëzve për t'u penduar? **Perëndia tha që Ai do të shkatërronte çdo qenie të gjallë në tokë.**
  2. Pse Perëndia vendosi të shpëtonte Noeun dhe familjen e tij? **Ata ranë dakord me Perëndinë që ata ishin mëkatarë dhe i besuan Atij për t'i shpëtuar përmes ardhjes së Çlirimtarit.**
  3. Çfarë i tha të bënte Perëndia Noeut? **Të ndërtonte arkën, sepse Perëndia do të përmbyste tokën.**
  4. A e dëgjoi ndonjë nga njerëzit mesazhin e Noeut për Perëndinë? **Jo.**
  5. A mund t'i shpëtojë dikush Perëndisë kur Ai vendos që është koha të ndëshkojë mëkatin? **Jo.**
  6. Kur erdhi përmbytja, a shpëtoi nga vdekja dikush jashtë arkës? **Jo.**
  7. Çfarë shenje dha Perëndia (në qiell) për të treguar se Ai nuk do ta shkatërrojë kurrë tokën përmes përmbytjes? **Ylberin.**
  8. A adhuruan Perëndinë tërë pasardhësit e Noeut? **Jo, vetëm disa adhuruan Perëndinë.**
  9. Çfarë bënte shumica e pasardhësve të Noeut? **Ata ndoqën gënjeshtat e Satanit. Ata adhuronin idhuj të bërë, si njerëzit zogjtë, kafshët dhe rrëshqanorët. Ata adhuruan gjithashtu diellin hënën dhe yjet.**
  10. Çfarë ndërtuan njerëzit që të ishin të rëndësishëm dhe të mos shpërndareshin në mbarë tokën siç urdhëronte Perëndia? **Kullën e Babelit.**
  11. Çfarë bëri Perëndia për të ndaluar ndërtimin e kullës? **Ai u dha gjuhë të ndryshme familjeve të ndryshme, në mënyrë që të mos flisnin më me njëri-tjetrin. Meqë nuk mund të kuptonin njëri-tjetrin, ata u shpërngulën në vende të ndryshme.**

**Abrahami:** Edhe pse njerëzit u rebeluan kundër Perëndisë dhe ndërtuan kullën e Babelit, Perëndia do të mbante premtimin e Tij për të dërguar një Çlirimtar për njerëzimin. Perëndia zgjodhi Abramin të ishte pasardhësi i Çlirimtarit. Perëndia i tha Abramit të largohej nga vendi i tij dhe të shkonte në një vend ku Perëndia i premtoi ta çonte.

1. A kishte Abrami një familje? **Po, Saraj ishte gruaja e Abramit. Ata nuk kishin fëmijë.**
2. Çfarë premtimi i dha Perëndia Abramit për fëmijët e tij? **Pasardhësit e Abramit do të bëheshin një komb i madh.**
3. A e zgjodhi Perëndia Abramin, sepse Abrami nuk ishte mëkatar? **Jo, tërë njerëzit janë mëkatarë. Abrami besoi dhe iu bind Perëndisë.**
4. Cilët kushërinj të tjerë shkuan me Abramin dhe Sarajn? **Nipi i Abramit, Loti.**
5. Pse Loti u largua nga Abrami? **Nuk kishte bar të mjaftueshëm për të ushqyer kafshët e shumta që kishin. Kështu Abrami i tha Lotit të zgjidhte vendin që donte.**
6. Ku u shpërngul Loti? **Loti shkoi në vendin që dukej si vendi më i bukur. Ishte fushë.**
7. Afër cilave qytete jetoi Loti? **Sodoma dhe Gomorra.**
8. **Si ishin njerëzit në Sodomë dhe Gomorrë? Të ligj, ata e injoronin Perëndinë.**
9. Çfarë i bëri Perëndia Sodomës dhe Gomorrës? **Ai dogji qytetet dhe njerëzit.**
10. Pse Perëndia i dërgoi engjëjt e Tij për të shpëtuar Lotin, gruan dhe familjen e tij? **Sepse Loti u pajtua me Perëndinë që ishte mëkatar dhe u besoi premtimeve të Perëndisë për të dërguar një Çlirimtar.**
11. Pse Perëndia e ktheu gruan e Lotit në një statujë kripe? **Sepse ajo nuk iu bind urdhrit që u kishte dhënë Perëndia, që të mos e kthenin vështirimin pas drejt qyteteve që po digjeshin.**
12. Çfarë emrash të rinj u dha Perëndia Abramit dhe Sarajt? **Abraham dhe Sara.**

## **Pyetje për diskutim**

1. Perëndia i tha Adamit që, nëse hanin frutën nga pema e njohjes të së mirës e të së keqes, ata do të vdisnin me siguri, por Satani i tha Evës që ata nuk do të vdisnin. Çfarë po sugjeronte Satani për Perëndinë? **Se Ai ishte gënjeshtar.**
2. Kur Adami dhe Eva kuptuan që ata ishin lakuriq, përse bënë rroba për vete? **Ngaqë qëndrimet e tyre ndaj trupave të tyre ndryshuan, ata u përpoqën të kujdeseshin për veprat e tyre, në vend që t'i kërkonin ndihmë Perëndisë.**
3. A e thirri Perëndia Adamin se nuk e dinte se ku ishin Adami dhe Eva? **Jo, Perëndia e dinte se ku ishin. Perëndia donte që ata të zgjidhnin të shkonin tek Ai dhe të pranonin mëkatin e tyre.**
4. Në ç'mënyrë u bënë Adami dhe Eva si Perëndia, pasi hëngrën frutën e pemës së njohjes të së mirës e të së keqes? **Tani ata dinin që ekzistonte e keqja, po ashtu edhe e mira.**
5. Përse Perëndia gjeti kohën t'i fliste Kainit për qëndrimin e tij të keq? **Sepse Perëndia e donte Kainin dhe donte që ai të pajtohej që ishte mëkatar dhe që të sillte flijimin e duhur.**
6. Cili ishte qëndrimi i shumicës së njerëzve në kohën e Noeut? **Ata mendonin vetëm për t'i pëlqyer vetes. Ata ishin egoistë dhe të dhunshëm. Ata nuk ishin të interesuar të njihnin apo t'i pëlqenin Perëndisë.**
7. Cila është ajo gjë e rëndësishme që duhet të kujtojmë për arkën? **Arka kishte vetëm një derë. Kishte vetëm një rrugë për t'u futur në arkë dhe për të shpëtuar nga gjykimi i Perëndisë.**
8. Si e mësoi të vërtetën rreth Perëndisë, brezi i njerëzve pas përmytjes?
  - a. **E vërteta rreth Perëndisë Krijues dhe gjykimi i Tij me anë të përmytjes u tregua nga brezi në brez.**
  - b. **Njerëzit mund të shikojnë që kishte një Krijues shumë të lartë në bazë të gjërave që Perëndia kishte krijuar. Dielli, hëna, yjet dhe tërë gjërat në tokë ishin provë që Perëndia ishte Krijuesi i tyre shumë i lartë.**
9. Çfarë bëri Abrami kur Perëndia i dha premtimet? **Ai i besoi Perëndisë. Ai u largua nga vendi i tij dhe shkoi atje ku e drejtoi Perëndia.**

# Mësimi 22 Perëndia i dha Abrahamit Isakun

## Qëllimi

Ky mësim tregon besnikërinë më të lartë, hirin dhe fuqinë sovranë të Perëndisë, duke i dhënë Abrahamit dhe Sarës, Isakun, si dhe duke siguruar më pas një dash për të vdekur në vend të Isakut.

Ky mësim do t'i ndihmojë fëmijët të:

- Shikojnë të drejtën që Perëndia ka mbi jetët e tyre, sepse Ai zotëron çdokënd dhe gjithçka.
- Kuptojnë që nuk ka asgjë të pamundur për Perëndinë.
- Shikojnë se ata nuk mund të shpëtohen vetë, por Perëndia shpëton ata që i besojnë Atij.
- Shikojnë që ata mund të shikojnë te Perëndia me anë të besimit.


Në historinë e sotme, duket sikur Abrahami ka hequr dorë nga pronësia dhe kontrolli i tij ndaj zotërimeve, gruas dhe jetës së djalit të tij të vetëm. Besimi i tij te Perëndia është si një prehe prej fëmijë dhe çlirim nga dyshimi, gjë që i mundëson të lërë gjithçka në duart e Perëndisë. Abrahami kuptoi atë që të gjithë ne duhet të kuptojmë: Perëndia është shumë besnik. Ai i mban gjithmonë premtimet e Tij.

## Hyrje

Dëshira jote është që fëmijët e klubit tënd të kujtojnë Abrahamin dhe besimin e tij te Perëndia. Kujtoi që kjo nuk është thjesht një ngjarje rreth dikujt në histori. Abrahami është “ati” ynë në besim. Megjithatë, ne duam që fëmijët e klubit të kujtojnë që këto histori rreth Abrahamit nuk janë për madhësinë e Abrahamit, por për atë të Perëndisë, si dhe për besnikërinë e Tij ndaj njerëzimit. Sot do të tregosh se si besimi i Abrahamit paraqitet si mënyra e drejtë për të vepruar ndaj besnikërisë së Perëndisë.

## Figurat

- Grafiku 16: Disa premtime të Perëndisë ndaj Abrahamit
- Figura 16: Abrahami ofron Isakun



## Historia

“A e gjen dot se çfarë zbuluam në Bibël, xhaxhi Piter?” - pyeti Xhoni.

“Çfarë gjetët, Xhon?” - pyeti xhaxhi Piteri.

“Unë me Karolën po kërkonim nëpër librat e ndryshëm në Bibël,” - tha Xhoni, - “dhe pamë emrin e Abrahamit të përmendur në disa libra të ndryshëm”.

“Jam i gëzuar që keni gjetur kohën për të parë në tërë Biblën” - tha xhaxhi Piteri. “Sa më shumë e lexojmë Biblën, aq më shumë do të mësojmë për Perëndinë dhe planet e Tij për ne”.

“Po pyesnim veten se pse flitet aq shumë për Abrahamin në Bibël” - tha Karola. “Sepse është i ndryshëm nga njerëzit e tjerë në Bibël” - tha xhaxhi Piteri.

“Çfarë do të thuash me këtë?” - pyeti Karola. “Për shkak të gjërave të mira që bëri?”.

“Po, por më e rëndësishmja,” - u përgjigj xhaxhi Piteri, - “është për shkak të premtimeve që Perëndia i dha Abrahamit. Dhe Abrahami i besoi Perëndisë”.

“Dhe Perëndia e pranoi sikur të ishte i drejtë” - thirri Xhoni.

“Kujtoj që kemi folur për tërë premtimet që Perëndia i dha Abrahamit. Vetëm se nuk i mbaj mend të gjitha”.

“Premtimet që i bëri Abrahamit janë shumë të rëndësishme për Të” - tha xhaxhi Piteri. “Prandaj Ai i përmend ato në Bibël. Ai dëshiron që t'i kujtojmë të gjitha. Le të shohim në Bibël dhe të gjejmë disa prej premtimeve që kemi folur”.

“Njëri nga premtimet ishte që Perëndia do të bënte një komb të madh prej Abrahamit” - kujtoi Karola. “Dhe Abrahami nuk kishte fare fëmijë në atë kohë!”.

“Shikoni nëse mund të gjeni premtimin e fundit të Zanafilla 12:3” - tha xhaxhi Piteri.

“Thotë që tërë njerëzit në tokë do të bekoheshin përmes Abrahamit” - tha Xhoni.

“Këtu përfshihemi dhe ne, ti dhe unë” - tha xhaxhi Piteri.

“Do të thuash që Perëndia mendoi për ne që në atë kohë?” - pyeti Karola.

“Po, Karola,” - u përgjigj xhaxhi Piteri, - “edhe në atë kohë Perëndia e dinte që ne do të lindnim. Perëndia di gjithçka. Dhe Ai zgjodhi të sillte bekim ndaj kujtdo që do të lindte nga pasardhja e Abrahamit. Çlirimtari i premtuar i Perëndisë do të ishte një prej pasardhësve të Abrahamit”.

“Perëndia tha gjithashtu, që pasardhësit e Abrahamit do të ishin sa yjet” - tha Xhoni. “Sa yje ka, xhaxhi Piter?”.

“Më tepër nga sa mund të numërojmë” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Perëndia po bënte një premtim shumë të madh e të mrekullueshëm!”.

“Si e dinte me siguri Abrahami se do të ndodhte e tëra kjo, sidomos duke qenë se nuk kishte fëmijë?” - pyeti Xhoni.

“Bibla na thotë që Abrahami i besoi Perëndisë, edhe kur dukej e pamundur” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Tërë këto gjëra që iu premtuan Abrahamit nuk vareshin nga aftësia e Abrahamit për t'i realizuar. Ato vareshin nga aftësia e Perëndisë për t'i realizuar. Nuk është madhështia e Abrahamit, por ajo e Perëndisë që tregohet në jetën e Abrahamit. Perëndia e përmbushi çdo premtim”.

“Por si i përmbushi Ai kur Abrahami nuk kishte fëmijë?” - pyeti Karola.

“Shiko,” - u përgjigj xhaxhi Piteri, - “Perëndia priti derisa Abrahami mbushi 100 vjeç dhe Sara 90. Pastaj Perëndia u dha atyre një djalë!”.

“Ata nuk mund të kishin një fëmijë në atë moshë, xhaxhi Piter!” - thirri Karola. “Kjo është e pamundur”.

“Jo për Perëndinë” - tha xhaxhi Piteri. “Dhe me këtë bir Perëndia kishte gjëra edhe më të mahnitshme për të bërë përmes jetës së Abrahamit. Perëndia vendosi besimin e Abrahamit në provë. Ai donte të provonte besimin e Abrahamit, donte të provonte se sa shumë besim kishte Abrahami tek Ai”.



## Le të shohim në Bibël



**Isaia 43:11 - “Unë, unë jam Zoti dhe përveç meje nuk ka Shpëtimtar tjetër”.**

Pasi të japësh mësimin sot, ndihmoi fëmijët të shohin që Isaku mund të shpëtohej vetëm me ndihmën e Perëndisë. Perëndia është Shpëtimtari i vetëm. Ai është më i madh nga të gjithë.

## Le të mendojmë

1. Kujt i dha Perëndia shumë premtime?  
a. Satanit; b. **Abrahamit**; c. Lotit.
2. Sa fëmijë kishte Abrahami kur Perëndia i bëri këto premtime?  
a. Një; b. Shumë; c. **Asnjë**.
3. Sa pasardhës tha Perëndia që do të kishte Abrahami?  
a. Asnjë; b. **Sa yjet në qiell**; c. Një.
4. A ishin Abrahami dhe Sara të rinj kur Perëndia u tha që do të kishin një fëmijë? Po / **Jo**.
5. A ka ndonjë gjë të pamundur për Perëndinë? Po / **Jo**.

## Mësime nga Fjala e Perëndisë

Thuaj fëmijëve të thonë vargun përmendësh nga mësimi 19, Zanafilla 15:6. Abrahami i besoi Perëndisë dhe Perëndia e pranoi njësoj sikur të ishte person i drejtë.

Sot do të studiojmë provën më të madhe të besimit të Abrahamit. Por më e rëndësishme se besimi i Abrahamit është **besnikëria e Perëndisë të Cilin i besoi**. Perëndia është personazhi kryesor i historisë dhe i tërë Biblës! Sigurohu që fëmijët e klubit t'i dëgjojnë me kujdes gjërat e mahnitshme që Perëndia ka bërë për Abrahamin.

### 1. Perëndia e përbushi premtimin e Tij dhe u dha Abrahamit dhe Sarës një bir - Zanafilla 21:1-3.

- Edhe pse Abrahami dhe Sara ishin shumë të moshuar për të pasur fëmijë, Perëndia kishte premtuar t'u jepte një djalë.
  - Abrahami ishte 100 vjeç dhe Sara 90.
  - Sara qeshi kur Perëndia tha që ajo do të kishte një djalë (Zanafilla 18:12).
  - Sara nuk kishte pasur kurrë një djalë; ajo e dinte se kjo ishte e pamundur në moshën e saj.
- Nuk ka asgjë të pamundur për Perëndinë; Ai mund të bëjë gjithçka që dëshiron.
- Shumë vjet kishin kaluar që kur Perëndia premtoi për herë të parë për t'i dhënë një djalë Abrahamit, por Perëndia nuk e kishte harruar premtimin e Tij.
  - Perëndia nuk e kishte ndryshuar mendjen.
  - Sara pati një bir, ashtu siç kishte premtuar Perëndia. Abrahami dhe Sara e quajtën birin e tyre Isak.

### 2. Perëndia urdhëroi Abrahamin dhe Sarën ta quanin birin e tyre Isak - Zanafilla 22:1-2.

Kishin kaluar shumë vjet dhe Isaku u rrit e u bë djalë i madh. I ati dhe e ëma e donin shumë. Abrahami besonte se të gjitha premtimet e Perëndisë rreth Çlirimtarit që do të vinte do të përbusheshin përmes Isakut dhe pasardhësve të tij.

- Një ditë Perëndia i tha Abrahamit të bënte gjënë më të vështirë, si dhe atë që nuk e priste kurrë.
- Perëndia nuk ishte mizor; Ai është gjithmonë i shenjtë dhe i mirë. Perëndia do të bënte diçka shumë të veçantë në jetët e Abrahamit dhe Isakut.
- Perëndia po e vinte në provë Abrahamin për të parë nëse ai e donte Isakun, më tepër sesa Perëndinë.<sup>47</sup>
- Çfarë autoriteti kishte Perëndia për t'i thënë Abrahamit të merrte Isakun dhe ta ofronte si sakrificë?
  - Perëndia i jep jetë çdo personi dhe çdo gjëje të gjallë. Perëndia krijoi gjithçka.
  - Prandaj Perëndia ka autoritet mbi tërë njerëzit dhe mbi çdo gjë.

<sup>47</sup> Hebrenjve 11:19 na thotë që Abrahami priste që Perëndia ta ngjallte Isakun prej së vdekurish. Ai e dinte se Perëndia kishte premtuar t'i jepte pasardhës dhe të dërgonte një çlirimtar përmes Isakut. Kështu veprimet e Abrahamit tregojnë besimin e tij te Perëndia për t'u kujdesur për situatën e tashme të vështirë dhe atë që kishte premtuar për të bërë në të ardhmen.



<sup>48</sup> Mendo pak për atë që po ndodhte! A kishte ndryshuar Perëndia mendje rreth Isakut dhe premtimeve të Tij? Si do të mund të përbusheshin premtimet e Perëndisë përmes Isakut nëse Abrahami do ta vriste? A kishte vendosur Perëndia që Çlirimtari nuk do të ishte një prej pasardhësve të Isakut?

=> Trego grafikun 16: Disa nga premtimet e Perëndisë ndaj Abrahamit.

<sup>49</sup> Krahoso: Abrahami ishte ndryshe nga Adami dhe Eva. Kur ata ishin në kopsht, Perëndia i tha Adamit të mos hante frutën e pemës së njohjes të së mirës e të së keqes, sepse, nëse do ta bënte, ata do të vdisnin me siguri. Por kur Satani i tha Evës që nuk do të vdisnin, Adami dhe Eva i besuan Satanit. Ata e dyshuan Fjalën e Perëndisë dhe nuk iu bindën Atij. Adami dhe Eva nuk i besuan Perëndisë, por Abrahami po. Ai besoi se Perëndia do të zbatonte Fjalën e Tij.

<sup>50</sup> Mendo: Vetëm Perëndia mund të shpëtonte Noeun dhe familjen e tij nga përmbytja, përmbytje e cila shkatërroi tërë njerëzit e tjerë në botë. Vetëm Perëndia mund të shpëtonte Lotin dhe vajzat e tij nga zjarri që shkatërroi Sodomën dhe Gomorrën. Vetëm Perëndia mund të shpëtonte Isakun nga vdekja!

## Përsëritje

Aktivitet me një mesazh të fshehtë: Unë, unë jam Zoti.

## Pyetje dhe përgjigje

1. Si mund t'i jepte Perëndia Abrahamit dhe Sarës një djalë, kur ata ishin shumë të moshuar? **Ngaqë Perëndia i jep jetë të gjithëve, Ai është i plotfuqishëm; Ai mund të bëjë gjithçka që dëshiron.**
2. Çfarë autoriteti kishte Perëndia për t'i kërkuar Abrahamit të ofronte Isakun si sakrificë? **Perëndia krijoi çdo gjë. Perëndia është zotëruesi i çdo gjëje.**
3. Cila është gjëja më e rëndësishme që mund të bëjmë? **Të besojmë te Perëndia.**
4. Kush i foli Abrahamit dhe kush e shpëtoi Isakun nga vdekja? **Perëndia.**
5. Pse po mbahej prej brirësh, dashi në shkurre? **Meqë Perëndia është i përsosur, Ai do të pranonte vetëm një ofertë që ishte e fortë dhe e shëndetshme.**

### 3. Abrahami besoi te Perëndia

- Si u përgjigj Abrahami?  
- Edhe pse Abrahamit iu tha të ofronte Isakun si flijim, ai nuk dyshoi te Perëndia. Ai pranoi atë që i kishte thënë Perëndia.<sup>48</sup>
- Si mund të përgjigjej në këtë mënyrë Abrahami?  
- Ai e njohte dhe besonte te Perëndia. Ai e dinte që Perëndia nuk do të gënente.  
- Abrahami e dinte që Perëndia nuk do t'i jepte premtime dhe pastaj të ndryshonte mendjen.
- A nuk ishte kjo diçka e pamundur për t'u bërë nga njeriu?  
- Abrahami ishte thjesht një person, një njeri si unë dhe ti. Kjo provë besimi ishte shumë e vështirë, mund të themi, e pamundur. Por Abrahami kishte kuptuar që Perëndia nuk dështon kurrë!
- Abrahami i besoi Perëndisë, ai menjëherë bëri përgatitjet për të shkuar në vendin ku i kishte thënë Perëndia<sup>49</sup> (Zanafilla 22:3-5).

### 4. Isaku pyet dhe Abrahami përgjigjet - Zanafilla 22:6-8.

- Shiko situatën e Isakut. Ai, pa diskutim, kishte parë shumë flijime.  
- Isaku e dinte që ndëshkimi për mëkatin është vdekja dhe se rruga e vetme për t'iu afruar Perëndisë ishte përmes besimit, duke ofruar gjakun e një qengji apo deleje si flijim në vend të njeriut.  
- Ai nuk e kuptonte se përse nuk kishin marrë një dele me vete. Abrahami nuk ia kishte thënë Isakut, atë që i kishte thënë atij Perëndia.
- Abrahami kishte besim te Perëndia. Besimi te Perëndia është gjëja më e rëndësishme që mund të bëjmë.

### 5. Abrahami e lidhi Isakun - Zanafilla 22:9-10.

- Isaku nuk kishte rrugëdalje. Ai u lidh dhe u vendos në altar.  
- Abrahami ngriti thikën për të vlarë Isakun.
- Perëndia e urdhëroi Abrahamin të ofronte Isakun si flijim, dhe Isaku nuk kishte mundësi të largohej kur ishte vënë në altar<sup>50</sup>.

### 6. Perëndia siguroi një dash në vend të Isakut - Zanafilla 22:10-12.

- Perëndia e shpëtoi Isakun; Ai i tha Abrahamit të mos e vriste birin e tij!
- Isaku nuk mund të shpëtohej, nëse nuk do të kishte ndonjë flijim tjetër të përshtatshëm për t'iu ofruar Perëndisë.  
- Abrahami dhe Isaku nuk kishin një flijim të përshtatshëm me vete.  
- Por Perëndia siguroi një ofertë tjetër në vend të Isakut.
- Perëndia siguroi në mënyrë të hirshme një dash në vend të Isakut - Zanafilla 22:13.  
=> Figurë e sugjeruar: Figura 16. Abrahami ofron Isakun
- Perëndia bëri që një dash të kapej prej brirësh në shkurre.  
- Nëse do të ishte kapur nga ndonjë pjesë tjetër e trupit, do të ishte dëmtuar duke u përpjekur të çlirohej.  
- Nëse do të ishte dëmtuar, nuk do të ishte një ofertë e pranueshme para Perëndisë. Perëndia do të pranonte si flijim vetëm një kafshë të shëndetshme dhe të fortë.  
- Ngaqë Perëndia është i përsosur, Ai do të pranojë vetëm atë që është e përsosur.
- Perëndia siguroi një flijim të pranueshëm në vend të Isakut. Perëndia është besnik. Ai e mbajti premtimin e Tij ndaj Abrahamit.  
- Përmes Isakut Perëndia do t'i jepte Abrahamit shumë pasardhës.
- Abrahami hoqi Isakun nga altari dhe vendosi në altar dashin që kishte siguruar Perëndia, në mënyrë që të flijohej në vend të Isakut. Dashi vdiq në vend të Isakut.

### 7. Abrahami i besoi Perëndisë për të dërguar Çlirimtarin - Zanafilla 22:14-19.

- Abrahami e quajti vendin ku Perëndia siguroi dashin: "Zoti do të furnizojë".
- Abrahami besoi se Perëndia do të siguronte gjithashtu Çlirimtarin për të shpëtuar njerëzimin nga pushteti i Satanit dhe nga ndëshkimi i mëkatit. Perëndia i mban premtimet e Tij.

# Mësimi 23

## Bijtë e Isakut

### Qëllimi

Do t'u tregosh fëmijëve rreth dy nipërve të Abrahamit: Esaut, një njeri që nuk i vlerësoi premtimet e Perëndisë dhe Jakobit, një njeri që i vlerësoi premtimet e Perëndisë. Ky mësim nuk do të trajtojë të gjitha hollësitë e jetës së Jakobit dhe Esaut; por do të nënvizojë ato gjëra që u flasin fëmijëve për Çlirimtarin që do të vinte. Gjithashtu do t'u tregosh fëmijëve të klubit për:


- Besnikërinë e Perëndisë për të realizuar premtimin e Tij për të sjellë një çlirimtar.
- Marrëzinë e zgjedhjes së një stili jete sipas botës.

### Hyrje

Bibla dhe shkrimet e tjera nga kjo kohë e historisë përmendin të drejtat e trashëgimisë. Këto të drejta janë shumë të rëndësishme, sepse zakonisht i japin djalit më të madh drejtimin e familjes, privilegje të veçanta dhe një pjesë më të madhe (të dyfishtë) të pasurisë së babait. Esau ishte djali më i madh me vetëm disa sekonda, por mezi priste trashëgiminë e të atit, Isakut. Ne do të mësojmë në historinë tonë sot se si Esau, për shkak të sjelljes së tij të marrë, nuk mori atë që kishte shpresuar.

### Figurat

- Figura 19: Jakobi bleu nga Esau të drejtën e parëbërnisë (Zanafilla 25:29-34)



### Historia

Xhoni dhe Karola po rrinin jashtë shtëpisë së tyre duke parë qiellin kur xhaxhi Piteri iu afrua dhe i pyeti: “Çfarë po shikoni?”.

“Po shikonim tërë yjet” - u përgjigj Xhoni. “Ke të drejtë, xhaxhi Piter. Është e pamundur të numërosh tërë yjet”.

“Ajo që nuk mund të kuptoj,” - tha Karola, - “është se si Isaku dhe familja e tij mund të kishin kaq shumë fëmijë. A kishte Isaku shumë fëmijë?”.

“Jo” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Isaku dhe gruaja e tij Rebeka kishin vetëm dy fëmijë. Ata ishin binjakë. Biri i parë që lindi ishte Esau dhe duke kapur prej thembre të vëllanë lindi djali i dytë, Jakobi”.

“Oh, jo!” - thirri Karola. “A nuk ishin Isaku dhe Rebeka të mërztur që kishin binjakë?”.

“Jo” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Ata ishin shumë të lumtur dhe mirënjohës që Perëndia u kishte dhënë atyre dy bijtë. Kujto, Perëndia u jep jetë tërë foshnjave. Ai nuk bën gabime. Perëndia tha që nga secili prej bijve do të dilte një komb i madh njerëzish”.

“Çlirimtari do të vinte përmes pasardhjes së Isakut, apo jo, xhaxhi Piter?” - pyeti Xhoni.

“Ke të drejtë, Xhon” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Perëndia kishte kursyer jetën e Isakut duke siguruar një dash për të vdekur në vend të tij, në mënyrë që ai të kishte shumë pasardhës, duke përfshirë edhe Çlirimtarin”.

“Pikërisht ashtu siç i kishte premtuar Abrahamit, babait të Isakut” - kujtoi Karola. “Por nga cili djalë do të rridhte Çlirimtari, xhaxhi Piter?” - pyeti Xhoni. “Nga Esau apo Jakobi?”.

“Shiko, në atë kohë,” - tha xhaxhi Piteri, - “premtimet rreth Çlirimtarit do të kalonin tek i parëlinduri. Këto zakone ishin shumë të rëndësishme për djalë e madh, sepse ai bëhej drejtuesi i familjes kur vdiste i ati. Ai merrte gjithashtu pjesën më të madhe të parave dhe zotërimeve të familjes”.

“Meqë Esau ishte më i madhi, përmes tij duhej të rridhte Çlirimtari” - pohoi Karola.

“Këtë priste edhe Isaku,” - tha xhaxhi Piteri, - “por Perëndia e dinte që Esau nuk ishte i interesuar për premtimet e Tij. Esau nuk besonte te Perëndia ashtu si Abrahami dhe Isaku. Esau ishte si Kaini. Ai nuk e konsideronte veten mëkatar dhe që kishte nevojë për t'u pranuar nga Perëndia. Esau i bëri gjërat sipas mënyrës së vet dhe jetoi vetëm për lumturinë e tij”.

“Atëherë, si ishte Jakobi, xhaxhi Piter?” - pyeti Karola.

“Jakobi bënte një jetë të qetë dhe mbante dele dhe gjedhë” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Jakobi nuk ishte si Esau. Jakobi i besoi Perëndisë si gjyshi i tij, Abrahami, dhe si babai i tij, Isaku”.

“Nëse ishin aq të ndryshëm, ata mbase nuk luanin shumë bashkë ndërsa rriteshin, apo jo, xhaxhi Piter?” - pyeti Xhoni.

“Jo,” - tha xhaxhi Piteri, - “nuk luanin. Ata kishin shumë probleme duke jetuar bashkë ndërsa rriteshin”.

“Dua ta di,” - tha Karola, - “nga cili do të rridhte Çlirimtari?”.

“Në rregull, Karola,” - tha xhaxhi Piteri, - “do t'ju tregoj se nga kush do të rridhte Çlirimtari, por së pari duhet të dëgjoni këtë histori për atë që i ndodhi njërit prej vëllezërve”.

## Le të shohim në Bibël



**Fjalët e Urta 5:21** - “Sepse rrugët e njeriut janë gjithnjë përpara syve të Zotit, dhe ai vëzhgon të gjitha shtigjet e tij”.

Shpjegoi fëmijëve të klubit që Perëndia shikon kudo ku shkon njeriu dhe gjithçka që bën, në çdo kohë. Ai jo vetëm e shikon atë që bën njeriu, por Ai e di arsyen se pse i bën gjërat. Ata nuk mund të mendojnë apo të bëjnë diçka që Ai nuk mund ta shohë apo ta dijë. Perëndia konsideron (peshon) dhe gjykon gjithçka që shikon.

## Le të mendojmë

1. A bën Perëndia ndonjëherë gabime? **Po / Jo.**
2. Kush ua jep jetën tërë foshnjave?  
a. Mamaja; b. Babai; c. **Perëndia.**
3. A besoi Esau te Perëndia? **Po / Jo.**
4. A besoi Jakobi te Perëndia? **Po / Jo.**
5. A shikon Perëndia dhe a di gjithçka? **Po / Jo.**

## Mësime nga Fjala e Perëndisë

Sot do të shikojmë disa nga gjërat që ndodhën në jetën e pasardhësve të Abrahamit, siç shkruhet në librin e Zanafillës. Perëndia i regjistroi në mënyrë të hollësishme këto ndodhi që ngjanë afërsisht 4000 vjet më parë! Historia jonë fillon në Kanaan.

### 1. Isaku dhe Rebeka - Zanafilla 25:19-20.

- Rebeka, gruaja e Isakut, lindi në vendin ku kishte jetuar Abrahami para se Zoti ta çonte në Kanaan.
- Kujtoni, Perëndia kishte kursyer jetën e Isakut duke siguruar një dash për të vdekur në vend të Isakut!
- Perëndia i kishte premtuar Abrahamit që përmes Isakut do të rridhnin shumë pasardhës, duke përfshirë edhe Çlirimtarin.

### 2. Lindja e Esaut dhe Jakobit - Zanafilla 25:21-26.

- Perëndia bëri të mundur që Isaku dhe Rebeka të kishin fëmijë, ashtu siç kishte bërë për Abrahamin dhe Sarën.
- Tani biri i Abrahamit, Isaku, kishte binjakë.
- Edhe para se të lindnin, Zoti e dinte se çfarë lloj njerëzish do të ishin Jakobi dhe Esau.
  - Perëndia tha që nga secili prej tyre do të rridhte një komb i madh njerëzish.
  - Perëndia njeh gjithçka rreth nesh, edhe kur jemi në barkun e nënës.
  - Nuk ka asgjë të vështirë për Perëndinë.

### 3. Esau nuk i besoi apo nuk i vlerësoi premtimet e Perëndisë.

- Esau ishte një gjuetar i zoti; ai e kalonte kohën duke gjurmuar dhe vrarë kafshët e egra në fusha - Zanafilla 25:27a.
- Premtimet rreth Çlirimtarit do t'i kalonin, sipas zakonit, Esaut, sepse ai ishte i parëlinduri i Isakut.
  - Çlirimtari nga Perëndia do të ishte një prej pasardhësve të Esaut.
  - Por Esau nuk ishte i interesuar për premtimet e Perëndisë.

<sup>51</sup> Bëja të qartë fëmijëve të klubit që Jakobi nuk e ndryshoi zgjedhjen e Perëndisë për bekimet. Jakobi ishte gjithmonë zgjedhja e Tij. Megjithatë, Jakobi mëkatoi kur e mashtrroi të atin, Isakun, duke bërë që ai t'i jepte bekimet. Rrugët e Perëndisë janë rrugët e vetme të drejta për të realizuar planet e Tij. Rruga e Jakobit bëri që vëllai i tij, Esau, ta urrente dhe atij iu desh të largohej nga shtëpia dhe familja e tij. Përsëri, ne shikojmë se si mëkati i njeriut sjell shpesh brengë jo vetëm për vetë ata, por edhe për të tjerët rreth tyre.

## Përsëritje

Shiko vargun përmendësh:  
Sepse rrugët e njeriut janë gjithnjë përpara syve të Zotit, dhe ai vëzhgon të gjitha shtigjet e tij (Fjalët e Urta 5:21).

## Pyetje dhe përgjigje

1. Cili vëlla ishte i interesuar për premtimet e Perëndisë? **Jakobi**.
2. Cili vëlla jetoi sipas mënyrës së tij dhe jetoi vetëm për gjërat e kësaj bote? **Esau**.
3. Kush ishte gjyshi i Esaut dhe Jakobit? **Abrahami**.
4. Kush ishte babai i Esaut dhe Jakobit? **Isaku**.
5. Pse Jakobi u largua nga shtëpia? **Sepse Esau ishte i zemëruar me të dhe donte ta vriste.**

- Esau nuk i besoi Perëndisë ashtu si Abrahami dhe Isaku.
- Esau ishte si Kaini.
- Ai nuk mendoi se ishte mëkatar.
- Ai nuk mendoi se kishte nevojë të pranohej nga Perëndia. Ai donte t'i bënte gjërat sipas mënyrës së tij.

### 4. Jakobi jetonte i qetë në çadrën e tij dhe mbante dele dhe gjedhë - Zanafilla 25:27b.

- Jakobi besoi te Perëndia i Abrahamit dhe i Isakut.

### 5. Esau ia shet Jakobit të drejtën e parëbirtisë (trashëgimisë) - Zanafilla 25:29-34.

- Esau e shet të drejtën e tij si i parëlindur për një tas me ushqim.

### 6. Jakobi merr bekimin si i parëlindur - Zanafilla 27:1-29.

- Jakobi donte të trashëgonte premtimet që ati i tij, Isaku, kishte trashëguar nga Abrahami, kështu që e mashtrroi të atin duke i marrë bekimet prej tij.<sup>51</sup>
- Megjithatë, Perëndia kishte vendosur, edhe para se të lindte Esau dhe Jakobi, që Jakobi do të merrte këtë bekim - Zanafilla 25:23.
- Çlirimtari do të ishte një prej pasardhësve të Jakobit.

### 7. Esau humbi bekimin e tij - Zanafilla 27:30-38.

- Esau qan, sepse bekimi i tij i kalon Jakobit.
- Esau nuk ishte i interesuar për premtimet e Çlirimtarit, por donte pozicionin dhe privilegjet që merrte i parëlinduri.

### 8. Jakobi u kthye në tokën e Abrahamit dhe Rebekës - Zanafilla 28:10.

- Esau ishte aq i zemëruar me Jakobin që i kishte marrë trashëgiminë e të atit, të cilën e mendonte të tijën, sa që planifikoi ta vriste - Zanafilla 27:41.
- Për shkak të planeve të Esaut, Jakobi u largua nga shtëpia e të atit dhe të ëmës. Ai filloi një udhëtim të gjatë për në Mesopotami, tokë nga e cila kishte ardhur gjyshi i tij, Abrahami.

Mendoni:

Esau ndoqi rrugën e vet dhe jetoi vetëm për kënaqësitë e kësaj bote. Këto ishin më të rëndësishme për të sesa gjërat të cilat Perëndia donte t'i jepte dhe t'i mësonte. Po ti? A do të jesh si Kaini dhe Esau dhe do të largohesh nga e vërteta e Perëndisë për të ndjekur rrugën tënde? Apo do të jesh si Abeli, Noeu, Abrahami dhe Isaku që pranuan mëkatin e tyre dhe i besuan Perëndisë për të siguruar Çlirimtarin?

Mësimet për mësuesin:

*Psalmi 146:5 thotë: "Lum ai që ka Perëndinë e Jakobit si ndihmë, shpresa e të cilit është tek Zoti, Perëndia i tij".*

*Perëndia i Jakobit? Kur lexojmë historinë e plotë të Jakobit në Bibël, shikojmë që Jakobi nuk ishte gjithmonë njeri me besim. Megjithatë, Jakob mashtruesi u bë Jakobi njeriu i besimit. Ai renditet te "heronjtë e besimit" te Hebrenjve 11:9, 20-21 dhe ai ishte njeriu të cilin Perëndia e zgjodhi të ishte babai i 12 fiseve që u bënë kombi i Izraelit.*

*Ndërsa japim mësim, le ta lexojmë edhe për vete tërë historinë e Jakobit, e cila mund të na shërbejë për të na kujtuar që rrugët e Perëndisë nuk janë si rrugët e njeriut. Ne mund të mos kishim "zgjedhur" një njeri si Jakobi. Në të njëjtën mënyrë, disa prej fëmijëve të klubit mund të mos jenë veçanërisht të lehtë për t'u dhënë mësim; në fakt, ata mund të jenë shumë të vështirë! Por ne duhet të kujtojmë që Perëndia e di fundin që nga fillimi dhe Ai na i ka sjellë këta fëmijë në mënyrë që t'u japim Fjalën e Tij.*

*Si e dimë? Fëmija që na duket se ka më pak gjasa të besojë, mund të na çudisë me përgjigjen e tij ndaj Fjalës së Perëndisë. Një prej gjërave të mëdha rreth historisë së Jakobit është që Perëndia i foli personalisht Jakobit disa herë dhe i dha atij premtimet e Tij.*

*Qofshim besnikë për të mësuar me anë të fuqisë së Frymës së Perëndisë. Le të duam ata të cilëve nuk u tregohet dashuri dhe le të shpallim Fjalën me besim të plotë tek Ai që mund të ndryshojë edhe mëkatarin më të keq në birin e Tij të dashur! "Jakobi" që ndërpreu takimet tona, mund të kthehet në "atin" e një "fisi" të madh besimtarësh!*



## Qëllimi

Ky mësim do të tregojë historinë e Jakobit dhe ëndrrës së tij, e cila flet për planin e Perëndisë për të dërguar një Çlirimtar për ta pajtuar njeriun me Perëndinë. Ti do t'u tregosh fëmijëve të klubit:


- Që ka vetëm një rrugë për te Perëndia dhe që vetëm Ai e siguron atë rrugë.
- Që nuk mund të bëjnë asgjë për të shpëtuar veten për t'u bërë të pranueshëm para Perëndisë.

## Hyrje

Pyeti fëmijët e klubit nëse kanë harruar ndonjëherë të bëjnë diçka që u është thënë apo që kanë premtuar të bëjnë. Pyeti nëse kur janë kujtuar për atë që kishin harruar të bënin, e kanë mbajtur premtimin apo e kanë bërë atë që u ishte kërkuar të bënin, ashtu siç bëri Karola. Është e lehtë t'i shtyjme gjërat që kemi për të bërë, por që nuk na vjen t'i bëjmë, deri në një çast tjetër dhe pastaj harrojmë prapë. Shpjego se si Perëndia mban çdo premtim. Ai e çon çdo plan deri në fund. Bibla është një libër i mahnitshëm, sepse Perëndia është plotësisht besnik.

## Figurat

- Grafiku 18: Perëndia, njeriu dhe veprat e mira
- Grafiku 19: Shkalla nga Perëndia te njeriu
- Grafiku 16: Disa nga premtimet e Perëndisë ndaj Abrahamit
- Figura 18: Ëndrra e Jakobit



## Historia

“Karola, je gati të ikim?” - thirri Xhoni. “Po të mos nxitojmë, nuk do t’ia dalim të shkojmë në qytet me xhaxhi Piterin. Ai do të niset pas ca minutash”.

“Erdha!” - thirri Karola, ndërsa po zbriste nga shkallët. “Nuk e mbaja mend ku i kisha vënë paratë”.

“I gjete?” - pyeti Xhoni.

“Po” - u përgjigj Karola. “Ishin në xhepin e fustanit tim të palarë, që ishte poshtë krevatit”.

“Ti gjithmonë i harron gjërat, Karola” - tha Xhoni. “Ti harxhon shumë kohë duke kërkuar gjërat, sepse nuk i vendos në vendin e duhur”.

“Nuk është e vërtetë, Xhon” - u ankua Karola. “Nuk harroj gjithmonë... Oh, jo! Shiko kopshtin e luleve! Duhet që të hiqja barërat e këqija nga kopshti para se të shkoja në qytet”.

“E shikon ku e kam fjalën, Karola” - tha Xhoni. “Ti harron gjithmonë!”.

“Nuk mund të shkoj në qytet tani” - thirri Karola. “Duhet të rri në shtëpi dhe të heq barërat”.

“Jo, Karola” - tha Xhoni. “Mund të shkojmë në qytet tani dhe pastaj kur të kthehemi në shtëpi mund t’i heqësh barërat”.

“Jo, Xhon, nuk mund ta bëj këtë” - tha Karola. “I premtova mamit që do t’i hiqja barërat para se të shkoja në qytet. Nuk mund ta shkel premtimin. Ja ku po vjen xhaxhi Piteri. Duhet t’i them që nuk mund të vij”.

“Hej, ç’bëni ju!” - përshëndeti xhaxhi Piteri. “Jeni gati për të shkuar në qytet?”.

“Nuk mund të vij” - tha Karola e trishtuar. “Duhet të qëndroj këtu dhe të heq barërat e këqija nga kopshti i luleve”.

“Pse nuk e bërë këtë më herët, Karola?” - pyeti xhaxhi Piteri.

“Sepse harron, si gjithmonë!” - pohoi Xhoni. “I thashë që të vinte me ne dhe t’i heqë barërat kur të kthehemi, por ajo i premtoi mamit që ta bënte këtë para se të shkonim në qytet. Ajo ngul këmbë që do të qëndrojë dhe të heqë barërat siç ka premtuar”.

“Karola, jam krenar për ty!” - tha xhaxhi Piteri. “Nuk është gjithmonë e lehtë të bësh gjënë e duhur. Bëre gabim që harrova dhe e shikoj që të vjen keq për këtë, por po e ndreq, sepse po e mban premtimin që i bëre mamit. Ti po bën atë që do të donte Perëndia që të bënim. Po sikur Perëndia të mos i mbante premtimet e Tij, Xhon? A do të ishte në gjendje t’i besojë Atij se do të bëjë atë që thotë se do të bëjë?”.

“Jo, mendoj se jo” - u përgjigj Xhoni. “Edhe pse ka raste, xhaxhi Piteri, kur pyes veten se si njerëzit mund të besojnë me të vërtetë që Perëndia do të jetë në gjendje t’i mbajë tërë premtimet e Tij. Gjërat nuk duket se shkojnë gjithmonë sipas mënyrës që ka planifikuar Ai”.

“Si mund të thuash këtë?” - pyeti Karola. “Gjithçka që kemi lexuar deri tani në Bibël tregon se si Perëndia i mban premtimet e Tij”.

“Ke të drejtë, Karola” - tha xhaxhi Piteri. “Perëndia nuk i harron kurrë planet e Tij dhe asgjë nuk mund ta ndalojë për t’i bërë gjërat”.

“Satani është shumë i fuqishëm, xhaxhi Piter” - kujtoi Xhoni. “A nuk mendon se ai do të përpiqej të ndalonte Perëndinë, në mënyrë që Ai të mos e dërgonte Çlirimtarin që do ta mundte atë?”.

“Po,” - u përgjigj xhaxhi Piteri, - “Satani është përpjekur: a e kujtoni se si vdiq Abeli, djali i Adamit dhe Evës? Por Perëndia dha Setin në vend të tij. Perëndia di gjithçka që do të ndodhë. Perëndia e di saktësisht se çfarë do të përpiqet të bëjë Satani. Perëndia është më i madh nga të gjithë. Perëndia ka pasur një projekt të madh për t’i shpëtuar njerëzit nga Satani, mëkati dhe vdekja. Ai i transmetoi premtimet e Tij nga një brez në tjetrin, nga ati te biri”.

“A e njihnin këta njerëz planin e Perëndisë?” - pyeti Karola.

“Disa prej tyre njihnin të paktën një pjesë të planit të Tij” - u përgjigj xhaxhi Piteri.


“Perëndia ia dha premtimin e Tij për një Çlirimtar Abrahamit, pastaj më vonë i bëri të njëjtin premtim Isakut, dhe më vonë djalit të tij, Jakobit”.

Plani: Këshilla, udhëzimi, drejtimi

“Oh” - tha Xhoni. “Kështu Abrahami e dinte që Isaku duhet të ishte gjallë; ishte pjesë e premtimit të Perëndisë. Abrahami duhet të kishte pasardhës për të pasur pasardhjen e Çlirimtarit. Tani e kuptoj!”.

“Ke të drejtë” - tha xhaxhi Piteri. “Perëndia mban çdo premtim; Ai realizon çdo plan. Perëndia është tërësisht besnik!”.

## Le të shohim në Bibël



**Psalmi 33:11 - “Plani i Zotit mbetet përjetë dhe qëllimet e zemrës së tij për çdo brez”.**

Shpjegoi fëmijëve se asgjë apo askush nuk mund t'i ndryshojë planet që ka bërë Perëndia. Planet e Tij nuk vjetërohen. Kur Perëndia na thotë se do të ndodhë diçka,

pavarësisht se sa kohë kalon, ne mund t'i besojmë Atij që Ai do ta realizojë.

## Le të mendojmë

1. A i ndryshon Perëndia ndonjëherë planet e Tij? **Po / Jo.**
2. A është Perëndia në gjendje t'i mbajë premtimet e Tij? **Po / Jo.**
3. A donte Satani që të vinte Çlirimtari? **Po / Jo.**
4. A mund ta ndalonte Satani Çlirimtarin nëse do të përpiquej? **Po / Jo.**
5. A është Perëndia më i madh nga të gjithë? **Po / Jo.**

## Mësime nga Fjala e Perëndisë

Për shkak të ndryshimeve të mëdha midis Esaut dhe Jakobit, problemet midis dy vëllezërve u shtuan në pikën që Esau kërcënoi të vriste Jakobin. Prandaj Jakobi u largua nga shtëpia e të atit dhe të ëmës, dhe filloi udhëtimin për në Mesopotami, tokë nga e cila kishte ardhur gjyshi i tij, Abrahami.

### 1. Ëndrra e Jakobit - Zanafilla 28:11-12.

- Nga Kanaani në Mesopotami ishte rrugë e gjatë, kështu që, rrugës, Jakobi duhet të flinte në male.
- Një mbrëmje ndërsa Jakobi flinte gjumë, Perëndia iu shfaq në ëndërr.
  - Me raste, gjatë atyre kohërave Perëndia u fliste njerëzve përmes ëndrrave.
  - Por tani që Fjala e Tij është e plotësuar, Ai na flet përmes Biblës.
- Shkalla që pa Jakobi në ëndërr është një tablo e mënyrës se si Çlirimtari eliminon hendekun midis njeriut dhe Perëndisë.
  - Perëndia është i vetmi që mund të gjejë një mënyrë për ne që t'i afrohem Atij.
  - Edhe nëse një person bën shumë, shumë vepra të mira për t'u përpjekur që t'i pëlqejë Perëndisë, përpjekjet e tij nuk do të mjaftojnë për të eliminuar hendekun e shkaktuar nga mëkati. (Fol për disa nga “veprat e mira” që disa njerëz mendojnë se do të mundësojnë që ata të shkojnë në qiell. Thuaj fëmijëve të marrin pjesë në këtë diskutim).<sup>52</sup>


Mendo:

Figura që vijon na kujton që, në fillim Adami dhe Eva ishin njësh me Perëndinë. Perëndia ecte me Adamin dhe Evën. Ata ishin miq me Perëndinë. Por kur nuk iu bindën Perëndisë, ata dhe tërë pasardhësit e tyre, përfshi ty dhe mua, u ndamë nga Perëndia. Shkalla, apo rruga për te Perëndia, ishte hequr. Nuk kishte mundësi që njerëzit të ktheheshin te Perëndia dhe të kishin përbashkësi me Të nëse Perëndia nuk siguronte një rrugë.

<sup>52</sup> Mund t'i ndihmosh fëmijët e klubit tënd që ta kuptojnë këtë figurë më mirë nëse merr si shembull diçka nga jeta e tyre, e cila është e ngjashme me këtë ilustrim. Një shembull mund të jetë: Disa shtëpi ndërtohen sipër nivelit të tokës. Nuk mund të hipësh në to pa shkallë. Kur largohesh nga shtëpia për të shkuar diku, ti heq shkallën, në mënyrë që kafshët të mos vjedhin ushqimin tënd. Shkalla është rruga për në shtëpi. Pa shkallën nuk ka mënyrë për t'u futur në shtëpi.




=> Grafiku 18: Perëndia, njeriu dhe veprat e mira



Edhe pse tërë njerëzit janë ndarë nga Perëndia për shkak të gënjeshtreve të Satanit dhe mosbindjes së Adamit ndaj Perëndisë, Perëndia planifikoi të dërgonte Çlirimtarin që do të mundësonte që Perëndia dhe njeriu të bashkoheshin si miq.

=> Grafiku 19: Shkalla nga Perëndia te njeriu



Por Perëndia premtoi që Çlirimtari do të shkatërronte Satanin dhe do të përtërinte miqësinë midis Perëndisë dhe njeriut. Çlirimtari do të ishte si shkalla që pa Jakobi, e cila arrinte nga toka në qiell. Përmes Çlirimtarit, njerëzit do të ishin edhe një herë tjetër në gjendje të bashkoheshin me Perëndinë<sup>53</sup>.

- Jakobi ishte një mëkatar, ashtu si ne.
  - Perëndia i tregoi plot hir Jakobit se ka vetëm një rrugë për te Perëndia.
  - Perëndia po i tregonte gjithashtu Jakobit që bekimet mund të rridhnin vetëm nga vetë Perëndia dhe që Jakobi duhet t'i besonte Perëndisë.
  - Perëndia donte që Jakobi, po ashtu edhe ne, të shohim që nuk ka asgjë që mund të bëjmë vetë për t'u bërë të pranueshëm para Perëndisë.

## 2. Perëndia i transmetoi Jakobit premtimet që i kishte dhënë Abrahamit dhe Isakut - Zanafilla 28:13-15.

- Perëndia po vazhdonte të vinte në jetë planin e Tij për të dërguar Çlirimtarin.
    - Shumë vjet kishin kaluar që kur Perëndia dha premtimin e parë të Çlirimtarit në kopshtin e Edenit.
    - Perëndia kishte thirrur Abrahamin dhe i kishte premtuar që nga familja e tij do të rridhte Çlirimtari.
    - Tani Abrahami ishte plakur dhe kishte vdekur.
    - Por Perëndia nuk e kishte harruar planin e Tij.
  - Perëndia i premtoi Jakobit, nipit të Abrahamit, që Çlirimtari që do të vinte do të ishte një prej pasardhësve të tij.
  - Jakobi e dinte me siguri se premtimet që i ishin dhënë gjyshit të tij, Abrahamit, dhe babait të tij, Isakut, tani i përkisnin atij.
  - Shumë vjet më vonë Jakobi u kthye në Kanaan.
  - Jakobi kishte 12 bij.
    - Shiko se çfarë kishte bërë tashmë Perëndia për të shumëzuar familjen e Abrahamit!
    - Secili prej stërnipërve të Abrahamit do të bëhej një fis i madh njerëzish.
    - Ne u referohemi akoma këtyre njerëzve si “dymbëdhjetë fiset e Izraelit”.
    - Izrael është emri që Perëndia i dha babait të tyre, Jakobit - Zanafilla 32:28.
  - Jakobi, nipi i Abrahamit, ishte tani Izraeli.
    - Edhe sot ne e quajmë kombin e Izraelit sipas emrit të këtij burri.
    - Perëndia po përmbushte tashmë premtimet e Tij të dhëna Abrahamit për të bërë përmes tij një komb të madh!
- => Trego grafikun 16: Disa nga premtimet e Perëndisë ndaj Abrahamit.

## Përsëritje

Shiko grafikun 19 për të plotësuar tri fjalët: njeriu, Çlirimtari dhe Perëndia.

## Pyetje dhe përgjigje

1. Në kohën e Jakobit, si fliste ndonjëherë Perëndia? **Me anë të ëndrrave.**
2. Çfarë pa Jakobi në ëndrrën që iu dha nga Perëndia? **Ai pa një shkallë të mbështetur në tokë, maja e së cilës prekte qiellin. Engjëjt e Perëndisë hipnin e zbrisnin në të dhe Perëndia ishte në majë të shkallës.**
3. Çfarë do të thoshte kjo ëndërr? **Do të thoshte që Çlirimtari, i Cili do të ishte pasardhës i Jakobit, do të ishte si shkalla që lidhte tokën me Qiellin. Përmes Çlirimtarit njerëzit do të bashkoheshin me Perëndinë.**
4. Perëndia i foli Jozefit në ëndërr. Si u flet Perëndia njerëzve sot? **Perëndia u flet njerëzve sot përmes Fjalës së Tij, Biblës.**
5. Çfarë emri të ri i vuri Perëndia Jakobit? **Izrael.**

# Mësimi 25 Jozefi, djali i Jakobit

## Qëllimi

Ky është mësimi i parë nga dy gjithsej, të cilët do të paraqesin veprën sovranë të Perëndisë përmes jetës së Jozefit për të çuar Izraelin në Egjipt. Besnikëria e Perëndisë theksohet përmes besimit të Jozefit tek Ai. Perëndia komunikoi me Jozefin përmes ëndrrave dhe realizoi gjithçka që kishte premtuar. Do t'u tregosh fëmijëve të klubit tënd:


- Që Perëndia njih të ardhmen e njeriut.
- Që Perëndia i përbush premtimet e Tij.
- Që Jozefi ishte njeri me besim.
- Që Perëndia i zbaton planet e Tij, edhe përmes rrethanave të vështira.

## Hyrje

Fëmijët e klubit tonë duhet të shikojnë që Perëndia vepron në jetët e njerëzve dhe kombeve. Ai nuk ka ndryshuar; dhe, edhe pse disa njerëz e quajnë këtë histori të lashtë, ajo mbetet e vërtetë për nevojat tona sot. Perëndia ka akoma kontroll mbi jetët tona. Ai njih të ardhmen tonë.

## Figurat

- Grafiku 1: Mësimi për Perëndinë
- Figura 19: Jozefi shitet skllav



Shënim: Jo të gjitha ndodhitë dhe hollësitë e historisë së Jozefit do të paraqiten në këto dy mësimë: vetëm ato hollësi që përcaktojnë temat kryesore dhe përcjellin skeletin historik të ngjijtes në pushtet të Jozefit, marrëdhënies së tij me vëllezërit dhe shpërnguljen e Izraelit në Egjipt.

## Histori

“Oh, xhaxhi Piter!” - thirri Karola. “Ndihe shumë keq!”.

“Si është puna, Karola?” - pyeti xhaxhi Piteri.

“Babi duhet të largohet për të gjetur punë” - u përgjigj Karola. “Do të më marrë malli për të”.

“Më vjen keq për ty dhe familjen tënde, Karola” - tha xhaxhi Piteri. “Që kur kompania ku punonte babi yt u dogj, ka qenë e vështirë që ai të gjejë një punë këtu afër. Si po ia kalon mami?”.

“Ajo është shumë e mërzitur” - tha Xhoni. “Ajo tha që nuk mund të kuptojë se si Perëndia lejoi që të ndodhte një gjë e tillë. Ajo mendon se Perëndia duhet të jenë në gjendje t'i gjejë babit një punë te fabrika jashtë qytetit. Atij do t'i duhet të udhëtojë vetëm pesë kilometra për në punë”.

“Pronari i fabrikës e njeh babin tonë” - tha Karola. “Ai e di që babi ynë ishte një punëtor i zoti. Ne nuk mund ta kuptojmë se pse nuk e merr në punë”.

“Duhet të flas me mamin tuaj dhe të përpiqem ta inkurajoj” - tha xhaxhi Piteri.

“Sepse, edhe pse Perëndia mund t'i japë babit tuaj një punë, ndoshta mund të jetë gjëja më e mirë që ai të mos gjejë një punë në fabrikë”.

“Pse?” - pyeti Xhoni. “Si mund të jetë gjëja më e mirë për babin tonë që të largohet nga shtëpia për të punuar?”.

“A e kujton atë fjalën që mësuam pak më parë?” - pyeti xhaxhi Piteri. “Fjala që përshkruan faktin që Perëndia është më i madh se të gjithë?”.

“Do të thuash ‘sovrani’?” - pyeti Karola.

“Shumë mirë, Karola” - tha xhaxhi Piteri. “Po, kjo është fjala. Do të thotë që Perëndia është autoriteti më i lartë. Ai është i vetmi që ka fjalën e fundit për gjërat dhe Ai e di saktësisht se si të bëjë që gjithçka të bashkëveprojë sipas planit të Tij, edhe kur gjërat duken të tmerrshme”.

“Por unë nuk kuptoj” - tha Xhoni. “A nuk do Perëndia që babi ynë të jetë në shtëpi me ne?”.

“Sigurisht që po, Xhon” - tha xhaxhi Piteri. “Por ndonjëherë na duhet të presim për pak kohë para se të ndodhin gjëra të mira. Ndonjëherë Perëndia ka gjëra të tjera të cilat Ai dëshiron që ne dhe të tjerët të mësojmë gjatë rrugës”.

“Nuk e kuptoj se si mund të ketë ndonjë gjë të mirë që mund të vijë nga largimi i babit tonë” - tha Xhoni. “E ardhmja nuk duket shumë e mirë për ne!”.

“Xhon, dua që të mendosh për diçka” - tha xhaxhi Piteri. “Si dukej e ardhmja kur mëkatuan Adami dhe Eva?”.

“Jo e mirë” - u përgjigj Xhoni. “Ndëshkimi i mëkatit është vdekja”.

“Por çfarë bëri Perëndia?” - pyeti xhaxhi Piteri.

“Ai premtoi një çlirimtar” - u përgjigj Karola.

“A e dërgoi Ai Çlirimtarin menjëherë?” - pyeti xhaxhi Piteri.

“Jo” - tha Karola.

“Si u duk kur Perëndia dërgoi përmbytjen?” - pyeti xhaxhi Piteri.

“E tmerrshme!” - tha Xhoni. “Por Perëndia e shpëtoi Noeun dhe këdo e gjithçka tjetër në arkë”.

“Po Abrahami?” - pyeti xhaxhi Piteri. “Ai nuk kishte fëmijë derisa u bë 100 vjeç. Dhe pastaj ja ku doli Isaku, a e kujtoni se si e shpëtoi Perëndia? Perëndia është i vetmi që mund të na shpëtojë! A mendon se nuk ka shpresë që babi yt të fillojë një punë afër shtëpisë?”.

“Kështu duket” - tha Karola. “Por mendoj nuk duhet të më lërë shpresa”.

“Unë do të doja që babai të rrinte në shtëpi tani” - tha Xhoni.

“Edhe unë” - tha xhaxhi Piteri. “Dhe mendoj se do të vlerësosh historinë që do të studiojmë. Perëndia bëri një gjë tjetër të mahnitshme. Kjo ishte pjesë e planit të Tij për të gjetur një rrugë që njerëzit të shpëtoheshin nga mëkatet e tyre. Këtë herë Perëndia lejoi që një njeri i pafajshëm të shkonte në burg”.

“A është e vërtetë kjo?” - pyeti Xhoni.

“Po,” - u përgjigj xhaxhi Piteri, - “ashtu ka ndodhur dhe Perëndia e përdori për mirë”.

## Le të shohim në Bibël



Vajtimet 3:26 - “Gjë e mirë është të presësh në heshtje shpëtimin e Zotit”.

Shpjegoi fëmijëve të klubit që ndonjëherë mund të duket se Perëndia të ka harruar ose që Ai nuk kujdeset për atë që të ndodh. Por Perëndia nuk na harron. Ai kujdeset për ne dhe Ai bën atë që premton. Ai nuk është si njerëzit që ndry-

shojnë mendjen, harrojnë premtimet e tyre apo thonë gënjeshtër. Perëndisë mund t'i besojmë. Ne duhet të presim me durim që Perëndia të bëjë atë që ka premtuar.

## Le të mendojmë

1. Kush është autoriteti më i lartë?  
a. Satani; b. Njeriu; c. **Perëndia**.
2. A është Perëndia sovran? **Po** / Jo.
3. A është ndëshkimi për mëkatin vdekja? **Po** / Jo.
4. Kush e shpëtoi Noeun nga përmbytja?  
a. **Perëndia**; b. Engjëjt; c. Arka.
5. A është Perëndia i vetmi që mund të na shpëtojë nga pushteti i Satanit? **Po** / Jo.

## Mësime nga Fjala e Perëndisë

Shumë vjet pasi Jakobi u largua nga shtëpia e të atit dhe të ëmës, ai u kthye në Kanaan ku kishte lindur. Jakobi kishte gjithsej 12 bij.

### 1. Jozefi, djali i preferuar i Jakobit - Zanafilla 37:1-3.

- Kur vëllezërit e Jozefit bënë gjëra të këqija, Jozefi i tregonte të atit, Jakobit.

### 2. Vëllezërit më të mëdhenj të Jozefit e urrenin - Zanafilla 37:4.

- Meqë Jozefi ishte djali i preferuar i të atit, tërë vëllezërit e tij më të mëdhenj e urrenin.

Mendo:

Arsyeja pse njerëzit zemërohen dhe urrejnë njëri-tjetrin është se secili ka lindur i ndarë nga Perëndia dhe zemra e secilit është e keqe. A ke ndonjëherë zemërim, urrejtje dhe gjëra të këqija në zemrën dhe mendjen tënde? Të gjithë kemi lindur të ndarë nga Perëndia dhe nuk kemi se si ta ndryshojmë veten. Ne i bëjmë këto gjëra mëkatore dhe të këqija, sepse kemi lindur mëkatarë ashtu si ati ynë, Adami.

### 3. Ëndrrat e Jozefit - Zanafilla 37:5-11.

- Perëndia e dinte me saktësi se çfarë do t'i ndodhte familjes së Jozefit.
  - Jozefi nuk mund të shikonte të ardhmen.
  - Jozefi nuk e dinte se si do të përmbusheshin ëndrrat e tij.
  - Perëndia e bëri të qartë që Jozefi do të bëhej drejtues dhe kryesues mbi familjen.
- E ardhmja njihet nga Perëndisë.

### 4. Jozefi shitet në Egjipt - Zanafilla 37:12-14, 18-20, 24, 28.

- Jozefi, atij që Perëndia i kishte premtuar se do të bëhej një drejtues, ishte tani skllav në Egjipt, i ndarë nga familja dhe vendlindja e tij - Zanafilla 39:1.

### 5. Zoti ishte me Jozefin - Zanafilla 39:1-6.

- Edhe pse Jozefi ishte skllav, atë e trajtuan mirë në fillim.
- Gruaja e pronarit të Jozefit gënjeu kundër tij - Zanafilla 39:19.

=> Trego grafikun 1: Mësimi për Perëndinë. Trego: “**Perëndia është kudo në çdo kohë; Ai di gjithçka**”.

=> Figura 19: Jozefi shitet skllav

<sup>54</sup> Mendo: Sa herë që bëjmë diçka, ky vendim na përket ne; ne bëjmë zgjedhjet se si do të përdoren ato që na përjasin. Kërkoj fëmijëve të japin shembuj të gjërave që u përjasin atyre.

## Përsëritje

Rretho gjërat që adhuronin egjiptianët: Diellin, lumin Nil, bretkosat, yjet, kafshët dhe hënën.

## Pyetje dhe përgjigje

1. Sa bij kishte Jakobi? **12**
2. Kush ishte djali i preferuar i Jakobit? **Jozefi.**
3. Si u ndien vëllezërit më të mëdhenj të Jozefit për dashurinë që babai i tyre kishte për Jozefin? **Ata ishin xhelozë dhe e urrenin.**
4. Çfarë ëndërroi Jozefi? **Lexo Zanafilla 37:7-9.**
5. Çfarë nënkuptonin ato ëndrra? **Ato nënkuptonin që Jozefit do t'i jepej një pozicion autoriteti mbi tërë familjen e tij.**
6. Kush u kujdes për Jozefin në burg? **Perëndia.**

## 6. Jozefi futet në burg - Zanafilla 39:20.

- Jozefi kishte akoma besim te Perëndia dhe Perëndia u kujdes për të.
  - Edhe pse vëllezërit e Jozefit e urrenin dhe gruaja e pronarit të tij gënjeu kundër tij, ai akoma besonte te Perëndia i vetëm dhe i vërtetë.
  - Ai e dinte se ishte mëkatar dhe mund të falej vetëm me anë të mëshirës së Perëndisë.
  - Ai besonte te premtimet e Perëndisë, ashtu si Abrahami, Isaku dhe Jakobi.
  - Askush nuk mund t'i pëlqejë Perëndisë nëse nuk beson atë që thotë Perëndia.
  - Gjëja më e madhe që mund të bëjmë është të pranojmë Fjalën e Perëndisë si të vërtetë dhe të besojmë gjithçka që ka shkruar Ai në Bibël.
- Perëndia nuk e la Jozefin edhe kur ai ishte në burg - Zanafilla 39:21-23.
  - Perëndia u kujdes për Jozefin, sepse kishte një plan të mrekullueshëm për jetën e tij.
  - Tani që Jozefi ishte në burg, dukej e pamundur që ai të bëhej drejtuesi dhe kryesuesi i familjes së tij, por Perëndia nuk ndryshon asnjëherë.
  - Perëndia bën gjithmonë atë që premtonte.

## 7. Ëndrrat e Faraonit - Zanafilla 41:1-8.

*Mendo:*

*Edhe pse Perëndia u fliste njerëzve në të shkuarën me anë të ëndrrave dhe po planifikonte t'i tregonte Faraonit përmes kësaj ëndrrë atë që do të ndodhte në Egjipt, zakonisht nuk është kjo mënyra se si Perëndia na flet sot. Pse jo? A nuk e di më Ai se çfarë do të ndodhë? Sigurisht që e di! Ai nuk ka ndryshuar. Ai di ende gjithçka për të ardhmen. Meqë Perëndia nuk u flet zakonisht njerëzve sot përmes ëndrrave, si na tregon atëherë se çfarë dëshiron që të dimë ne për të ardhmen? Ai na i mëson gjërat që dëshiron të dimë përmes Fjalës së Tij, Biblës.*

- Faraoni, mbreti i Egjiptit, nuk e njhte apo nuk e adhuronte Perëndinë e vërtetë e të gjallë.
- Egjiptianët adhuronin diellin, hënën dhe yjet; kafshët dhe krijesat zvarranike; dhe lumin Nil.
- Perëndia planifikoi të përmbushte qëllimet e Tij, duke përdorur këtë mbret dhe vend të keq.
- Perëndia është sovran mbi tërë njerëzit dhe kombet, edhe pse mund të mos e njohin apo adhurojnë.

- Ai mund të përdorë **këdo**, në **çfarëdo lloj mënyre që zgjedh**, për të përmbushur qëllimet e Tij.

- Perëndia është më i madh se të gjithë dhe më i fuqishëm se të gjithë.

*Jotja, o Zot, është madhështia, fuqia, lavdia, shkëlqimi, madhëria, sepse gjithshka që është në qiell dhe mbi tokë është jotja. E jotja o Zot është mbretëria, dhe ti ngrihesh sovran mbi gjithshka (1 Kronikave 29:11).*

- Ai është sundimtari më i lartë i çdo gjëje.
- Perëndia është Krijuesi i të gjithë njerëzve<sup>54</sup>.
- Perëndia është dhuruesi i jetës dhe Ai që na mban gjallë.

*Nga ti vijnë pasuria dhe lavdia; ti sundon mbi gjithçka; në dorën tënde janë forca dhe fuqia, dhe ti ke fuqinë për të bërë të madh dhe për t'u dhënë forcë të gjithëve (1 Kronikave 29:12).*

- Perëndia na krijoi dhe, me të drejtë, ne i përkasim Atij.
- Perëndia mund të bëjë gjithçka që dëshiron me ne.
- Ngaqë Perëndia është i drejtë, të gjitha gjërat që Ai bën kundrejt njerëzve janë të drejta.
- Perëndia do të punonte përmes jetës së një Faraoni egjiptian dhe një të burgosuri izraelit për të bërë diçka që do t'u shërbente tërë njerëzve të Tij.
- Në këtë kohë Jozefi ishte në burg.
  - Edhe pse ishte në burg, Jozefi besoi se qëllimet e Perëndisë ishin të drejta për të.
  - Edhe pse nuk e dinte në atë kohë se si do të punonte Perëndia, Jozefi i besoi Perëndisë dhe jetoi me besim, duke besuar që Perëndia do të bënte atë që ishte më e mira.

Javën që vjen do të zbulojmë se çfarë nënkuptonin ëndrrat e mbretit dhe çfarë qëllimi kishte Perëndia që e çoi Jozefin në Egjipt.

# Mësimi 26

## Qëllimi

Ky është mësimi i dytë që paraqet sovranitetin e Perëndisë, duke vepruar përmes jetës së Jozefit për të çuar Izraelin në Egjipt. Ky mësim do të tregojë se si Perëndia e përdor Jozefin për të ruajtur (shpëtuar) pasardhjen e Çlirimtarit. Do t'u tregosh gjithashtu fëmijëve:


- Që Perëndia i përbush premtimet e Tij.
- Që Jozefi ishte një njeri me besim.
- Që Perëndia i realizon planet e Tij, edhe përmes rrethanave të vështira.
- Që Perëndia është në kontroll.

## Hyrje

Shpjegoi fëmijëve që Perëndia jo vetëm di atë që ndodh, por kupton gjithashtu gjithçka që ndodh, sepse Ai ka kontrollin më të lartë mbi gjithçka që ndodh. Diskuto me fëmijët që ne nuk i kuptojmë gjithmonë arsyet se pse ndodhin gjërat. Ndonjëherë e kuptojmë më herët pse ndodhin disa gjëra dhe të tjerat më vonë. Në historinë tonë sot u duk një kohë e gjatë për Xhonin dhe Karolën që të kuptonin se pse babai i tyre duhet të largohej nga shtëpia për të gjetur një punë. Por atyre nuk iu desh të prisnin sa ç'priti Jozefi në burg para se të zbulonte që Perëndia e dërgoi atje. Perëndia ka kontroll mbi të gjitha gjërat. Ai e di se cila është më e mira për ne. Periudha e pritjes do të zgjasë sa kohë të dojë Perëndia, Ai do të përdorë kë të dojë dhe kur të dojë. Ai mund të bëjë këtë, sepse Perëndia është më i madh se të gjithë dhe më i rëndësishëm se të gjithë; Ai është autoriteti më i lartë.

## Figurat

- Grafiku 16: Disa nga premtimet e Perëndisë ndaj Abrahamit
- Figura 20: Vëllezërit e Jozefit përkulen para tij



# Izraeli shkon në Egjipt

## Historia

“E di?” - thirri Karola ndërsa xhaxhi Piteri u ngjit në shtëpinë e saj.

“E dëgjove nga babi?” - pyeti xhaxhi Piteri.

“Po, e dëgjuam” - tha Karola. “Nga e dije ti?”.

“Nuk e dija” - u përgjigj xhaxhi Piteri, duke qeshur. “Thjesht po hamendësoj. M'u duke shumë e lumtur, kështu që mendova që ishte për shkak se ke marrë ndonjë lajm nga babi yt. A ka filluar punë?”.

“Po” - u përgjigj Karola. “Por nuk mbaron këtu. Të kujtohet që the se planet e Perëndisë janë më të mira se tonat dhe...”.

“Dhe që Ai dëshiron që të mësojmë diçka ndërkohë që presim të realizohen planet e Tij” - ndërpreu Xhoni.

“Po” - tha xhaxhi Piteri. “E kujtoj që jua thashë”.

“Atëherë, është e vërtetë” - tha Xhoni i gëzuar. “Ne nuk kishim ëndërruar kurrë që babi ynë të gjente një punë të tillë!”.

“Atëherë,” - tha xhaxhi Piteri, - “më tregoni për këtë punën e re që ka gjetur babi juaj”.

“Në rregull” - tha Karola. “Kur babi shkoi në qytet për të gjetur punë, ai po kërkonte një punë të ngjashme me atë që kishte këtu. Pasi kërkoi vërdallë për një punë për disa ditë dikush e telefonoi për një punë. A mund ta besosh xhaxhi Piter, dikush e telefonoi babin tonë!”.

“Ne nuk e kuptojmë gjithmonë se si vepron Perëndia, apo jo, Karola?” - pyeti xhaxhi Piteri.

“Sigurisht që jo” - u përgjigj Karola.

“Prit se ka akoma edhe një lajm të mirë” - tha Xhoni. “Babi filloi punë sot për këtë kompani. Megjithatë, ai do të punojë në qytet vetëm derisa të trajnohet”.

“A e gjen dot se ku do të punojë pasi të trajnohet, xhaxhi Piter?” - pyeti Karola e gëzuar.

“Nuk e di” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Do të jetë afër me shtëpinë tuaj?”.

“Po, afër!” - tha Xhoni. “Nuk ka nevojë të përdorë makinën për të shkuar në punë”.

“Duket që Perëndia paska pasur planin më të mirë” - tha xhaxhi Piteri. “Po sikur babi yt të mos shkonte në qytet për të gjetur punë? A do të kishte gjetur punë?”.

“Kam menduar për këtë” - u përgjigj Xhoni.

“Xhaxhi Piteri,” - tha Karola, - “ti vazhdon të na thuash se sa i mirë është Perëndia, se si njeh gjithçka që do të na ndodhë në të ardhmen dhe që Ai mund të realizojë planet e Tij pavarësisht se si na duken gjërat e këqija. Tani e kam parë vetë që ke thënë të vërtetën për Perëndinë. Nuk do ta harroj kurrë atë që ka bërë Perëndia për ne”.

“As unë” - tha Xhoni. “Kam mësuar se Perëndia është i plotfuqishëm. Ai mund të bëjë gjithçka, edhe të pamundurën!”.

“Shpresoj të mos e harroni,” - tha xhaxhi Piteri, - “sepse është e lehtë të harrosh atë që bën Perëndia për ne kur gjithçka shkon mirë në jetën tonë. Shumë njerëz mendojnë se ata nuk do të harrojnë mirësinë e Perëndisë dhe pastaj menjëherë e harrojnë. A e kujtoni historinë e Jozefit në burg? Atë e lanë në burg për vite me radhë e megjithatë, ai nuk e harroi Perëndinë dhe mirësinë e Tij. Jozefi e dinte që mirësia e Perëndisë nuk ka të bëjë vetëm me gjërat materiale: gjëra që na i jep Ai. Ai i besoi gjithmonë Perëndisë për të ardhmen e tij, edhe pse nuk i kuptonte planet e Perëndisë për të. Ai nuk u ankua kundër Perëndisë”.

“E kujtoj” - tha Karola. “Por ti the që Perëndia përdori kohën e Jozefit në burg për të mirë. Nuk kam parë ende një gjë të mirë nga kjo”.

“Sepse nuk ju kam treguar ende vazhdimin e historisë” - tha xhaxhi Piteri. “Uluni dhe dëgjoni një histori të mirësisë së Perëndisë ndaj Jozefit, që është e ngjashme me mirësinë që ka treguar ndaj babit tuaj”.



## Le të shohim në Bibël



**Fjalët e Urta 21:1 - “Zemra e mbretit në duart e Zotit është si rrjedhat e ujit; atë e drejton ngado që do ai”.**

Shpjego se si Perëndia i bën lumenjtë të ndjekin rrugën që dëshiron Ai, ashtu si njerëzit hapin kanale për të çuar ujin në kopshtet e tyre. Ata hapin kanale për ta çuar ujin në drejtimin që duan. Ata po kontrollojnë se ku po shkon uji.

Uji do të rrjedhë përgjatë kanaleve të tyre, gjë e cila do t'u sjellë ujë për bimët e tyre. Ndhimoi fëmijët të kuptojnë që ashtu si Perëndia drejton lumenjtë e ujit, po kështu Ai mund të drejtojë rrugën e mbretërve. Perëndia është më i madh se çdo gjë dhe më i rëndësishëm se çdo gjë; Ai është autoriteti më i lartë.

## Le të mendojmë

1. Kush është Ai që ka planet më të mira?

a. Njeriu; b. Satani; c. **Perëndia**.

2. A i kuptojmë gjithmonë planet e Perëndisë? Po / **Jo**.

3. A harrojmë ndonjëherë për mirësinë e Perëndisë? **Po** / Jo.

4. A ka ndonjë mbret më të fuqishëm se Perëndia? Po / **Jo**.

5. A ka ndonjë gjë shumë të vështirë që Perëndia nuk mund ta bëjë? Po / **Jo**.

## Mësime nga Fjala e Perëndisë

Ndërsa përgatitesh për këtë mësim, lexo Zanafillën, kapitulli 40 dhe kapitullin 41:1-13. Para se të fillosh mësimin e sotëm, trego shkurtimisht historinë e Jozefit në burg, siç shkruhet në vargjet e mësipërme. Sigurohu të flasësh për pikat e mëposhtme: Jozefi kishte interpretuar ëndrrat për një kupëmbajtës dhe një bukëpjekës në burg. Ëndrrat ishin realizuar. Jozefi i kërkoi kupëmbajtësit t'i thoshte Faraonit që ai ishte akoma në burg. Kur kupëmbajtësi doli nga burgu, ai harroi t'i fliste Faraonit për Jozefin. Historia jonë sot fillon dy vjet pasi kupëmbajtësi kishte dalë nga burgu. Kupëmbajtësi u kujtua më në fund se si Jozefi kishte interpretuar ëndrrën e tij në burg; ai i tha Faraonit për Jozefin.

### 1. Jozefi interpreton ëndrrat e Faraonit - Zanafilla 41:14-16, 25-36.

- Jozefi, vetë, nuk ishte në gjendje të interpretonte ëndrrat e mbretit, por ai **pati besim te Zoti** për t'i dhënë interpretimin e ëndrrave të Faraonit.
- Perëndia i dha Jozefit interpretimin, në mënyrë që mbreti të mësonte se çfarë do të ndodhte në vendin e tij.

### 2. Jozefit iu dha vendi i dytë pas Faraonit - Zanafilla 41:37-44.

- Perëndia bëri që Faraoni ta vendoste Jozefin si sundimtarin e dytë më të rëndësishëm në Egjipt, i dyti në radhë pas Faraonit!
- Edhe pse Jozefi kishte kaluar përvoja të vështira, Zoti ishte në kontroll.
  - Zoti nuk e kishte harruar Jozefin.
  - Ëndrrat që Perëndia i kishte dhënë atij si i ri, do të realizoheshin.
  - Perëndia bën gjithmonë atë që planifikon.
- Kur erdhi koha që Perëndia të bënte atë që kishte planifikuar, e nxori Jozefin nga burgu dhe i dha një pozicion të lartë, ashtu siç i kishte treguar Jozefit përmes ëndrrave të tij kur ishte më i ri.

### 3. Vëllezërit e Jozefit shkuan në Egjipt për ushqim - Zanafilla 42:1-3, 6-8.

- Përsëri Perëndia do të realizonte gjërat që i kishte treguar të riut Jozef në ëndrrat e tij.
- Vëllezërit e Jozefit u përkulën para tij!


Shënim: Jo të gjitha ndodhitë dhe hollësitë e historisë së Jozefit paraqiten këtu: vetëm ato hollësi që përkufizojnë temat kryesore dhe përcjellin sfondin historik të ngjijtes së Jozefit në pushtet, marrëdhënien e tij me vëllezërit dhe shpërnguljen e Izraelit në Egjipt. Nëse ke kohë mund të lexosh më tepër për Shkrimet, apo të tregosh më tepër hollësi për këtë histori të gëzuar.

Shënim: Ky mësim përfshin shumë pjesë të Shkrimit. Nëse fëmijët janë në gjendje të lexojnë ata duhet të inkurajohen të lexojnë një pjesë të tekstit. Por ata mund të lexojnë më ngadalë dhe fëmijët e tjerë mund të humbasin interesin kur ka shumë për t'u lexuar. Kështu që, përveç fëmijëve, mund të jetë e dobishme për ty që të alternosh leximin e këtyre pjesëve nga ti vetë ose nga disa prej ndihmësve të rritur.

=> Figura 20: Vëllezërit e Jozefit përkulën para tij



## Përsëritje



Egjipti



## Pyetje dhe përgjigje

1. Kush ia dha Jozefit kuptimin e ëndrrave të Faraonit? **Perëndia.**
2. Çfarë kuptimi kishin ëndrrat e Faraonit? **Perëndia po i tregonte mbretit që do të kishte shtatë vjet të korra të mbara, të cilët do të pasoheshin nga shtatë vjet zi buke.**
3. Si i realizoi Perëndia ëndrrat që i kishte shfaqur Jozefit kur ky ishte i ri? **Zoti i dha Jozefit dituri për t'i interpretuar ëndrrat e mbretit, kështu që Jozefit do t'i jepej pozicioni i dytë për nga rëndësia, pas mbretit.**
4. Pse Jakobi e mori tërë familjen e tij për të jetuar në Egjipt?
  - a. Sepse Jakobi kishte dëgjuar që Jozefi ishte në Egjipt;
  - b. Sepse kishte shumë ushqim në Egjipt;
  - c. Sepse mbreti e ftoi Jakobin për të jetuar në Egjipt;
  - d. Sepse Perëndia kishte planifikuar që të ndodhte kjo.
5. Si quheshin pasardhësit e Abrahamit, Isakut dhe Jakobit? **Bijtë e Izraelit, izraelitë apo Izrael.**

### 4. Jozefi tregon identitetin e tij të vërtetë - Zanafilla 43:1-2; 45:3-9.

- Jozefi qau kur u tregoi vëllezërve se kush ishte.
- Jozefi nuk donte të hakmerrej kundër vëllezërve. Jozefi u shpjegoi se Perëndia kishte nën kontroll atë që i ndodhi atij dhe që Ai i kishte përdorur për mirë veprimet e tmerrshme të vëllezërve.
- Perëndia e kishte vendosur Jozefin sundimtar mbi Egjipt, në mënyrë që ai të siguronte ushqim për izraelitët në mes të zisë së bukës.
- Perëndia po siguronte për pasardhësit e Abrahamit dhe po ruante (shpëtonte) pasardhjen për Çlirimtarin.
  - Perëndia di gjithçka që do të ndodhë.
  - Perëndia bën që të gjitha gjërat të veprojnë sipas vullnetit dhe planit të Tij.

### 5. Izraeli zbriti në Egjipt - Zanafilla 45:25-28; 46:5-7.

- Perëndia e di se çfarë do të ndodhë; Perëndia i mban gjithmonë premtimet e Tij.
  - => Trego grafikun 16: Disa nga premtimet e Perëndisë ndaj Abrahamit.
  - Shumë vjet më parë Perëndia i kishte thënë Abrahamit që pasardhësit e tij do të shkonin në një vend tjetër.
  - Edhe pse kishin kaluar disa qindra vjet, Perëndia bëri atë që kishte premtuar.
  - Gjithçka që thotë Perëndia në Fjalën e Tij, do të ndodhë ashtu siç ka thënë Perëndia.
- Gjërat shumë të vështira që i ndodhën Jozefit rezultuan të ishin një pjesë e rëndësishme e planit të Perëndisë.
- Jozefi me vëllezërit dhe babanë e tij, Jakobin, jetonin tani në Egjipt, ashtu siç i kishte thënë Perëndia Abrahamit.
- Të gjithë pasardhësit e Jakobit apo të Izraelit quheshin tani bijtë e Izraelit, izraelitë apo thjesht Izrael.

Edhe sot Perëndia i mban premtimet e Tij. Perëndia do t'i realizojë ende planet e Tij për mirë, edhe në kohëra të vështira.

# Mësimi 27 Pyetje, pyetje, pyetje

## Qëllimi

Ky mësim është përsëritje e asaj që kemi mësuar në gjashtë mësimet e fundit. Mund të bësh pyetje të tjera apo t'i përshtatësh pyetjet sipas moshës së fëmijëve. Të lutem referoju për ndihmë faqeve 33-34, për të zhvilluar mësimet dhe lojërat e përsëritjes.

## Hyrje

Shpjegoi fëmijëve që do të bësh një “test”, ashtu siç e bënë Xhoni dhe Karola me xhaxhi Piterin. Do të testosh fëmijët për atë që kanë mësuar gjatë gjashtë mësimëve të fundit rreth Abrahamit, Isakut, Esaut, Jakobit dhe Jozefit: të tërë pasardhës të Adamit e Evës dhe Noeut.

## Figura

*Shënim: Nëse e bën këtë përsëritje pas pyetjeve të testit, mund të kalosh më tepër kohë duke përsëritur ato pjesë mësimi që fëmijët nuk i kujtojnë mirë.*

- Grafiku 1: Mësimi për Perëndinë
- Përdore këtë për të përsëritur atributet e Perëndisë.
- Grafiku 2: Perëndia është më i madh se të gjithë
- Grafiku 16: Disa nga premtimet e Perëndisë ndaj Abrahamit

## Historia

“Përsëritje, xhaxhi Piter!” - përsëriteti Karola.

“Përsëritje Xhon e Karola!” - tha xhaxhi Piteri.

“Çfarë ke në dorë, xhaxhi Piter?” - pyeti Xhoni.

“Bllokun tim të shënimeve” - tha xhaxhi Piteri. “Kam shkruar tërë historitë e ndryshme nga Bibla për të cilat kemi folur së bashku. Meqë ju të dyve ju pëlqen të bëni gara për historitë, vendosa të sajoj disa pyetje për historitë e fundit për të cilat kemi folur. Këtë gjë do ta quajmë ‘test’. Ky do të shërbejë për të parë kush di më shumë”.

“Më pëlqen kjo ide!” - tha Karola. “Herën e fundit që bëmë diçka të tillë, unë dhe Xhoni iu përgjigjëm të njëjtit numër pyetjesh. Këtë herë mendoj se do t’u përgjigjem unë më shumë pyetjeve sesa ai”.


“Kam një ide tjetër” - tha Xhoni. “Mendoj se do të fitoj dhe do t’u përgjigjem më tepër pyetjeve sesa ty, kështu që le ta bëjmë që kush humbet duhet të bëjë diçka të ëmbël për fituesin”.

“Oh, Xhon,” - tha Karola, duke qeshur, - “gjithmonë përpiqesh që dikush të të bëjë diçka për të ngrënë! Vetëm mbaj mend, nëse humbet, ti do të më bësh mua diçka për të ngrënë”.

“Dhe meqë unë do të bëj pyetjet,” - tha xhaxhi Piteri, duke qeshur, - “do të ndihmoj fituesin të hajë trofeun”.

“Në rregull, xhaxhi Piter,” - tha Xhoni, - “le të fillojmë!”.

## Le të shikojmë në Bibël



Le të shikojmë se sa vargje kanë mësuar përmendësh fëmijët e klubit tënd dhe sa janë në gjendje t'i thonë. Bëj një pyetje për secilin nga gjashtë vargjet që kemi përdorur në gjashtë mësimet e fundit. Shembuj: Kush mund të thotë Isaia 43:11? Zemra e kujt është në duart e Zotit? Përgjigju pyetjes dhe cito vargun përmendësh që i përgjigjet kësaj pyetjeje. Fëmijët mund të fitojnë pikë

shtesë për thënien e tërë vargjeve.

Isaia 43:11; Fjalët e Urta 5:21; Psalmi 33:11; Vajtimet 3:26; Fjalët e Urta 21:1.

## Le të mendojmë

Ndërsa ke mësuar nga Zanafilla 21 deri te 46:7, mësimet kanë mbuluar kohën nga Abrahami, djali i tij Isaku, bijtë e Isakut, më pas te Esau dhe Jakobi, dhe te djali i Jakobit, Jozefi. Këto mësimet kanë paraqitur besnikërinë më të lartë të Perëndisë, hirin dhe fuqinë e tij sovranë. Çdo mësim ka folur për besnikërinë e Perëndisë për të vazhduar planin e Tij për të dërguar një çlirimtar. Sërish, sovraniteti dhe gjithëfuqia e Perëndisë tregohen në kontrollin që Ai ka mbi tërë krijimin.

**Isaku:** Edhe pse Abrahami dhe Sara ishin shumë të moshuar për të pasur fëmijë, Perëndia kishte premtuar t'u jepte atyre një djalë. Shumë vjet kishin kaluar që kur Perëndia i premtoi për herë të parë Abrahamit një djalë, por Perëndia nuk e kishte harruar premtimin e Tij. Ai nuk e kishte ndryshuar planin e Tij. Perëndia mund të vendoste t'i jepte Abrahamit dhe Sarës një djalë, sepse Perëndia është Krijuesi i tërë njerëzve dhe gjërave. Sara lindi një djalë, ashtu siç kishte premtuar Perëndia. Abrahami dhe Sara e quajtën birin e tyre Isak. Ashtu si Abrahami dhe Sara i përkisnin Perëndisë, po kështu edhe biri i tyre Isak i përkiste Perëndisë.

1. Kujt i dha Perëndia shumë premtime? **Abrahamit.**
2. Sa pasardhës tha Perëndia se do të kishte Abrahami? **Abrahami do të kishte aq pasardhës sa kishte yje.**
3. Sipas pasardhjes së kujt, premtoi Perëndia për të dërguar Çlirimtarin? **Asaj të Abrahamit dhe Isakut.**
4. Çfarë i kërkoi Perëndia Abrahamit për t'i bërë Isakut? **Ta ofronte si flijim.**
5. Çfarë autoriteti kishte Perëndia për t'i kërkuar Abrahamit të ofronte Isakun si flijim?
  - a. Perëndia është Krijuesi i çdo gjëje; për këtë arsye Ai është zotëruesi i çdo gjëje.
  - b. Perëndia i dha jetën Isakut.
6. Nëse Abrahami do të vriste Isakun, atëherë Abrahami nuk do të kishte pasardhës me anë të të cilëve të vinte Çlirimtari. A mendoi Abrahami se Perëndia kishte ndryshuar mendjen për Çlirimtarin, që Ai të vinte nga pasardhja e tij? **Jo, Abrahami i besoi Perëndisë. Ai ishte i sigurt që Perëndia i mban gjithmonë premtimet e Tij.**
7. Çfarë mendoi Abrahami se do të bënte Perëndia kur të flijonte Isakun? **Abrahami mendonte se nëse do të vriste Isakun, ashtu siç e kishte urdhëruar Perëndia, Ai do ta ringjallte prej së vdekurish.**
8. Kur Abrahami e lidhi Isakun dhe e vuri në altar, a kishte ndonjë mundësi Isaku që të çlirohej nga vdekja? **Jo, Isaku nuk mund ta çlironte veten nga vdekja.**
9. A ka ndonjë mënyrë që një person mund ta shpëtojë veten nga paga e vdekjes dhe ndëshkimit të përjetshëm që meriton për shkak të mëkateve të tij? **Jo, askush nuk mund të shpëtojë veten nga ndëshkimi i Perëndisë. Askush nuk mund t'i shpëtojë Perëndisë.**
10. Kush i foli Abrahamit dhe e shpëtoi Isakun nga vdekja? **Perëndia.**

11. A kishte ndonjë person tjetër që mund ta shpëtonte Isakun nga vdekja, përveç Perëndisë?  
**Jo.**
12. Kush siguroi një fljirim për të zënë vendin e Isakut? **Perëndia.**
13. Pse mbahej dashi prej brirësh në shkurre? **Për shkak se Perëndia është i përsosur, Ai do të pranonte vetëm një fljirim që ishte i fortë dhe i shëndetshëm.**
14. Pse Abrahami e quajti vendin ku Perëndia i siguroi dashin “Zoti do të furnizojë”? **Sepse Abrahami besonte që, ashtu si Zoti siguroi dashin në vend të Isakut, Zoti do të siguronte një ditë Çlirimtarin, i Cili do të mundte Satanin dhe do të çlironte njerëzimin nga pushteti i Satanit dhe ndëshkimi i përjetshëm.**

**Esau, Jakobi dhe Jozefi:** Esaut nuk i interesonin premtimet që Perëndia i kishte dhënë Abrahamit për Çlirimtarin. Esau nuk pranoi se ishte mëkatar dhe as besoi në mëshirën e Perëndisë. Esau jetoi për atë që mund të kishte dhe për atë që mund të bënte për momentin. Jakobi dhe Jozefi i besuan Perëndisë. Jakobi dhe Jozefi besuan te premtimet rreth Çlirimtarit.

1. Prej pasardhësve të kujt do të vinte Çlirimtari, të Esaut apo të Jakobit? **Të Jakobit.**
2. Pse Jakobi u largua nga shtëpia e të atit dhe e së ëmës? **Sepse Esau ishte i zemëruar me Jakobin dhe donte ta vriste.**
3. Çfarë pa Jakobi në ëndrrën e dhënë nga Perëndia? **Ai pa një shkallë të mbështetur mbi tokë, maja e së cilës prekte qiellin. Engjëjt e Perëndisë ngjiteshin dhe zbrisnin në shkallë, dhe Perëndia qëndronte në majë të shkallës.**
4. Çfarë kuptimi kishte ëndrra e Jakobit? **Që Çlirimtari, i Cili do të ishte pasardhës i Jakobit, do të ishte si shkalla që lidhte tokën me qiellin. Përmes Çlirimtarit njerëzit mund të bashkoheshin me Perëndinë.**
5. Perëndia i foli Jakobit në ëndërr. Si u flet Perëndia njerëzve sot? **Sot Perëndia u flet njerëzve kryesisht përmes Fjalës së Tij, Biblës.**
6. Kush ishte djali i preferuar i Jakobit? **Jozefi.**
7. Si reagues vëllezërit më të rritur të Jozefit ndaj dashurisë së babait për Jozefin? **Ata ishin xhelozë dhe e urrenin Jozefin.**
8. Çfarë ëndrre pa Jozefi? **Ai pa në ëndërr që ai dhe vëllezërit e tij lidhnin duaj, dhe duajt e vëllezërve të tij u përkulën para duajve të tij. Ai pa në ëndërr gjithashtu që dielli, hëna dhe yjet u përkulën para tij.**
9. Çfarë kuptimi kishin ato ëndrra? **Ata nënkuptonin që Jozefi do të bëhej drejtues dhe kryesues mbi tërë familjen e tij.**
10. Kush e njihte të ardhmen e Jozefit dhe ia tregoi atij përmes ëndrrave të tij? **Perëndia.**
11. Ç’pjesë të së ardhmes njeh Perëndia? **Perëndia njeh tërë të ardhmen.**
12. Çfarë i bënte Jozefit vëllezërit e tij? **Ata e shitën Jozefin për t’u bërë skllav në Egjipt.**
13. Çfarë i ndodhi Jozefit në Egjipt? **Gruaja e pronarit të Jozefit gënjeu kundër tij dhe ai u fut në burg.**
14. Kush u kujdes për Jozefin në burg? **Perëndia.**
15. Pse u kujdes Perëndia për Jozefin?
  - a. **Sepse, edhe pse Jozefi ishte mëkatar, i besoi Perëndisë dhe mëshirës së Tij;**
  - b. **Sepse Jozefi u besoi premtimeve të Perëndisë rreth Çlirimtarit;**
  - c. **Sepse Perëndia kishte një plan të mrekullueshëm për jetën e Jozefit.**

Përko referencat me vargun e saktë.

1. Isaia 43:11; 2. Fjalët e Urta 5:21;
3. Psalmi 33:11; 4. Vajtimet 3:26;
5. Fjalët e Urta 21:1

4. Gjë e mirë është të presësh në heshtje shpëtimin e Zotit.
3. Plani i Zotit mbetet përjetë dhe qëllimet e zemrës së tij për çdo brez.
2. Sepse rrugët e njeriut janë gjithnjë përpara syve të Zotit, dhe ai vëzhgon të gjitha shtigjet e tij.
5. Zemra e mbretit në duart e Zotit është si rrjedhat e ujit; atë e drejton ngado që do ai.
1. Unë, unë jam Zoti dhe përveç meje nuk ka Shpëtimtar tjetër.

16. Kush ia dha Jozefit interpretimin e ëndrrave të Faraonit? **Perëndia.**
17. Çfarë kuptimi kishin ëndrrat e Faraonit? **Perëndia po i bënte të ditur mbretit që do të kishte shtatë vjet të korra të mbara, të cilat do të pasoheshin nga shtatë vjet thatësire.**
18. A mundet Perëndia të bëjë atë që dëshiron, edhe në vende ku njerëzit nuk e njohin apo adhurojnë Atë? **Po, Perëndia është në gjendje të bëjë atë që dëshiron, sepse Ai është Shumë i Larti.**
19. Si i realizoi Perëndia ëndrrat që i dha Jozefit kur ai ishte i ri? **Zoti i dha Jozefit dituri për të interpretuar ëndrrat e mbretit, në mënyrë që Jozefi të merrte pozitën e të dytit pas mbretit.**
20. Pse e mori Jakobi tërë familjen e tij për të jetuar në Egjipt?
  - a. **Sepse Jakobi kishte dëgjuar që Jozefi ishte në Egjipt.**
  - b. **Sepse kishte shumë ushqim në Egjipt.**
  - c. **Perëndia kishte planifikuar të ndodhte një gjë e tillë.**
  - d. **Sepse mbreti e kishte ftuar Jakobin të jetonte në Egjipt.**
21. Si quheshin pasardhësit e Abrahamit, Isakut dhe Jakobit? **Bijë të Izraelit, izraelitë apo Izrael.**

## Pyetje për diskutim

1. Pse Perëndia ishte në gjendje t'i jepte Abrahamit dhe Sarës një djalë, edhe pse ai ishte 100 vjeç dhe ajo 90?
  - a. **Sepse Perëndia u jep jetë tërë njerëzve.**
  - b. **Perëndia është i plotfuqishëm. Ai mund të bëjë gjithçka që dëshiron.**
2. Cili ishte ndryshimi i madh midis Esaut dhe Jakobit? **Esau nuk u interesua për premtimet që Perëndia i kishte dhënë Abrahamit rreth Çlirimtarit. Esau nuk pranoi që ishte mëkatar dhe nuk i besoi mëshirës së Perëndisë. Esau jetoi për të tashmen dhe për gjërat që mund të mblidhte dhe të kishte. Jakobi pranoi se ishte mëkatar dhe i besoi Perëndisë. Jakobi besoi dhe u interesua për premtimet rreth Çlirimtarit.**
3. Pse Perëndia nuk i harroi premtimet e Tij rreth Çlirimtarit dhënë Adamit dhe Evës në kopshtin e Edenit dhe Abrahamit? **Perëndia nuk harroi, sepse Ai nuk ndryshon dhe bën gjithmonë atë që thotë.**
4. Mësuam që Jozefi kaloi shumë vështirësi. Çfarë vështirësish kaloi? **U shit nga vëllezërit, u largua nga i ati, u çua në skllavëri e pastaj në burg.**
5. Gjërat që i ndodhën Jozefit rezultuan si pjesë e rëndësishme e planit të Perëndisë. Cili ishte plani i Perëndisë? **Plani i Perëndisë ishte të bënte Jozefin një drejtues të rëndësishëm në Egjipt, në mënyrë që ai të ishte në pozicion për të siguruar ushqim për izraelitët.**
6. Kë përdori Perëndia për të vendosur Jozefin në pozitë drejtimi? **Faraonin, mbretin e Egjiptit.**
7. Cili është autoriteti më i lartë i çdo gjëje? **Perëndia.**

# Mësimi 28

## Qëllimi

Ky mësim dhe ai që vijon do të tregojnë sovranitetin e Perëndisë, kujdesin e dashur për të ruajtur Izraelin në skllavëri dhe zgjedhjen e Moisiut për t'i nxjerrë izraelitët nga skllavëria.

Do t'u tregosh gjithashtu fëmijëve të klubit tënd:

- Që Perëndia është i plotfuqishëm, i gjithëdijshëm dhe i shenjtë.
- Që dëshira e madhe e Satanit për të shkatërruar planet e Perëndisë për t'i çliruar njerëzit nga skllavëria e Satanit.
- Që askush nuk mund të pengojë qëllimet e Perëndisë; Ai është besnik për t'i realizuar në kohën që zgjedh.

Referenca shtesë të Shkrimit: Veprat e Apostujve 7:17-22.

## Hyrje


Historia jonë sot na kujton që Bibla është e vërtetë. Është një histori shumë e përpiktë e njeriut. Është një mesazh i rëndësishëm nga Perëndia që ka si qëllim të dëgjohet prej nesh sot. Historitë që do të dëgjosh janë pjesë e historisë sonë. Dhe kujto që Perëndia është i njëjti sot, siç ka qenë në kohën kur ka ndodhur kjo histori. Perëndia nuk ndryshon asnjëherë. Ai është gjithnjë i shenjtë, i plotfuqishëm dhe i gjithëdijshëm. Ai bën gjithmonë atë që thotë. Ai është autoriteti më i lartë: Ai është më i madh nga të gjithë!

## Figurat

- Grafiku 20
- Figura 22: Shpëtimi i foshnjës Moisi



- Figura 21: Skllavëria e Izraelit në duar të egjiptianëve



# Izraelitët bëhen skllavër

## Historia

“Shiko se çfarë gjeta në gazetë, xhaxhi Piter!” - tha Karola e gëzuar. “Gjeta emrin ‘Izrael’ në faqe të parë të gazetës!”.

“Jam i gëzuar që shikoj që po i mban sytë hapur dhe po mëson!” - tha xhaxhi Piteri. “A i kujton gjërat e para që mësuam për Izraelin kur filluam të flisnim për Biblën?”.

“A ishte për popullin që Perëndia përdori për të shkruar Biblën?” - pyeti Xhoni.

“Ke të drejtë, Xhoni!” - tha xhaxhi Piteri. “Perëndia zgjodhi judenjtë, pra, izraelitët, për të shkruar Fjalën e Tij. Të gjithë, përveç njërit, ishin judenj”.

“Kujtoj atë që më the, xhaxhi Piter” - tha Karola. “Ti the që Izraeli ishte si mikrofoni i Perëndisë për të shpallur Fjalën e Tij ndaj botës”.

“Ke të drejtë, Karola” - tha xhaxhi Piteri. “Dhe Izraeli është ende shumë i rëndësishëm dhe shumë nëpër lajme sot”.

“Si është në Izrael sot?” - pyeti Xhoni.

“Një pjesë e Izraelit ka ndryshuar” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Por një pjesë e tij ka mbetur njësoj si në kohërat e Biblës. Shumë nga vendet që përmenden dhe për të cilat flitet në Bibël janë akoma atje. Shumë njerëz jetojnë në Izrael dhe shumë prej tyre janë judenj: njerëz që mund të gjurmojnë paraardhjen e tyre familjare deri në kohët biblike. Kujtoni, izraelitët apo judenjtë e gjurmojnë historinë e tyre deri tek Abrahami dhe Jakobi, të cilin Perëndia e quajti Izrael”.

“Sa kohë më parë kanë jetuar Abrahami dhe Jakobi?” - pyeti Karola.

“Unë e di përgjigjen!” - tha Xhoni. “Ka kaluar shumë kohë. Abrahami jetoi 4000 vjet më parë. Dhe Jakobi ishte nipi i tij”.

“Çfarë ndodhi me izraelitët pasi shkuan në Egjipt me Jozefin, xhaxhi Piter?” - pyeti Karola. “Ndonjëherë ne shohim edhe emrin Egjipt në gazetë”.

“Po,” - tha xhaxhi Piteri, - “dhe disa nga gjërat që fliten në Bibël mund të jenë edhe atje”.

“Ndonjëherë harroj që këto histori që lexojmë në Bibël janë të vërteta,” - tha Xhoni, - “por kur shoh që historitë ndodhën në vende reale, kujtoj që po flasim për gjëra që kanë ndodhur me të vërtetë në histori. Më pëlqen të mësoj për tërë këto vende dhe për këta njerëz”.

“Është me të vërtetë interesante, Xhon” - tha xhaxhi Piteri. “Por gjëja e mrekullueshme rreth Biblës është se na tregon se si është Perëndia: kush është Ai”.

“Nuk e kisha ditur që Perëndia të kishte plane të tilla të mëdha” - tha Karola.

“Gjithçka që ka premtuar e ka realizuar, edhe pse ndonjëherë është dashur pak kohë”.

“Po, Perëndia bën gjithmonë atë që planifikon” - tha xhaxhi Piteri. “Tani, Karola, le t'i përgjigjem pyetjes tënde rreth izraelitëve në Egjipt. Kur u zhvendosën në Egjipt kishte zi buke dhe Jozefi ishte sundues atje; e tërë kjo ishte pjesë e planit të Perëndisë. Pas shumë viteve Jozefi u plak dhe vdiq dhe një tjetër faraon, që është njësoj si mbreti, sundoi në Egjipt. Ai u tregua i keq me izraelitët”.

“A e lejoi Perëndia?” - pyeti Xhoni.

“Për pak kohë” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Por pastaj izraelitët filluan t'i thërrasin Perëndisë për ndihmë. Perëndia donte që ata të pranonin që nuk mund të bënin gjë për veten. Vetëm Perëndia mund t'i ndihmonte”.

“Po filloj të kuptoj diçka tjetër në Bibël!” - tha Karola. “Jo vetëm që është reale, por është një libër historie; dhe njerëzit janë njësoj si njerëzit sot. Edhe ne kemi nevojë për ndihmën e Perëndisë!”.



## Le të shohim në Bibël



Isaia 45:22 - “Kthehuni nga unë dhe do të shpëtoni, ju mbarë skaje të tokës. Sepse unë jam Perëndia dhe nuk ka asnjë tjetër”.

## Le të mendojmë

1. A i zgjodhi Perëndia izraelitët të shkruanin Fjalën e Tij? **Po** / Jo.
2. A është e tërë Bibla e vërtetë? **Po** / Jo.
3. Kush ishte sundimtar në Egjipt kur izraelitët u shpërngulën atje?
  - a. Abrahami; b. Jakobi; c. **Jozefi**.
4. A ishte Faraoni i ri në Egjipt i mirë ndaj izraelitëve? **Po** / **Jo**.
5. Kush mund të na shpëtojë?
  - a. Ne mund të shpëtojmë veten; b. Familja jonë; c. **Perëndia**.

## Mësime nga Fjala e Perëndisë

Sot do të fillojmë të studiojmë librin e dytë të Biblës: Eksodin. “Eksod” do të thotë “dalje”. Ky libër flet për historinë se si Perëndia nxori popullin e Tij, izraelitët, nga Egjipti.

### 1. Izraeli u rrit në numër dhe pasuri - Eksodi 1:6-7.

- Jozefi vdiq në Egjipt.
  - Jozefi, vëllezërit e tij dhe familjet e tyre duhet të vazhdonin të jetonin në Egjipt pas vdekjes së të atit, edhe pse thatësira kishte kaluar.
  - Izraelitët nuk u kthyen në tokën të cilën Perëndia kishte premtuar t’ua jepte Abrahamit, Isakut dhe Jakobit.
- Rreth 350 vjet kishin kaluar midis kohës që Izraeli zbriti në Egjipt dhe kohës që historia e tyre fillon përsëri të përmendet në librin e Eksodit.
  - Izraeli kishte jetuar në Egjipt tërë atë kohë.
- Bijtë e Izraelit kalonin mirë në Egjipt.
  - Ata kishin familje të mëdha.
  - Ata gjithashtu u bënë shumë të pasur.
  - Ata kishin shumë lopë, dhi dhe dele.
  - Kishte shumë bar për kafshët e tyre.
  - Mbreti sillej shumë mirë me ta.
  - Por gjërat ndryshuan shpejt.

### 2. Plani i keq i mbretit të ri - Eksodi 1:8-11.

- Kush mendoni se po e drejtonte Faraonin (mbretin) në këtë plan të tij të keq?
  - Satani; ai e urren Perëndinë dhe njeriun.
- Pse Satani donte të shkatërronte kombin e Izraelit?
  - Satani e dinte se Perëndia kishte premtuar të dërgonte Çlirimtarin që do të shkatërronte Satanin dhe do të çlironte njeriun nga pushteti i tij.
  - Satani e dinte gjithashtu që Perëndia kishte premtuar që ky Shpëtimtar do të lindte përmes kombit të Izraelit.
- Satani nuk donte që ndokush të çlirohej nga pushteti i tij.

### 3. Lindja e Moisiut dhe plani i nënës së tij - Eksodi 2:1-4.

- Do të shohim tani mënyrën se si Perëndia vepronte përmes jetës së një izraeliti të quajtur Moisi.
  - Prindërit e tij i besuan Perëndisë për t’u kujdesur për foshnjën e tyre mashkull.

=> Trego grafikun 20: Izraeli.



**Lexo:** Zanafilla 12:3; 28:14.

=> Figura 22: Shpëtimi i Moisiut foshnjë



**Lexo:** Romakëve 8:28.



**Lexo:** Veprat e Apostujve 7:22.

## Përsëritje

Isaia 45:22: Kthehuni nga unë dhe do të shpëtoni, ju mbarë skaje të tokës. Sepse unë jam Perëndia dhe nuk ka asnjë tjetër.

## Pyetje dhe përgjigje

1. Pse mbreti i Egjiptit i bëri izraelitët skllavër? **Ngaqë ata ishin bërë më të shumtë në numër sesa egjiptianët, mbreti kishte frikë që izraelitët mund të bashkoheshin me armiq të egjiptianëve, kundër tyre, dhe kështu të merrnin nën kontroll Egjiptin.**
2. Kush po e drejtonte mbretin në planet e tij të këqija? **Satani.**
3. Pse Satani donte të shkatërronte izraelitët? **Satani e dinte se Perëndia u kishte premtuar Abrahamit, Isakut dhe Jakobit që një prej pasardhësve të tyre do të ishte Çlirimtari.**
4. Kë përdori Perëndia për të mbrojtur Moisiun? **Motrën e madhe të Moisiut dhe vajzën e Faraonit.**
5. Pse e lejoi Zoti vajzën e Faraonit të birësonte Moisiun? **Sepse Perëndia planifikoi të përdorte Moisiun për të çliruar izraelitët nga skllavëria.**

## 4. Moisiu u birësua nga vajza e Faraonit - Eksodi 2:5-10.

- Perëndia përdori motrën e madhe të Moisiut, madje edhe vajzën e Faraonit për të mbrojtur Moisiun!
- Pastaj Perëndia e ktheu Moisiun te nëna e tij për ta ushqyer, derisa ai u rrit për t'u çuar te vajza e Faraonit.
- Perëndia planifikoi të përdorte Moisiun për të çliruar izraelitët nga skllavëria.
  - Perëndia e dinte që Moisiu do të ishte më i sigurt në shtëpinë e Faraonit sesa në ndonjë vend tjetër.
  - Perëndia e dinte që Moisiu do të mësonte atje shumë gjëra të cilat do të ishin të rëndësishme që t'i dinte për punën e tij të ardhshme si drejtues i popullit të tij.
  - Perëndia është më i madh se Satani; Perëndia është më i madh se çdokush dhe çdo gjë tjetër.
  - Askush nuk mund të ndalojë Perëndinë për të bërë gjithçka që planifikon.
  - Ne mund t'i besojmë gjithmonë Perëndisë, edhe kur gjërat na duken keq.
  - Perëndia u kujdes për Izraelin, popullin e Tij, edhe kur ishin skllavër; dhe Ai kujdeset gjithmonë për ne.

Shënim: Mund t'i përfshish këto pyetje në mësimin tënd, ose mund t'i përdorësh në fund për të përmbledhur mësimin. Kjo do t'u japë fëmijëve të klubit përvojë në leximin e Shkrimit, si edhe në kërkimin e përgjigjeve po aty.

## Le të shohim përsëri në Bibël.

Thuaj fëmijëve të hapin Biblat e tyre tek Eksodi 2:1-9. Kërkoj t'u përgjigjen pyetjeve të mëposhtme duke e lexuar pjesën nga Biblat e tyre kur u drejtohesh:

1. Kur nëna e Moisiut nuk mund ta mbante më fshehur, ku e vendosi?  
*Eksodi 2:3 - Në një kosh xunkthi*
2. Kush vëzhgonte se çfarë do t'i ndodhte Moisiut?  
*Eksodi 2:4 - Motra e Moisiut*
3. Kush zbriti në lumë për t'u larë dhe pa koshin?  
*Eksodi 2:5 - Vajza e Faraonit*
4. Kush shkoi për të nxjerrë koshin nga kallamishtet përgjatë lumit?  
*Eksodi 2:5 - Shërbëtorja e vajzës së Faraonit*
5. Çfarë tha vajza e Faraonit kur hapi koshin?  
*Eksodi 2:6 - "Ky është një fëmijë hebreu".*
6. Çfarë ofroi të bënte motra e Moisiut?  
*Eksodi 2:7 - "A duhet të shkoj të thërras një tajë nga gratë hebre që ta mëndë këtë fëmijë për ty?"*
7. Kë mori motra e Moisiut për të ushqyer foshnjën Moisi?  
*Eksodi 2:8 - Nënë e Moisiut*
8. Çfarë i tha vajza e Faraonit që të bënte nëna e Moisiut?  
*Eksodi 2:9 - "Merre me vete këtë fëmijë, mende për mua, dhe unë do të të jap pagën tënde".*

Diskutim: Kush po e mbronte me të vërtetë Moisiun? Perëndia.

Pse donte Perëndia të mbronte Moisiun? *Perëndia donte të përdorte Moisiun për të çliruar izraelitët nga skllavëria.*

Kujtoji fëmijët e klubit që askush dhe asgjë nuk mund të ndalë Perëndinë për të bërë atë që planifikon.

# Mësimi 29

## Qëllimi

Ky mësim do të vazhdojë të tregojë sovranitetin e Perëndisë, kujdesin në ruajtjen e Izraelit kur ishte në skllavëri dhe thirrjen e Moisiut për t'i nxjerrë nga skllavëria. Do t'u tregosh gjithashtu fëmijëve:


- Që Perëndia është i plotfuqishëm, i gjithëdijshëm dhe i shenjtë.
- Dëshirën e fortë të Satanit për të prishur planet e Perëndisë për të çliruar njerëzit nga skllavëria e tij.
- Që askush nuk mund të ndalë qëllimet e Perëndisë; Ai është besnik për t'i realizuar në kohën që zgjedh.
- Që vetëm Perëndia mund të çlirojë njeriun nga skllavëria e Satanit. Njeriu nuk është në gjendje të shpëtojë veten apo të tjerët.

## Hyrje

Përmes historisë dhe mësimet të sotëm, ne duam që të fëmijët të zhvillohet një nderim në rritje për Perëndinë. Duam që ata të njohin në mirë karakterin e Perëndisë. Perëndia nuk merr vendime të çastit të fundit, të cilat mund të funksionojnë, por mundet edhe që jo; kjo në bazë të reagimit të njerëzve ndaj planeve të Tij. Planet e Perëndisë janë bërë para fillimit të njeriut. Ai nuk i ndryshon planet e tij dhe askush tjetër nuk mund ta bëjë Atë që t'i ndryshojë. Planet e Perëndisë janë të përsosura.

## Figura

- Figura 23: Shkurra që digjet



*Shënim: Ky mëson trajton disa pjesë të mëdha të Shkrimit. Për të kursyer kohë dhe për të mbajtur gjallë interesin e fëmijëve mësuesi mund të lexojë pjesët e gjata. Inkurajo fëmijët të të ndjekin në Biblat e tyre ndërsa lexon. Jepu atyre mundësi për të lexuar pjesët më të shkurtra.*

# Perëndia thërret Moisiun

## Historia

“Karola!” - thirri xhaxhi Piteri. “Çfarë po bën me vëllain e vogël?”.

“Oh” - tha Karola duke qeshur. “Unë me Xhonin po përpiqemi të shohim nëse ky kosh e mban vëllanë tonë mbi ujë, ashtu siç mbajti Moisiun. Megjithatë, nuk duket se i pëlqen shumë”.

“E kuptoj arsyen” - tha xhaxhi Piteri. “Po i hyn ujë nga të gjitha anët!”.

“E dimë” - tha Xhoni. “Nuk mund ta kuptojmë se pse po futet uji në kosh”.

“Xhon” - tha xhaxhi Piteri. “A kujtoni që lexuam në Bibël që mamaja e Moisiut vuri diçka në kosh për ta izoluar, në mënyrë që uji të mos futej brenda dhe të bënte që koshi të fundosej?”.

“Po” - u përgjigj Xhoni. “Por koshi ynë është i thurur mirë, kështu që menduam se nuk do të fuste ujë pa qenë nevoja e izolimit”.

“Atëherë,” - tha xhaxhi Piteri, - “siç mund ta shikoni, uji po futet brenda. Nëse do ta lini vëllanë atje, ai mund të mbytet”.

“E kuptoj se çfarë do të thuash!” - thirri Karola. “Shiko, Xhon! Uji ka mbuluar çarçafin e tij! Sa mirë që erdhe xhaxhi Piter. Ne nuk po e vëzhgonim si duhet”.

“Po sikur koshi i Moisiut të fuste ujë, xhaxhi Piter?” - pyeti Xhoni. “Nuk do të kishte se kush ta çlironte popullin nga skllavëria”.

“Ka diçka,” - u përgjigj xhaxhi Piteri, - “motra e Moisiut po e vëzhgonte nga bregu i lumit. Por më e rëndësishmja, Perëndia po e vëzhgonte gjithashtu. Ai nuk do të lejonte që Moisiu të mbytej. Ai kishte plane që Moisiu të shpëtohej, të rritej dhe të shpëtonte popullin izraelit nga skllavëria. Perëndia nuk i ndryshon kurrë planet e Tij.”

“Pse e lejoi Perëndia vajzën e Faraonit ta merrte Moisiun me vete në shtëpi?” - pyeti Karola. “Perëndia është i plotfuqishëm. A nuk mund të bënte Ai që mamaja e Moisiut ta mbante?”.

“Ke të drejtë, Karola” - tha xhaxhi Piteri. “Perëndia është i plotfuqishëm dhe Ai mund ta kishte mbrojtur Moisiun ndryshe, por dërgimi i Moisiut në shtëpinë e Faraonit ishte pjesë e planit të Perëndisë”.

“Perëndia lejoi mamanë e Moisiut ta mbante për pak kohë, apo jo, xhaxhi Piter?” - pyeti Xhoni.

“Po” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Prindërit e Moisiut i ishin shumë mirënjohës Perëndisë për këtë! Por kur Moisiu u rrit, Perëndia e dinte se ai do të ishte më i sigurt në shtëpinë e Faraonit sesa në ndonjë vend tjetër. Ai dinte gjithashtu që Moisiu do të mësonte shumë gjëra atje, të cilat do të ishin të rëndësishme për t'i ditur për punën e tij të ardhshme si drejtuesi i popullit të tij”.

“Nëse kishte aq shumë izraelitë,” - tha Karola, - “pse nuk mund të largoheshin nga Egjipti? Pse qëndronin dhe punonin shumë për Faraonin?”.

“Faraoni ishte shumë i fuqishëm” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Ata nuk mund të arratiseshin nga Faraoni i keq. Ata nuk kishin armë për të luftuar kundër ushtrisë së Faraonit”.

“Kur na tregove për Moisiun javën e kaluar,” - kujtoi Xhoni, - “ti the që izraelitët i thirrën Perëndisë për ndihmë. Si mund t'i ndihmonte Moisiu ata kur ishte thjesht një foshnjë?”.

“Kjo është një pyetje me vend” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Perëndia e kishte zgjedhur Moisiun për të nxjerrë popullin e tij nga Egjipti shumë vjet para se njerëzit t'i thërrisnin Perëndisë për ndihmë. A e kujtoni kur folëm se si ndonjëherë Perëndia i planifikon gjërat shumë vjet para se t'i realizojë? Perëndia po e përgatiste Moisiun për të drejtuar popullin e tij, por ndonjëherë përgatitja mund të kërkojë një kohë të gjatë. Dhe ndonjëherë duhet një kohë e gjatë para se populli t'i thërrasë më në fund Perëndisë për ndihmë”.

“A e dinte Moisiu që Perëndia e kishte zgjedhur për të nxjerrë popullin nga skllavëria?” - pyeti Karola.

“Jo para se të rritej” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Çoja vëllanë mamasë, Karola, dhe kur të kthehesh do t'ju tregoj se si Perëndia i tha Moisiut të nxirrte popullin e tij nga Egjipti”.

**I Shenjtë:** I përsosur dhe pa asgjë të keqe apo të ligë

**Shkëmb:** I fortë, i sigurt

## Le të shohim në Bibël



**1 Samuelit 2:2 - “Nuk ka asnjë të shenjtë si Zoti, sepse nuk ka asnjë tjetër veç teje, nuk ka asnjë shkëmb si Perëndia ynë”.**

Shpjegoi fëmijëve të klubit që kur vargu thotë se Perëndia është si shkëmb, do të thotë që Perëndia është i fortë si një shkëmb, nuk lëviz. Perëndia është gjithmonë i njëjti: Ai nuk ndryshon. Ai është besnik.

## Le të mendojmë

1. A u pëlqente izraelitëve të ishin skllavër? Po / Jo.
2. A mund ta shpëtonin veten izraelitët nga skllavëria? Po / Jo.
3. Ku u rrit Moisiu?
  - a. Në shtëpinë e prindërve; b. Anës lumit; c. **Në shtëpinë e vajzës së Faraonit.**
4. Kë zgjodhi Perëndia për të nxjerrë izraelitët nga Egjipti?
  - a. Jozefin; b. **Moisiun;** c. Faraonin.
5. A ka ndonjë të shenjtë si Perëndia? Po / Jo.

## Mësime nga Fjala e Perëndisë

Shoqërisë tonë i pëlqen të flasë për dobësitë e njerëzve dhe për atë që ata nuk janë në gjendje të bëjnë. Ata nuk mendojnë për fuqinë e Perëndisë. Kur Perëndia ka një plan që dikush të bëjë diçka për Të, Ai do ta aftësojë atë person për ta përbushur. Bibla na tregon një tablo të vërtetë të Perëndisë dhe njerëzve: njerëz që janë të dobët në vetvete, por të cilët, me anë të besimit, mund të përdoren fuqishëm nga Krijuesi ynë plot hir, shumë i lartë dhe sovran, Perëndia. Perëndia është me të vërtetë personi kryesor në këtë histori të vërtetë dhe të mrekullueshme. Ai na ka treguar në Fjalën e Tij shumë shembuj të dobësisë njerëzore të shërbëtorit të Tij të zgjedhur, Moisiut. Megjithatë, përmes këtij personi të dobët, Perëndia kreu çlirimin për Izraelin. Në fund Perëndia siguroi shpëtimin për tërë njerëzimin përmes Çlirimtarit të premtuar të Izraelit.

### 1. Moisiu, kur u bë burrë - Eksodi 2:11-22.

- Izraelitët mbaheshin robër nga Faraoni i keq.
  - Ata nuk mund të shpëtonin.
  - Moisiu u përpoq t'i ndihmonte, por dështoi.
  - Asnjë qenie njerëzore nuk mund ta çlironte popullin e tij nga Faraoni i keq.
  - Vetëm Perëndia mund t'i ndihmonte.<sup>55</sup>

### 2. Moisiu pa shkurren që digjej - Eksodi 3:1-3.

- Kjo shkurre ishte një shkurre e zakonshme: gjëja e pazakontë ishte që edhe pse digjej, nuk po konsumohej.
  - Pse nuk po konsumohej shkurrja?
  - Sepse Perëndia ishte në shkurre!
  - Perëndia është Shumë i Larti. Askush nuk mund t'i bëjë ato gjëra që mund t'i bëjë Perëndia.

### 3. Perëndia i dha mesazhin e Tij Moisiut - Eksodi 3:4-12.

- Moisiu nuk e dinte që Perëndia ishte në shkurre derisa Ai i foli nga mesi i zjarrit.
- Perëndia i tha Moisiut të hiqte këpucët si shenjë respekti ndaj Perëndisë, i Cili është i përsosur dhe i shenjtë: Krijuesi i madh.
- Perëndia zgjedh këdo që i pëlqen për të bërë vullnetin e Tij. Kur vjen koha që Perëndia të përbushë planet e Tij, askush nuk mund ta ndalojë.

<sup>55</sup> Mendo: Sa herë që bëjmë diçka, ky vendim na përket ne; ne bëjmë zgjedhjet se si do të përdoren ato që na përkasin. Kërko fëmijëve të japin shembuj të gjërave që u përkasin atyre.

=> Figura 23: Shkurrja që digjet

## Përsëritje

Shiko vargun përmendësh:

1 Samuelit 2:2 Nuk ka asnjë të shenjtë si Zoti, sepse nuk ka asnjë tjetër veç teje, nuk ka asnjë shkëmb si Perëndia ynë.

## Pyetje dhe përgjigje

1. A mund t'i çlironte Moisiu izraelitët nga skllavëria? **Jo.**
2. Kush është i vetmi që mund ta çlirojë një person nga kontrolli i Satanit? **Perëndia.**
3. Kë premtoi Perëndia se do të dërgonte me Moisiun për të takuar Faraonin? **Aaronin, vëllanë e Moisiut.**
4. Pse shkurrja që pa Moisiu nuk konsumohej, edhe pse ishte në flakë? **Shkurrja nuk konsumohej, sepse Perëndia Shumë i Lartë ishte në të.**
5. Çfarë bënë izraelitët kur Moisiu u tha atyre atë që kishte thënë Perëndia? **Ata i besuan Fjalës së Perëndisë përmes Moisiut. Ata ishin mirënjohës që Zoti i kishte dëgjuar thirrjet e tyre për ndihmë.**

- Perëndia i tha Moisiut që Ai e kishte zgjedhur për t'i nxjerrë izraelitët nga skllavëria në Egjipt dhe për t'i kthyer në tokën që i kishte dhënë Abrahamit.
- Moisiu nuk ia kishte dalë mbanë kur u përpoq ta ndihmonte popullin e tij. Ai e dinte që nuk ishte në gjendje që t'i fliste mbretit dhe të çlironte Izraelin nga skllavëria me anë të forcës së tij.
- Perëndia tha që Ai do të ishte me Moisiun dhe Ai i dha Moisiut një shenjë.
  - Perëndia i premtoi Moisiut që Ai do ta sillte sërish në këtë mal, në malin Sinai apo malin Horeb, ku po qëndronte para shkures që digjej.

### 4. “UNË JAM” - Eksodi 3:13-18.

- Moisiu nuk ishte akoma i kënaqur.
    - Populli i tij, izraelitët, e kishin refuzuar kur ishte përpjekur t'i ndihmonte më parë. A do ta besonin tani?
- Shpjego:
- Në kohërat biblike, emrat kishin kuptim. Emri i një personi tregonte diçka për atë person. Për shembull, emri i Moisiut do të thotë “i nxjerrë jashtë”, sepse ai u nxor nga uji kur e gjeti vajza e Faraonit.

Por si mund t'i jepte Perëndia vetes vetëm një apo dy emra? Ishte e pamundur: Perëndia është shumë i madh për t'u përshkruar!

Çfarë emri mund t'i vinte vetes Perëndia për t'u treguar izraelitëve tërë gjërat që duhet të njihen për Të? Kjo ishte diçka që nuk mund të bëhej. Prandaj Perëndia i tha Moisiut t'i thoshte Izraelit që “UNË JAM-i” e kishte dërguar.

Ky emër, “UNË JAM”, përfshin shumë, aq sa ne nuk mund ta kuptojmë plotësisht. Ai do të thotë që Perëndia nuk ka nevojë për diçka: Ai ka gjithçka në vetvete. A i kujtoni fjalët e para në Bibël: “Në fillim Perëndia...”? **Perëndia ishte tashmë atje në fillim.** Ai nuk kishte fillim dhe nuk ka as fund. Ai krijoi gjithçka. Ai është i madhi “UNË JAM-i”; Ai është më i madh se të gjithë.

- Faraoni, egjiptianët dhe madje Satani, nuk mund ta mbanin popullin e Perëndisë kur Zoti, “UNË JAM-i”, vendosi t'i çlironte.

### 5. Perëndia e dinte se çfarë do të bënte mbreti - Eksodi 3:19-20.

- Perëndia e dinte se si do të reagoonte mbreti. Perëndia i njeh mendimet, fjalët dhe veprimet tona para se t'i mendojmë, t'i themi apo t'i bëjmë.

### 6. Perëndia e dha Aaronin, që të bëhej ndihmësi i Moisiut - Eksodi 4:13.

- Moisiu kishte një sugjerim tjetër: Ai i tha Zotit të dërgonte dikë tjetër, i cili mund të ishte një drejtues më i mirë se ai.
- Zoti ishte i zemëruar me Moisiun që po vazhdonte t'ia kthente fjalën, por Ai premtoi të dërgonte Aaronin, vëllanë e madh të Moisiut, për ta ndihmuar (Eksodi 4:14-17).

### 7. Moisiu iu bind Zotit - Eksodi 4:18.

- Zoti i tha Moisiut që mbreti dhe të tjerët që kishin planifikuar t'i bënin keq kishin vdekur tashmë (Eksodi 4:19-20).

### 8. Zoti dërgoi Aaronin për të takuar Moisiun - Eksodi 4:27-28.

- Zoti e mbajti premtimin e Tij ndaj Moisiut dhe dërgoi vëllanë e tij të madh, Aaronin, për ta takuar. Aaroni do të ishte përkrah Moisiut për ta ndihmuar kur të shkonte te Faraoni, për t'i kërkuar që t'i linte izraelitët të largoheshin.
- Moisiu dhe Aaroni u kthyen në Egjipt. Ata thirrën popullin e tyre, izraelitët, dhe u thanë atyre atë që Zoti i kishte thënë Moisiut.

### 9. Izraeli besoi që Zoti kishte dërguar Moisiun - Eksodi 4:29-31.

- Izraelitët i besuan Fjalës së Perëndisë të dhënë përmes Moisiut. Ata ishin mirënjohës që Zoti kishte dëgjuar thirrjen e tyre për çlirim.



# Mësimi 30

## Qëllimi


Ky mësim paraqet sovranitetin, gjithëdijen dhe plotfuqinë e Perëndisë kur Ai shkakton plagët në Egjipt. Fëmijët e klubit do të shikojnë që Perëndia i mban premtimet e Tij dhe kujdeset për ata që besojnë tek Ai.

## Hyrje

Pyeti fëmijët e klubit nëse dinë se çfarë lloj perëndish të rreme adhuronin njerëzit e Egjiptit (gjëra të krijuara, si dielli, hëna, kafshët, Faraonin e tyre, lumin Nil). Pyeti fëmijët se çfarë thotë Bibla: Cili është i vetmi që duhet të adhurojmë (Perëndia, Krijuesi).

## Figurat

- Grafiku 20: Izraeli
- Figura 24: Moisiu, Aaroni dhe magjistarët para Faraonit (Përdore këtë figurë nëse ke kohë për të përfshirë Eksodin 7:8-13 te mësimi yt).



# Perëndia dërgon plagë në Egjipt

## Historia

“Xhaxhi Piter,” - tha Xhoni, - “a dëgjove për paralajmërimet e tajfunit?”.

“Po” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Po vija t’u tregoja prindërve tuaj për to”.

“A mendon se mund të vijë deri këtu?” - pyeti Karola.

“Nuk e di” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Por kur na paralajmërojnë në këtë mënyrë, do të thotë që ka rrezik të madh që tajfuni ta prekë këtë zonë. Është e rëndësishme të rrimë të informuar në rast se tajfuni drejtohet këtej”.

“Dëgjova një prej miqve të mi të thoshte se ai nuk do të dëgjonte asnjë prej paralajmërimeve”. “Ai tha: ‘Kot thonë se nuk ka për të ndodhur gjë’”.

“Të injorosh paralajmërimet është një gjë e rrezikshme” - tha xhaxhi Piteri.

“Njerëzit vdesin për shkak se refuzojnë të dëgjojnë paralajmërimet. Disa vjet më parë njerëzit u paralajmëruan që do të dilte llavë nga mali”.

“Do të thuash vullkan” - pyeti Karola.

“Po,” - u përgjigj xhaxhi Piteri, - “por ai mal nuk kishte nxjerrë llavë prej një kohe të gjatë: mbase njëqind vjet. Njerëzit jetonin në rrëpirën e tij dhe disa prej tyre ishin atje duke bërë ekskursion dhe duke kaluar një kohë të bukur”.

“Atëherë, a iku shumica e njerëzve?” - pyeti Xhoni.

“Vetëm disa prej tyre u larguan” - tha xhaxhi Piteri. “Pjesa tjetër ishte si ai miku për të cilin po flisje ti. Ata menduan se asgjë nuk do të ndodhte, edhe pse u paralajmëruan shumë herë”.

“A shpërtheu vullkani, xhaxhi Piter?” - pyeti Xhoni.

“Po” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Ishte edhe më i tmerrshëm nga sa e kishin imagjinuar. Shumë njerëz u vranë: njerëz që mund të ishin shpëtuar nëse do t’ua kishin vënë veshin paralajmërimeve dhe do të ishin larguar menjëherë”.

“Kjo është e tmerrshme!” - tha Karola. “Ata nuk kishin pse të vdisnin, apo jo?”.

“Jo” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Ata ishin paralajmëruar, shumë herë: ashtu si njerëzit në kohën e Noeut”.

“Pyes veten se pse veprojnë njerëzit ashtu?” - pyeti Xhoni.

“Mos dëgjimi i paralajmërimeve është një lloj rebelimi” - u përgjigj xhaxhi Piteri.

“Ne jemi të gjithë pak e shumë kështu: nuk duam të na thonë se çfarë duhet të bëjmë. Është pjesë e natyrës mëkatore”.

“Ashtu siç u rebelua Satani?” - pyeti Karola.

“Po” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Një shembull tjetër i rebelimit është Faraoni që sundoi në Egjipt gjatë kohës së Moisiut. Ky faraon refuzoi të dëgjonte Perëndinë”.

“Ky është Faraoni të cilit Perëndia donte që Moisiu t’i fliste, në mënyrë që t’i linte izraelitët të largoheshin nga Egjipti” - kujtoi Xhoni. “A e dinte Faraoni se kush ishte Perëndia, xhaxhi Piter?”.

“Faraoni adhuronte perënditë e rreme” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Ai nuk donte ta njihnte Perëndinë e vetëm të vërtetë”.

“Pse nuk donte ta njihnte Perëndinë?” - pyeti Xhoni.

“Disa njerëz janë krenarë për vetveten” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Ata refuzojnë t’i dëgjojnë të tjerët. Ata nuk e kuptojnë se varen tërësisht nga Perëndia për gjithçka. Ata refuzojnë të besojnë që Ai është Krijuesi”.

“Pse i lejon Perëndia njerëzit të dalin paq?” - pyeti Karola. “Nuk i lejon” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Por Ai ndonjëherë lejon që një person të sillët ashtu për pak kohë. Perëndia u jep kohë mëkatarëve që të pendohen dhe t’i besojnë Atij. Por Ai gjykon çdo mëkat. Tërë paralajmërimet e Perëndisë janë të vërteta. Ai bën atë që thotë në Fjalën e Tij”.

“Atëherë, a e dëgjoi ndonjëherë Faraoni Perëndinë?” - pyeti Xhoni.

“Jo, nuk e dëgjoi” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Perëndia gjykoi rebelimin e Faraonit dhe e bëri në mënyrë të tillë që ne e kujtojmë edhe sot. Le të hapim Biblën dhe le të shohim se çfarë bëri Perëndia”.



## Le të shohim në Bibël



**Psalmi 106:8 - “Megjithatë Zoti i shpëtoi për hir të emrit të tij, për të bërë të njohur fuqinë e tij”.**

Izraelitët që jetonin në Egjipt në atë kohë nuk e kishin parë madhësitë dhe fuqinë e Perëndisë. Ata vetëm sa kishin dëgjuar për Zotin dhe atë që kishte bërë Ai për Abrahamin, Isakun, Jakobin dhe Jozefin. Tani Zoti do të përdorte këtë

faraon të keq për të treguar fuqinë dhe diturinë e Perëndisë ndaj këtyre izraelitëve.

## Le të mendojmë

1. A u pëlqen njerëzve t’u thuhet se çfarë duhet të bëjnë? **Po / Jo.**
2. Kush adhuronte perënditë e rreme?  
a. Noeu; b. Moisiu; c. **Faraoni.**
3. A e dëgjoi ndonjëherë Faraoni Perëndinë? **Po / Jo.**
4. A e gjykon Perëndia gjithmonë mëkatën? **Po / Jo.**
5. Kush ka më tepër fuqi se të gjithë?  
a. Satani; b. **Perëndia**; c. Faraoni.

## Mësime nga Fjala e Perëndisë

Mësimi i sotëm është një vazhdim i historisë së Moisiut dhe izraelitëve të skllavëruar në Egjipt. Izraelitët ishin skllavëruar nga një faraon i fuqishëm. Por Perëndia do të siguronte një mënyrë që të çliroheshin!

### 1. Faraoni refuzoi t’i bindej urdhrat të Perëndisë të dhënë përmes Moisiut dhe Aaronit - Eksodi 5:1-2.

- Perëndia përdori Moisiun dhe Aaronin për t’i folur mbretit të Egjiptit, por ai refuzoi t’i bindej urdhrat të Zotit.<sup>56</sup>
- Faraoni nuk e njhte Perëndinë dhe Krijuesin e vetëm të vërtetë e të gjallë të tërë tokës.
- Egjiptianët nuk e adhuronin Perëndinë; ata adhuronin gjërat që kishte bërë Perëndia.
  - Ata adhuronin lumin Nil, lumin më të madh në vendin e tyre.
  - Ata adhuronin edhe diellin, hënën dhe shumë lloje të ndryshme kafshësh.
  - Ata kishin shumë, shumë perëndi.
  - Ata adhuronin gjithashtu Faraonin, mbretin e tyre, si perëndi.
- **Shumica e njerëzve të botës kishin zgjedhur të mos mësonin për Perëndinë e vërtetë.**
- Perëndia e kishte thirrur Abrahamin dhe e kishte bërë atin e kombit të Izraelit.
  - Perëndia e bëri këtë në mënyrë që përmes Izraelit të mund të ruante njohjen e vërtetë të Perëndisë.
  - Përmes Izraelit Perëndia planifikoi t’ia bënte të njohur të vërtetën rreth vetes çdo personi në botë.
  - E vërteta rreth Perëndisë është në Bibël, të cilën Perëndia e dha përmes izraelitëve.
- Perëndia do t’ia mësonte të vërtetën rreth vetes mbretit të Egjiptit, por Faraoni nuk donte të dëgjonte.

### 2. Përmes rebelimit të Faraonit, Zoti kishte si qëllim t’i tregonte Izraelit se Ai ishte Perëndia i tyre - Eksodi 6:1-8.

### 3. Përmes rebelimit të Faraonit Zoti planifikoi t’u tregonte egjiptianëve që vetëm Ai është Perëndia i gjallë e i vërtetë - Eksodi 7:4-5.

- Perëndia kishte planifikuar t’u tregonte egjiptianëve që:
  - Vetëm Ai është Perëndia i vërtetë e i gjallë me fuqinë mbi tërë tokën.

Shënim: Ky mësim trajton disa pjesë të mëdha të Shkrimit. Për të kursyer kohë dhe për të mbajtur gjallë interesin e fëmijëve, mësuesi mund të lexojë pjesët më të gjata. Nxiti fëmijët të të ndjekin te Biblat e tyre ndërsa lexon. Jepu mundësinë të lexojnë pjesët më të shkurtra.

<sup>56</sup> Faraon ishte titulli që u jepej tërë sundimtarëve të Egjiptit gjatë kësaj kohe në histori.

=> Trego grafikun 20: Izraeli.

Thua ju fëmijëve të klubit të thonë Psalmin 106:8.

<sup>57</sup> Mendo: Egjiptianët ishin njerëz shumë të zgjuar e të zotë: disa ishin shkrimtarë, matematicienë, kimistë, drejtues ushtarakë dhe qeveritarë, arkitektë, artistë, zejtarë, etj.. Por ata ishin tërësisht të verbër në pikëpamjen e tyre ndaj Perëndisë. Edhe pse e mbajtën Izraelin në skllavëri, vetë egjiptianët ishin të skllavëruar: ata ishin skllavë të Satanit.

<sup>58</sup> Për shkak të kohës, nuk do t'i lexojmë të gjitha hollësitë e atyre që ndodhën. Por nëse do të gjeshe kohë më vonë, mund ta lexosh historinë tek Eksodi 7:14-10:29. Sigurohu të thuash që kjo është një histori e vërtetë, ashtu siç është shkruar për ne në Bibël.

<sup>59</sup> Secila nga plagët tregonte një prej perëndive të rreme të egjiptianëve: për shembull, perëndia i tyre bretkosë, perëndia i tyre diell dhe perëndia i tyre stuhi. Perëndia po u tregonte egjiptianëve që Ai është Perëndia i vetëm i vërtetë.

## Përsëritje

Faraoni mbajti të njëjtin qëndrim ndaj secilës prej plagëve që Perëndia dërgoi në Egjipt. Rënditi këto fjali sipas radhës në të cilën kanë ndodhur.

3. Faraoni tha që do t'i linte izraelitët të iknin.
2. Faraoni thirri Moisiun dhe i kërkoi që t'i largonte plagët.
1. Perëndia dërgoi një plagë në Egjipt.
5. Faraoni ngurtësoi zemrën dhe u bë më krenar.
4. Perëndia hoqi plagën.
6. Faraoni nuk i la izraelitët të shkonin.

## Pyetje dhe përgjigje

1. Si planifikoi Perëndia ta përdorte Faraonin e keq? **Perëndia planifikoi ta përdorte këtë mbret krenar për t'i treguar gjithkujt që Perëndia i Izraelit është Perëndia i vetëm i vërtetë e i gjallë dhe Ai është Shumë i Larti.**
2. Si e tregoi Zoti fuqinë e Tij? **Zoti dërgoi plagët e mëdha e të tmerrshme mbi egjiptianët.**
3. A e kishin parë më parë izraelitët madhësinë dhe fuqinë e Perëndisë? **Jo, ata vetëm sa kishin dëgjuar për to.**
4. Çfarë i ndodhi Faraonit sa herë që refuzonte t'i linte izraelitët të largoheshin? **Ai e ngurtësonte më tepër zemrën dhe bëhej më krenar.**
5. A meritonin izraelitët të mbroheshin nga Perëndia? **Jo, edhe ata ishin mëkatarë dhe meritonin gjykimin e Perëndisë.**

- Perënditë tek të cilët kishin besim dhe adhuronin nuk ishin në gjendje t'i mbronin nga Perëndia i vërtetë: Perëndia i Izraelit<sup>57</sup>.

- Faraoni ishte i vendosur të luftonte kundër Perëndisë. Prandaj Perëndia planifikoi të përdorte këtë mbret të keq, për të shfaqur fuqinë e Tij të madhe dhe gjykimin e tmerrshëm mbi tërë ata që rebelohen kundër Tij.
- Askush që lufton kundër Perëndisë nuk mund të fitojë apo t'i shpëtojë ndëshkimit.

## 4. Zoti dërgoi nëntë plagë në Egjipt<sup>58</sup>.

- Ngaqë mbreti i Egjiptit refuzoi t'i linte izraelitët, Zoti filloi të tregonte fuqinë e Tij të madhe.
  - Në fillim Zoti ktheu ujin e lumit Nil (dhe të tërë përrënjtë, liqeneve dhe kanaleve) në gjak.
  - Më pas Ai dërgoi plagët e bretkosave, mushkonjave dhe mizave.
  - Pastaj Perëndia bëri që kuajt, gjedhët, delet, devetë dhe gomarët e egjiptianëve të sëmureshin.
  - Më pas Zoti bëri që tërë egjiptianët të kishin ulçera të tmerrshme.
  - Kjo u pasua nga një breshër i tmerrshëm, plaga e karkalecave dhe nga tri ditë e tri net errësirë e thellë në çdo vend ku jetonin egjiptianët.
- Faraoni dhe populli egjiptian nuk mund të shpëtonin veten nga këto plagë të tmerrshme të dërguara nga Zoti. As perënditë e tyre nuk mund t'i shpëtonin.<sup>59</sup>
- Nëse Perëndia nuk do të ishte i mëshirshëm dhe i dashur me izraelitët, edhe ata do të kishin vuajtur nga plagët.
- Por Ai mbrojti izraelitët, në mënyrë që asnjë prej këtyre gjërave të tmerrshme të mos u ndodhte asnjërit prej tyre, edhe pse ata po jetonin afër, në të njëjtin vend.
  - Zoti i mbrojti izraelitët, edhe pse ishin mëkatarë, dhe nuk e meritonin kujdesin e Tij.
  - Zoti i mbrojti për shkak të dashurisë, mëshirës dhe hirit të Tij.
  - Një arsye tjetër se pse i mbrojti Perëndia izraelitët ishte se Perëndia nuk i kishte harruar premtimet e Tij ndaj Abrahamit, Isakut dhe Jakobit.
  - Perëndia e mbrojti gjithashtu Izraelin nga plagët, në mënyrë që mbreti i Egjiptit të kuptonte që Perëndia i Izraelit ishte Perëndia i vetëm i vërtetë e i gjallë në tërë tokën.
- Faraoni mbajti të njëjtin qëndrim ndaj secilës prej këtyre plagëve:
  - Sa herë që Zoti dërgonte një plagë në Egjipt, Faraoni thërriste Moisiun dhe i kërkonte atij të largonte plagën.
  - Faraoni tha që atëherë do ta linte Izraelin të largohej.
  - Kur Faraoni thoshte që do t'i linte izraelitët të shkonin të lirë, Zoti e hiqte plagën.
  - Por, porsa Zoti largonte plagën, Faraoni e ngurtësonte zemrën dhe nuk i linte izraelitët të largoheshin nga Egjipti.
  - Sa herë që Faraoni e bënte këtë, ai e ngurtësonte gjithnjë e më shumë zemrën dhe bëhej më krenar.

# Mësimi 31

## Qëllimi

Ky mësim paraqet shenjtërinë, hirin dhe mëshirën e Perëndisë në çlirimin e Tij të Izraelit përmes Pashkës. Ti do t'u mësosh gjithashtu fëmijëve të klubit:


- Sovranitetin, besnikërinë dhe plotfuqinë e Perëndisë.
- Seriozitetin e mëkatit.
- Që ndëshkimi për mëkatin është vdekja.
- Që Perëndia i mban premtimet e Tij dhe kujdeset për ata që besojnë tek Ai.
- Që ata nuk munden ta shpëtojnë veten nga gjykimi i Perëndisë.
- Që Perëndia siguron një rrugë shpëtimi për ata që besojnë tek Ai.
- Domethënien e Pashkës.

## Hyrje

Diskuto me fëmijët e klubit se si njerëzit sot nxiten vazhdimisht të jenë “më të mëdhenjtë” dhe për t'i bërë gjërat “sipas mënyrës së tyre”. Sunduesi i kësaj bote (Satani) i mëson fëmijët dhe të rriturit të vënë veten në fillim dhe të mos e lejojnë Perëndinë apo dikë tjetër t'u thonë se çfarë duhet të bëjnë. Në historinë e sotme fëmijët e klubit do të shohin se si Faraoni besoi në fuqinë e vet dhe fuqinë e perëndive të rreme, por mësoi me shumë vonesë që ai nuk ishte më i madhi dhe që nuk mund të vepronte sipas kokës së tij.

## Figurat

- Figura 25: Gjaku i Pashkës i vendosur te shtalkat e dymve



- Figura 26: Faraoni dhe djali i tij i vdekur



# Perëndia kaloi tutje Izraelit

## Historia

“Po shikoj që keni shkruar përsëri te blloku i shënimeve” - u tha xhaxhi Piteri Xhonit dhe Karolës.

“Po” - tha Karola. “Po shkruanim nëntë plagët që dërgoi Perëndia ndaj egjiptianëve rebelë dhe pastaj do të vizatojmë figurën e secilës. Disa nga gjërat që Perëndia dërgoi nuk i kemi dëgjuar më parë”.

“Si stuhia e breshrit” - tha Xhoni. “Ne nuk kemi parë kurrë për një stuhi breshri më parë”.

“Pyetëm mësuesin për plagët që Perëndia u dërgoi egjiptianëve,” - tha Xhoni, - “dhe ai tha që ato nuk kanë ndodhur. Ai tha që askush nuk mund t'i shkaktojë ato plagë. Ishte e pamundur”.

“A i tha ndonjë nga ju që Perëndia është i plotfuqishëm?” - pyeti xhaxhi Piteri. “Dhe, a i the që Perëndia mund të bëjë gjithçka që dëshiron?”.

“Po,” - u përgjigj Karola, - “por ai tha që nëse kanë ndodhur me të vërtetë, pse nuk vuajtën edhe izraelitët nga plagët; ata ishin ngjitur me egjiptianët”.

“Çfarë i the atij?” - pyeti xhaxhi Piteri.

“Nuk e dinim se çfarë t'i thoshim” - u përgjigj Xhoni. “Nuk e dinim se përse nuk vuajtën edhe izraelitët nga ato plagë të tmerrshme”.

“Shiko,” - tha xhaxhi Piteri, “kishte disa arsye se pse Perëndia nuk lejoi që izraelitët të vuanin nga ato plagë të tmerrshme.”

“Mendoj se e di njërën prej arsyeve” - tha Xhoni. “A mos është ngaqë izraelitët nuk mëkatuan si egjiptianët; ata ishin aq të mirë, saqë nuk meritonin të vuanin?”.

“Por mendoj se të gjithë mëkatuan” - tha Karola.

“Ke të drejtë, Karola” - tha xhaxhi Piteri. “Zoti nuk e mbrojti Izraelin meqë ishte pa mëkat, apo meqë meritonte kujdesin e Tij. Ai i mbrojti ata për shkak të dashurisë, mëshirës dhe hirit të Tij”.

“Po Çlirimtari?” - pyeti Karola. “A nuk ishte kjo njëra prej arsyeve që Ai e mbrojti Izraelin?”.

“Po” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Perëndia nuk e kishte harruar premtimin e Tij ndaj Abrahamit, Isakut dhe Jakobit. Ai do ta ruante pasardhjen e izraelitëve, me anë të të cilëve do të vinte Çlirimtari. Perëndia e mbrojti gjithashtu Izraelin nga plagët, në mënyrë që mbreti i Egjiptit të kuptonte që Perëndia i Izraelit ishte Perëndia i vetëm i vërtetë e i gjallë në tërë tokën”.

“Edhe pas gjithë atyre plagëve,” - tha Xhoni, - “ai akoma refuzoi t'i bindej Perëndisë dhe t'i linte izraelitët të largoheshin”.

“Izraelitët mund të kenë pyetur veten të habitur nëse kishte ndonjë gjë që mund ta detyronte Faraonin që t'i linte të largoheshin” - tha Karola. “Çfarë mund të bënte Perëndia më tepër?”.

“Kujtoni,” - tha xhaxhi Piteri, - “kur folëm se si Perëndia nuk u çudit që Faraoni refuzoi ta linte popullin të shkonte? Perëndia i kishte premtuar edhe Abrahamit, Isakut dhe Jakobit që Ai do t'i kthente pasardhësit e Abrahamit në tokën që Ai u kishte dhënë atyre. Tani ishte koha që Perëndia kishte zgjedhur për ta bërë këtë gjë. Asgjë nuk mund ta ndalte Perëndinë për ta mbajtur premtimin e Tij”.

“Mezi pres ta dëgjoj!” - tha Karola e gëzuar. “Çfarë bëri Perëndia më pas për ta detyruar Faraonin që t'i linte izraelitët të largoheshin?”.

“Perëndia i tha Moisiut se si izraelitët duhet të përgatiteshin për plagën e fundit e të tmerrshme” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Zoti e dinte që pas kësaj plage përfundimtare, Faraoni do t'i linte izraelitët të shkonin”.

“Atëherë, çfarë bëri Perëndia? - pyeti përsëri Karola. “Duhet të ketë qenë vërtet e tmerrshme, në mënyrë që të ishte më e keqe se plagët që kishte dërguar tashmë Perëndia!”.

“Kjo është një pjesë shumë e rëndësishme e historisë njerëzore” - tha xhaxhi Piteri. “Le të hapim Biblën dhe të shohim saktësisht se çfarë ndodhi”.

## Le të shohim në Bibël



**Naumi 1:7** - “Zoti është i mirë, është një fortesë në ditën e fatkeqësisë; ai i njeh ata që kërkojnë strehë tek ai”.

Diskuto me fëmijët e klubit tënd për mirësinë, dashurinë dhe mëshirën e Perëndisë ndaj atyre që besojnë tek Ai.

## Le të mendojmë

1. A mëkatuan izraelitët? **Po** / Jo.
2. A i meritonte Izraeli dashurinë, mëshirën dhe hirin e Perëndisë? Po / **Jo**.
3. A u bind Faraoni dhe a i la izraelitët të shkonin? Po / **Jo**.
4. A ishte Perëndia i çuditur që Faraoni nuk e linte popullin të shkonte? Po / **Jo**.
5. A mundet dikush apo diçka ta ndalë Perëndinë që të mos i mbajë premtimet e Tij? Po / **Jo**.

## Mësime nga Fjala e Perëndisë

Sot do të tregosh historinë e Pashkës. Duhet t'i mësosh me kujdes hollësitë e Pashkës të cilat paraqiten në këtë mësim, në mënyrë që t'i përdorësh për paraqitjen e ungjillit.

### 1. Gjykimi i Perëndisë ndaj egjiptianëve - Eksodi 11:1, 4-7.

Edhe pse Zoti kishte dërguar tashmë nëntë plagë të tmerrshme ndaj egjiptianëve rebelë, Faraoni refuzoi sërish t'i bindej Zotit dhe t'i linte izraelitët të lirë. Perëndia e dinte që Faraoni do të ishte kryeneç dhe do të refuzonte t'i lëshonte izraelitët. Perëndia i kishte thënë Moisiut që do të ndodhte kjo.

- Ky mbret i keq, Faraoni, nuk mund ta ndalte Perëndinë për t'i çliuar pasardhësit e Abrahamit.
- Zoti e dinte që, pas kësaj plage, Faraoni do t'i lëshonte izraelitët.

### 2. Udhëzimet e Zotit ndaj Moisiut.

- Perëndia i tha Moisiut se si duhet të përgatiteshin izraelitët për plagën e fundit dhe më të tmerrshmen.

Mendo:

Edhe izraelitët ishin mëkatarë dhe meritonin të vdisnin për mëkatet e tyre. Ata do të kishin vuajtur nga ky gjykim i fundit e i tmerrshëm nëse nuk do të kishte qenë për mëshirën dhe hirin e Perëndisë. Perëndia i kujtoi premtimet që i kishte bërë Abrahamit, Isakut dhe Jakobit<sup>60</sup>.

- Kjo është ajo që Zoti i tha Moisiut se duhet të bënin izraelitët, për t'i shpëtuar të parëlindurit e tyre nga vdekja.

#### a. Ata duhet të zgjidhnin një qengj pa të meta - Eksodi 12:1-5.

- Kryetari i çdo familjeje duhet të zgjidhte një qengj apo kec. Qengji apo keci duhet të ishte i përsosur.<sup>61</sup>

#### b. Ata duhet të vrisnin qengjin dhe të mblidhnin gjakun në një enë - Eksodi 12:6.

- Qengji duhet të mbahej deri ditën e katërmbëdhjetë të muajit.
- Ata duhet ta therrnin kafshën mbrëmjen e asaj dite.
- Gjak i qengjit, nga i cili varej jeta e tij, duhet të rridhte. Kjo duhet t'u kujtonte izraelitëve që ndëshkimi për mëkatin është vdekja.

<sup>60</sup> Perëndia kishte premtuar t'i çonte pasardhësit e Abrahamit në tokën që Ai u kishte dhënë. Tani ishte koha që Perëndia kishte zgjedhur për ta realizuar këtë gjë.

<sup>61</sup> Kujto: A e kujtoni dashin që duhet të flijohej në vend të Isakut? Ai ishte kapur për brirësh në një shkurre. Pse ishte kapur prej brirësh? Perëndia është i përsosur dhe gjithçka që Ai thotë dhe bën është e përsosur. Ai nuk do të pranonte kurrë si flijim një kafshë që ishte e sëmurë apo e lënduar.

<sup>62</sup> Kur izraelitët vranë qengjat dhe gjaku rrodhi prej tyre, njerëzit u kujtuan që ndëshkimi për mëkatin është vdekja. Ashtu si dashi vdiq në vend të Isakut, qengjat e përsosur që u zgjodhën dhe u vranë nga izraelitët vdiqën në vend të bijve të tyre të parëlindur.

=> Figura 25: Gjaku i Pashkës i vendosur te shtalkat e dymve

<sup>63</sup> Izraelitët duhet të qëndronin brenda shtëpive të tyre, në të cilat kishin vendosur gjakun. Ishte pikërisht ashtu, sikur ata po fshiheshin prapa vdekjes dhe gjakut të qengjit, të cilin Perëndia u kishte thënë që duhet ta vrisnin në vend të të parëlindurit.

<sup>64</sup> Mendo: Mund të imagjinosh frikën e Perëndisë që kaloi përmes izraelitëve! Ata e dinin që Perëndia e kishte me tërë mend atë që tha. Ata i besuan dhe iu bindën Zotit.

## Përsëritje

Mjetet: Ena në dorën e personit, gjaku te shtalkat, dega e përdorur për të vendosur gjakun te shtalkat dhe qengji në tokë.

## Pyetje dhe përgjigje

1. Cili ishte gjykimi i fundit që dërgoi Perëndia ndaj egjiptianëve?  
**Perëndia dërgoi plagën që vrau të parëlindurin në çdo familje egjiptiane dhe të parëlindurin e tërë gjësë së tyre të gjallë.**
2. Çfarë do të kishte ndodhur nëse izraelitët nuk do të kishin bërë gjithçka saktësisht siç i kishte udhëzuar Perëndia? **Fëmijët e tyre të parëlindur do të kishin vdekur.**
3. Kush është i vetmi që mund të na tregojë se si t'i afrohem Perëndisë dhe të pranohemi prej Tij? **Perëndia.**
4. Çfarë ndodhi në shtëpitë e egjiptianëve? **Perëndia vrau të parëlindurin e çdo familje.**
5. Çfarë u ndodhi izraelitëve? **Tërë fëmijët e tyre ishin të sigurt, asnjë prej tyre nuk vdiq.**

Kujtoni:

Para se Adami dhe Eva të mëkatonin, nuk kishte vdekje në botë. Por kur Adami dhe Eva u ndanë nga Perëndia për shkak të mosbindjes së tyre, Perëndia tha që trupat e tyre duhet të vdisnin. Tërë pasardhësit e Adamit dhe Evës kishin lindur mëkatarë, të ndarë nga Perëndia. Kjo është arsyeja se pse tërë njerëzit duhet të vdesin fizikisht, përfshi ty dhe mua.<sup>62</sup>

### c. Ata duhet të vendosnin gjakun në të dyja shtalkat dhe sipër derës - Eksodi 12:7.

- Perëndia u tha izraelitëve që të mblidhnin gjakun në një enë. Pastaj duhet të merrnin një degë të hollë të një farë bime dhe ta ngjyenin në gjak.
- Me këtë degë ata duhet ta vendosnin gjakun te shtalkat dhe sipër derës së shtëpisë ku ata do të hanin qengjin atë natë.
- Ishte gjaku i qengjit te shtalkat që do ta shpëtonte të parëlindurin nga gjykimi i Perëndisë.

### d. Ata duhet të qëndronin brenda shtëpisë në të cilën kishin vendosur gjakun - Eksodi 12:22.<sup>63</sup>

### e. Ata nuk duhet të thyejnë kockat e qengjit - Eksodi 12:46.

- Këto ishin udhëzimet e Izraelit. Ata duhet të bënë gjithçka sipas asaj që Zoti i tha Moisiut.

Kujtoni:

Perëndia ka qenë gjithmonë i njëjti. Njerëzit nuk mund të shpëtojnë veten sipas mënyrës së tyre. A kujtoni që Ai refuzoi t'i pranonte veshjet që Adami dhe Eva bënë për vete në kopshtin e Edenit? Perëndia refuzoi edhe ofertën që solli Kaini, sepse nuk ishte sipas udhëzimeve të Tij. Perëndia i tha Noeut të bënte një arkë saktësisht sipas udhëzimeve të Tij. Në të njëjtën mënyrë, edhe izraelitët duhet ta bënë gjithçka saktësisht, ashtu siç e kishte udhëzuar Perëndia Moisiun.

### 3. Premtimi i Zotit ndaj izraelitëve - Eksodi 12:12-14.

- Perëndia u premtoi izraelitëve që kur të shikonte gjakun në shtëpitë e tyre, Ai nuk do ta lejonte plagën të futej dhe të vriste të parëlindurin e tyre.

### 4. Besimi dhe bindja e Izraelit - Eksodi 12:28.<sup>64</sup>

### 5. Tërë të parëlindurit egjiptianë vdesin - Eksodi 12:29-30.

- Çdo i parëlindur fëmijë egjiptian dhe i parëlindur i çdo gjëje të gjallë egjiptiane vdiq.
  - Zoti kaloi përmes Egjiptit, ashtu siç tha se do të bënte.
    - Kur Perëndia vendos të ndëshkojë mëkatin, njeriu nuk ka mundësi të shpëtojë vetë nga mëkati.
  - Ngaqë Izraelitët kishin vendosur gjakun në shtëpitë e tyre si bindje ndaj Zotit, asnjë prej fëmijëve të tyre të parëlindur apo gjësë së gjallë, nuk vdiq.
    - Perëndia tha se do të bënte që i parëlinduri në secilën prej shtëpive egjiptiane të vdiste, dhe e bëri.
    - Perëndia tha që do të kalonte tutje çdo shtëpie ku do të shikonte gjakun, dhe e bëri.
- => Figura 26: Faraoni dhe djali i tij i vdekur
- A ishte paralajmëruar Faraoni? Po! Nëntë plagët e tjera që Zoti kishte premtuar të dërgonte, kishin ndodhur të gjitha.

### 6. Faraoni u tha izraelitëve të shkonin - Eksodi 12:31-36.

- Faraoni e thirri Moisiun atë natë dhe i tha atij që t'i nxirrte izraelitët jashtë Egjiptit.
- Faraoni mendoi se mund të luftonte kundër Perëndisë, por askush nuk mund të luftojë kundër Zotit dhe të fitojë. A i mbani mend premtimet që Perëndia i bëri Abrahamit?  
=> Trego figurën 16: Disa nga premtimet e Perëndisë ndaj Abrahamit.
- Katërqind vjet kishin kaluar dhe tani egjiptianët po u jepnin ar dhe argjend skllëvërve të tyre, izraelitëve. Dhe egjiptianët po u thoshin atyre të largoheshin menjëherë! Perëndia nuk i harron kurrë premtimet e Tij. Zoti e kishte çliruar popullin e Tij, ashtu siç kishte premtuar.



# Mësimi 32

## Qëllimi

Ky mësim paraqet fuqinë, besnikërinë, hirin dhe mëshirën e Perëndisë të shfaqur në sigurimin e Tij për popullin e Tij, shpesh jo besnik, Izraelin. Tregon paaftësinë e izraelitëve për të çliruar veten. Do t'u tregosh gjithashtu fëmijëve të klubit tënd:


- Sovranitetin dhe plotfuqinë e Perëndisë.
- Që njeriu mund të shpëtohet vetëm sipas vullnetit dhe planit të Perëndisë.
- Besnikërinë e Perëndisë për të përm-bushur premtimet e Tij.
- Që Perëndia kryen mrekulli: ajo që duket e pamundur për njeriun është e mundur për Perëndinë.

## Hyrje

Shpjegoi fëmijëve të klubit që disa njerëz nuk besojnë te mrekullitë. Disa edukatorë të sotëm po përpiqen të "heqin" nga historia veprat e mrekullueshme të Perëndisë, të cilat i kishte regjistruar në mënyrë të qartë në Bibël. Edhe disa që e quajnë veten edukatorë të krishterë kanë mashtruar veten dhe të tjerët duke dhënë arsye natyrore për ndodhitë e mrekullueshme. Disa njerëz e mohojnë plotësisht të vërtetën e ndodhive biblike, duke i quajtur thjesht histori apo mite. Për të pranuar plotësisht një mrekulli si të vërtetë, një person duhet të besojë që Perëndia është Ai që thotë se është. Nëse Perëndia është Krijuesi sovran i gjithësisë, atëherë mrekullitë e Biblës nuk janë përtej fuqisë së Tij për t'i realizuar. Njerëzit nuk po hedhin poshtë thjesht mrekullitë; ata po hedhin poshtë Perëndinë. Kur besojmë që Bibla është Fjala e vërtetë e Perëndisë, ne pranojmë atë që thotë Perëndia për veten. Ai është Krijuesi sovran, Perëndia i gjithë-fuqishëm, i gjithëdhijshëm dhe i vetmi.

## Figurat

- Grafiku 20: Izraeli
- Figura 27: Kalimi i Detit të Kuq



# Perëndia e çliron Izraelin në Detin e Kuq

## Historia

“Po shikoj që ju të dy po shkruani sërish në bllokun tuaj të shënimeve” - tha xhaxhi Piteri. “A po i shënoni akoma tërë plagët që Perëndia dërgoi ndaj egjiptianëve?”.

“Jo” - tha Karola. “Kemi mbaruar me plagët. Po përpiqemi të kujtojmë tërë gjërat e mëdha që ka bërë Perëndia. Gjëra që askush nuk ka qenë në gjendje t'i bëjë”.

“Fjala për gjërat e mëdha që bën Perëndia është ‘mrekulli’” - tha xhaxhi Piteri. “Në Bibël ‘mrekullia’ është një vepër e veçantë e Perëndisë, në të cilën Perëndia zgjedh të bëjë diçka që nuk do të ndodhte në rrjedhën normale të ligjeve fizike që ka vendosur”.

“Nuk i kuptova tërë këto fjalë që the, xhaxhi Piter,” - tha Xhoni, - “por mendoj se e di çfarë do të thuash. Një mrekulli është diçka që mund ta bëjë vetëm Perëndia. Do të ishte e pamundur që dikush tjetër apo diçka tjetër ta bënte, as nuk do të ndodhte natyrshëm në këtë botë që Perëndia ka krijuar”.

“E vërtetë, Xhon,” - tha xhaxhi Piteri, - “dhe askush nuk mund ta shpjegojë se si ndodhi. Mund të quhet thjesht mrekulli. Bibla flet për shumë, shumë mrekulli. Ato janë pjesë e historisë së vërtetë”.

“Jam i sigurt që izraelitët janë të lumtur që Perëndia kryen mrekulli” - tha Karola. “Përndryshe nuk do të ishin në gjendje të largoheshin nga Egjipti”.

“Po,” - tha xhaxhi Piteri, - “Perëndia i përdori mrekullitë për t'i çliruar izraelitët nga Egjipti. Por kujtoni, këta izraelitë kishin dëgjuar vetëm atë që kishte bërë Perëndia për Abrahamin, Isakun, Jakobin dhe Jozefin. Perëndia gjithashtu donte që ata të shikonin madhështinë, fuqinë dhe dashurinë e Tij të madhe për krijimin e Tij, dashuri ku ata bënë pjesë”.

“Më vjen keq që tërë ata qengja duhet të vdisnin” - tha Karola e trishtuar. “Do të doja që ata të mos vdisnin, në mënyrë që izraelitët të çliroheshin”.

“Kjo është për shkak të Adamit dhe të Evës, apo jo, xhaxhi Piter?” - pyeti Xhoni. “Ngaqë nuk iu bindën Perëndisë, ata u ndanë nga Ai. Kujtoni, Karola, Perëndia vrau një kafshë për të bërë veshje për ta. Perëndia u tha se për shkak të mëkatit të tyre, derisa të dërgonte Çlirimtarin, ata duhet të flijonin një qengj të përsosur, në mënyrë që të mund t'i afroheshin Atij”.

“Kjo është e vërtetë” - tha xhaxhi Piteri. “Tërë pasardhësit e Adamit dhe Evës kishin lindur mëkatarë, të ndarë nga Perëndia. Kjo është arsyeja se pse trupat e tërë njerëzve duhet të vdesin, përfshi ju dhe mua. Kur izraelitët vranë qengjat dhe gjaku u derdh, njerëzit u kujtuan që ndëshkimi për mëkatin është vdekja. Ashtu siç vdiq dashi në vend të Isakut, qengjat e përsosur, të cilët u zgjodhën dhe u vranë nga izraelitët, vdiqën në vend të fëmijëve të tyre të parëlindur”.

“Kur ndodh mrekullia e radhës në Bibël, xhaxhi Piter?” - pyeti Karola.

“Izraelitët do të përjetojnë shumë mrekulli në udhëtimin e tyre për në tokën që Perëndia u kishte premtuar” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Por mrekullia e radhës ndodhi menjëherë pasi u larguan nga Egjipti”.

“Ata duhet të kenë qenë vërtetë të lumtur që Perëndia ishte me ta në këtë udhëtim” - tha Xhoni.


“Duhet të ishin,” - tha xhaxhi Piteri, - “por kur Faraoni ndryshoi mendje dhe i ndoqi izraelitët, ata e harruan mbrojtjen e Perëndisë, u frikësuan për jetët e tyre dhe filluan të murmurisnin kundër Moisiut”.

“Si mund të mendonin që Perëndia do t'i harronte kur sapo kishte bërë tërë ato gjëra të mrekullueshme për ta?” - pyeti Karola.

“Shiko,” - u përgjigj xhaxhi Piteri, - “mendoj se ata ende nuk kishin mësuar t'i besonin Perëndisë. Megjithatë, Moisiu besoi te Perëndia dhe u tha izraelitëve që edhe ata duhet të besonin tek Ai. Le të lexojmë se si Perëndia i nxori izraelitët nga Egjipti”.



## Le të shohim në Bibël



**Psalmi 46:10** - “Ndaluni dhe pranoni që jam Perëndi; do të ngrihem lart midis kombeve, do të ngrihem lart mbi tokë”.

Shpjego që Perëndisë mund t'i zihet besë, pavarësisht se çfarë ndodh. Ai është më i madh se të gjithë dhe na do. Perëndinë duhet ta lavdërojmë, sepse Ai është më i madh nga të gjithë. Askush nuk mund të dalë fitimtar kundër Tij.

## Le të mendojmë

1. Në Bibël, mrekulli është diçka që mund ta bëjë vetëm Perëndia? **Po** / Jo.
2. A kanë lindur mëkatarë tërë pasardhësit e Adamit dhe Evës? **Po** / Jo.
3. Cili është ndëshkimi për mëkatin?  
a. Burgu; b. Asgjë; c. **Vdekja**.
4. A do të harrojë Perëndia krijimin e Tij? **Po** / **Jo**.
5. Kush i nxori Moisiun dhe izraelitët nga Egjipti?  
a. Aaroni; b. **Perëndia**; c. Nuk kishin drejtues.

=> Trego grafikun 20: Izraeli.

## Mësime nga Fjala e Perëndisë

Bibla flet për shumë e shumë mrekulli. Mrekullitë janë pjesë e historisë së vërtetë. Mrekullitë na tregojnë madhësinë e Perëndisë dhe na mësojnë rreth fuqisë dhe dashurisë së Tij të madhe për krijimin e Tij. Sot do të lexojmë për disa mrekulli që Perëndia bëri për izraelitët. Kujtoni, këto histori janë fakte historike.

### 1. Perëndia i drejtoi izraelitët me anë të një reje - Eksodi 13:17-18, 21.

- Perëndia i çliroi izraelitët nga skllavëria në Egjipt dhe filloi t'i çonte në tokën që i kishte premtuar paraardhësit të tyre, Abrahamit.
  - Numri i izraelitëve ishte rritur shumë.
  - Kur izraelitët shkuan për herë të parë në Egjipt ishin vetëm 70.
  - Tani, 430 vjet më pas, ishin mbase rreth dy milion e gjysmë.
- Perëndia i drejtoi atje ku Ai donte që ata të shkonin, me anë të një kolone reje gjatë ditës dhe të një kolone zjarri gjatë natës.
  - Perëndia e mbante kolonën para tyre gjatë tërë kohës: ata mund ta shikonin ditë e natë.
  - Ata do të humbisnin dhe përfundimisht do të kishin vdekur në shkretëtirë nëse Zoti nuk do t'i kishte drejtuar. Ai i donte, prandaj u kujdes për ta.
- Perëndia po i mbronte izraelitët, në mënyrë që Çlirimtari i madh do të lindte në botë.
  - Izraelitët janë pasardhës të Abrahamit.
  - Zoti i kishte premtuar Abrahamit që një prej pasardhësve të tij do të ishte Shpëtimtari i botës.
- Perëndia po e mbronte Izraelin, sepse Ai po u jepte atyre Fjalën e Tij, në mënyrë që ata t'ia jepnin botës. Fjalët që kemi lexuar sot iu dhanë fillimisht Izraelit.

<sup>65</sup> E njëjta gjë vlen edhe për ne. Ne nuk mund t'i shpëtojmë zemërimit të Perëndisë kundër mëkatit. Ne nuk mund t'i rregullojmë gjërat midis nesh dhe Perëndisë me anë të gjërave që bëjmë. Vetëm Perëndia mund të na shpëtojë nga ndëshkimi i përjetshëm.

=> Figura 27: Kalimi i Detit të Kuq

## Përsëritje

Aktivitet me këtë mesazh të fshehtë: "Nda-luni dhe pranoi që jam Perëndi".

## Pyetje dhe përgjigje

- Si ua tregoi Perëndia izraelitëve se ku të shkonin? **Perëndia i drejtoi me anë të resë gjatë ditës dhe me anë të kolonës së zjarrit natën.**
- Çfarë bënë izraelitët kur panë ushtritë e Faraonit t'i ndiqnin? **Ata fajësuan Moisiun dhe thanë që ai duhet t'i kishte lënë në Egjipt.**
- A kishte ndonjë mënyrë se si izraelitët mund ta shpëtonin veten? **Jo.**
- Çfarë duhet të kishin bërë izraelitët? **Ata duhet të kishin kërkuar Zotin dhe duhet t'i kishin besuar Atij për t'i shpëtuar.**
- Pse nuk ishte e vështirë për Perëndinë të hapte detin?  
  - Sepse Perëndia krijoi detin;**
  - Sepse Perëndia është Shumë i Larti dhe nuk ka asgjë të vështirë për Të.**

## 2. Faraoni vendosi ta merrte sërish Izraelin - Eksodi 14:5-7.

- Faraoni drejtohej nga Satani.
- Ai nuk do të hiqte dorë dhe nuk do t'i linte izraelitët të largoheshin. Ai planifikoi t'i kthente mbrapsht.

## 3. Izraelitët kishin frikë dhe fajësuan Moisiun - Eksodi 14:10-14.

- Edhe pse izraelitët kishin parë tërë gjërat e mëdha e të fuqishme që kishte bërë Zoti në Egjipt, ata akoma nuk besonin te Zoti.
- Megjithatë, Moisiu besoi te Zoti dhe u tha izraelitëve t'i besonin Perëndisë.
- Edhe pse izraelitët mëkatuan dhe nuk i besuan Zotit, Ai ishte i mëshirshëm dhe planifikoi t'i çlironte.
  - Izraelitët nuk mund ta çlironin veten.
  - Deti ishte përballë tyre dhe ushtritë egjiptiane ishin pas.

Kujtoni:

Kur Perëndia nxori nga kopshti Adamin dhe Evën, larg Tij, ata nuk mund të ktheheshin pas dhe nuk mund t'i rregullonin gjërat mes tyre dhe Perëndisë. Vetëm Perëndia mund të siguronte një rrugë, në mënyrë që të pranoheshin përsëri prej Tij. Ishte Perëndia që siguroi një mënyrë që Abeli të pranohej prej Perëndisë. Vetëm Perëndia mund të shpëtonte Noeun dhe familjen e tij nga përmytja. Kur Isaku ishte i lidhur dhe i vendosur në altar, dhe babai i tij kishte ngritur thikën mbi të, vetëm Perëndia mund ta shpëtonte. Prindërit e fëmijëve të parëlindur të Izraelit nuk do të mund t'i kishin shpëtuar fëmijët e tyre nga vdekja nëse Perëndia nuk do të kishte siguruar një mënyrë. Dhe Izraeli nuk do të mund të largohej nga egjiptianët nëse Perëndia nuk do të siguronte një mënyrë për ta.<sup>65</sup>

## 4. Perëndia hapi detin - Eksodi 14:15-16.

- Perëndia krijoi detin, kështu që Ai ka kontroll të plotë mbi të.

Kujtoni:

Në fillim tërë toka ishte e mbushur me ujë. E kujtoni se si Zoti bëri që ujërat të tërhiqeshin, në mënyrë që të dilte toka e thatë? Zoti, i Cili bëri që ujërat të tërhiqeshin, nuk kishte ndryshuar. Ai e urdhëroi këtë det që të tërhiqej, në mënyrë që njerëzit e Tij të ecnin në tokë të thatë për të dalë në anën tjetër. Perëndia mund të bënte këtë, sepse Ai ka kontroll mbi tërë tokën.

- Perëndia nuk e kishte të vështirë ta hapte detin, në mënyrë që izraelitët të dilnin në anën tjetër.

## 5. Izraeli u drejtua nga Perëndia përmes detit - Eksodi 14:19-25.

- Zoti nuk e braktisi popullin e Tij.
  - Ai premtoi t'i nxirrte të sigurt nga Egjipti dhe t'i çonte në tokën që i kishte premtuar Abrahamit.
  - Zoti i drejtoi izraelitët në shtegun që hapi përmes detit.
  - Zoti e zhvendosi renë që e drejtonte Izraelin dhe e vendosi midis tyre dhe egjiptianëve.
    - Pas izraelitëve reja ishte e shndritshme si dielli.
    - Ajo dha dritë, në mënyrë që izraelitët të shikonin se ku po shkonin.
    - Megjithatë, përballë egjiptianëve reja ishte e zezë.
    - Kishte vetëm errësirë përballë tyre.
- Egjiptianët vazhdonin akoma t'i ndiqnin nga pas, sepse Zoti kishte planifikuar t'i shkatërronte.

## 6. Perëndia e mbyti ushtrinë egjiptiane në det - Eksodi 14:26-29.

- Ushtritë egjiptiane u mbytën nga Perëndia në det. Askush nuk mund të luftojë kundër Perëndisë dhe të fitojë.
- Zoti i mbrojti tërë izraelitët - Eksodi 14:30.
  - Asnjë prej tyre nuk u mbyt dhe egjiptianët nuk kapën asnjë prej tyre.
  - Zoti i shpëtoi për shkak të dashurisë që kishte për ta, dhe sepse Ai u kishte premtuar t'i shpëtonte.
- Kur Izraeli pa gjërat e mëdha që bëri Zoti, ata besuan tek Ai - Eksodi 14:31.

# Mësimi 33

## Qëllimi

Mësimi i sotëm do të jetë një përsëritje e asaj që kemi mësuar gjatë pesë mësimëve të fundit. Mund të bësh më tepër pyetje apo t'i përshtatësh pyetjet sipas moshës së fëmijëve të klubit tënd. Të lutem referohu për ndihmë faqeve 33-34, për të zhvilluar mësimet dhe lojërat e përsëritjes.

## Hyrje

Sot nuk do të kemi histori. Kjo do të jetë një ditë përsëritjeje. Mund të përdorësh pyetjet për të bërë një Test Awana me fëmijët. Këto pyetje trajtojnë vetëm pesë mësimet e fundit. Megjithatë mund të përdorësh tërë pyetjet e mëparshme të përsëritjes dhe mund të përsëritësh mësimet e tërë vitit.

## Figurat

*Shënim: Nëse e bën këtë përsëritje pas pyetjeve të testit, mund të kalosh më tepër kohë duke përsëritur ato pjesë të mësimëve që fëmijët nuk i mbajnë mend mirë.*

- Grafiku 1: Mësimi për Perëndinë Përdore këtë për të përsëritur atributet e Perëndisë.
- Grafiku 2: Perëndia është më i madh se të gjithë
- Grafiku 16: Disa nga premtimet e Perëndisë ndaj Abrahamit

# Pyetje, pyetje, pyetje!

## Histori

Ky mësim nuk ka histori.

## Le të shohim në Bibël



Le të shohim se sa vargje kanë mësuar përmendësh fëmijët dhe se sa janë në gjendje t'i thonë. Bëj një pyetje për secilin prej pesë vargjeve që kemi përdorur në pesë mësimet e fundit. Shembuj: Kush mund të thotë Isainë 45:22? Te kush duhet të shohim për t'u shpëtuar? Përgjigju pyetjes dhe cito vargun përmendësh që i përgjigjet kësaj pyetjeje. Fëmijët mund të fitojnë pikë shtesë

për recitimin e tërë vargjeve të mëposhtme.

Isaia 45:22; 1 Samuelit 2:2; Psalmi 106:8; Naumi 1:7; Psalmi 46:10.

## Le të mendojmë

Ke qenë duke dhënë mësim nga libri i dytë i Biblës, Eksodi. Ke mësuar se si Perëndia nxori popullin e Tij, izraelitët, nga Egjipti. Këto mësimet kanë treguar kujdesin sovran e të dashur të Perëndisë, në ruajtjen e Izraelit në skllavëri dhe në zgjedhjen e Moisiut për t'i çliruar. Mësimet paraqisnin gjithashtu sovranitetin, fuqinë, gjithëdijen dhe plotfuqinë e Perëndisë në shkaktimin e plagëve në Egjipt. Tregohet fuqia, hiri dhe mëshira e Tij në çlirimin e Izraelit përmes Pashkës. Ke mësuar që izraelitët nuk mund ta shpëtonin veten; vetëm Perëndia mund t'i çlironte.

**Moisiu dhe izraelitët:** Izraelitët ishin pasardhës të Abrahamit, Isakut, Jakobit dhe Jozefit. Kur Jozefi ishte sundimtar në Egjipt, familja e tij, e cila kishte jetuar në Kanaan, u shpërngul në Egjipt për shkak se kishte zi buke në Kanaan.

1. Pse mbreti i Egjiptit i bëri izraelitët skllavër? **Sepse ata ishin bërë më të shumtë në numër sesa egjiptianët; mbreti kishte frikë që izraelitët mund të bashkoheshin me armiqtë e egjiptianëve për t'u ndeshur kundër tyre dhe të merrnin nën kontroll Egjiptin.**
2. Kush ishte duke e drejtuar mbretin në planet e tij të këqija? **Satani.**
3. Pse dëshironte Satani t'i shkatërronte izraelitët? **Satani e dinte se Perëndia i kishte premtuar Abrahamit, Isakut dhe Jakobit që një prej pasardhësve të tyre do të ishte Çlirimtari.**
4. Kush e gjeti Moisiun në një kosh në lumë? **Vajza e Faraonit.**
5. Pse e lejoi Perëndia vajzën e Faraonit ta birësonte Moisiun? **Sepse Perëndia planifikoi ta përdorte Moisiun për t'i çliruar izraelitët nga skllavëria.**
6. A mund ta shpëtonin veten izraelitët nga skllavëria apo mund t'i shpëtonte Moisiu? **Jo.**
7. Kush është i vetmi që mund ta çlirojë një person nga kontrolli i Satanit? **Perëndia.**
8. Pse shkurrja që pa Moisiu nuk po konsumohej, edhe pse ishte në flakë? **Shkurrja nuk u konsumua, sepse Perëndia, Shumë i Larti, ishte te shkurrja.**
9. Pse Perëndia i tha Moisiut t'i hiqte këpucët kur po qëndronte përballë shkures që digjej? **Për të treguar respekt ndaj Perëndisë që është i përsosur dhe i shenjtë.**
10. Cili ishte sugjerimi që kishte Moisiu për Perëndinë, kur Perëndia i tha Moisiut se e kishte zgjedhur për t'i nxjerrë izraelitët nga skllavëria? **Moisiu i tha Perëndisë që të dërgonte dikë tjetër, i cili do të ishte një zgjedhje e mirë sesa ai.**
11. A mendoi Perëndia se mbreti i Egjiptit do t'i lironte menjëherë izraelitët kur Moisiu do t'i tregonte atë që kishte thënë Zoti? **Jo, Ai e dinte që mbreti nuk do t'i çlironte izraelitët derisa të ishte i detyruar ta bënte një gjë të tillë. Perëndia di gjithçka.**

12. Si planifikoi Perëndia ta përdorte Faraonin e keq? **Perëndia planifikoi ta përdorte këtë mbret krenar për t'i treguar kujtdo që Perëndia i Izraelit është Perëndia i vetëm i vërtetë dhe që Ai është Shumë i Larti.**
13. A e kishin parë madhësinë dhe fuqinë e Perëndisë izraelitët që jetonin në Egjipt në këtë kohë? **Jo, ata vetëm sa kishin dëgjuar për Zotin dhe atë që kishte bërë për Abrahamin, Isakun, Jakobin dhe Jozefin.**
14. Si e tregoi Perëndia fuqinë e Tij? **Perëndia dërgoi plagë të mëdha e të tmerrshme ndaj egjiptianëve.**
15. A meritonin izraelitët të mbroheshin nga plagët? **Jo, edhe ata ishin mëkatarë dhe meritonin gjykimin e Perëndisë.**
16. Sa plagë kishte dërguar Perëndia ndaj egjiptianëve para gjykimit të fundit? **Nëntë.**
17. Cili ishte gjykimi i fundit që dërgoi Perëndia ndaj egjiptianëve? **Perëndia dërgoi një plagë që vrau të parëlindurin e çdo familje egjiptiane dhe të parëlindurin e çdo gjëje të gjallë.**
18. Çfarë do të kishte ndodhur nëse izraelitët nuk do të kishin bërë gjithçka saktësisht sipas asaj që Perëndia udhëzoi Moisiun? **Fëmijët e tyre të parëlindur do të ishin vvarë.**
19. Kush është i vetmi që mund të na thotë se si mund t'i afrohem Perëndisë dhe të pranohemi prej Tij? **Perëndia.**
20. Çfarë ndodhi në shtëpitë e egjiptianëve atë natë kur Perëndia tha se do të vriste të parëlindurin e çdo familje? **Perëndia i vrau, ashtu siç tha se do të bënte.**
21. Cili ishte premtimi i Perëndisë ndaj izraelitëve? **Perëndia u premtoi që kur të shikonte gjakun te shtalkat dhe mbi dyer, Ai do të kalonte tutje.**
22. Çfarë u ndodhi izraelitëve? **Tërë fëmijët e tyre ishin të sigurt.**
23. Çfarë i tha Faraoni, mbreti, Moisiut pasi vdiqën të parëlindurit e egjiptianëve? **Faraoni i tha Moisiut që t'i nxirrte tërë izraelitët jashtë Egjiptit.**
24. Si u tregoi Zoti izraelitëve se ku të shkonin? **Perëndia i drejtoi me anë të resë gjatë ditës dhe me anë të kolonës së zjarrit natën.**
25. Çfarë do të kishte ndodhur nëse Perëndia nuk do t'i kishte drejtuar izraelitët me kolonën e resë? **Ata do të kishin humbur dhe përfundimisht do të kishin vdekur në shkretëtirë.**
26. Ku do të shkonin izraelitët? **Në Kanaan, quajtur Izrael, toka që Perëndia ua dha Abrahamit, Isakut dhe Jakobit.**
27. Çfarë bënë izraelitët kur panë ushtritë e Faraonit të vinin pas tyre? **Ata fajësuan Moisiun dhe thanë që ai duhet t'i kishte lënë në Egjipt.**
28. A kishte ndonjë mënyrë që izraelitët të shpëtonin veten? **Jo.**
29. Çfarë duhet të kishin bërë izraelitët kur panë egjiptianët të vinin? **Ata duhet t'i thërrisnin Perëndisë dhe t'i besonin Atij për t'i shpëtuar.**
30. Pse nuk ishte e vështirë që Perëndia të hapte detin?
  - a. **Sepse Perëndia krijoi detin;**
  - b. **Sepse Perëndia është Shumë i Larti dhe nuk ka asgjë të vështirë për Të.**
31. Çfarë bëri Perëndia për t'i mbrojtur izraelitët nga egjiptianët që po ecnin përmes detit? **Perëndia vendosi renë pas izraelitëve, në mënyrë që të ishte midis tyre dhe egjiptianëve. Reja ndriçoi për t'u treguar rrugën izraelitëve, por përballë egjiptianëve ishte një re e errët dhe e zezë.**
32. Çfarë u ndodhi ushtrive egjiptiane që i ndoqën izraelitët përmes detit? **Ushtritë egjiptiane u mbytën nga Perëndia në det.**
33. Pse egjiptianët nuk mund të shpëtonin nga Perëndia? **Ngaqë Perëndia është më i madh se të gjithë, askush nuk mund të luftojë kundër Tij dhe të fitojë. Ai është Shumë i Larti.**

\* Shënim: Sigurohu që fëmijët të kuptojnë që kjo nuk është "Pesë hapat për t'u shpëtuar" sot. Ata duhet të kuptojnë se është gjaku që i shpëtoi të parëlindurit e Izraelit; edhe kjo duhet të bëhet saktësisht siç kishte udhëzuar Perëndia.

Përko referencën me vargun e duhur.

1. Isaia 45:22;      2. 1 Samuelit 2:2;
3. Psalmi 106:8;    4. Naumi 1:7;
5. Psalmi 46:10

4. *Zoti është i mirë, është një fortesë në ditën e fatkeqësisë; ai i njeh ata që kërkojnë strehë tek ai.*

3. *Megjithatë Zoti i shpëtoi për hir të emrit të tij, për të bërë të njohur fuqinë e tij.*

5. *Ndaluni dhe pranoni që jam Perëndi; do të ngrihem lart midis kombeve, do të ngrihem lart mbi tokë.*

1. *Kthehuni nga unë dhe do të shpëtoni, ju mbarë skaje të tokës. Sepse unë jam Perëndia dhe nuk ka asnjë tjetër.*


2. *Nuk ka asnjë të shenjtë si Zoti, sepse nuk ka asnjë tjetër veç teje, nuk ka asnjë shkëmb si Perëndia ynë.*

34. A mund të gjejë dikush një mënyrë për të shpëtuar veten nga ndëshkimi i Perëndisë për mëkatet e tij dhe ta bëjë veten të pranueshëm para Perëndisë? **Jo.**

35. Çfarë bënë izraelitët kur panë gjërat e mëdha që bëri Zoti? **Izraelitët besuan te Zoti.**

## Pyetje për diskutim

1. Pse Perëndia vendosi t'i shpëtonte izraelitët nga skllavëria?
  - a. Sepse Perëndia pa vuajtjet e tyre dhe dëgjoi thirrjet e tyre;
  - b. Sepse Perëndia i donte ata dhe planifikoi të zbulonte dashurinë dhe mëshirën e Tij ndaj tyre;
  - c. Sepse Perëndia i kishte premtuar Abrahamit që Ai do t'i bënte pasardhësit e Abrahamit një komb të madh dhe se, përmes këtyre pasardhësve, do të vinte Çlirimtari në botë.
2. Çfarë do të thotë emri i Perëndisë: "UNË JAM"? Do të thotë që Perëndia nuk ka nevojë për asgjë dhe për askënd. Ai ka qenë atje para fillimit të çdo gjëje. Ai është Krijuesi i çdo gjëje, gjithçka është nën pushtetin e Tij dhe Ai është tërësisht i pavarur nga të gjitha gjërat.
3. Pse plagët nuk ranë edhe mbi izraelitët?
  - a. Për shkak të dashurisë dhe hirit të Perëndisë;
  - b. Ngaqë Perëndia nuk i kishte harruar premtimet e Tij ndaj Abrahamit, Isakut dhe Jakobit që do t'i bënte pasardhësit e tyre një komb të madh dhe Ai do të ishte Perëndia i tyre;
  - c. Në mënyrë që mbreti i Egjiptit të kuptonte që Perëndia i Izraelit ishte Perëndia i vetëm i vërtetë e i gjallë në tërë tokën.
4. Çfarë u tha Perëndia izraelitëve për të bërë, në mënyrë që fëmijët e tyre të parëlindur të mos vdisnin?<sup>1</sup>
  - a. Ata duhet të zgjidhnin një qengj pa të meta;
  - b. Ata duhet ta vrisnin qengjin dhe ta mblidhnin gjakun e tij në një enë;
  - c. Ata duhet ta vendosnin gjakun te shtalkat dhe sipër derës;
  - d. Ata duhet të qëndronin brenda shtëpive ku kishin vendosur gjakun;
  - e. Ata nuk duhet të thyenin kockat e qengjit.
5. Pse e mbrojti Perëndia Izraelin?
  - a. Sepse Ai është i dashur dhe i mëshirshëm;
  - b. Sepse një prej pasardhësve të Izraelit do të ishte Çlirimtari i madh i mëkatarëve;
  - c. Për shkak të premtimeve të Tij ndaj Abrahamit, Isakut dhe Jakobit;
  - d. Sepse Ai do t'i jepte Izraelit Fjalën e Tij për t'ia dhënë botës.



# TruthSeekers

## **Rrënjët e besimit**

**Manuali i mësuesit**

### **Pjesa 4**

**Mësimet për ata që  
kanë munguar**



Tabela në faqen vijuese do të të ndihmojë të dish se cilat mësimet duhet të trajtohen, në varësi të javës, kur një fëmijë i ri fillon të marrë pjesë në klub. Meqë Kërkuesit e së Vërtetës ndërton një themel biblik, të vërtetat njëra pas tjetrës, është e rëndësishme që fëmija të arrijë mësimet kur ka munguar. Këto mësimet janë themelore në kuptimin e mesazhit të ungjillit. Duke përdorur Manualin e Mësuesit, e kemi bërë të thjeshtë që një drejtues t'i ndihmojë fëmijët për t'i arritur të tjerët shpejt dhe plotësisht.

Një drejtues duhet të japë mësimin për ata që mungojnë gjatë Kohës së Skuadrës apo në një kohë tjetër sipas zgjedhjes së tij, por jo gjatë Kohës së Këshillimit, në mënyrë që të mos lërë pas dore ndonjë mësim themelor. Një drejtues që i ka dhënë mësimet Kërkuesit e së Vërtetës në të shkuarën duhet të jetë i përgatitur t'i japë këto mësimet në çdo javë të caktuar. Disa fëmijë do të kërkojnë disa sesione përsëritjeje për të trajtuar mësimet kur kanë munguar.

Kujtohu të përdorësh Biblën kur jep këto mësimet. Nxiti studentët të cilët kanë Bibla që t'i marrin me vete në klasë. Tregoi atyre pjesët e Biblës dhe se si t'i përdorin (shembull: Pasqyra e lëndës, Dhiata e Vjetër, Dhiata e Re, kapitujt dhe numrat e vargjeve).

Duke ndjekur tabelën në faqen tjetër, thuaj drejtuesit të mësojë këto pika kryesore nga mësimet:

**Qëllimi:** Kjo është një pikë kyçe e të vërtetës që fëmijët duhet të kuptojnë. Sigurohu që ajo që jep nga mësimi t'i ndihmojë fëmijët ta kuptojnë këtë qëllim.

**Le të shikojmë në Bibël:** Shpjego domethënien e vargut bashkë me ndonjë fjalë të vështirë. Fëmijët duhet t'i mësojnë përmendësh vargjet e renditura në tabelën, në faqen tjetër.

**Mësimet nga Fjala e Perëndisë:** Përfshi sa më tepër mësimet të jetë e mundur. Javët që duhet të trajtohen disa mësimet, mund të përmbledhësh mësimin, por sigurohu që qëllimi i mësimet të jetë i qartë. Përdor pyetjet e përsëritjes të mësimetve 10 dhe 21 për t'u siguruar që fëmijët i kuptojnë pikat kryesore të mësimet. Pyetjet e mësimetve 10 dhe 21 që duhen përsëritur renditen në tabelë në javët e duhura.

**Figurat.** Përdori grafikët apo figurat vetëm nëse u korrespondojnë drejtpërdrejt pikave kyçe të mësimet.

Java	Mësimi 1 për ata që kanë munguar	Mësimi 2 për ata që kanë munguar	Mësimi 3 për ata që kanë munguar	Mësimi 4 për ata që kanë munguar	Mësimet 10 & 21 Pyetje për përsëritje
2	<b>Mësimi 1</b> Vargu 2: 2 Timoteut 3:16				Për Biblën: 1-5
3	<b>Mësimi 1&amp;2</b> Vargjet: 2 Timoteut 3:16; Psalmi 90:2				Për Biblën: 1-5 Për Perëndinë: 1-7
4	<b>Mësimi 1&amp;2</b> Vargjet: 2 Timoteut 3:16; Psalmi 90:2	<b>Mësimi 3</b> Vargu: Gjoni 1:3			Për Biblën: 1-5 Për Perëndinë: 1-7 Për engjëjt dhe Satanin: 1-6
5-8	<b>Mësimi 1&amp;2</b> Vargjet: 2 Timoteut 3:16; Psalmi 90:2	<b>Mësimi 3&amp;4</b> Vargjet: Gjoni 1:3; 1 Kronikave 29:11a			Për Biblën: 1-5 Për Perëndinë: 1-7 Për engjëjt dhe Satanin: 1-15
9-11	<b>Mësimi 1&amp;2</b> Vargjet: 2 Timoteut 3:16; Psalmi 90:2	<b>Mësimi 3&amp;4</b> Vargjet: Gjoni 1:3; 1 Kronikave 29:11a	<b>Mësimi 8</b> Vargu: Psalmi 24:1		Për Biblën: 1-5 Për Perëndinë: 1-7, 13-14 Për engjëjt dhe Satanin: 1-15
12	<b>Mësimi 1&amp;2</b> Vargjet: 2 Timoteut 3:16; Psalmi 90:2	<b>Mësimi 3&amp;4</b> Vargjet: Gjoni 1:3; 1 Kronikave 29:11a	<b>Mësimi 8&amp;11</b> Vargjet: Psalmi 24:1; Psalmi 119:160		Për Biblën: 1-5 Për Perëndinë: 1-7, 13-14 Për engjëjt dhe Satanin: 1-15 Për Adamin dhe Evën: 1-7
13	<b>Mësimi 1&amp;2</b> Vargjet: 2 Timoteut 3:16; Psalmi 90:2	<b>Mësimi 3&amp;4</b> Vargjet: Gjoni 1:3; 1 Kronikave 29:11a	<b>Mësimi 8&amp;11</b> Vargjet: Psalmi 24:1; Psalmi 119:160	<b>Mësimi 12</b> Vargu: Hebrejve 4:13	Për Biblën: 1-5 Për Perëndinë: 1-7, 13-14 Për engjëjt dhe Satanin: 1-15 Për Adamin dhe Evën: 1-13
14	<b>Mësimi 1&amp;2</b> Vargjet: 2 Timoteut 3:16; Psalmi 90:2	<b>Mësimi 3&amp;4</b> Vargjet: Gjoni 1:3; 1 Kronikave 29:11a	<b>Mësimi 8&amp;11</b> Vargjet: Psalmi 24:1; Psalmi 119:160	<b>Mësimi 12&amp;13</b> Vargjet: Hebrejve 4:13; Romakëve 5:12	Për Biblën: 1-5 Për Perëndinë: 1-7, 13-14 Për engjëjt dhe Satanin: 1-15 Për Adamin dhe Evën: 1-23
15	<b>Mësimi 1&amp;2</b> Vargjet: 2 Timoteut 3:16; Psalmi 90:2	<b>Mësimi 3&amp;4</b> Vargjet: Gjoni 1:3; 1 Kronikave 29:11a	<b>Mësimi 8&amp;11</b> Vargjet: Psalmi 24:1; Psalmi 119:160	<b>Mësimi 12-14</b> Vargjet: Hebrejve 4:13; Romakëve 5:12; Fjalët e Urta 14:12	Për Biblën: 1-5 Për Perëndinë: 1-7, 13-14 Për engjëjt dhe Satanin: 1-15 Për Adamin dhe Evën: 1-29

Nëse një fëmijë merr pjesë pas javës së 15 të klubit, mund të përsërisësh mësimet për ata që kanë munguar nga java e pesëmbëdhjetë, por fëmija duhet të marrë pjesë në Kohën e Mësimit Rrënjët e besimit, pjesa 1, kur të kthehen në klub vitin e ardhshëm.







1 East Bode Road  
Streamwood, Illinois 60107-6658 U.S.A.  
[www.awanainternational.org](http://www.awanainternational.org)